

“PËRGJEGJËSIA CIVILE E DËMIT NË MJEDIS”

Artan MANUSHAQE

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
(shkenca juridike), me profil (e drejtë civile), për marrjen e gradës shkencore
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. Dr. Endira BUSHATI

Numri i fjalëve: 59'340

Tiranë, tetor 2017

DEKLARATA E AUTORËSISË

Deklaroj se ky punim shkencor është produkt i punës time, si dhe të gjitha referencat dhe burimet janë të njohura rregullisht.

© E drejta e autorit: Artan MANUSHAQE, 2017

ABSTRAKT

Studimi ynë ka qasje optimiste dhe ka për qëllim analizimin, studimin, gjetjet, konkluzionet që lidhen me dëmin në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile ndaj mjedisit, duke u bazuar mbi të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare në mbrojtje të mjedisit, jetës, shëndetit dhe cilësisë së jetës. Studimi synon përmirësimin dhe optimizimin teorik dhe praktik të dëmit në mjedis dhe të së drejtës së mjedisit, për efikasitetin në drejtësi, në kontekstin e lirive dhe të drejtave të njeriut, gjithashtu përpiqet që të analizoj dhe të japë disa sugjerime dhe gjetje në aspektin e së drejtës materiale dhe procedurale për efikasitetin e të drejtës shqiptare në lidhje me dëmin në mjedis dhe dëmit në mjedis në të ardhmen, duke i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore, se si e garanton e drejta shqiptare dëmin në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.

Në studimin tonë janë përdorur metoda të kërkimit shkencor gjerësisht të njohura si: metoda analitike, krahasimore, interpretuese, empirike, doktrinare, metoda jurisprudenciale, ajo e deduksionit dhe induksionit, të integruara midis tyre.

Punimi është i ndarë në disa kapituj. Në kapitullin e parë bëhet një përmbledhje e përgjithshme e punimit për të gjitha elementet dhe strukturën. Kapitulli i dytë bën një analizë teorike të normativës mjedisore që lidhet me dëmin në mjedis si pjesë përgjegjëse juridiko-civile ndaj mjedisit. Historiku i të drejtës së mjedisit dhe dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile trajtohet në rrafshin ndërkombëtar dhe kombëtar në kapitullin e tretë. Në kapitullin e katërt, analiza trajton kuadrin e legjislacionit shqiptar në tërësinë e tij për fushën e legjilacionit mjedisor dhe dëmit në mjedis, për të vazhduar me kapitullin e pestë ku bëhet një analizë specifike e legjislacionit të dëmit në mjedis si pjesë e

përgjegjësisë juridiko-civile. Kapitulli i gjashtë paraqet një vështrim krahasues të së drejtës dhe jurisprudencës ndërkombëtare me atë vendase dhe se si trajtohet kjo përgjegjësi. Studimi mbyllet me kapitullin e shtatë dhe të fundit, me gjetjet se legjislacioni dhe e drejta jonë nuk e ka të mirëpërcaktuar dëmin në mjedis dhe në veçanti dëmit në mjedis në të ardhmen, pasi legjislacioni në këtë fushë është ende i pa pplotë, i paqartë dhe pa eksperiencën e duhur. Kësisoj, ajo nuk garanton një efikasitetit maksimal të përgjegjësisë juridiko-civile ndaj mjedisit, legjitimitit aktiv (ratio materia) në procesin civil për shpërblimin e dëmit, të mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe cilësisë së jetës, por edhe për të garantuar një mjedis të pastër të shëndetshëm për të tashmen dhe brezat e ardhshme si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm.

ABSTRACT

Our study has an optimistic approach and aims at analyzing, studying, finding, environmental-related conclusions as part of civil law enforcement on the environment, based on domestic and international law in the protection of the environment, life, health and quality of life. The study aims at the theoretical and practical improvement and optimization of environmental and environmental damage, for efficiency in justice, in the context of human rights and freedoms. The study tries to analyze and provide some suggestions and findings in terms of material and procedural law on the effectiveness of Albanian law regarding environmental damage and environmental damage in the future, by answering the research question on how to guarantees the Albanian right to damage to the

environment as part of legal-civil liability. In our study, widely used research methods are used: analytical, comparative, interpretative, empirical, doctrinal, jurisprudential, deduction and induction methods, integrated between them. The paper is divided into chapters. In the first chapter, a general summary of the work for all the elements and structure is made. The second chapter makes a theoretical analysis of environmental norms related to environmental damage as a responsible part of civil law on the environment. The history of environmental law and environmental damage as part of civil law responsibility is dealt with internationally and nationally in the third chapter. In the fourth chapter, the analysis addresses the framework of Albanian legislation in its entirety for the field of environmental legislation and environmental damage, to continue with the fifth chapter where a specific analysis of environmental damage legislation is included as part of jurisdictional civil liability. The sixth chapter presents a comparative overview of international law and jurisprudence with domestic law and how this responsibility is addressed. The study concludes with the seventh and last chapter, with the findings that our legislation and our rights are not well-defined in environmental damage and in particular environmental damage in the future, as the legislation in this area is still incomplete, unclear and without proper experience. Thus, it does not guarantee the maximum efficiency of civil-legal liability to the environment, the active substance in the civil process for the compensation of damage, the protection of life, health and quality of life, but also to guarantee a clean environment healthy for the present and future generations as part of sustainable development

DEDIKIMI

Ky punim në radhë të parë iu dedikohet të gjithë atyre që kanë humbur jetën nga kanceri i shkaktuar si pasojat e ndotjes dhe dëmit në mjedis, si dhe të gjithë atyre personave që vuajnë pasojat e dëmeve dhe ndotjes mjedisore.

Si dedikim ndaj tyre, do të vazhdoj me pasion dhe përkushtim që fushën e së drejtës së dëmit në mjedis dhe përgjegjësisë juridiko-civile ta sistematizojmë, ta zgjerojmë dhe përsosim më tej, duke mbrojtur më shumë, më mirë dhe më me efikasitet të drejtat dhe liritë civile, si dhe jetën dhe shëndetin e çdonjërit prej nesh, duke e trajtuar mjedisin si një të mirë publike e cila na mbron të gjithëve dhe na mbanë gjallë jo vetëm si qenie fizike, por edhe si qenie sociale e në harmoni me rregullat e natyrës.

Ky punim është kontribut dhe detyrim ndaj Shqipërisë dhe shoqërisë.

Faleminderit!

FALENDËRIME

Ky punim nuk mund të realizohej pa mbështetjen ndër vite të pedagogëve dhe Universitetit European të Tiranës, si dhe pedagogëve të tjerë në veçanti të së drejtës në Shqipëri, të cilët kanë kontributin e tyre të pazevendësueshëm me motivimin dhe dijet që ata më kanë dhënë ndër vite; dije të cilat jam përpjekur t'i reflektoj në këtë punim. Një falënderim i singertë shkon për ata.

Falënderim i veçantë shkon për udhëheqësen shkencore, pedagogen Endira BUSHATI, një person mjaft miqësor, profesionist dhe bashkëpunues.

Falënderoj gjithashtu edhe familjen time, e cila më ka përkrahur në çdo moment, edhe jashtë mundësive të tyre, si dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në këtë punim, duke ju premtuar drejtësi, dinjitet, dhe se nuk do të lodhem asnjëherë që ajri, uji, toka, mjedisi në Shqipëri e më gjerë, të jetë i pastër, i pandotur dhe jetësor për çdo njeri ashtu siç i ka hije vendit të Shqiptonjave.

Artan MANUSHAQE

Tiranë, 2017

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATA E AUTORËSISË.....	2
ABSTRAKT.....	3
ABSTRACT.....	4
DEDIKIMI.....	6
FALENDËRIME.....	7
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT.....	11
KAPITULLI I-STRUKTURA E TEMES.....	1
1.1 Hyrje.....	1
1.2 Shtrim i Problemit.....	2
1.3 Qëllimi i Studimit.....	4
1.4 Burimet e Referimit.....	5
1.5 Pyetja Kërkimore dhe Hipoteza.....	6
1.6 Mundësitë dhe Kufizimet.....	7
1.7 Rëndësia e Studimit.....	9
KAPITULLI II-ASPEKTI TEORIK I TË DREJTËS SË MJEDISIT.....	11
2.1 Hyrje.....	11
2.2 E drejta e mjedisit globalzimi i normës dhe përgjegjësia juridiko-civile ndaj mjedisit.....	12
2.3 Dëmi në mjedis dhe e drejta e mjedisit si pjesë e lirive dhe të drejtave të njeriut.....	17
2.4 Zhvillimi i të drejtave procedurale në kontekstin mjedisor, të dëmit material dhe jo material në mjedis.....	25
2.5 E drejta e mjedisit në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe dëmi në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.....	30
2.6 Doktrina e Realizimit Juridik dhe ndikimi në fushën e mjedisit dhe dëmit në mjedis.....	33
2.6.1 Procesi i ri i sistematizimit të kulturës juridike ose Konstitucionalizmit.....	34
2.7 Normativa Kushtetuese dhe ligjore e dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.....	36
2.8 Prespektiva dhe një qëndrimi doktrinare në fushën e dëmit në mjedis, lirive dhe të drejtave të njeriut që kanë lidhje me të.....	39
2.9 Metodologjia dhe Metoda e Studimit.....	43
KAPITULLI III-HISTORIKU I TË DREJTËS MJEDISORE DHE DËMIT NË MJEDIS SI PËRGJEGJËSIS JURIDIKO CIVILE.....	45

3.1 Hyrje.....	45
3.2 Vështrim historik për të drejtën e Mjedisit	46
3.3 E drejta e mjedisi në shek. XVII-XVIII dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis	47
3.3.1 Anglia	47
3.3.2 Kodi i Napoleonit (KN) dhe ndikimi në të drejtën e mjedisit dhe dëmi në mjedis si pjesë e përgjegjësive juridiko-civile	49
3.4 E Drejta e Mjedisit dhe dëmi në mjedis në shekullin e XX.....	50
3.4.1 Historiku i së drejtës së mjedisit, Karta Universale e të Drejtave të Njeriut, OKB dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.....	53
3.4.3 Historiku i së drejtës së Mjedisit dhe dëmit në mjedis si pjesë e lirive civile në të Drejtën Europiane, KEDNJ dhe GJEDNJ.....	57
3.5 Hitoriku i dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësive juridiko-civile në Shqipëri.....	60
3.5.1 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis sipas Kanunit të Lek Dukagjinit (KLD)	60
3.5.2 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis sipas Statutit të Shkodrës.....	61
3.5.3 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis sipas Kanunit të Labërisë.....	62
3.5.4 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis mbas Shpalljes së Pavarësisë, si dhe periudha e monarkisë.....	64
3.5.5 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis midis viteve 1945-1990	66
3.5.6 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis mbas viteve 1990, si dhe anëtarësimi i Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe mjedisore.....	70
3.5.7 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia mjedisore. Marrëveshja e Asocim Stabilizimit (MSA) dhe legjislacioni Aquis Comunautaire (AC).....	72
KAPITULLI IV-MBROJTJA E MJEDISIT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR.....	76
4.1 Hyrje.....	76
4.2. Normativa Kushtetuese	76
4.3 Legjislacioni kuadër mjedisor që përcakton kriteret e përgjithëshme të dëmit në mjedis, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.....	83
4.4 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis-LVNM	92
4.5. Legjislacioni Sektorial Mjedisor.....	94
4.6 Legjislacioni Penal Mjedisor dhe dëmi në mjedis	95
KAPITULLI V-DËMI NË MJEDIS SI PJESË E PËRGJEGJËSISË JURIDIKO CIVILE.	98
5.1 Hyrje.....	98

5.2. Interesi i ligjshëm, legjitimimi ratione materiae dhe dëmit në mjedis, si pjesë e efikasiteti në drejtësi.....	99
5.2.1 Faji në Kodin Civil.....	101
5.2.2 Lidhja shkakësore.....	106
5.2.3 Teoria e kushteve jo te drejtpërdrejta (adekuat/të përshtatshëm) për dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.....	111
5.2.4 Teoria e lidhjes shkakësore të drejtpërdrejtë.....	112
5.2.5 Paligjshmëria e Veprimit.....	114
5.2.6 Dëmi (në mjedis).....	116
5.2.7 Dëmi jashtëkontraktor (mjedisor).....	118
5.2.8 Teoria e Riskut me rastin e shkaktimit të dëmit nga sendet e rrezikshme.....	118
5.2.9 Dëmi i Sigurtë (në mjedis).....	119
5.3 Padia (Ius Civile).....	121
5.3.1 Iniciativa e palës në proces, një detyrim por edhe një e drejtë (parimi disponibilitetit).....	122
5.3.2 Sigurimi i Padisë (për dëmin mjedisor).....	125
5.3.3 Legjitimiteti (ratione materiae).....	129
5.3.4 Roli i Konventës së Aarhusit dhe i legjislacionit shqiptar.....	135
5.3.5 Neni 9 i Konventës së Aarhusit.....	137
5.4 Aksesi në drejtësi sipas Konventës së Aarhusit.....	138
5.5 Kodi i Porcedurës Civile e drejta për t’u legjitmuar (dëmi në mjedis).....	142
5.6 Legjitimi i Organizatat jo fitimprurëse.....	144
5.7 Raste nga jurisprudenca shqiptare për çështjet e dëmeve në mjedis.....	148
5.7.1 Rasti i Gjirit të Vlorës 2005.....	148
5.7.2 Rasti i Liqeni Artificial Tiranë “ndërtimet nën digë” 2014-2015.....	150
5.7.3 Rasti i ndërtimit të “këndit të lojrave për fëmijë” të Parku i Liqenit Artificial Tiranë 2016.....	152
5.7.4 Çështja e importit të mbetjeve dhe Ligj për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2016.....	155
KAPITULLI VI-VËSHTRIM KRAHASIMOR.....	157
6.1 Hyrje.....	157
6.2 Çfarë parashikojnë normativat e vendeve Europiane për mbrojtjen e mjedisit.....	158
6.2.1 Përgjegjësia Juridiko-Civile e dëmit në mjedis në BE, Itali.....	158
6.2.2 Kushtetua Franzece (Carta Dell’Ambiente).....	164
Kushtetuta Franceze.....	164

6.3 “Kodi Mjedisor” si nevojë për rritjen e efikasitetit të përcaktimit të dëmit në mjedis	166
6.4. Raste nga jurisprudenca ndërkombëtare të dëmit në mjedis.....	169
6.4.1 Rasti Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar. (Dëmi në mjedis nga zhurmat).....	169
6.4.2 Rasti Lopez Ostra kundër Spanjës. (Mungesa e infomimit, dhe pjesëmarrja në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka shkaktuar dëm në mjedis)	171
6.4.3 Në rastin Roche kundër Britanisë. (Mungesa e infomimit, dhe pjesëmarrja në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka shkaktuar dëm në mjedis)	172
6.4.4 Rasti Oneryldyz kundër Turqisë. (Mungesa e Infomimit për Mjedisin ka shkaktuar dëm në mjedis, duke cënuar jetën dhe shëndetin e personave si dhe të drejtën për të gëzuar një jetë familjare dhe të qetë).....	174
6.4.5. Rasti Fadeyeva kundër Ruisë. (Mungesa e infomimit dhe pjesëmarrja në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka dëmtuar shëndetin e personave)	175
KAPITULLI VII-KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....	177
Konkluzione:	177
Rekomandime:.....	182
BURIME / BIBLIOGRAFIA	196

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

Shkurtime dhe akronime

LMM	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP, General Domestic Product)
KLD	Kanuni i Lek Dukagjinit
STSH	Statuti i Shkodrës
KL	Kanuni i Labërisë
KC	Kodi Civil
KN	Kodi i Napoleonit
KP	Kodi Penal
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
KE	Këshilli i Evropës
BE	Bashkimi Evropian
KRSH	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

GJK	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
GJL	Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë
KI	Kushtetuta Italiane
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
GJKI	Gjykata Kushtetuese Italiane
GJKsI	Gjykata e Kasacionit Italiane (ekuivalent i Gjykatës së Lartë)
RSH	Republika e Shqipërisë
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
GJED	Gjykata Europiane e Drejtësisë
PJC	Përgjegjësia Juridiko-Civile

Fjalor terminologjik

Mjedis

Tërësia e kushteve natyrore në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, shfaqet një dukuri etj.: hapësira dhe gjithçka rreth e rrotull; ambienti. Mjedis i rrethues (gjeografik, i jashtëm). Mjedis përcjellës (veçues) elektrik. Kushtet

shoqërore e jetësore, në të cilat rron e vepron njeriu; grup njerëzish me kushte të përbashkëta, në gji të të cilave rron a punon dikush; ambient. (Fjalori shqip-shqip)¹

E Drejtë e mjedisit

Tërësia e normave juridike, zakonore, e cila rregullon veprimtarinë në këtë fushë dhe veprimtarinë e saj me fusha të tjera të së drejtës.

Përgjegjësia për Mjedisin (detyrimet që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit)

Personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar².

Dëmtim i mjedisit

Është dëmi i kryer ndaj mjedisit apo humbja e funksionit natyror të pjesëve përbërëse të mjedisit, shkaktuar nga humbja e ndonjë prej përbërësve të tij, nga ndërhyrjet, nga njeriu, ndaj lidhjeve të përbërësve të mjedisit dhe/ose rrjedhës natyrore të zhvillimit të tyre.³

Padia (Mjedisore)

Padia është e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo, mbi çështje që lidhen me

¹ Fjalori Shqip-Shqip, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, fq. 796

² Kodi Civil neni 424

³ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 5 pika 3

dëmin mjedisor. Pala kundërshtare ka të drejtë të diskutojë dhe të ngrejë prapësime mbi themelin dhe bazueshmërinë në ligje të këtij pretendimi.⁴

Padia Mjedisore, në kuptimin e ngushtë, nënkupton pretendimit për dëmet që shkaktohen në mjedis, Padia Mjedisore ose për çështjet mjedisore, në kuptimin e gjerë, përfshin jo vetëm pretendimet për dëmet në mjedis, por edhe ato pretendime për dëme që i shkaktohen apo mund t'i shkaktohen individit direkt ose indirekt nëpërmjet dëmtimit të mjedisit.

E Drejta për Padi

- Në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjes dhe dëmtimit të tij, qytetari, publiku dhe organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë:

a) t'u kërkojnë organeve shtetërore përkatëse marrjen e masave të duhura brenda afateve dhe në përputhje me autoritetin që u jep ligji;

b) të ngrenë padi në gjykatë, në kushtet e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile, kundër organit publik ose personit fizik e juridik që ka sjellë dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë.⁵

Cilësi e Mjedisit

Është gjendja e mjedisit apo e një përbërësi të tij në një kohë të caktuar, e shprehur nëpërmjet treguesve fizikë, kimikë, biologjikë, estetikë apo të tjerë.⁶

Ndotje

⁴ Kodi i Procedurës Civile, neni 31

⁵ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit neni 48

⁶ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 5 pika 2

Futja e drejtpërdrejtë ose jo, si rezultat i veprimtarisë së njeriut, e substancave, dridhjeve, rrezatimit, erërave të pakëndshme, nxehtësisë apo zhurmës në ajër, ujë apo tokë, në atë masë që mund të jetë e dëmshme për cilësinë e mjedisit ose shëndetin e njeriut, që mund të çojë në dëmtimin e pronës materiale apo të përkeqësojë dhe të ndërhyjë në shërbimet e përdorimet e tjera të ligjshme të mjedisit.⁷

Subjekt Ndotës

Çdo person, fizik apo juridik, veprimtaria e drejtpërdrejtë ose jo e drejtpërdrejtë e të cilit shkakton ndotjen e mjedisit⁸.

Rrjedhje Minimale Ekologjike

Regjimi i rrjedhjes në një trup ujor sipërfaqësor, shtrat lumor, basen ujor apo zonë bregdetare, e nevojshme për të ruajtur një qëndrueshmëri të ekosistemit natyror dhe përfitimeve të tyre.⁹

Parimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të tyre, nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë

⁷ Po aty, neni 5 pika 10

⁸ Po aty, neni 5 pika 15

⁹ Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, neni 4 pika 46

mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.¹⁰

Parimi Ndotësi Pagan

Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar.¹¹

Parimi i Qasjes së Integruar:

1. Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit në tërësinë e tij.

2. Autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cenueshmërinë e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përsëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.¹²

Parimi i Ruajtjes së Burimeve Natyrore:

¹⁰ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 6

¹¹ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 12

¹² Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 10

1. Mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore dhe të materialeve të përfuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve.
2. Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve e projekteve, brenda kompetencave të tyre, nxitin marrjen e masave dhe kryerjen e veprimtarive për mbrojtjen e burimeve natyrore¹³

Parimi i Përgjegjësisë së Ndërsjellë dhe Bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të Strategjisë për Mbrojtjen e Mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.
2. Republika e Shqipërisë siguron bashkëpunimin dhe solidaritetin për zgjidhjen e problemeve mjedisore globale dhe ndërqeveritare përmes marrëveshjeve ndërkombëtare e shkëmbimit të informacionit mjedisor.
3. Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre, sigurojnë mënyrën dhe kushtet e bashkëpunimit me personat fizikë dhe juridikë, privatë, me qëllim arritjen e objektivave për mbrojtjen e integruar të mjedisit.¹⁴

Rrezik Ndaj Mjedisit:

¹³ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 8

¹⁴ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 11

Është mundësia që paraqet një veprimtari njerëzore për të shkaktuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, dëmtimin e mjedisit apo për të vënë në rrezik jetën dhe shëndetin e njeriut.¹⁵

¹⁵ Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 5 pika 13

KAPITULLI I-STRUKTURA E TEMES

1.1 Hyrje

Ky punim përpiqet të paraqesë dhe analizojë, si dhe të japë disa përgjigje në lidhje me efikasitetin në drejtësi të përgjegjësive juridiko-civile lidhur me dëmin në mjedis. Në këtë hulumtim janë përdorur qasje dhe teori të ndryshme, por kryesisht ajo fokusohet tek elemente si, dëmi në mjedis në të ardhmen i cili trajtohet nga dy teori, ajo e shkaqeve jo të drejtpërdrejta, dhe e shkaqeve të drejtpërdrejta. Legjitimimi i palëve, përcaktimi i dëmit dhe dëmit në mjedis në të ardhmen, interesi i ligjshëm për t'u legjitimuar vijnë si raste nga praktika e jurisprudencës shqiptare dhe ndërkombëtare. Kazualiteti adekuat (shkaqet jo të drejtpërdrejta) lidhet me një tërësi rrethanash për të përcaktuar dëmin në të ardhmen apo dëmin e shkaktuar në mjedis, përcaktim nga i cili del përgjegjësia juridike për dëmin e shkaktuar në mjedis. Kryesisht kauzaliteti (shkaku) i drejtpërdrejta e lidh dëmin në të ardhmen me një dëm të ndodhur më parë me të cilin ka një lidhje, e cila do të mundësonte nxjerrjen sa më të qartë të figurës së përgjegjësive juridiko-civile, për rrjedhojë edhe legjitimimin e palëve në procesin civil për dëmin në mjedis.

Në kuptimin e realizimit juridik¹⁶, normat mjedisore kanë nevojë të trajtohen në normat juridike më të larta të vendit për të krijuar një substrat për akte të tjera juridike me hierarki më të ulët, të cilat do të rrisin garancitë për një efikasitet më të madh, në rastin tonë për përgjegjësinë juridiko-civile që buron nga dëmi mjedisor. Punimi përpiqet që të japë një pamje të efikasitetit të legjislacionit shqiptar në lidhje me dëmin në mjedis si pjesë e

¹⁶ Realizimi Juridik është një proces i përshtatjes dhe balancimit të normës juridike në hapësirë dhe në kohë, duke filluar që nga parimet Kushtetuese. Përfaqësuesi me klasik i shekullit të 20 i procesit të sistematizimit të kësaj norme është Ronald Dworkin (e trajtuar më poshtë).

përgjegjësisë juridiko-civile, si në aspektin teorik ashtu dhe praktik, edhe pse e drejta procesuale e mjedisit por edhe ajo materiale është një e drejtë e re dhe ende e panjohur mirë dhe e zhvilluar jo vetëm në Shqipëri si doktrinë e plotë, por edhe në Europë e në nivel ndërkombëtar si pjesë dhe sfidë e proceseve globalizuese.

1.2 Shtrim i Problemit

Dëmi në mjedis si përgjegjësi juridiko-civile në të drejtën tonë trajtohet kryesisht në kuptimin objektiv, pra duhet të ketë ndodhur një dëm në mjedis i cili të ketë shkaktuar një dëm ndaj personit që të mund të kemi legjitimim aktiv për palët nga e cila të mund të plotësohen figurat e përgjegjësisë juridiko-civile për procesin civil. Çështjet e dëmit në mjedis kushtëzohen nga shumë faktorë. Në shumë vende të Europës dhe jashtë, mbrotja e mjedisit ngrihet në nivelin e një norme themelore që lidhet drejtpërdrejt me të drejtat e individit, si ajo e shëndetit e jetës, e jetës private, e pronës etj., e cila rrit efikasitetin e përcaktimit të figurës së përgjegjësisë juridike të dëmit në mjedis. Edhe pse Direktivat e BE-së nuk kanë një përcaktim specifik dhe të unifikuar për dëmin në mjedis, dhe dëmin në mjedis në të ardhme edhe si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile, praktika dhe jurisprudenca kanë ecur me hapa të shpejtë në këto vende. Shtete të veçanta, duke u bazuar tek këto rregullore, e kanë zhvilluar jurisprudencë në këtë fushë gjatë 15 viteve të fundit. Nëse efekti serë në botë nga emetimi i karbonit nga industritë e mëdha, shkarkon rreth 30-40% karbon më shumë se norma e lejuar, dhe kjo ndotje mjedisore nuk ka efekt të menjëhershëm në shëndetin tonë por vjen në mënyrë graduale të heshtur, ne nuk kemi shumë mundësi të legjitimohemi, pasi dëmi nuk është shfaqur dukshëm (kushti objektiv),

ndërkohë që dëmet në mjedis janë të ndryshme dhe përfshijnë shumë institute, janë të mëdha të heshtura dhe shpesh herë me kosto të mëdha dhe të parikuperueshme si për mjedisin, ashtu edhe për njeriun. Ky është një nga problemet më të mëdha, në kuptimin objektiv të së drejtës sonë: nëse dëmi nuk shfaqet, nuk kemi dëm; nëse nuk ka shkak të drejtpërdrejtë, nuk kemi dëm në mjedis por bëhet edhe më e vështirë për t'u vërtetuar dëmi në shëndetin e njeriut. Vetë termi mjedis në analizën e të së cilit del edhe dëmi mjedisor, nuk ka sot një përcaktim unik në botë. Kryesisht legjislacioni, teoria por edhe praktika jonë njeh dëmin real (kushtin objektiv dhe shkakun e drejtpërdrejtë) të shkaktuar në mjedis, i cili ka ndodhur, por rruga burokratike dhe ligjore për të provuar lidhjen shkakësore midis dëmit të ndodhur në mjedis dhe dëmtimit të shëndetit është një hallkë tjetër e problemit që ndeshet në sistemin tonë normativ nga e cila nuk del qartë përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis, për pasojë edhe legjitimimi aktiv (ratio materia) i palëve në procesin gjyqësor është pothuajse i pamundur, dhe si rezultat çënohet parimi i efikasitetit në drejtësi, ku aplikimi i parimit të ndalimit dhe i parandalimit të dëmeve në mjedis në pronën private bëhet i vështirë, për të mos folur për impaktin negativ në jetën, shëndetin dhe cilësinë e jetës së individit. Mungesa e një legjislacioni të plotë të posaçëm të dëmit në mjedis vjen edhe nga paqartësia e normës materiale, procedurale, praktika e munguar, si dhe moszhvillimi i kësaj doktrine. Shqipëria në këtë fushë është në një emergjencë mjedisore, pasi një fushë e parregulluar dhe e paspecifikuar mirë krijon hapësira të cilat shfrytëzohen për përfitime të caktuara, duke shfrytëzuar në mënyrë barbare burimet natyrore, duke dëmtuar dhe ndotur mjedisin; në thelb, dëme që i kemi shkaktuar vetes sonë, me kosto të lartë për jetën, shëndetin dhe cilësinë e jetës, si dhe duke mos garantuar në mënyrë të efikase dhe të qartë përgjegjësinë juridiko-civile të palëve në proces. Plotësimi, qartësimi,

interpretimi i elementeve procedurale dhe material në fushën e së të drejtës së mjedisit - dëmi në mjedis/ dëmi në mjedis në të ardhme si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile apo i fushave që kanë lidhje me të, nga pikëpamja teorike dhe praktike do të ndikonin në rritjen e efikasitetit në drejtësi për çështjet mjedisore në radhë të parë në procesin civil të dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.

1.3 Qëllimi i Studimit

Qëllimi dhe objektivat kryesore të këtij studimi janë, të evidentojë, analizojë, të dalë me gjetje dhe të rekomandojë zgjidhje për të drejtën shqiptare me theks dëmin në mjedis si pjesë të përgjegjësisë juridiko-civile, si dhe të ndikojë në fushën e normativës së mjedisit për ta plotësuar, qartësuar, harmonizuar sa më mirë atë edhe duke e bërë më efikas parimin për një proces të rregullt dhe ligjor. Dëmi në mjedis analizohet përgjithësisht në një kuptim të përgjithshëm.

Ky studim nuk është veçse një përpjekje për të pasuruar dijet tona, por mbi të gjitha është kontribut në fushën e dëmit në mjedis dhe të drejtën e mjedisit, e cila në vendin tonë është ende e patrajtuar mirë si në aspektin teorik por edhe praktik, arsye të cilat bëhen shkak për shmangie nga ligji dhe e drejta, duke mundësuar shfrytëzimin barbar të burimeve natyrore, keqpërdorimin dhe ndotjen e mjedisit ku ne jetojmë, shkaqe të cilat burokratikisht çojnë në shmangien dhe mosidentifikimin e përgjegjësisë juridiko-civile të dëmit në mjedis. Mbrojta e Mjedisit është një qëllim tjetër, mjedisi është *res communis omnium*, pra është e imja, e jotja, dhe e atyre që do të vijnë pas nesh, prandaj duhet mbrojtur me fanatizëm.

Qëllim tjetër i studimit është mbrojtja e shëndetit, e cilësisë së jetës së individit dhe interesit publik nëpërmjet përmirësimit të rregullit dhe marrëdhënies shoqërore, rregullime të cilat do të ndikonin pozitivisht për uljen e vdekjeve nga kanceri dhe sëmundjeve të tjera që shkaktohen si pasojë e ndotjes dhe dëmit në mjedis, ku Shqipëria renditet ndër vendet e para në Evropë¹⁷ dhe botë përse i përket vdekshmërisë nga ndotja e ajrit, por edhe nga ndotjet e tjera mjedisore; dhe kjo gjë nuk duhet lejuar. Një ndër qëllimet e këtij punimi është edhe Integrimi i legjislacionit shqiptar me atë Evropian dhe ndërkombëtar.

Mbrojtja dhe përgjegjësia ndaj mjedisit është detyrim për çdo qytetar.

1.4 Burimet e Referimit

Kryesisht burimet e referimit kanë qenë të ndryshme, duke filluar që nga legjislacioni shqiptar, ai komunitar dhe ndërkombëtar; jurisprudenca vendase dhe ndërkombëtare, si dhe doktrinat e ndryshme. Rol të veçantë si pjesë e burimeve në këtë punim mbart e drejta italiane.

Burime të referimit kanë qenë edhe eksperiencia personale për çështje të ndryshme brenda edhe jashtë vendit, si padi mjedisore në gjykatë për dëmin mjedisor, punime shkencore në BE, punime shkencore në Shqipëri. Autorë të ndryshëm të së drejtës dhe doktrinat ndërkombëtare kanë qenë pjesë e burimeve referuese, institucionet publike dhe private kanë qenë pjesë e burimeve. Biblioteka UET, media online dhe burimet e internetit gjithashtu më kanë ndihmuar në këtë studim si referenca të rëndësishme; emisione, debate të ndryshme në nivel teknik. Konsulta dhe biseda me pedagogë, kryesisht të së drejtës, nga universitete të

¹⁷ Sipas të dhënave të OBSH, Shqipëria është e treta në Europë për nga vdekshmëria nga ndotja e ajrit, pas Bosnjës dhe Bullgaisë. Shqipëria regjistroi me 166.1 vdekje për 100 mijë banorë. Revista Monitor 20. 05. 2017, <http://www.monitor.al/shqiperia-bullgaria-dhe-bosnja-vdjekjet-te-larta-ne-europe-nga-ndotja-e-ajrit/>

ndryshme shqiptare më kanë ndihmuar shumë në orinetimin e burimeve të referimit apo edhe vetë ata si burime direkte shumë të vlefshme për këtë studim.

1.5 Pyetja Kërkimore dhe Hipoteza

Më poshtë janë shtruar pyetjet kërkimore dhe hipotezat të cilat udhëheqin punimin doktoral, pyetjet kërkimore dhe hipoteza janë formuluar dhe përcaktuar në mënyrë të tillë që në substancë të reflektojnë dëmin në mjedis si pjesë të përgjegjësisë juridike dhe të palëve si pjesë e procesit civil dhe aspekteve të tjera që lidhen me të, duke sugjeruar edhe gjetjet e këtij studimi.

- Si e garanton e drejta shqiptare dëmin në mjedis si pjesë të përgjegjësisë juridiko-civile?
- A garanton e drejta shqiptare dëmin në mjedis në të ardhmen për efekt të përmbushjes së kriterit të interesit të ligjshëm si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile?
- A është në përputhje kuadri normativ shqiptar me aktet ndërkombëtare që lidhen me përgjegjësinë juridiko-civile ndaj mjedisit?
- A është efikas aksesimi në drejtësi, kur flasim për përgjegjësi juridiko-civile ndaj mjedisit (dëmit në mjedis) dhe mbrojtjen e mjedisit?

Hipoteza: Mungesa e përcaktimit të qartë dhe saktë të dëmit në mjedis dhe dëmit në mjedis në të ardhmen, nuk gjen një garantim efikas, duke ndikuar në paqartësinë e përgjegjësisë

juridiko-civile të palëve dhe legjitimitit në procesin civil për çështjet mjedisore dhe shpërblimin e palës së dëmtuar, gjithashtu nuk garantohet një mbrojtje efikase e mjedisit.

1.6 Mundësitë dhe Kufizimet

Mundësitë për të realizuar këtë punim kanë qenë relativisht të kufizuara për disa faktorë.

Çështje të tilla që lidhen me trajtimin e dëmit në mjedis në të ardhmen ose i heshtur si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile dhe legjitimitit të palëve në procesin civil dhe jo vetëm, janë në embrionet e veta për mënyrën e trajtimit dhe nga pikëpamja teorike dhe praktike ende nuk janë zhvilluar për shkakun se shoqëria dhe doktrina është në evolucion e sipër në këtë fushë.

Fusha e së drejtës mjedisore është një e drejtë e re jo vetëm në Shqipëri por edhe në kontinentin në rrafshin ndërkombëtarë, vetë dëmi mjedisor është një nënfushë edhe më e re. Ajo ka rreth dyzet vjet që ka filluar të trajtohet duke filluar nga vendet më të zhvilluara dhe të industrializuara. Fusha e të drejtës dhe lirive mjedisore si pjesë e gjeneratës së tretë, ka lidhje të pandashme me fushën e lirive ekonomie, politike, sociale, edhe si pjesë e parimit për një zhvillimit të qëndrueshëm. Ky punim kufizohet dhe përpiqet të trajtojë dëmin në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile nga ku buron edhe legjitimiteti i procesit civil. Dëmi në mjedis dhe dëmi në të ardhmen në kontekstin e së drejtës shqiptare dhe ndërkombëtare në këtë punim trajtohet kryesisht si dëm klasik ndaj pronës, si keqshfrytëzim i burimeve natyrore dhe pasojave që ato shkaktojnë duke ndotuar ajrin, ujin edhe tokën... Punimi kufizohet dhe përpiqet të trajtojë pjesëmarrjen dhe vendimmarrjen e publikut në proceset e projekteve apo veprimtarive mjedisore, si elemente që lidhen edhe

me përgjegjësinë juridiko-civile dhe legjitimimin në proces ndaj shkakimit të dëmit në mjedis-dëmit në mjedis në të ardhme, si pjesë e kriterëve përcaktues të dëmit në mjedis nga e cila del edhe përgjegjësia ndaj mjedisit. Kjo temë vazhdon rrugëtimin e punimit tim të mëparshëm në MSH, të temës së diplomës (UET) me temë “Ngritja e Padisë Mjedisore”. Disiplina e së drejtës, kushtetese, administrative, civile, penale janë pjesë e pandashme dhe e lidhur në këtë proces studimi të së drejtës private dhe dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile. Pa kuptuar mjedisin si tërësi normative, nuk mund të kuptojmë dëmin në mjedis si koncept për ta zhvilluar brenda fushës civile dhe figurës së përgjegjësisë juridiko-civile.

Kufizim ka përbërë edhe mungesa e literaturës bazë në Shqipëri por edhe jashtë saj, e cila ka qenë dhe mbetet një problem në fushën e legjislacionit dhe të së drejtës mjedisore në veçanti për përgjegjësinë juridiko-civile dhe dëm në mjedis. Doktrina dhe jurisprudenca në këtë fushë në Shqipëri, pothuajse është e pazhvilluar, aspekt i cili më krijon shumë vështirësi në studimin e kësaj fushe. Aspekti financiar ka qenë një pengesë tjetër pasi ato pak literatura që gjenden edhe në bibliotekat ndërkombëtare janë tepër të shtrenjta madje ndonjëherë të papërbalueshme dhe mundësit e mia financiare janë të kufizuara. Pavarësisht këtyre pengesave, nuk jam dekurajuar, por përkundrazi, kam punuar më fort për të arritur objektivat dhe qëllimet e këtij studimi, i cili mendoj se është nga punimet e para në Shqipëri që përpiqet të trajtojë këtë fushë të së drejtës në aspektin jo vetëm procesual të së drejtës private dhe këndvështrimi i lirive dhe të drejtave të individit, por edhe doktrinare të së drejtës. Studimi i dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë civile mjedisore, në këtë

punim, përpiqet që të eci bashkarisht dhe në kohë më studimet e tjera ndërkombëtarë në këtë fushë.

1.7 Rëndësia e Studimit

Siç e kemi përmendur edhe më sipër, mjedisi është një fushë e re e së drejtës e rëndësishme për shëndetin e njeriut. Përgjegjësia juridiko-civile ndaj mjedisit vjen si një mjet i domosdoshëm procesual për t'u mbrojtur nga ndotësit dhe shkaktarët e dëmit, por edhe si instrument parandalues për dëmtimin e mjedisit si pjesë e të drejtave civile. Ndryshimet që po pëson klima dhe shoqëria po ndikojnë në rritjen e sëmundjeve tumorale, në shëndetin dhe cilësinë e jetës së individit. Faktorët që ndikojnë në këto ndryshime nuk janë vetëm natyrore por edhe njerëzore. Duke filluar që nga vitet shtatëdhjetë e më pas, mjedisi dhe PJC ndaj mjedisit ka filluar të jetë pjesë e rëndësishme e marrëdhënies shoqërore dhe ndër-institucionale, për këto arsye janë krijuar shumë konventa, traktate dhe akte të tjera juridike ndërkombëtare dhe rajonale të cilat në thelbin e vet kanë mbrojtjen e mjedisit dhe garantimin e standardit të zhvillimit të qëndrueshëm (shoqëri-ekonomi-mjedis), term i dalë nga samiti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Johaneshburg, 2001. Në kushtet kur Shqipëria është ende një vend i pazhvilluar dhe pjesë e një ekonomie dhe e tregut botëror, është e nevojshme që ligjet për mbrojtjen e mjedisit dhe lirive që lidhen me të të jenë sa më efikase dhe t'i përgjigjen këtyre kërkesave, duke filluar që nga mbrojtja e jetës, shëndetit dhe cilësisë së jetës, zhvillimi i qëndrueshëm, çështje të sigurisë, si dhe aspekteve harmonizuese të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian e më gjerë. Të drejtat mjedisore janë në qendër të vëmendjes së zhvillimeve globale edhe për shkakun e rritjes së konsumit i cili lidhet drejtpërsëdrejti me shfrytëzimin e burimeve natyrore me ndryshimet e

klimes, te natyres, ujit, ajerit, tokes, ushqimit, kulturës dhe te gjithë elementeve mjedisore te cilat mbartin ne vetvete edhe konceptin e pergjegjesisë juridiko-civile per demin e shkaktuar mjedisor.

Rëndësia e këtij studimi qëndron në faktin se ai përpiqet dhe tenton të disiplinojë dhe zhvillojë një fushë ende të panjohur dhe të re në vend, siç është ajo e dëmit në mjedis, si pjesë të përgjegjesisë juridiko-civile ndaj mjedisit, e cila lidhet ngushtë edhe me shumë fusha të tjera të së drejtës, si ajo kushtetuese, administrative, penale, e drejta ndërkombëtare.

KAPITULLI II-ASPEKTI TEORIK I TË DREJTËS SË MJEDISIT

2.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të trajtohen aspekte teorike të së drejtës mjedisore, të drejtave dhe lirive të tjera që lidhen me të, duke e filluar trajtimin teorik nga e drejta materiale dhe procedurale të të drejtave të njeriut, që kanë lidhje me mjedisin ose janë norma të posaçme mjedisore apo të interpretueshme dhe të inkorporuara me të drejta të tjera. Karta Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) është pjesë e këtij trajtimi, Samiti Stokholmit, Deklarata e Rios dhe Samiti i Johannesburgut, Konventa e Aarhusit, si dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut është një tjetër aspekt normative për rolin dhe pozitën që ka e drejta në figurën e përgjegjësisë juridiko-civile ndaj mjedisit. Pjesë teorike në këtë kapitull është edhe Gjykata Europiane për të Drejtave e Njeriut në Strasburg, e cila vjen me jurisprudencën e saj, për mënyrën se si ajo i trajton këto të drejta procesuale dhe materiale për efikasitetin në drejtësi dhe dëmin në mjedis. Direktiva¹⁸ për dëmin në mjedis dhe përgjegjësia juridiko-civile është pjesë e këtij kapitulli. Teoria e Realizmit Juridik në këtë kapitull është pjesë e zhvillimeve globale normative të periudhës kur fillon të normohet e drejta e mjedisit dhe e dëmit në mjedis. Në këtë kapitull jam përpjekur të trajtoj nga pikpamja teorike, materiale dhe procesuale, të drejtën shqiptare duke filluar me Kushtetutën, se si trajtohet e drejta e mjedisit dhe efektiviteti i normativës shqiptare për aksesin në drejtësi në lidhje me çështjet mjedisore, si dhe disa teori në fushën e dëmit që kanë lidhje me dëmin në mjedis.

¹⁸ Direktiva 2004/35, 2000/60 për dëmin mjedisor dhe përgjegjësin juridiko civile

2.2 E drejta e mjedisit globalizimi i normës dhe përgjegjësia juridiko-civile ndaj mjedisit.

E drejta e mjedisit është një e drejtë e re jo vetëm në Shqipëri, por në rrafshin global. Me zhvillimin e shpejtë të shoqërisë vjen edhe procesi i industrializimit të ekonomisë. Industrializimi në vetvete solli një hap të madh në mirëqenien e shoqërisë, por u pasua edhe me fenomene negative të shfrytëzimit të shpejtë dhe të dëmshme të burimeve natyrore duke e ndotur dhe dëmtuar mjedisin. Kryesisht, kjo fushë, në kuptimin normativ, nuk është e mbuluar mirë, edhe pse vitet e fundit ka një përpjekje për ta trajtuar në kuadrin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut për vetë rëndësinë që ajo paraqet dhe përfaqëson.

E drejta për mbrojtjen e mjedisit bën pjesë në të ashtuquajturën gjeneratë e tretë e të drejtave të njeriut (mbas lirive politike dhe lirive ekonomike), të cilat po njohin sot një vëmendje të veçantë në veprimtarinë e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, duke marrë dhe forma të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Disa autorë mendojnë se ajo ka lindur në gjysmën e dytë të shekullit të XX-të dhe i përgjigjet nevojës për ndërgjegjësim për të penguar shkatërrimin e ekosistemit tonë të kërcënuar seriozisht nga rreziqet potenciale me të cilat përballet civilizimi modern, të cilat kanë ndryshuar në natyrë dhe madhësi dhe janë të llojeve të ndryshme sipas sociologut Ulrich Beck¹⁹, edhe pse konceptet e rrezikut nga ai personal në shekullin e nëntëmbëdhjet kanë marrë një kuptim dhe përgjegjësi solidare për shoqërinë e shekullit të njëzetë. Rreziqet sociale dhe mjedisore kanë për tendencë të jenë të lidhura më njëra-tjetrën dhe prodhojnë atë që quhet dëmi në mjedisor. Në momentin që këto rreziqe mjedisore kthehen në aksidente apo dëmtojnë njëra-tjetrën,

¹⁹Beck. U, Risk Society, Towards a new Modernity, Sage, London, 1992

atëherë në kuptimin e së drejtës ato marrin kuptimin e Drejtësisë Mjedisore, duke i dhënë edhe një kuptim normativ në përballjen me sfidat që sjell globalizimi në zgjidhjen e konflikteve, si dhe në unifikimin dhe standardizimin e kësaj fushe në nivel ndërkombëtar për mbrojtjen e të lirive dhe të drejtave të njeriut²⁰, pasi rreziqet shfaqin probleme dhe bëjnë bashkë faktorin human dhe johuman për zgjidhjen e këtyre çështjeve²¹ kaq të ndjeshme të shekullit të njëzet e një. Samiti i OKB-së në Stokholm, 1972, për mjedisin human dhe vendimmarrja e tij në nivel politik, i dha një shtysë të madhe të drejtës së mjedisit për t'u trajtuar edhe në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore për individin si të drejtën e jetës²², por fokusi dhe vëmendja për mjedisin dhe mbrojtjen e tij fillon më parë, me Kartën Universale të të Drejtave të Njeriut më 1945 (Komisioni Ekonomik dhe Sociale i OKB-së)²³, e cila garantonte të drejtat e njeriut duke shtruar rrugën për modernizimin e të drejtës dhe legjisllacionit ndërkombëtar mjedisor si fazë paraprake e procesit të implementimit në nivel rajonal apo kombëtar. Mjedisi interpretohej nëpërmjet lirive dhe të drejtave të tjera të Kartës, si liritë ekonomike, liritë sociale, politike etj.²⁴, proces që vazhdon edhe sot dhe shkon drejt përsosmëris së mëtejshme.

²⁰ Ballbe. M, Comparative View of Administrative Law Issues, Albdesign Printing House, Tiranë 2010 43-48

²¹ Latour. B, Politiques de la Nature, Comment faire entrer les sciences en democratie, La Decouverte, Paris, 1999

²² Declaration of the United Nations Conference on the Human Environment, Preambular para 1 and Principle 1, reprinted in: 11 I.L.M. 1416, 1972

²³ Karta e Kombeve të Bashkuara [nënshkruar në datën 26 qershor 1945 në San Francisko; hyrë në fuqi në datën 24 tetor 1945

²⁴ Artikulli 2 Liria nga Diskriminimi, artikulli 3 E drejta e Jetës, Lirisë, Sigurisë personale, artikulli 12 Liria nga ndërhyrjet me Privatësinë, Familjen, Shtëpinë dhe Korrespondencën, artikulli 25, E drejta e Standartit të mirë të jetesës, artikulli 27, E drejta për të marrë pjesë në jetën Kulturore të Komunitetit.

Sipas profesorit të së drejtës në Londër Philip Sandas²⁵, për të përcaktuar pasojat dhe përgjegjësitë ndaj mjedisit nga pikëpamja praktike, arsyet duhet të gjenden në njohjen e së drejtës ndërkombëtare dhe fushës së mjedisit, si dhe në kontekstet e hartimit të ligjit dhe të së drejtës ndërkombëtare, midis të drejtave ekonomike dhe sociale, civile dhe politike. Natyra dhe shtrirja ekonomike dhe të drejtat sociale përcaktojnë dhe të drejtat themelore për të cilat individi legjitimohet, përfshi edhe standardin minimal mjedisor (për shembull ndotja e mjedisit dhe lidhjet e tjera me ndotjen) të përcaktuar nga ligji, sigurisht duke lejuar zhvillimin e ekonomisë, por edhe duke mbrojtur mjedisin nga dëmet mjedisore

Të drejtat civile dhe politike janë substanciale²⁶ për nga natyra të lidhura me të drejtën e mjedisit duke iu referuar si pjesë e të drejtave “për një proces të rregullt dhe ligjor”, fusha të cilat përcaktojnë dhe ndikojnë të drejta dhe aspekte procedurale në institucione (Kushtetuta, Kod i Procedure, Kod Civil, Kodi Penal, Gjykatat, doktrinat). E drejta ndërkombëtare e mjedisit, vitet e fundit, ka përparuar shumë dhe Konventa e Aarhusit është një tregues konkret në fushën e Demokracisë Mjedisore dhe lirive themelore të individit, liri si ajo e informimit, pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes, si dhe aksesit në drejtësi të individit për çështjet mjedisore, tashmë janë bërë pjesë e legjislacionit Europian dhe kombëtar. Nga

²⁵ Shih Sands. P, Human Rights and the Environment, (Professor of Law and Director of the PICT Centre for International Courts and Tribunals at University College London; and Barrister, Matrix Chambers. This contribution is taken from Philippe Sands) Principles of International Environmental Law (Cambridge University Press, 2nd edition, 2003). United Nations Environment Programme for the Geneva Environment Network with the financial support of the Swiss Agency for the Environment, Forests and Landscape, Geneva 2004.

²⁶ E drejta për jetën, e drejta për shëndetin, e drejta për informacion, pjesëmarrje dhe vendimmarrje mjedisore, e drejta për tu mos diskriminuar, e drejta e pronës, e drejta për të pasur një jetë familjare dhe të qetë... etj. të gjitha këto të drejta janë të shpjeguara më poshtë bazuar në vendimet e Gjykatës e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut Strasburg, dhe autoriteteve të tjera ndërkombëtare.

pikëpamja e efikasiteti, këto ligje zbatohen më mirë dhe kanë impakt më shumë në pushtetin lokal (nuk mund të thuhet e njëjtja gjë për vendin tonë).

Të drejtat, detyrimet civile dhe politike janë të konfiguruar nga disa traktate mjedisore dhe instrumente të tjera ndërkombëtare në nivel botëror dhe rajonal. Këto të drejta janë të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit dhe janë një pikë nisjeje për implementimin e tyre duke përfshirë të drejtën për jetën²⁷; ndalimi kundër trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtrues²⁸; e drejta për mbrotje të barabartë nga diskriminimi²⁹; e drejta për ankimim efektiv para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të njeriut³⁰; liria e shprehjes³¹ dhe e drejta për të marrë informacion; e drejta për një gjykim të drejtë dhe publik nga një gjykatë ose trupë e paanëshme, si dhe në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve; e drejta kundër ndërhyrjes arbitrare në jetën private dhe familjare³²; e drejta e ndalimit të ndërhyrjes arbitrare të heqjes së pronësisë etj., të drejta të cilat në legjislacionet kombëtare janë integruar edhe në disa Kushtetuta si të drejta themelore, apo nëpërmjet interpretimit që u është dhënë këtyrë normave ato janë ngritur në nivele të të drejtave themelore si në aspektin material po aq dhe procesual në

²⁷Art. 6(1); 1950 ECHR, Art. 2(1); 1969 ACHR, Art. 4(1); 1981 African Charter, Art. 4

²⁸Art. 7; 1950 ECHR, Art. 3; 1969 ACHR, Art. 5; 1981 African Charter, Art. 5.

²⁹UNDHR1948, Art. 7; 1966 ICCPR, Art. 3; 1969 ACHR, Art. 24; 1981 African Charter, Art. 3(2); (shih H. Smets, *Le principe de non discrimination en Matière de protection de l'environnement*, 2000 Rev. Eur. Droit de l'Env. 1)

³⁰UNDHR1948, Art. 8; 1950 ECHR, Art. 13; 1969 ACHR, Art. 25; 1981 African Charter. Art. 7(1) and 26.

³¹ Shih. *Bladet Tromsø and Stensaas v Norway*, ECtHR, Judgment of 20 May 1999 (newspapers freedom under Article of the 1950 ECHR to publish environmental information – consequences of sealhunting – of local, national and international interest)

³²UNDHR1948, Art. 12; 1966 ICCPR, Art. 17; 1950 ECHR, Art. 8 (1) (shih Powell and Rayner, *supran.* 297; 1969 ACHR, Art. 11.)

mbrojtje të mjedisit. (Për shembull, Kushtetuta Shqiptare të drejtën për informacion mjedisor³³ e ka të ngritur në nivel kushtetues).

Shumë nga këto parime themelore të përcaktuara në Deklaratën e Rios 1992 dhe Stokholmit 1972 (OKB), jo vetëm shërbejnë për të mbrojtur liritë themelore që lidhen me mjedisin dhe dëmin në mjedis, por edhe duhet të njihen nga avokatët apo ekspertët të cilët merren me këto fusha, pasi mjedisi ka nevojë për njohuri të shumë fushave për të kuptuar dhe bërë lidhjen e posaçme me këtë fushë si pjesë të përgjegjësisë juridiko-civile ndaj mjedisit dhe dëmit në mjedis. Samitit i Johannesburgut 2002 e zhvilloi edhe më tepër fushën e të drejtës së mjedisit dhe bëri të pamundurën për të kaluar nga klauzolat e përgjithshme në ato të posaçme për programimin, implemtimin dhe afirmimin e të drejtave mjedisore, në respekt të të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut, përfshi edhe të drejtën për zhvillim, mbrojtje të diversitetit kulturor, janë esenciale për zhvillimin e qëndrueshëm dhe garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të gjithë pëfitimeve që ai sjellë. Në samitin e Johannesburgut, Bashkimi Europian³⁴ pranoi se ka një lidhje të brendshme midis mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm³⁵; propozimi u trajtua nga asambleja dhe pati një debat për mënyrën se si ai ishte formualuar, pasi pala e shteteve e më të fuqishme ekonomike të cilat kapitalin e tyre e bazonin mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore, nuk dakordësohej me palën tjetër të shteteve të cilat përkrahnin idenë se ky shfrytëzim i burimeve natyrore nuk duhet të shihet i ndarë nga zhvillimi i qëndrueshëm ku mjedisi është njeri komponent i tij dhe se qytetari

³³ Kushtetuta e Republikës së Shqipëris neni, 56.

³⁴ Shih Human Rights and the Environment, Conclusions of a Joint OHCHR-UNEP Meeting of Experts on Human Rights and the Environment, Geneva (January 2002), UN Doc. HR/PUB/02/2.

³⁵ UN Doc. A/CONF.199/L.1, 26 June 2002, paragraph 152. Cf. EU Council Conclusions, 'From Monterrey to Johannesburg: Preparation for the World Summit on Sustainable Development, 30 May.

është në qendër të saj, andaj edhe këto të drejta duhet të marrin karakter të posaçëm për t'i mbrojtur më mirë ata. Më pas, asambleja pranon se lidhja mes tyre është brenda përcaktimit të parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe i drejtohet komisionit të drejtësisë se si mund të implementohet në norma të tjera çështja e mbrojtjes së mjedisit duke e lënë të hapur debatin për sesionin e radhës për përcaktime më specifike të kësaj çështje, dhe inkurajon implementimin dhe zbatimin "inter alia" të Konventës së Aarhusit si instrumenti i vetëm deri më tani i aspektit procedural administrativ si të drejta themelore për mbrojtjejn e mjedisit, dhe si pjesë e efikasitetit³⁶ të aksesit në drejtësi (debati vazhdon) e cila buron nga neni 10 i Deklaratës së Rio për zhvillimin e qëndrueshëm, ku përfshihet edhe mjedisi si pjesë e ekonomisë, e progresit shoqëror dhe teknologjik.

2.3 Dëmi në mjedis dhe e drejta e mjedisit si pjesë e lirive dhe të drejtave të njeriut

Pse duhet që mbrojtja e mjedisit të trajtohet si çështje e të drejtave të njeriut? Ka disa përgjigje të mundshme. Qartësisht, në kontrast me pjesën tjetër të së drejtës ndërkombëtare, e drejta e mjedisit në prespektivë adreson direkt ndikimet e dëmeve të mjedisit në jetën, shëndetin, jetën private dhe pronën individuale të individëve, në raport me ndikimet që mund të ketë në mjedis në përgjithësi. Mbrojtja e mjedisit nga dëmi në mjedis mund të shërbejë për të siguruar standarde më të larta të cilësisë së mjedisit, duke u bazuar në detyrimet e shteteve për të marrë masa për kontrollin e ndotjes që ndikon në shëndetin dhe jetën private, të cilat vijnë nëpërmjet garancive procedurale dhe materiale të së drejtës (p.sh. KA). Mbi të gjitha, ajo ndihmon për të promovuar sundimin e ligjit në këtë kontekst. Qeveritë janë përgjegjëse të drejtpërdrejta nëse dështojnë në rregullimin dhe kontrollin e

³⁶ Shih Rezolutën e OKB nr 2003/71, 25 Prill 2003.

këtyre shqetësimeve mjedisore, duke përfshirë edhe ato të shkaktuara nga korporatat, si dhe për lehtësimin e aksesit në drejtësi dhe zbatimin e ligjeve mjedisore dhe vendimeve gjyqësore. Idetë e para ku mjedisi filloi të trajtohej si e drejtë më vetë fillon mbas viteve 1960, çka më pas finalizohet edhe me një akt juridik nga shtetet palë të OKB-së, këtu fillon të zhvillohet edhe dëmi mjedisor në përgjithësi dhe si e drejtë civile në veçanti. Mbas viteve 1990 kemi edhe vendimet e para nga GJEDNJ³⁷ dhe gjykatat e shteteve të tjera Europiane, si Italia³⁸, Franca... kryesisht, aty ku mjedis dhe dëmi ndaj tij trajtohen si e drejtë themelore në mënyrë indirekte, duke interpretuar norma të tjera të së drejtës në kuadrin e lirive dhe të drejtave të individit, si p.sh. e drejta për jetën, e drejta e shëndetit, e drejta për të mos u diskriminuar, e drejta për t'u informuar, e drejta e pjesmarrjes dhe e vendimmarrjes në çështjet mjedisore, e drejta e pronës. Zgjerimi i të drejtave ekonomike dhe sociale që përfaqësojnë edhe elementet e interesit publik në mbrojtje të mjedisit, i ka dhënë jetë edhe idesë se ekzistencës së të drejtës mjedisore dhe dëmit në mjedis, nuk mund të kuptohet dëmi në mjedis si fushë e të drejtës civile pa kuptuar më parë të drejtën e mjedisit. Të drejtat themelore mjedisore nuk mund të garantohen pa përcaktuar kufij, shtetet janë të detyruara ta bëjnë këtë gjë, edhe pse ekziston një llojë frike se këto të drejta mund bëhen të drejta bazike themelore për shkak të fushveprimit të gjerë që ajo ka. Zgjidhja e kësaj marrëdhënieje vjen nëpërmjet përgjigjes se rasti individual dhe interesat e mbrojtura

³⁷ Rasti Lopez Ostra vs Spanjë López, Application no. 16798/90, ESCR-Net, 1994.

Rasti Roshe vs Mbretëria e Bashkuar ECHR - 32555/96, 1996.

Rasti Oneryyldyz vs Turqi, application no. 48939/99, ECHR 657, 2004.

Rasti Fadeyeva vs Russia Case No. 55723/00, ECHR 9 June 2005.

Rasti Eco- trans vs Moldsvila Curtea de Apel Chisinau, ECHR Case nr. 3 – 2039/2008.

Rasti Tatar vs Romania, application no. 67021/01, ECHR 2009.

³⁸ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane. nr. 67/1992, 84. Vendimi i Gjykatës Italiane të Kasacionit nr. 4476 datë 21 mars 2012, 78.Decreto nr. 152/2006 (T.U. ambiente) - Bosetti & Gatti 2006.

ligjërisht, duhen peshuar drejt³⁹ dhe në ekuilibër midis tyre. Dimensionet e mjedisit dhe dëmeve në mjedis janë diskutuar rrallë në trajtimet e përgjithshme akademike të ligjit, të drejtave të njeriut, ku nuk ka pothuajse asnjë debat mbi marrëdhëniet në mes të drejtave të njeriut dhe mjedisit dhe dëmit në mjedis si kategori juridike⁴⁰. Literatura kryesisht është e shkruar nga ambientalistët ose avokatët ndërkombëtarë me njohuri të përgjithshme në fushën e mjedisit⁴¹. Rritja e ngarkesës së gjykatave në shqyrtimin e çështjeve dhe dëmeve në mjedis në kontekstin e të drejtave të njeriut, si dhe traktatet në lidhje me këtë fushë, tregojnë për rëndësinë e ligjit dhe të drejtave të njeriut në këtë fushë apo që kanë lidhje me këtë fushe. Është e dukshme se dimensionet e të drejtave mjedisore është i reflektuar në shumë Konventa dhe akte ndërkombëtare si Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike KNDCP, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe Popujve etj. Fokusi kryesor i jurisprudencës ka qenë trajtimi i mjedisit në të drejtën për jetën, të drejtën e jetës private, të drejtën e shëndetit, të drejtën e pronës. Disa traktate të të drejtave të njeriut kanë gjithashtu dispozita specifike mjedisore dhe dëmeve në mjedis të formuluar në terma relativisht të ngushtë, të fokusuar në

³⁹ C. Agudo, Doc. 9791 16 April 2003 Environment and human rights Report Committee on the Environment, Agriculture and Local and Regional Affairs Rapporteur., Spain, SOC, Parliamentary Assemble.

⁴⁰ P. Alston, H. Steiner, and R. Goodman, *International Human Rights in Context* (3rd edn, 2008) and O. De Schutter, *International Human Rights Law* (2010) refer to some of the precedents and list environment in their indexes but there is no significant discussion of the precedents from an environmental perspective. Compare Loucaides, 'Environmental Protection through the Jurisprudence of the ECHR, 75 *BYBIL* (2004) 249 and Desgagne, 'Integrating Environmental Values into the ECHR, 89 *AJIL* (1995) 263.

⁴¹ Shih, D. Anton and D. Shelton, *Environmental Protection and Human Rights* (2011); Francioni, 'International Human Rights in an Environmental Horizon, 21 *EJIL* (2010) 41; D. Bodansky, J. Brunnée, and E. Hey (eds), *The Oxford Handbook of International Environmental Law* (2007), at chs 28 and 29; Boyle, 'Human Rights or Environmental Rights? A Reassessment, 18 *Fordham Environmental L Rev* (2007) 471; A.E. Boyle and M.R. Anderson (eds), *Human Rights Approaches to Environmental Protection* (1996). Even environmental lawyers can be blind to the human rights perspectives: there is no reference to them in C. Streck et al., *Climate Change and Forests, Emerging Policy and Market Opportunities* 2010.

shëndetin e njeriut, por edhe të të drejta të tjera. Të tjera konventa nuk i përfshijnë këto të drejta specifikesht, si KEDNJ dhe KNDCP. Zhvillimi i shpejtë i jurisprudencës mjedisore në Europë, vitet e fundit solli edhe propozime konkrete, ku me anë të një protokollit shtesë në KEDNJ, u kërkua që kjo fushë të bëhesh pjesë integrale e saj, por ky propozim ka nendshur në refuzimin konstant të burokratëve europianë⁴² dhe lobingjeve të korporatave të mëdha me arsyetimin se pengon zhvillimin ekonomik të vendeve dhe mardhëniet tregtare, dhe se terminologjia e konceptit mjedis dhe dëm në mjedisor akoma nuk ka një përcaktuar të saktësuar dhe të unifikuar etj., dhe se ky protokoll shtesë për mbrotjen e mjedisit mund të bëhet pengesë për zhvillim ekonomik sipas lobingjeve pro-korporatiste.

Pavarësisht refuzimit, Këshilli i Evropës në vitin 2005, duke rishikuar vendimet e Gjykatës së Strasburgut, përcakton disa parime të përgjithshme edhe në përmbledhje të rasteve si Guerra kundër Italis, Lopez Ostra kundër Spanjës, Oneryildiz kundër Turqisë, Fadeyeva kundër Ruisisë, Taskin dhe të tjerë kundër Turqisë, Budayeva dhe të tjerët kundër Ruisisë, Tatar kundër Rumanisë etj., miraton një manual tek i cili tregohet se si e drejta për jetën private, ose e drejta për jetën, në kontekstin e dëm në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile, mund të përdoret për të detyruar qeveritë për të rregulluar këto marrëdhënie nga rreziqet mjedisore, si të zbatojnë ligjet mjedisore apo të zbulojnë informacione mjedisore. Këto të drejta, si e drejta për jetën dhe respektimin e jetës private dhe pronave, nuk sjellin thjeshtë disa ndalime për ndërhyrje të qeverisë apo të personave të tjerë, por ajo ngarkon qeverinë për të marrë masat e duhura për të garantuar këto të drejta si detyrim

⁴² Në 16 Qershor 2010, Komiteti i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës vendosi të mos e miratoj të drejtën e mjedisit si pjesë të KEDNJ.

pozitiv⁴³ i saj për të përcaktuar saktësisht me legjislacion edhe përgjegjësinë juridiko-civile që rrjedh nga ky cënim i mjedisit. Çështjet e mjedisit dhe e dëmeve në mjedise nga pikëpamaja e diskriminimit kishin filluar të ishin pjesë e studimeve dhe rezolutave⁴⁴ të OKB-së që mbas Samitit të Rios më 1992.

Dështimi për detyrimin pozitiv që qeveria ka për të marrë masa ose zbatuar ligjin (Lopez Ostra, Guerra, Fadeyeva) për rastet e dëmeve në mjedis përbën një nga arsyet kryesore në këto raste, duke mos lënë pas edhe problematikat veçanësisht edhe procedurën e vendimmarrjes apo përgjegjësinë civile dhe administrative. Edhe pse mbrojtja e mjedisit është objektiv legjitim që mund të justifikojë qeveritë në kufizimin e të drejtave të caktuara, duke përfshirë edhe të drejtën për zotërimin e pronës. Të drejtat e njeriut nuk i referohen një të drejte specifike për mjedisin, për këtë arsye lind nevoja e njohjes së brendshme të këtyre të drejtave si ajo për jetën, e drejta për ushqim, e drejta për strehim, e drejta e shëndetit⁴⁵, që të mund të realizohen në kuadrin e të drejtës së mjedisit, ku sigurisht edhe kriteret e përcaktimit të interesit të ligjshëm për legjitimitimin vijnë në radhë të parë nga ajo se çfarë është dhe ëfarë përbën dëmi në mjedis në kuptimin e ligjit dhe përcaktimin e përgjegjësisë juridiko-civile si pjesë e rëndësishme në aspektin procedural të kësaj të drejte.

Në fillim të vitit 2011, Këshilli i OKB-së të të Drejtave të Njeriut nisi një studim të marrëdhënieve mes të drejtave të njeriut dhe të mjedisit⁴⁶. Megjithatë, marrëdhënia mes të

⁴³ Shih Oneryildiz kundër Turqisë.

⁴⁴ Shih Rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme të OKB, nr 44/228, 22 Dhjetorë 1989, dhe rezoluta nr45/94, 14 Dhjetor 1990.

⁴⁵ A. Boyle, Human Rights and the Environment, *European Journal of International Law* (2012) 23 (3): 613-642.

⁴⁶ Shih UN Human Rights Council (UN HRC) res. 16/11, 'Human Rights and the Environment', 24 Mar. 2011.

drejtave të njeriut dhe mbrojtjen së mjedisit në të drejtën ndërkombëtare është larg nga të qenit e thjeshtë apo e drejtpërdrejtë. Tema është sfiduese për agjendën e institucioneve të të drejtave të njeriut dhe për UNEP, pjesërisht për shkak se aty konkurrojnë hegjemonitë burokratike globale.

Sipas profesorit Eliuh Lauterpacht (profesor në Univesitetin e Kembrixhit për të drejtën ndërkombëtare), kodifikimi ligjor ekzistues (në planin ndërkombëtar, për konventat mjedisore) me qëllim rregullimin e jetës së komunitetit është frenues mbi progresin⁴⁷. Nëse unifikimi, kodifikimi i së drejtës së mjedisit është i domosdoshëm dhe përmban elemente të rëndësishme të zhvillimit progresiv dhe reformimin e ligjeve, pyetja e vërtetë që duhet të shtrohet është se sa larg është, dhe a është politika dhe sa e kujdesshme është për të shkuar atje (të një protokollit global për mbrojtjen e mjedisit, “Kushtetutë Globale Mjedisore”).

Pyetja nuk është nëse një deklaratë ose protokoll për të drejtat e njeriut dhe mjedisit duhet të dakordësohen me të drejtat civile dhe politike, por se sa të drejta mjedisore do të na duhet të shtojmë, sa është masa e tyre... (deri ku shkon ky dëm mjedisor si përgjegjësi civile, sa më i madh dëmi aq më e madhe përgjegjësia)!

Çfarë mund të themi se është e re, ose që zhvillohet në korpuset ekzistuese të ligjeve për të drejtat e njeriut? Ka tre mundësi të dukshme.

E para, të drejtat proceduriale janë tepër të rëndësishme për mjedisin dhe të drejtat e njeriut, deri në Deklaratën e Rios të vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin (Zhvillimin e Qendrueshëm).

⁴⁷ Shih UN, Survey of International Law in Relation to the Work of the ILC, GAOR A/CN.4/Rev. 1 (1949), at paras 3–14 (hereafter ‘UN Survey’).

Çdo përpjekje për të kodifikuar ligjet për të drejtat e njeriut, pashmangshmërisht duhet të marin në konsideratë edhe zhvillimin. Duke e ndërtuar ligjin ekzistues në mënyrë të tillë, ruajmë dhe i japim vlerë edhe të drejtës procedurale në kontekstin mjedisor, si dhe e qartësojmë, sqarojmë përmbajtjen e saj në nivel global, duke krijuar një lloj uniformiteti të së drejtës mjedisore, ku modeli i interesit publik dhe i llogaridhënies më të përshtatshme në kontekstin mjedisor, në këtë, drejtim është Konventa e Aarhusit⁴⁸ e cila, nga ana procedurale është një instrument thelbësisht i rëndësishëm që lidhet me jetën dhe cilësinë e jetës sonë⁴⁹.

Së dyti, një deklaratë apo protokoll mund të jetë një mekanizëm i përshtatshëm për artikulumin në një formë kontraversale të termave ende të diskutueshme të së drejtës për një mjedis të mirë, derisa e drejta të njohë lidhjen e një mjedisi të kënaqshëm brenda korpusit të të drejtave civile, ekonomike, sociale dhe politike. Kjo do ta bëjë shumë më të qartë marrëdhënien midis mjedisit, njeriut dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke ruajtur, trajtuar, përdorur në mënyrë të qëndrueshme edhe burimet natyrore.

Së treti, problemet e së drejtës së mjedisit në rrafshin global ndeshen me shumë sfida, të tilla si ndryshimi klimës, çarja e shtresës së ozonit, ndotjet ndërkufitare, të cilat nëse nuk mbulohe nga ligjet për të drejtat e njeriut edhe në nivel jashtëterritorial, atëherë ato nuk mund të përdoren për të mbrojtur mjedisin në nivel global. Edhe nëse e kalojmë këtë sfidë,

⁴⁸http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/Publications/Aarhus_Implementation_Guide_interactive_eng.pdf

⁴⁹ Experts Group on Environmental Law of the World Commission on Environment and Development, Environmental Protection and Sustainable Development: Legal Principles and Recommendations, Graham & Trotman/Martinus Nijhoff, London/Dordrecht/Boston, 1986, p.40.

problemi me liritë dhe të drejtat e individit në nivel kombëtar mbeten të konsiderueshme, pasi ajo është një fushë e re dhe e gjerë e së drejtës dhe ende e pazhvilluar.

Teoria e metodave që i përkasin dhënies së një vlere për mjedisin qëndron në vlerësimin e dëmeve në mjedis mbi bazat e një metode të vlerësimit monetar të efekteve fizike. Kjo metodë konsiston në vëzhgimin e ndryshimeve fizike të gjendjes dhe vendeve natyrore për të vëzhguar humbjen që ajo çon në prodhimin e të mirave dhe shërbimeve, përshembull: ekonomistët llogarisin kostot e uljes së rendimenteve të kulturave lidhur me uljen e elementeve ushqimore të tokave lidhur me erozionin. Kjo metodë do të ishte shumë e pjesshme sipas kritikëve.

Kështu, prerja masive e pyjeve për tregtinë e drurit, do të çonte jo vetëm në një lidhje direkte të humbjes së prodhimit pyjor jolenjozë, por gjithashtu një humbje të të ardhurave nga ata që kryejnë shëtitje, që mund të jenë të rëndësishme në disa zona, gjithashtu edhe një humbje e biodiversitetit, ose ndryshime klimaterike dhe erozion të tokave. (Ky është dëmi direkt material në mjedisi. Po ai jomaterial..?)⁵⁰.

Këto janë metodat e limiteve të teorisë utilitariste për mjedisin, të cilat janë më shumë përkrah konceptit ekonomik sesa të mbrotjes së mjedisit nga dëmet në mjedis. Në tërësinë e vet, teoritë për rritjen ekonomike janë gjithnjë përballë teorive në mbrotje të mjedisit nga dëmet në mjedis, por ajo që është e rëndësishme është qasja në ekuilibrin me zhvillimit të qendrueshëm.

⁵⁰ <http://www.unesco.org/most/Fashikulli-1B.pdf> fq 5

2.4 Zhvillimi i të drejtave procedurale në kontekstin mjedisor, të dëmit material dhe jo material në mjedis

Jo të gjitha të drejtat "e mjedisit" gjenden në traktatet kryesore të të drejtave të njeriut. Në kuadrin e së drejtës së mjedisit, disa të drejta specifike në këtë fushë mund të gjenden dhe interpretohen në ligje apo akte ndërkombëtare të ndryshme, të cilat nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë⁵¹, por ka edhe akte ndërkombëtare që mund të jenë bërë pjesë e së drejtës së brendshme dhe janë të detyrueshme për t'u zbatuar; shembull i qartë është Konventa e Aarhusit 1998 mbi Qasjen në Informimin Publike Pjesëmarrjen dhe Vendimmarrjen, dhe Aksesin në Drejtësi për Çështjet Mjedisore (Konventë e miratuar nga Komisioni Ekonomik i OKB-së për Evropën në 1998)⁵². Konventa e Aarhusit është në realitet rreptësisht procedurale në përmbajtje dhe lidhet me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore dhe aksesin në drejtësi dhe informacion dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me dëmin në mjedis material dhe jo material dhe përgjegjësinë juridiko-civile të subjekteve. Ajo e merr frymëzimin nga parimi 10 i Deklaratës së Rio 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillim⁵³, e

⁵¹ Shih, Vienna Convention on the Law of Treaties (VCLT), Art. 31(3)(c); Demir v. Turkey [2008] ECtHR 1345. As 'living instruments' human rights treaties must be interpreted by reference to current conditions:

⁵² Cit Kofi Anan, ish-Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së, vërejtje se: "Edhe pse rajonale në fushëveprimin e saj, rëndësia e Konventës së Aarhusit është globale. Ajo është një nga sipërmarrjet më ambicioze në fushën e "demokracisë së mjedisit", deri më tani e ndërmarrë nën kujdesin OKB. Sipas tij Konventa ka "potencial për të shërbyer si një kornizë globale për të drejtat e mjedisit si dhe të forcojë vullnetin e qytetarëve. Preambula e saj jo vetëm na kujton Parimin numër një të Deklaratës së Stokholmit 1972 mbi Mjedisin Njerëzor, por ajo pranon se "mbrojtja adekuate e mjedisit është thelbësore për njeriun, mirëqenien dhe gëzimin e të drejtave themelore të tij, përfshirë të drejtën për vetë jetën", por ajo gjithashtu pohon se "çdo person ka të drejtë të jetojë në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tij, por dhe si detyra individuale dhe në bashkëpunim me të tjerët, për të mbrojtur dhe për të përmirësuar mjedisin për të mirën e të tashmes dhe brezave të ardhshëm".

⁵³ Parimi 10 parashikon se: "Çështjet mjedisore janë trajtuar mirë me pjesëmarrjen e të gjithë qytetarëve të interesuar në nivelin përkatës. Në nivel kombëtar, çdo individ do të ketë të drejtën e informimit të duhur që mbahet nga autoritetet publike në lidhje me mjedisin, duke përfshirë informacionin mbi materialet e rrezikshme dhe aktivitete në komunitetet e tyre, si dhe mundësi për të marrë pjesë në proceset e

cila i jep mbështetje të qartë kategorisë së të drejtave procedurale mjedisore, të inkorporuara në Konventën e Aarhusit dhe brenda konceptit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe ajo është jo thjeshtë zgjerimin i demokracisë pjesëmarrëse dhe vendimmarrëse, por edhe përmirësimin e qeverisjes në nivel lokal dhe qendror, dhe rritje e efikasitetit të aksesit në drejtësi për publikun për të drejtat e qytetarit⁵⁴.

Kushdo që ngre dyshimin se Aarhus është një traktat i të drejtave të njeriut, duhet të ketë parasysh tre gjëra.

- Së pari, ajo ndërton mbi të drejtën një vendosje të gjerë të aksesit në drejtësi nëpërmjet elementeve procedurale që shërbejnë për të mbrojtur të drejtën e jetës, të shëndetit dhe jetës familjare (nga dëmi në mjedis, material dhe jo material, kontraktor - jo kontraktor, si pjesë edhe e përgjegjësisë juridiko-civile)
- Së dyti, ai jep jashtëzakonisht të drejta direkte mbi individët (publikun) dhe jo thjesht shteteve, e veçantë nga aktet e tjera ndërkombëtare, pasi kryesisht ato i japin më shumë të drejta autoritetit publik; për këto arsye ajo është më afër lirive dhe të drejtave të njeriut kur i shkaktohet një dëm në mjedis, material ose jo material (p.sh., trashëgimia kulturore, cënimi i jetës private)
- Së treti, elementet thelbësore të Konventës si e drejta për informacion për çështjet e mjedisit apo e drejta e pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes në çështjet mjedisore, si

vendimmarrjes. Shtetet duhet të lehtësojnë dhe inkurajojnë ndërgjegjësimin publik dhe pjesëmarrjen duke vënë gjerësisht në dispozicion informacionin. Aksesit në procedurat gjyqësore dhe administrative, duhet t'u sigurohet në mënyrë efektive.

⁵⁴ Shih Deklaratën e Ministrave të Mjedisit të rajonit të Komisionit Ekonomik Europian të OKB (UN/ECE), Conference e 4-ërt Ministeriale për Mjedisin në Europë " Aarhus, Danimark, 23-25 Qershor 1998, para 40.

dhe aksesit në drejtësi - kanë qenë të gjithë të përfshira në të drejtën evropiane të të drejtave të njeriut nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut, ku dëmi në mjedis trajtohet edhe si përgjegjësi jashtëkontraktore juridiko-civile ndaj subjekteve.

Në thelb, të drejtat e Konventës së Aarhusit janë edhe të drejta të KEDNJ-së, të zbatueshme në ligjin kombëtar dhe përmes Gjykatës së Strasburgut.

Në këtë këndvështrim, Konventa e Aarhusit nuk mund të shihet thjeshtë dhe vetëm si e drejtë kombëtare dhe Evropiane por, edhe si e drejtë ndërkombëtare e cila ndikon në rregullim fushës së dëmit në mjedis jashtëkontraktual por edhe kontraktual. Vende të cilat nuk janë anëtare ose nuk e kanë ratifikuar ende KA, si SHBA, Kanada, vende të Amerikës së Jugut apo Azisë kanë filluar të përdorin doktrinën e kësaj konvente.

Konventa e Aarhusit është gjithashtu e rëndësishme sepse ndryshe nga konventat e tjera për të drejtat e njeriut, ajo ofron dhe nxit aktivizmin e Interesit Publik nga OJF-të dhe grupet e interesit⁵⁵, për aq kohë sa ata që paraqesin kërkesën me një “interes të mjaftueshëm” janë të autorizuar që të angazhohen në çështje gjyqësore në interes publik, dhe kur e drejta e tyre, ose të drejtat e dhunuara të njeriut, nuk përbëjnë çështje (pra, për ligje të tjera që këto raste nuk ofrojnë garanci apo nuk kanë një bazë juridike, konventa nëpërmjet OJF-ve dhe grupeve të interesit i garanton ato, mos-informimi përbën shkak të ligjshëm për të vërtetuar dëmit në mjedis dhe përgjegjësin juridiko civile).

⁵⁵ Shih Arts 4/1-a, 6, dhe 9, Pedersen, ‘European Environmental Human Rights’, 21 *Georgetown Int’l Environmental L Rev* (2008) 73.

Neni 9 i Aarhus, në këtë mënyrë, duket se shkon përtej kërkesave të KEDNJ-së. Nenin 6 shprehet për të drejtat e pjesëmarrjes publike për këdo që ka një "interes" në çështjet mjedisore, duke përfshirë edhe OJQ-të që kanë një "interes të mjaftueshëm", termi interes i mjaftueshëm, ose në kontekstin juridik shqiptar është interes i ligjshëm⁵⁶, nuk është i përcaktuar nga Konventa, por në vendimin e saj të parë, atë të Komitetit të Pajtushmërisë Aarhus⁵⁷, ajo u shpreh se⁵⁸, "ajo çfarë përbën një interes të mjaftueshëm (interes të ligjshëm) dhe dëmtim të një të drejte do të përcaktohet në përputhje me ligjin kombëtar, ata duhet të vendosin", me qëllim të dhënies së aksesit të publikut në fjalë në drejtësi", në kuadër të Konventës".

Gjykata e Strasburgut në shumë raste i referohet drejtpësdrejtë KA-së dhe orinetimeve të Komiteteve të Përputhshmërisë i cili është i specializuar vetëm për çështje që lidhen me të drejtat mjedisore.

Ky është një ndryshim i rëndësishëm dhe me implikime të rëndësishme për çdo debat rreth një të drejte autonome për një mjedis të mirë apo të kënaqshëm në fushën e së drejtës. OJF-të mjedisore jo vetëm që përdorin qasje në informim dhe lobim për të rritur ndërgjegjësimin ndaj shqetësimeve mjedisore, por studimet kanë treguar se ato kanë një kurbë në rritje tendence dhe suksesi në aktivitetet e tyre në proceset gjyqësore në interes publik⁵⁹. Kjo lloj qasje në intersin publik nga Konventa e Aarhusit është ndjekur dhe implementuar edhe në

⁵⁶ K.Pc.C, neni 32.

⁵⁷ Committee of Compliance ose Komiteti i Përputhshmërisë, është një organ këshillues i Konventës së Aarhusit.

⁵⁸ Shih Komitetin i Pajtushmërisë Aarhus, (UNECE), Bond Beter Leefmilieu Vlaanderen VZW – Findings and Recommendation with Regard to Compliance by Belgium (Comm. ACCC/C/2005/11) ECE/MP.PP/C.1/2006/4/Add. 2 (28 July 2006), at paras 33–36.

⁵⁹ Shih de Sadeleer, Roller, and Dross, Access to Justice in Environmental Matters, Final Report, Doc. ENVA.3/ETU/2002/0030, Part I, at sect. 3.

marrëveshje të tjera Evropiane, p.sh., neni 8/1 i UNECE, Protokolle të vitit 2003 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, parasheh “se çdo palë duhet të sigurojë mundësi të hershme, në kohë, efektive për pjesëmarrjen e publikut, kur të gjitha mundësitë janë të hapura në vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe programeve⁶⁰”. Për këtë qëllim të rëndësishm publik përfshin edhe OJF-të si subjekte në fushën e mjedisit dhe mbrojtjes së tij. (Vetë mosinformimi nga subjekti që e ka detyrim ndaj publikut, përbën premisë të mjaftueshme për të shkaktuar dëm mjedisor).

Prandaj këtu shtrohet pyetja: a duhet praktika gjyqësore e GJEDNJ-së të ndjekë precedentin e interesit publik të përcaktuar nga Aarhushi, siç e ka në shumë raste të tjera, për dëmin në mjedis, material dhe jo material? Çfarë qëllimi ka interesi publik në zgjidhjen e çështjeve mjediosore në kontekstin e të drejtave të njeriut? OJF-të tashmë i kanë këto të drejta për mbrojtjen e të drejtave të shkeluara ndaj “personave” dhe nuk ka nevojë për një zgjerim normativë tjetër tani për tani për këtë qëllim!? Në thelbin e vet, edhe mosinformimi-pjesëmarrja e personit (publikut) në proceset për çështjet mjediosore përbën dëm në mjedis, dhe këtu kemi përgjegjësi juridiko-civile nga e cila lind legjitimiteti aktiv për procesin civil për dëmshpërblim, kompensim apo pretendime të tjera që parashtron pala në proces.

⁶⁰ Komisioni i Ekonomik Evropian i OKB-së, Protokolle Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, 2003, art. 2/8.

2.5 E drejta e mjedisit në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe dëmi në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk e parashikon një mbrojtje si dispozitë të posaçme që synon mbrojtjen e të drejtave “të mjedisit”, por ajo, në disa aspekte, ngrihet në nivel themelor nga vendimet dhe interpretimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Ajo nuk ka një përcaktim specifik për përgjegjësinë juridiko-civile dhe dëmin në mjedis. Konventa është një instrument tradicional i të drejtave të njeriut, që synon mbrojtjen e individëve dhe jo mbrojtjen e të drejtave kolektive; Padia Mjedisore kryesisht ngrihet si një e drejtë kolektive.

Ankimimet në KEDNJ për mjedisin kryesisht futen në dy kategori:

1. Mbrojtja e mjedisit kundrejt të drejtës së shfrytëzimit të trojeve.

Në rastet kur ka pronësi individuale mbi trojet, kur e drejta e pronarit të truallit për ta shfrytëzuar atë kufizohet nga masa që justifikohen në mbrojtje të mjedisit, gjykata, edhe pse ka njohur të drejtën e pronës si aspekt të lirive themelore të njeriut, njeh edhe të drejtën e shtetit për të ruajtur zonat me bukuri natyrore për të vënë në zbatim programe mbrojtëse mjedisore.⁶¹

2. Cënimi i mjedisit si pjesë e ndërhyrjes në jetën/ pronën private.

Kërkesat e vetme në lidhje me cënimin e mjedisit (dëm në mjedis) dhe që mund të argumentohen në bazë të KEDNJ-së, janë ato ku cënimi shkel në mënyrë të drejtpërdrejtë

⁶¹ Rasti, Eco- trans vs Moldsvila, Curtea de Apel Chisinau, ECHR Case nr. 3 – 2039/2008.

një të drejtë individuale të mbrojtur nga Konventa. Në pjesën më të madhe çështjet e mjedisit përfshihen në ndërhyrjet në jetën private ose banesën e individëve për ta gëzuar në mënyrë paqësore pronën e vetë, e cila bie në sferën e nenit 8.12 të KEDNJ, ose të drejtën për të gëzuar në mënyrë paqësore pronën e vet, të mbrojtur nga neni 1 i Protokollit 1 të Konventës. Sipas GJEDNJ, shteti, kur konstaton shfrytëzime që dëmtojnë mjedisin si nga autoriteti publik dhe privat, ka detyrimin të rregullojë këtë veprimtari dhe se është detyrimi i tij pozitiv të marrë masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të siguruar të drejtat e kërkuesve në bazë të paragrafit 1 të nenit 8 nga ky dëm mjedisor (rasti Lopez Ostra kundër Spanjës etj.).

Në një kohë kur zhvillimi ekonomik shihet si qëllimi thelbësor i qeverisjes, vendimet e GJEDNJ do të shërbejnë si një kujtesë për zhvillime të mundshme jurisprudenciale dhe pasojat që ky zhvillim ka ndaj njerëzve dhe mjedisit (Bianku L, 2005 : 489/490).

Dëmi në mjedis, si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile në aspektin teorik dhe doktrinal, trajtohet në mënyra të ndryshme, në varësi të sistemeve ligjore, ekonomike, politike, sociale, mjedisore, dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në këtë disiplinë. Disa vende të zhvilluara këtë të drejtë kryesisht e kanë të ngritur në nivel themelor, qoftë si dispozitë e posaçme normative, materiale dhe procedurale, por edhe si interpretim që vjen nga dispozita të ndryshme nga praktika e GJEDNJ të cilat lidhen me të drejtën e mjedisit, dhe precedentin e përcaktimit të dëmit në mjedis kryesisht ai jashtëkontraktuale (material dhe jo material). Prandaj fusha e së drejtës së mjedisit dhe dëmit në mjedis në veçanti nuk është e harmonizuar, e qartë dhe e saktë në nivel komunitar dhe global, pasi është në një moment zhvillimor. Edhe pse ka një Direktivë të Parlamentit European dhe Këshillit, “Mbi

përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar⁶², efekteve të dëmshme në mjedisi,⁶³ përsëri ajo nuk e plotëson dot boshllëkun e përcaktimit të dëmit në mjedis dhe përgjegjësisë juridiko-civile. Vetë direktiva pason disa akte të mëparshme në kuadrin e legjislacionit mjedisor dhe fushës së dëmit në mjedis, por edhe këtu ajo na paraqitet si një rregullator i kufizuar mbi të cilën ajo ngre disa nga parimet e përgjithshme dhe për sa i përket përgjegjësisë juridiko-civile që rrjedh nga dëmi mjedisor. Vetë konceptin e dëmit në mjedis ajo e trajton vetëm në kuadrin e dëmit në ambient/natyre/florë/faunë dhe shprehet se është e kufizuar vetëm për këtë aspekt të dëmit në mjedis si përgjegjësi civile ndaj mjedisit. Natyrisht që kjo direktivë përbën një hap pozitiv për sa i përket përgjegjësisë juridiko-civile në fushën e dëmit në mjedis, por ajo nuk i jep zgjidhje plotësisht dhe efikasitet konceptit të dëmit në mjedis edhe përtej mjedisit. Kjo direktivë përgjegjësinë ndaj mjedisit apo dëmit në mjedis, e shpërndan edhe në përcaktimet e tjera ligjore, rajonale dhe kombëtare.

⁶² Direktivë 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar.

⁶³ Direktiva 2000/60 Mbi Përcaktimin e efekteve negative dhe negative të gjendjes ekologjike, kimike dhe/ose sasisë dhe/ose mbi ecurinë potenciale të ujërave të interesuara.

2.6 Doktrina e Realizimit Juridik dhe ndikimi në fushën e mjedisit dhe dëmit në mjedis

Doktrina e Realizimit Juridik⁶⁴ dhe ndikimi në fushën e mjedisit. Në fillim të epokës moderne, fillimet e shek. XIX, shkenca juridike vendoset nën ndikimin e doktrinës themelore amerikane që është Realizmi Juridik, i cili ngrihet mbi disa koncepte:

a) se edhe parimet Kushtetuese nuk duhen konsideruar absolute, (në rastin e të drejtës për një mjedis të pastër e të shëndetshëm), ato ndryshojnë në kohë dhe hapësirë si norma por edhe si interpretime normash kushtetuese në parim.

b) skema tipike e ngurtë e logjikës duhet të zëvendësohet nga logjika e balancës, norma juridike duhet parë në një këndvështrim më të gjerë, racional, jo vetëm në formë por edhe përmbajtje:

c) gjykimet balancuese duhen konceptuar si vlerësime të ftohta të interesave sociale në lojë, pra kur themi interesave sociale marrim parasysh edhe grupet e interesit si trustet, korporatat e mëdha të cilat ushtrojnë veprimtari industriale apo veprimtari, që kanë impakt të madh në mjedis që prekin direkt ose indirekt shëndetin dhe jetën e individit dhe të shoqërisë apo dëmeve të ndryshme në mjedis⁶⁵.

Procesi i Konstitucionalizimit ka filluar të lindë si doktrinë gjatë shekullit të XXI në vitet 1960-1970 në periudhën postmoderne, ku zhvillimi industrial dhe global shtronte kërkesa të tjera për kohën, fuqizimi i korporatave në SHBA dhe në ekonominë botërore, duke

⁶⁴ Koment: Përfaqësuesi klasik i Realizimit Juridik është Ronald Dvorkin, i njohur edhe për diskrecionin që ai tenton ti japë “Gjyqtarit Herkul” kur normat evoluojnë, por edhe si organ më i specializuar që mund të bëjë interpretimin e normave kushtetuese dhe ligjeve. Dvorkin është për një pushtet diskrecional më të madh të gjyqësorit, në raport me ekzekutivin. Procesit i Realizimit Juridik fillon pikërisht në vitet 60-70 kur globalizimi kalon nga moderjan në postmoderne dhe normat mjedisore janë pasojë e këtij procesi filozofiko-sociologjike që e karakterizonë shoqërin si evolucion. (Manushaqe. A)

⁶⁵ Vasjari A, 2013-2014.

shfrytëzuar burimet natyrore në masë, kërkimet e naftës në tokë dhe në det, shpyllëzimet, ndërtimi i fabrikave masive në vendet e mëdha dhe të fuqishme të botës viheshin përballë kërkesave të sindikatave dhe organizatave të punëtorëve të cilët kërkonin më shumë liri e të drejta sociale, sigurisht të lidhura ngushtësisht edhe me të drejtat mjedisore dhe mbrotjen e mjedisit.

2.6.1 Procesi i ri i sistematizimit të kulturës juridike ose Konstitucionalizmit

Ky proces arrihet me tre mënyra:

1. Aplikimi horizontal i parimeve ose të drejtave kushtetuese në marrëdhëniet mes privatëve. Normat kushtetuese konsiderohen të përshtatshme për të rregulluar edhe marrëdhëniet mes privatëve dhe shtetit dhe si të tilla ato mund të përdoren edhe në konfliktet juridike mes privatëve, si dhe të aplikohen edhe nga disa gjykata të zakonshme por edhe nga gjykatat e shkallës së parë, atyre të apelit dhe Gjykatës së Lartë, çka do të garantonte më mirë një liri themelore pozitive në Kushtetutë. (Rasti mund të ishte e drejta për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm, apo e drejta për të ngritur padi për çështjet mjedisore)

2. Interpretimi special juridik i dispozitave Kushtetuese:

Në kushtet kur nuk ekziston një e drejtë pozitive e drejtpërdrejtë në Kushtetutë, si e drejta për një mjedis të shëndetshëm, mund të burojnë edhe nga parime të tjera në Kushtetutë si interpretime të cilat të mund të apelojnë në çdo kontekst social, duke eliminuar

njëkohësisht lagunat kushtetuese, p.sh. si pika e dytë e nenit 59 e cila shprehet se objektivat sociale nuk mund të ankimohen në gjykatë; nëse do të kishim edhe një dispozitë kushtetuese që sanksiononte mbrojtjen e shëndetit e njeriut dhe cilësinë e jetës, pasoja dhe dëme që do të vinin për shkaqe të ndotjes së ajrit, atëherë këtu nëpërmjet interpretimit të normës për mbrojtjen e shëndetit nga ajri i ndotur do të mund të legjitimoheshim dhe kishim një Interes më të Ligjshëm në mënyrë të drejtpërdrejt nga Kushtetuta për dëmin në mjedis, si dhe për të gëzuar të drejtën e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm sipas parimit të Përgjegjësisë së “Dëmit të shkaktuar dhe parimit Ndotësi Pagan”. (Ademi N, 2008 : 478), natyrisht do të ndikonte edhe mirpërcaktimin dhe efiaksitetin të përgjegjësisë juridiko-civile dhe dëmit në mjedis.

3. Rileximi në një optik të re i temave si përgjegjësia civile (dëmit në mjedis), shkaqet e justifikimit në fushën penale, rregjimi i defekteve të aktit administrativ.

Është e pashmangshme që normat kushtetuese mund të mos hyjnë në konflikt kushtetues midis tyre. Kjo do të thotë se ato duhet t’i nënshtrohen një procesi interpretimi dhe balancimi. Përse është i nevojshëm balancimi? Nevoja për të balancuar parimet ose të drejtat kushtetuese ka si shkak faktin se këto parime apo të drejta mund të përplasen dhe nuk mund të realizohen njëkohësisht.

Në kushtet kur raportet e Bashkimit European apo direktivat e BE⁶⁶ theksojnë se ligjet penale për mbrojtjen e mjedisit nuk po japin efektet e tyre, apo mosefikasiteti i akteve

⁶⁶ Direktiva për Mbrojtjen e Mjedisit nëpërmjet Veprave Penale 2008/99

administrative⁶⁷ nuk është i mjaftueshëm për të mbrojtur mjedisin nga dëmet mjedisore apo nuk përputhen me Aquis Communautaire, ose kur përgjegjësia civile në lidhje me dëmin në mjedis dhe shëndetin nuk del qartë apo shmanget nëpërmjet burokracisë dhe hapësirave ligjore, ky legjislacion duhet balancuar duke filluar që nga norma themelore Kushtetuta.

2.7 Normativa Kushtetuese dhe ligjore e dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile

Edhe pse ka patur një debat (Komisioni Parlamentar, 2006)⁶⁸ kushtetues në hartimin e Kushtetutës së Shqipërisë në lidhje me çështjet e mjedisit, nuk u arrit që e drejta themelore e posaçme “për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër” të sanksionohet si e drejtë e veçantë në Kushtetutë. Pavarësisht përcaktimit të dy dispozitave në Kushtetutë të informimit ndaj mjedisit dhe mjedisi si objektiv social i shtetit, ajo nuk u ngrit në nivelin e një të drejtë themelore e cila të mund të ankimohej drejtpërsëdrejti në Gjykatën Kushtetuese apo të përbënte një bazë të fortë ligjore për legjitimimin aktiv.

⁶⁷VKMnr.387, date 06.05.2015 “Per rregullat për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve/PCT-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCBve/PCT-ve të përdorura, VKM 360, date 29.04.2015. për listën e Ndotësve Organik të Qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre, Vendimi Nr. 435, date 12.09.2002 “Për miratimin e normave mbi shkarkimet në ajër në Republikën e Shqipërisë datë 23.03. 2016.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 956, datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e kurorës së gjelbër të Tiranës dhe masat për mbrojtjen e saj”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.994, Për Tërheqjen e Mendimit të Publikut në Vendimarrje për Mjedisin datë 02.07. 2008, Vendim i Këshillit të Ministrave nr 247, Për Përcaktimin e Rregullave, të Kërkesave e Procedurave për Informimin dhe Përfshirjen e Publikut në Vendimarrje Mjedisore, datë 30.04. 2014, Vendim i Këshillit të Ministrave për tërheqjen e mendimit të publiku në vendimarrjet për mjedisin Nr.994, datë 2.7. 2008, 19, Vendim i Këshillit të Ministrave Për të Drejtën e Publikut për të Pasur Informacion Mjedisor nr.16, datë 04.01. 2012 Raport Progreset e BE të vitit 2013, 2014, 2015, 2016, e shumë akteve të tjera.

⁶⁸ Diskutim i Komisionit Parlamentar, për hartimin e projekt Kushtetutës mars – shtator 1998, 2006 Vëllimi 1.

Kushtetuta jonë e ka paraparë të drejtën e një mjedisi, “*për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm*” si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij⁶⁹, pavarësisht se në vendimin e GJK formalisht ajo e ka njohur dëmin në mjedis si figurë juridike por që mbetet më shumë në planin teorik kur ndeshemi në praktikë.

E drejta për të patur një mjedis të pastër e të shëndetshëm, për të garantuar shëndetin dhe cilësinë e jetës, nuk ka një rregullim të posaçëm ligjor si rasti i Italisë, për këto arsye⁷⁰ nuk gëzon mbrojtje Kushtetuese si norma më e lartë themelore, por ajo ia lë këtë proces normave të tjera të përgjithshme Kushtetuese të interpretueshme, apo që janë nën hirerarkinë e Kushtetutës, si Konventat, Kodet, dhe ligjet, të cilat në zbatim të këtij koncepti e humbasin ose e bëjnë të pamundur përmbajtjen reale legjitimitimin aktiv (*locus standi*). Siguria juridike e këtyre normave shpeshherë kushtëzohet nga faktorë politikë – ekonomik, social dhe legjislativ, sidomos në një sistem politik – juridik ku siguria e normës juridike shfaq probleme konstante si pjesë e një shoqërie në tranzicion.

Jurisprudenca shqiptare ndeshet në vështirësi për përcaktimin e dëmit në mjedis në të ardhmen⁷¹, ajo ka vështirësi si në planin teorik ashtu edhe në atë praktik; si për legjitimitimin e palëve në proces, ashtu edhe për përcaktimin e dëmit eventual mjedisor edhe real, faktorë

⁶⁹ <http://www.silvae.it/flex/cm/pages/ServeBLOB.php/L/IT/IDPagina/>(Shih, I diritto all'ambiente: principi costituzionali, evoluzione legislative, 1. La tutela costituzionale dell'ambiente).

⁷⁰ La Corte Costituzionale in particolare con la sentenza del 30 aprile 1986 n. 121 e con la sentenza del 30 dicembre 1987 n.641 ha ribadito che: “l'ambiente è protetto come elemento determinativo della qualità della vita..”, kapitulli I.

⁷¹Avokatura e Shtetit (prapësues), parashtrime në Padin nr 3439(03136-2016) vendim në datën 13.06.2016, Gjykata Administrative Shkalla e Parë Tiranë.

të cilët ndikojnë drejtpërsëdrejti në legjitimimin e palëve dhe efikasitetin për përcaktimin e dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile në procesin civil dhe jo vetëm.

Fakti juridik që ligji i ngarkon pasojat juridike është ngjarja që ka ndodhur ose që mund të ndodhë. Ndodhja e kësaj ngjarjeje detyron shkaktuesin e dëmit të shpërblejë dëmin e shkaktuar si pasojë e ngjarjes (Legeir G, 2008 : 158). Doktrina dhe jurisprudenca të ndryshme e trajtojnë në mënyrë të ndryshme kushtin nga i cili lind dëmi. Vende si Austria, Gjermania, Zvicra, Franca etj., në shkaktimin e dëmit nëpërmjet veprimit apo mosveprimit të subjektit, marrin parasysh raportin e proporcionit të veprimeve të dëmshme në proporcion me dëmin e shkaktuar. Pra, nuk kemi një kusht të drejtpërdrejtë të vetëm siç e përcakton doktrina e kushtit të drejtpërdrejtë të lindjes së ngjarjes, por kemi një tërësi rrethanash të cilat vlerësohen në bindjen dhe gjykimin e brendshëm të gjyqtarit për ekzistencën e dëmit në mjedis jashkontraktual.

Pra, efikasiteti i aksesit të së drejtës për legjitimimin e palëve dhe figurës së përgjegjësisë juridiko-civile nuk mund të kufizohet vetëm në lindjen e një fakti juridik të drejtpërdrejtë, por e një tërësie faktesh sipas kësaj doktrine e cila merr në raport proporcionin e veprimeve apo mosveprimeve në proporcion me dëmin e shkaktuar në mjedis. Kjo doktrinë e Shkakut Adekuat parashikon edhe dëmin abstrakt dhe joreal, pra dëmin që mund të ndodhë duke u bazuar në analizën e teorisë së riskut se sa këto veprime joligjore mund të shkaktojnë dëme në mjedis në të ardhmen. Shqipëria aplikon kryesisht doktrinën kusht-objektiv (shkakut të drejtpërdrejt), dëmit real që ka ndodhur. Në thelb, kjo doktrinë është efikase për dëmin në mjedis por në zbatimin e saj në praktikë dhe në përcaktimin e përgjegjësisë juridiko-civile ajo bëhet tepër e vështirë. Kryesisht, vendet e zhvilluara ndjekin doktrinën e kushteve jo të

drejtpërdrejta të shkakimit të dëmit në mjedis për të përcaktuar përgjegjësinë juridiko-civile, pasi faza e kushtit objekti të drejtpërdrejtë është një stad i zhvilluar tashmë, pa kaluar në kushtin e drejtpërdrejtë, teorikisht nuk mund të kalojmë në kushtet indirekte të shkakimit të dëmit në mjedis.

Normat për mjedisin, duke i analizuar në materie, janë norma transversale, ato duhet të na mbrojnë përballë zhvillimeve globale dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore, shfrytëzime të cilat ndikojnë fuqishëm në shëndetin fizik dhe psikik të njeriut. Kjo mbrojtje duhet të konsolidohet edhe më tepër duke u mbështetur edhe në “parimin e përgjegjësisë së ndërsjelltë dhe bashkëpunimit të autoriteteve dhe publikut”, të cilat vendosin kriteret në përcaktimin se çfarë përbën dëm në mjedis dhe elemente të tjera që lidhen me këtë figurë juridike të së drejtës civile dhe jo vetëm.

2.8 Prespektiva dhe një qëndrimi doktrinare në fushën e dëmit në mjedis, mjedisit, lirive dhe të drejtave të njeriut që kanë lidhje me të

Interesi për pozitën e lirive dhe të drejtave mjedisore civile si ai i dëmit në mjedis, përcaktohen nga vetë shtetet duke u mbështetur në politikat e veta social-ekonomike dhe interesit publik. Duke t’iu përgjigjur pyetjes në aspektin negativ, thjesht do të afirmojmë qëndrimin ekzistues të ligjit dhe të drejtave të njeriut se nuk kanë asgjë për të thënë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, dhe duke i parë në mënyrë pozitive do të shkojmë drejt një rruge dhe do të gjejmë dyer të hapura për një të drejtë të mirë të mjedisit, dhe kjo na shpie tek pyetja substanciale më e madhe: e duam një të drejtë të tillë? A duam zgjerim të të

drejtave apo thjesht interpretim të korpusit ekzistues të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut? Kjo nuk është një çështje që shqetëson thjesht dhe vetëm Shqipërin dhe Evropën, përkundrazi, ajo potencialisht ndikon në të gjitha konventat, traktatet kryesore të të drejtave të njeriut, duke pasur parasysh mënyrën e punës së gjykatave, vetëdijen për të bashkërenduar veprimtarinë e tyre në fushën e dëmit në mjedis.

Artikulli i të drejtës për një mjedis të mirë të shëndetshëm brenda kontekstit të të drejtave sociale, kulturore, ekonomike nuk është e një natyre obstruksioniste për të drejtën, përkundrazi; saktësimi, qartësimi, disiplinimi zgjerimi i një të drejte të tillë do të shkonte në favor të interesit publik, dhe do t'i jepte një pozitë më të madhe në rrafshin global promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke e filluar normimin që nga Kushtetuta, Kodet, Ligjet..., dhe Jurisprudenca jonë në tërsinë e vet. Kjo gjë arrihet pa dëmtuar apo krijuar probleme në legjislacionet kombëtare, duke lejuar shtetin që të vlerësojë vetë modelin e zhvillimit të vendit dhe hapësirën e vet normative duke qënë e balancuar në aspektet mjedisore, ekonomike dhe sociale, si dhe pa cënuar strukturën e të drejtave të njeriut.

Kjo fushë e së drejtës do të ndërtohet edhe duke u bazuar mbi precedentët e Stokholmit, Rios, KEDNJ/GJEDNJ, konferencave të tjera ndërkombëtare dhe kombëtare, apo jurisprudenca vendase shqiptare.

Elaborimi i mëtejshëm i të drejtave procesuale, mbështetur në Konventën e Aarhusit, do të lehtësojë zbatimin e një të drejte të tillë, si dhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar i japim një rol më të madh OJF-ve, publikut në evokimin e këtyre çështjeve dhe

efikasitetit të aksesit në drejtësi, përfshi këtu edhe proceset gjyqësore (përfshi përgjegjësinë juridiko-civile dhe dëmin në mjedis, legjitimimin e palëve në proceset civile/administrative mjedisore) duke aplikuar edhe doktrinën e dëmit abstrakt dhe joreal, pra dëmin që mund të ndodhë duke u bazuar në analizën e teorisë së riskut se këto veprime joligjore mund të shkaktojnë dëme në të ardhmen në mjedis, aplikim i cili mendoj se do të rriste efikasitetin në procesin e përgjegjësisë juridiko-civile. Një akt, një deklaratë ose protokoll për të drejtat e njeriut dhe mjedisin, mbart kuptim me kusht që ajo të sjellë së bashku të drejtat ekzistuese si ato civile, ekonomike, politike dhe sociale me një qasje koherente dhe në të njëjtën kohë rikonceptim në gjuhën e të drejtave, sociale dhe ekonomike, idenë e një mjedisi miqësor të mirë dhe të përbashkët, e paraparë si interes publik edhe në kontekstin global, për të cilat shtetet kanë përgjegjësi për ta mbrojtur mjedisin nga dëmet në mjedis në mënyrë progresive dhe për aq sa e lejojnë burimet.

Normat dhe të drejtat mjedisore vihen përballë sfidave të tilla si ndryshimet klimaterike dhe zhvillimet ekonomike globale. Debati shtrihet edhe përtej kufijve të një vendi, pasi çështjet e mjedisit (dëmet mjedisore) kanë edhe karakter eksterritorial ose ndërkuftarë dhe çështja e juridiksionit mbetet ende problematike dhe sfiduese, ose edhe në rastin kur njëri vend është anëtar i një traktati ndërsa pala tjetër nuk është anëtare, burokracia funksionon si një ingranazh bllokues për mbrojtjen e mjedisit në kuptimin e efikasitetit të lirive dhe të të drejtave që lidhen me të sajat.

Politikat ekonomike më të mëdha, në lidhje me emetimin e gazit në mbarë botën, përcaktohen në përputhje me Protokollin e Kyotos⁷². Kyoto është një instrument ku shtetet, korporatat e mëdha, llojnë për interesat e tyre ekonomike për të vendosur kufij të lartë të çlirimit të gazrave kryesisht nga industritë e rënda⁷³, dhe Deklarata e Rios dhe Konventa e Aarhusit janë në anën tjetër të medaljes, të cilat kërkojnë më pak ndotje mjedisore nëpërmjet kufizimit të shfrytëzimit të burimeve natyrore, që në thelb mbrojnë dhe janë pjesë e lirive dhe e të drejtave të njeriut.

E drejta e mjedisit dhe dëmi mjedisor duhet të jetë pjesë e të drejtave jo vetëm civile dhe themelore të vendit tonë, por ato duhen promovuar fuqishëm për të mbrojtur mjedisin ku ne jetojmë brenda konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Përforcimi, qartësimi, përjasja, specifikimi, integrimi i normativës mjedisore, dëmi në mjedis, në legjislacionin dhe të drejtën tonë, jo thjesht do të garantonte më tepër efikasitetin e përgjegjësisë juridiko-civile dhe përcaktimin e dëmit në mjedis, por do ta mbronte mjedisin ku ne jetojmë më mirë dhe përfitimet do të ishin më të mëdha, si në aspektin personal, ashtu edhe në interes publik. Të drejtat private janë pjesë e të drejtave të “Ombrellës së Madhe”, asaj Publike⁷⁴, si pjesë e një interesi më të madh publik dhe jo diskriminues ndaj të drejtave private. Rregullimi ligjor i ligjeve dhe aktive sepcifike që kanë lidhje më dëmin në mjedis apo të fushës së mjedisit, në radhë të parë ato vijnë si një normë publike, ndaj edhe efikasiteti i legjitimitetit të palëve në procesin civil lidhet dhe me faktin e vërtetimit të këtij dëmi në mjedis në bazë

⁷² http://unfccc.int/kyoto_protocol/items/2830.php

⁷³ Rasti i takimit të G7 në Sicili (IT), datë 25-26 maj 2017, ku nuk u arrit një marrëveshje tjetër për Klimën pasi SHBA (Presidenti D. Trump) nuk pranoi kufizimet e emetimit të gazrave në atmosferë. Ora News, edicioni i lajmeve 19:30, datë 27 maj 2017.

⁷⁴ Mandro A Leksion UET 2014-2015.

të përcaktimeve që bën e drejta publike për përgjegjësinë juridiko-civile lidhur me dëmin në mjedis.

2.9 Metodologjia dhe Metoda e Studimit

Metodologjia e cila ka shoqëruar punimin, ka qenë e përzier.

Premisat kryesore të Metodologjisë janë nisur nga format logjike të procesit të njohurive, si dhe nga mundësia e kufizimit/ zbatimit të tyre në shkencë të caktuar ose të një kërkimi të caktuar shkencor.

Janë përdorur metoda të kërkimit shkencor gjerësisht të njohura si: metoda analitike, metoda krahasimore, metoda interpretuese, metoda empirike, metoda doktrinare, metoda jurisprudenciale, ajo e deduksionit dhe e induksionit, metoda e abstragimit. Këto metoda të kombinuara më kanë ndihmuar të përzgjedh, analizoj dhe të dal me gjetje konkrete në lidhje me temën.

Metoda analitike më ka ndihmuar të bëj një analizë të së drejtës në tërësi dhe asaj mjedisore në veçanti.

Metoda krahasimore më ka ndihmuar për të bërë krahasimin e të drejtës shqiptare me të drejta të tjera, në nivel legjislativ, jurisprudenciale dhe doktrine, si dhe të krahasimeve të sistemeve të ndryshme.

Metoda empirike ka qenë e faktor mjaft i rëndësishëm në këtë punim, pasi kam sjellë edhe eksperiencat e mia personale në këtë fushë, si me artikujt shkencorë të botuar në vendet e

BE-së por edhe ato në Shqipëri. Çështjet e ndryshme civile-administrativo-publike, apo të një interesi publik, janë pjesë e eksperiencave të mia në të cilat ndërthuret teoria me praktikën në këtë fushë, e cila është në fillimet e veta. Metoda interpretuese bën një interpretim të së drejtave të ndryshme apo akteve në lidhje me të drejtën mjedisore, duke u integruar edhe me metodën doktrinare, jurisprudenciale, empirike etj. Hulumtimi cilësor ka udhëhequr punimin në këtë fushë. Metoda e abstragimit ka lidhje edhe me metodën e deduksionit dhe induksionit në kuptimin e pasojave dhe të mirave që mund të vijnë në të ardhmen në mjedis, ku përgjegjësia juridiko-civile nuk del qartë edhe për faktin se dëmi në mjedis jashtëkontraktor (material dhe jo material) është ende një kategori e gjerë, e pa-specifikuar dhe në zhvillim e sipër, kështu legjitimimi i palëve në proces bëhet edhe më i vështirë.

Metoda jurisprudenciale përpiqet të ndërtojë një logjikë judike të mbështetur mbi të drejtën në tërësi, kushtetutat, konventat, ligjet, aktet, praktikat dhe precedentët e gjykatave ndërkombëtare dhe kombëtare, si doktrinave dhe burimeve të tjera të së drejtës të cilat kanë lidhje direkte më të drejtën e mjedisit, si në aspektin procedural por edhe material për efikasitetin në drejtësi për çështjet mjedisore.

KAPITULLI III-HISTORIKU I TË DREJTËS MJEDISORE DHE DËMIT NË MJEDIS SI PËRGJEGJËSIS JURIDIKO CIVILE

3.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të trajtohet historiku i të drejtës mjedisore në tërësi, duke filluar që nga fjala mjedis dhe periudhat e hershme para Krishtit, për të vazhduar me të drejtën zakonore, mandej do të trajtohen statutet dhe kanunet si dhe evolucionin në kohë të kësaj të drejte në të drejtën ndërkombëtare dhe në vendin tonë, duke filluar që nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku e gjejmë të drejtën mjedisore si të drejtë themelore, traktatet, konventat dhe akte të tjera normative kombëtare apo ndërkombëtare, si dhe në kontekstin e etapave të revolucionit industrial dhe si ndikuan ato dhe aspekte të tjera historike në fushën e mjedisit dhe normave mjedisore dhe lindjen e konceptit të dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile. Në pjesën e parë bëhet një paraqitje e historikut të së drejtës mjedisore në planin ndërkombëtar, më pas vazhdohet me historikun e së drejtës mjedisore shqiptare dhe se si trajtohej përgjegjësia juridiko-civile mjedisore. Historiku fillon me Kushtetutën shqiptare për të drejtën e informimit në lidhje me mjedisin dhe aspekte të tjera se si ajo u amendua, a ka lidhje me mjedisin dhe a e mbrohet atë nga pikëpamja e efektivitetit të aksesit në drejtësi si pjesë e Corpus Iuris (Mandro A, 2007 : 31/32/33). Historiku i Sistemit politiko-juridik dhe doktrina e supermacisë së ekzekutivit dhe gjyqësorit në lidhje me legjislacionin mjedisor; pozita dhe tendenca e sistemit, si dhe fillimet e aksesit në drejtësi për mjedisin dhe dëmit në mjedis.

3.2 Vështrim historik për të drejtën e Mjedisit

Fjala “*Mjedis*” vjen nga fjala shqipe “*midis*”⁷⁵

Fjala Mjedis, sipas Fjalorit të Shqipes së Sotme, nënkupton tërësinë e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, shfaqet një dukuri etj.: hapësira e gjithçka rreth e rrotull; ambient (Akademia e Shkencave, 2002 : 796-797). Mjedis është shkenca që studion marrëdhënien e ndërsjelltë të njeriut me njeriun; marrëdhënien e ndërsjelltë të njeriut me botën që e rrethon; marrëdhënien e ndërsjelltë të njeriut me qenie me ndërgjegje më të ulët. Kjo marrëdhënie e njeriut shtrihet deri në burimet abstrakte, si uji, dielli, lumenjtë, shkëmbinjët, malet, peizazhet, ajri, toka, ngjyrat, estetika etj. Të gjitha këto elemente të marra në unitet, përbëjnë atë që quhet faktori mjedisor ku Toka, Uji, Ajri, janë komponentë të patjetërsueshëm të këtij mjedisi, ku ne japim e marrim me njëri-tjetrin në kuadrin e cikleve të mbyllura (keqpërdorimi apo mospërdorimi i duhur i këtyre komponentëve përkthehet në dëm mjedisor ndaj qytetarit). Vetë Toka deri më sot njihet si planet i pazëvendësueshëm.

Ajo është një cikël i mbyllur në kuptimin se nëse ti hedh diçka që e dëmton atë, ajo ta kthen mbrapsht në kuadrin e ciklit të mbyllur, madje në mënyrë të shumëfishtë, siç po ndodh tani me globalizimin, ku pasojat kryesore të tij po ndihen tanimë jo vetëm në shtetet më të globalizuara, por edhe në Shqipëri me ndryshimet klimaterike me shira të rrëmbyeshëm, me përmbytje zonash të banuara dhe tokash bujqësore, me stinët e vitit të cilat kanë ndryshuar raport me njëra-tjetrën. (Guri S, 2012: 48). Njeriu fal, Natyra nuk fal.

⁷⁵ Cipo K, Çabej E, Domi M, Krajni A, Myderrizi O, UET fq. 318.

Kur flasim për “Mjedisin”, në radhë të parë flasim për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit tonë nga dëmet që shaktohen në mjedis, mjedis është çdo gjë që na rrethon. Pavarësisht se mjedisi ka lindur dhe bashkëjetuar me njeriun, ai u arrit të kuptohej dhe trajtohej si shkencë më vete e të drejtës tepër vonë, prandaj edhe sot ai është ende një fushë e re e të drejtës ndërkombëtare e cila i shërben mbrojtjes së shëndetit, jetës dhe mjedisit në shkallë botërore⁷⁶.

E drejta e mjedisit i përket të ashtuquajturës gjeneratë e tretë e të drejtave të njeriut, për vetë rolin dhe rëndësinë që ajo ka marrë për sigurinë dhe mbrojtjen e qenieve njerëzore.⁷⁷

3.3 E drejta e mjedisi në shek. XVII-XVIII dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis

3.3.1 Anglia

Periudha e mesjetës nuk nxiti zhvillimin e ideve të Realizmit Iluminist për shkak të luftërave edhe mosvendosjes së urave të komunikimit. (Defo D. 1982: 15). Epoka e ideve të ndritura, ose iluminizmi, do të ishte e pashmangshme sepse shoqëria njerëzore ishte në proces evolucion, evolucion i cili fillon me kufizimin e autoritetit të mbretit me Magnia Carta Libertium shek. XII dhe me Bill of Rights shek. XVI (1689), kartë e cila i siguronte çdo individ të drejta për t’u mbrojtur nga arrestimet arbitrare të pushtetit që kishte mbreti, si dhe filloi procesin e shkëputjes së kishës nga shteti dhe kalimi nga e drejta hyjnore në të

⁷⁶ <http://www.unesco.org/most/Fashikulli-3B.pdf> shih instrumentat juridike ndërkombëtare fq. 2.

⁷⁷ <http://www.letterebeniculturali.unibo.it/it/corsi/insegnamenti/insegnamento/2011/353247> shih Gardini G, Regole Dell’Informazione: Principi Giuridici, Strumenti, Casi Bruno Mondadori 2009, 8.

drejtën shkencore -natyrore rreth shekullit të XVI-XVII (Hazizi S: 2008/9). Revolucioni i vitit 1642 në Angli fillon të identifikojë më mirë burimet natyrore dhe shfrytëzimin e tyre, pikërisht një ndër aktet më të hershme që lidhet me mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e minierave dhe djegies së qymyrit në ambiente të hapura nga veprimtaritë e kohës, jo vetëm afër qendrave të banuara, por edhe larg tyre vjen nga Anglia që në shekullin e XIV, ky akt i Mbretit Eduard i Parë⁷⁸ e kufizonte këtë veprimtari në atë masë që ai të mos shfaqte problematika në lidhje me shëndetin e njeriut, natyrën dhe mjedisin. Marrëdhënia e njeriut me mjedisin deri para Revolucionit Anglez të shekullit XVII ka qenë mjaft miqësore, revolucioni industrial i pas shekullit të XVII filloi të shfrytëzonte burimet natyrore të tokës dhe elementeve përbërëse të mjedisit në mënyrë jo shumë të kontrolluar, kjo edhe për faktin se e drejta dhe formimi i strukturave shtetërore ishin në hapat e parë dhe mjedisi ende nuk ishte kuptuar si një faktor jetik për shëndetin dhe sigurinë e shoqërisë. Me lindjen edhe strukturimin e formës së shtetit merr jetë edhe fillimi i normimit të së drejtës për dëmin mjedisor, pasi e drejta zakonore nuk ishte efikase në nxjerrjen dhe mirëpërcaktimin e kësaj përgjegjësie. Duke kaluar nga një e drejtë zakonore në një të drejtë të normuar, përgjegjësia juridiko-civile ndaj mjedisit fillon gradualisht të shfaqet si fushë më vete e së drejtës dhe me rëndësi të madhe. Fundvitet e shekullit të XIX dhe fillimet e shekullit të XX do të ishin vitet e lindjes të së drejtës mjedisore si disiplinë, duke u shfaqur edhe dëmi mjedisor si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile. Shpikja e motorit me avull në gjysmën e dytë të shekullit XVIII në Britaninë e Madhe⁷⁹ nga Xhems Vati do t'i hapte rrugën më vonë edhe

⁷⁸ <http://bybil.oxfordjournals.org/content/69/1/287.citation> shih Shelton D, Kiss AC, Manual of European Environmental Law.

⁷⁹ B. Apostollska – Toshevska, A. Stojmilov, Gjeografia Ekonomike, Drejtimi ekonomik, juridik dhe tregtar Teknik i ekonomisë, Industria dhe transferimi i prodhimtarisë industriale në botë fq. 25.

motorit me djegie të brendshme diesel. Me të ishte shënuar fillimi i revolucionit të parë industrial. Ajo solli deri te zëvendësimi i prodhimit me dorë me anë të makinës, rritjen e produktiviteti të punës dhe deri te zgjerimi i vëllimit të prodhimit, fenomene sociale të cilat diktonin kushte dhe rrethana te reja të marrëdhënieve juridiko-civile të cilat duhet të disiplinoheshin nga e drejta për t'iu përshtatur progresit shoqëror krahas së cilit fillojnë të shfaqen edhe fillimet e shfrytëzimit të burimeve natyrore dhe dëmeve në mjedis nga faktori njeri, edhe si nevojë e një procesi balancues midis veprimtarisë njerëzore dhe natyrës.

3.3.2 Kodi i Napoleonit (KN) dhe ndikimi në të drejtën e mjedisit dhe dëmi në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile

E Drejta e Mjedisit merr pamje reale mbas revolucionit borgjez, anglo-francez të shekullit XVII-XVIII në Europë. Revolucioni industrial e përshtati edhe më mirë me realitetin këtë të drejtë, duke i ardhur në ndihmë edhe me një nga kryeveprat e kodifikimit të së drejtës materiale, si Kodi Civil Francez i Napoleon Bonapartit, i cili bazën e pati tek kodikët e Justinianit të Parë. Napoleonit iu nevojitën mbi 4 vjet punë bashkë me juristët francezë por edhe ekspertë të tjerë për ta studiuar, formuluar, përfunduar edhe normuar Kodin Civil francez, kod i cili hodhi hapin gjigand për rregullimin e marrëdhënieve juridiko-civile, në shoqërinë e pas-revolucionit në Europë, SHBA dhe më gjerë. Ky kod do të hapte rrugën e ndërtimit të legjislacioneve moderne të mëvonshme, të kodeve civile të procedurës civile, të kodeve penale në Franc, Itali, Rusi në Europë e më gjerë. Ai do të përcaktonte të drejtën e pronës private, barazin para ligjit, parimet e përgjegjësi për dëmin e shkaktuar, të drejtën e punës dhe një sërë të drejtash të tjera të cilat shtruan rrugën për zhvillimin e legjislacionit

civil edhe në fushën e mjedisit dhe dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile. Deri para hyrjes në fuqi të Kodit të Napoleonit (1804), në Francë kishte më shumë se 250 kode të ndryshme.

“Kodi i Napoleonit i vitit 1810 u bë baza juridike e periudhës klasike moderne edhe e periudhave të mëpasshme” (Cela K, 2008: 28)

Edhe sot ai mbetet vepra më origjinale e normave materiale dhe procedurale civile, si dhe e normave të tjera ligjore që kanë lidhje me të, pasi Napoleoni nuk u kufizua vetëm në hartimin e normave civile por edhe penale, kushtetuese, administrative, publike, megjithëse kryefjala mbeti Kodi Civil i tij, ose “Kodi i Napoleonit” siç njihet ndryshe. (Tarle E, 2004: 136)

3.4 E Drejta e Mjedisit dhe dëmi në mjedis në shekullin e XX

Periudha e viteve 1900-1945 ishte periudha në të cilën bota do të kalonte midis dy konflikteve botërore të përgjakshme, konflikte të cilat do të merrnin jetën e më shumë se 70 milion jetëve e miliona të plagosur me pasoja të mëvonshme për shëndetin dhe jetën e tyre. Pasojat më të mëdha do t'i kishte mjedisi jo vetëm për dëmin që shkaktuan këto luftëra, por edhe për shfrytëzimin barbar të burimeve natyrore nga faktori njeri në funksion të luftës dhe të një ideologjie shkatërruese.

Me kalimin e sistemit nga ai feudal në atë kapitalist, industria e shfrytëzimit të burimeve natyrore merr formën e industrisë së luftës dhe duke filluar nga vitet 1900 deri në mbarim të Luftës së Dytë Botërore 1945 dëmet ishin të shumta si për njeriun ashtu edhe për natyrën.

Pikërisht rreth viteve 1960-1970 fillon dhe zhvillohet edhe e drejta ndërkombëtare bashkëkohore moderne e mjedisit (Guri S, 2012: 72) si një e drejtë e pazhvilluar më parë, e cila u diktua nga rrethanat e dëmeve të shkaktuara në mjedis, si dhe nga pasojat e konflikteve botërore si një shoqëri e konsumit ku burimet natyrore si pjesë e konceptit të mjedisit fillojnë dhe racionalizohen bashkë me njeriun, proces ky i filluar që në vitin 1750 ku i gjithë sistemi global ka qenë i ndërtuar mbi parashikimin e popullsisë, ushqimit, punëtorëve, ushtarëve; sistem i cili ndryshon mbas shekullit të XXI me futjen e teknologjisë e cila do të çojë në rënien e punës së krahut e të popullsisë, si dhe shtimin e emigracionit (Friedman G, 2010: 29). Gradualisht fillon rregullimi ligjor në mënyrë të posaçme për çështje që lidhen me mjedisin dhe dëmet e shkaktuara ndaj tij. Marrëveshjet e mëparshme midis shteteve kishin karakter thellësisht individuale dhe ishin jo-efikase për të shmangur dëmet që po i shkaktoheshin mjedisit në nivel rajonal dhe botëror, por edhe për t'i paraprirë globalizimit, si procese⁸⁰ këto marrëveshje u zgjeruan dhe u bënë më konkrete si në aspektin e çështjeve që kanë lidhje me mjedisin, por edhe si dimension kufijsh ku marrëveshjet, traktatet, konventat dy-palëshe po zëvendësoheshin me pjesëmarrjen e shumë shteteve duke kaluar nga stadi ndërkombëtar-rajonal në atë ndërkombëtar-botëror. Me zhvillimin e industrisë kemi edhe lindjen e taksave mjedisore në teorinë ekonomike, e cila u zhvillua në saj të ekonomistit Arthur Cecil Pigou 1877-1959, i cili propozoi një tatim që i

⁸⁰ http://www.asil.org/sites/default/files/ERG_ENVIROMENT.pdf International Environmental Law, A Burnet fq. 1.

caktohet ndotësit bazuar në koston e vlerësuar të dëmit të bërë. Në punën e tij, Pigou zbuloi kostot e fshehura të ndotjes prodhuar nga emetimet e gazrave të fabrikave dhe minierave në Mançester, të cilat ishin dyfish më të mëdha në terma monetare se vlera e prodhimit të çelikut të marra së bashku; pra, ai kuptoi se ky shfrytëzim i burimeve natyrore dhe kjo industri prodhimi kishte një rezultat negativ për njerëzimin, prandaj parimi “Ndotësi Pagan” e ka zanafillën te kjo taksë dhe tek ky shkencëtar, dashamirës i mjedisit, ku përgjegjësia civile e palës që ka shkaktuar dëmin në mjedis nuk kufizohet vetëm me kushtin objektiv, dëmin real faktit, por edhe atë që do të ndodhë në të ardhmen në shëndetin e njeriut dhe fenomenet e natyrës të ndikuara nga kjo veprimtari (kostot e fshehura/dëm i fshehur/i heshtur). Në librin e tij "The Economics of Ëelfare", Pigou zhvilloi konceptin e Alfred Marshall për eksternalitetet, kostot e imponuara ose përfitimet që u jepen të tjerëve dhe që nuk merren parasysh nga personi që ka kryer veprimin (dëmi jashtëkontraktor mjedisor). Ai argumentoi se ekzistenca e eksternaliteteve është justifikim i mjaftueshëm për ndërhyrjen e qeverisë. Nëse dikush po krijon një eksternalitet negativ, siç është ndotja, për shembull, ai është duke u angazhuar në shumë aktivitete që gjenerojnë eksternalitetin. Pigou evokoi një taksë mbi aktivitete të tilla për t'i dekurajuar ata. Pigou mbështeti subvencionet për aktivitetet që krijuan eksternalitete të tilla pozitive. Këto tani quhen taksat dhe subvencionet Pigoviane.

Analiza e Pigou u pranua deri në vitin 1960, kur Ronald Coase tregoi se taksat dhe subvencionet nuk janë të nevojshme nëse njerëzit e prekur nga eksternaliteti (dëmet në mjedis/ jashtëkontraktore) dhe njerëzit që e krijojnë atë lehtë mund të mblidhen së bashku dhe të negociojnë. Shtimi i skepticizmit rreth konkluzioneve të Pigou është pikëpamja e re

e prezantuar nga ekonomistët e zgjedhjes publike, që qeveritë dështojnë ashtu siç bëjnë tregjet. Megjithatë, shumica e ekonomistëve ende mbrojnë taksat e Pigovisë si një mënyrë shumë më efektive për t'u marrë me ndotjen sesa standardet e imponuara nga qeveria⁸¹.

Lindja e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar në mjedis dhe dëmshpërbilmi apo kompensimi i saj, identifikohet drejtpërsëdrejti me parimin e Pigou “Kush ndot, paguan”, teori e cila e zhvilloi dhe është aktuale edhe sot në fushën e dëmit në mjedis, kryesisht atij jashtëkontraktor, por edhe duke i dhënë të drejtës së mjedisit një qasje më reale dhe objektive si fushë e një rëndësie të veçantë.

3.4.1 Historiku i së drejtës së mjedisit, Karta Universale e të Drejtave të Njeriut, OKB dhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë

Aty nga vitet 1910, bota ishte shumë më tepër e njësuar sesa në çdo periudhë tjetër të historisë njerëzore. Pjesa e tregtisë ndërkombëtare e prodhimit të përgjithshëm botëror ishte më e madhe se asnjëherë më parë, ndërsa do t'i afrohej kjo gjendje vetëm në vitet 1970-1980, investimet si përqindje totale ishin më të larta se kurdoherë më parë. E drejta ndërkombëtare ishte e drejta që vinte nga tradita e Grotiusit. Sistemet ndërkombëtare ishin sisteme Perëndimore të modelit të Vesfalisë “Shtete Kombe Sovrane” dhe i territoreve koloniale që i kishin nën zotërim. Përfitime të këtij sistemi global janë zhvillimet e pjesës së dytë të pasviteve 1500, me krijimin e organizatave apo aleancave politike, ushtarake, e

⁸¹ <http://www.econlib.org/library/Enc/bios/Pigou.html>

më pas të shoqëruar me marrëveshje për tregtinë, ekonominë apo forma të ndryshme organizimi, (Huntington S P, 2004: 70-71) elemente mbi të cilat ngrihet edhe e drejta e mjedisit. Me mbarimin e luftës së parë botërore, u krijua Lidhja e Kombeve, 14 shkurt 1919 (Kissinger H, 1999: 243) e cila do t'i hapte rrugë më pas, në vitin 1945, themelimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Deklaratës Universale të së Drejtave të Njeriut 1948 (OKB - DUDNJ), themelim i bërë nga shtetet e dala fituese mbas Luftës së Dytë Botërore. Kjo organizatë do të jetë ende sot organizata më e madhe në botë për numrin e anëtareve që ka dhe fuqinë e vendimeve të saj. Me themelimin e OKB-së, fillojnë politikatat e para në lidhje me çështjet që prekin mjedisin në nivel botëror edhe si aspekte themelore të çështjeve të sigurisë globale⁸². Asambleja e Përgjithshme e OKB, duke u mbështetur në Këshillin Ekonomik e Social ka formuar një komision të veçantë - Komisioni për të Drejtat e Njeriut me 1946, me detyrë që të përgatisë rregullat më të hollësishme lidhur me të drejtat e njeriut. Komisioni ka formuar më vonë më shumë nënkomisione, këshilla, grupe ekspertësh etj., të ngarkuar që të merren me pengimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e pakicave, çështjet e cënimit të të drejtave të njeriut, ky komision ka trajtuar indirekt edhe çështje që lidhen me mjedisin në atë periudhë. Me miratimin e Kartës Universale të të Drejtave të Njeriut, 10 dhjetor 1948 (Komiteti. Sh. Helsinkit 1994: 10) dhe ruajtjen e këtyre të drejtave sipas Konventës së Romës (Konventa e Romës, 4 nëntor 1950, hyrë në fuqi më 3 shtator 1953), këto të drejta bëhen pjesë e të drejtës ndërkombëtare njëherë e përgjithmonë, duke pushuar së qenuri çështje dhe kompetencë ekskluzive e shteteve, ato tashmë bëhen çështje të shqetësimit të ligjshëm të bashkësisë ndërkombëtare, duke filluar edhe faza e parë ajo e harmonizimit të legjislacionit ndërkombëtar dhe me një perspektivë

⁸² <https://searcheorks.stanford.edu/vieë/2094600>

të hapur në të ardhmen për ta unifikuar atë në nivel rajonal e global⁸³. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, si pjesë e strukturës së OKB-s, në statutin e saj identifikon parimet e përgjithshme nga të cilat mund të burojnë ligje; ligje mbi të cilat do të zgjidhen rastet e çështjeve konfliktuale që lidhen me dëmin e shkaktuar në mjedis. GJND arsyeton se e drejta zakonore nuk mund të jetë pjesë integrale e principeve të ligjit por pjesë plotësuese e ligjit në tërësi, pasi e drejta zakonore nuk është e njëjtë në çdo vend⁸⁴. Nuk është e njëjtë për çdo rast dhe zgjidhjet nuk janë efektive, përkundrazi, praktikat e mira ndërkombëtare në lidhje me çështjet e mjedisit/ dëmet në mjedis, lundrimi p.sh., fillojnë edhe bëhen raste krahasuese ndërshtetërore dhe kështu ato marrin një kuptim më të gjerë rajonal dhe ndërkombëtar që shpesh drejt një përafrimi më efikas të legjislacionit mjedisor si një çështje e përbashkët, ku e drejta zakonore ja lë vendin principeve të legjislacionit ndërkombëtar, parimeve të së drejtës ndërkombëtare, të cilat ecin në rrugën e harmonizimit të unifikimit jo vetëm të legjislacionit mjedisor të organizatave rajonale, por të së drejtës në tërësi si sfida për shoqërinë. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, si rast të parë të saj ka patur gjykimin e çështjes “Korfuzi”⁸⁵ 1946, kur Shqipëria ende nuk ishte pjesë e OKB. Nga jurisprudenca ka patur edhe një lloj diskutimi se kjo çështje është trajtuar edhe në kuptimin e dëmit në mjedis, që i është shkaktuar mjedisit nëpërmjet ndotjes së ujrave detare nga shpërthimi dhe minimi detar.

⁸³ Bercusson B, European Loë (in Context) (Promoting a process for realisation of fundamental labour rights) fq. 101.

⁸⁴ <http://www.unep.org/delc/Portals/119/publications/Judicial-Handbook-Environmental-Law> Për më shumë shih: Judicial Handbook on Environmental Law, Shelton D, Kiss A, United Nations Environment Program, Kreu 1 fq. 37.

⁸⁵ Krisaf K. Shkrim i botuar në ballkanweb në 21/10/ me rastin e 70 vjetorit të “Incidentit të kanalit të Korfuzit” 2016, shkëputur nga libri për tokën dhe detin e Shqipërisë, <http://www.balkanëeb.com/site/incidenti-i-korfuzit-ne-driten-e-fakteve-te-reja/>

E drejta ndërkombëtare e mjedisit rreth viteve gjashtëdhjetë fillon dhe bëhet pjesë integrale e shoqërisë, edhe për shkakun e rreziqeve që po i kanoseshin mjedisit nga shfrytëzimi i burimeve natyrore në mënyrë të pakontrolluar, si dhe ndotja industriale. Konferenca e Stokholmit (1972) mblodhi rreth 113 shtete, organizata ndërkombëtare, organizata joshtetërore dhe është konsideruar si pika e kthesës së historisë së zhvillimit të së drejtës ndërkombëtare mjedisore dhe mbrojtjes së mjedisit

Konferenca arriti në dy qëllime kryesore:

1. Miratoi një deklaratë mbi mjedisin njerëzor, dhe një sërë parimesh detyruese politikisht që do të ndiqeshin prej qeverive dhe popujve në mbrojtje të mjedisit dhe burimeve natyrore, si ajri, uji, toka, flora dhe fauna, të cilat duhet të mbrohen për përfitime të gjeneratave të sotme dhe atyre të ardhmshme përmes planifikimit dhe menaxhimit të kujdesshëm.
2. Konferenca miratoi një paket prej 109 rekomandimesh, ligjërisht jo të detyrueshme për shtetet, por me qëllimin për të parandaluar dhe adresuar problematikat e së ardhmes, si çështje që lidhen me legjislacionet kombëtare dhe liritë e të drejtat e njeriut që ndikohen nga çështjet e mjedisit, dëmin në mjedis, përgjegjësinë ndaj këtyre dëmeve etj. Kushtetutat e shumë vendeve si Spanja dhe Portugalia, disa vite më vonë mjedisin do ta ngrinin në nivel kushtetues, model i cili kryesisht do të ndiqesh nga vendet e Europës Lindore edhe pas viteve '90.

Konferenca e Stokholmit do të pasohet më vonë edhe nga një sërë traktatesh, protokollesh në nivel global dhe rajonal për mjedisin, si ajo e raportit Brutland 1987⁸⁶ – ku u paraqit për her të parë termi zhvillim i qëndrueshëm, për të vazhduar me Johaneshburgun në vitin 2002 e deri tek Potokollit i Kyotos 1997, si dhe Marrëveshja e Parisit 2015 për reduktimin e emisioneve dhe gazrave ndotëse me efektin serë.

3.4.3 Historiku i së drejtës së Mjedisit dhe dëmit në mjedis si pjesë e lirive civile në të Drejtën Europiane, KEDNJ dhe GJEDNJ

Konventa Europiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive (KEDNJ) themelore të saj, u miratua në 4 Nëntor të 1950. Konventa Evropiane ka rëndësi shumë të madhe, pasi është dokumenti i parë që rregullat deklarative i ka shndërruar në rregulla kontraktuese, ka paraparë një mekanizëm i cili ka për të siguruar zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut ndërmjet shumë subjekteve të një rajoni, dhe në fund hyrja në Këshillin e Evropës kushtëzohet me repektimin e të drejtave të njeriut të kësaj konvente dhe detyrimeve që lindin nga kjo konventë. Si fillim, kjo konventë i trajton çështjet e mjedisit dhe dëmit në mjedis brenda aspektit ekonomik-tregtar, më pas shohim se e drejta e mjedisit shfaqet si politikë më vete e Këshillit dhe Unionit Europian; ajo fillon dhe trajtohet nga pikëpamja ligjore si një e drejtë themelore për liritë dhe të drejtat e individit për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, të pastër dhe të sigurt për të tashmen dhe brezat e ardhshëm. Në vijim do të

⁸⁶ Udhëzues për strukturat e qeverisjes vendore E drejta e publikut për informacion mjedisor dhe pjesëmarrje në vendimmarrje fq. 11.

kemi protokolle si ai i 1952, 1963, 1994 etj., të cilat dalin për të plotësuar këto konventa dhe deklarata. Më 21 janar 1959 u krijua Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut për të zgjidhur këto konflikte që të do të lindnin nga interpretimi i amendamenteve të KEDNJ, por edhe i çështjeve të ndryshme për të harmonizuar dhe unifikuar legjislacionet e vendeve me atë komunitarë.

Traktati i Romës 1957

Edhe pse Traktati i Romës (1957) nuk parashikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë amandamente në lidhje me çështjet dhe dëmet që mund t'i shkaktoheshin mjedisit, nenet 100 dhe 235 (Pozzo B, 2005: 24) të Traktatit të Romës, në të cilin neni 100 flet për tregun e përbashkët, mbi të cilin “e lejon Komunitetin të angazhohet në krijimin dhe funksionimin e tregut të përbashkët” dhe neni 235 vjen në formën e një dispozite të përgjithshme ku Komunitetit i duhet të marrë masa të domosdoshme, për të cilat ky traktat nuk ka përcaktime specifike me synim kryesor, në çastin e hartimit të traktatit, rritjen e shkallës së bashkimit ekonomik dhe politik, si dhe vendosjen e një tregu të përbashkët edhe pse në mënyrë të drejtpërdrejtë fjala “Mjedis” nuk përmendej; sigurisht ka patur edhe problematika të shfaqura më vonë të cilat u pasuan nga traktatet, konventat dhe aktet e tjera për të plotësuar boshllëkun ligjor të krijuar për shkak të zhvillimit dhe globalizimit por edhe si një proces në dinamikë i së drejtës mjedisore. Që prej vitit 1967 e deri në vitin 1987 Këshilli i Evropës krijoi dhe miratoi më shumë se 150 akte normative dhe për çështjet e

mjedisit parashikohet një seksion i vecantë si pjesë e rritjes ekonomike dhe një pjesëmarrje me e gjerë në politikibërjet për çështjet e mjedisit, si ajo e informimit së pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes për çështjet mjedisore të cilat lidhen më padinë mjedisore dhe efikasitetin e saj

Akti Unik 1987 i KE do të plotësojë parimet e papërmendura në Traktatin e Romës ku çështjet, dëmet dhe masat që duhet të merren në lidhje me mjedisin u trajtuan në mënyrë të posaçme. Rezoluta e Këshillit të Komunitetit European më datë 6 maj 1986 ishte rruga e nisur në Samitin e Stokholmit ku u vendosën parimet kryesore për ndërtimin e Aktit Unik. Akti Unik riafirmoi se në funksion të përmbushjes së të ashtuquajturës “Nevoja të Mëdha”, shtetet anëtare duhet të provojnë se legjislacionet kombëtare nuk janë diskriminuese ose nuk kanë amendamente kufizuese në lidhje me nevojat e mëdha: si shëndetësia, mjedisi, tregtia, siguria, mbrojtja e konsumatorit etj. Nenet 130r dhe 130t të Aktit Unik e parashikonin “Mbrojtjen e Mjedisit” si një nga objektivat kryesore të Komunitetit⁸⁷. Shtetet e Bashkuara, si pjesë e bërthamës së qytetërimit Perëndimor (Huntington S P, 2004 : 20/291/192), gjatë viteve 1960-1970 miratuan një sërë aktesh normative në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Kjo periudhë u quajt stadi i “ Interesit Publik ” sepse shumë ligje i vinin në mbrojtje mjedisit, konsumatorit dhe shëndetit të njeriut në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte si asnjëherë më parë, ndërkohë fillon sanksionohet edhe parimi “Ndotësi Pagan”. Në nivel global u organizua Konferenca e Parë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) në Stokholm “Mbi Mjedisin Njerëzor”, e cila i dha një interes dhe vëmendje më të madhe këtyre çështjeve. Mbas samitit të Parisit, i cili pasoi Konferencën e

⁸⁷ Po aty.

Stokholmit, në vitin 1973 u përpilua nga Komuniteti një Plan Veprimi për Mjedisin i cili njihet si Plani i Parë në lidhje me këto çështje. Edhe Gjykata Europaine e Drejtësisë e mbështeste shqyrtimin, gjykimin dhe vendimmarrjen mbi këto dispozita të traktateve të mësipërme⁸⁸, si baza kryesore në lidhje me çështjen e dëmit në mjedis apo që kanë lidhje me mjedisin. Krijimi i Ministrive të Mjedisit në shumë vende të botës gjatë kësaj periudhe do të pasohej edhe nga themelimi i shumë organizatave mjedisore. Në Shqipëri, Ministria e Mjedisit krijohet në vitin 2001.

3.5 Hitoriku i dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile në Shqipëri

3.5.1 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis sipas Kanunit të Lek Dukagjinit (KLD)

Ndër burimet kryesore të së drejtës zakonore në vendin tonë, ka qenë Kanuni i Lek Dukagjinit, përmbledhje e At Shtjefën Konstandin Gjeçovit (l'Albania, 1941 327). KLD i përbërë nga norma penale dhe jo penale, Kanuni i Lumës, Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Labërisë ose Sharrtet e Idris Sulit, ndryshe dhe kanune të tjerë lokalë apo rajonalë, i trajtonin çështjet që lidheshin me mjedisin jo në mënyrë direkte dhe duke përmendur termin mjedis në veçanti. KLD kishte disa norma të cilat ishin ndërtuar mbi logjikën e veprimtarisë së asaj zone, e cila në aktivitetin e saj kryesor kishte blegtorinë; këto vepra trajtoheshin në bazë të madhësisë dhe rëndësisë së dëmit që u shaktohej personave në pronën private ku objekte më së shumti të këtyre veprave ishin vjedhja e bagëtive dhe e

⁸⁸ <http://publications.eipa.eu/en/details/&tid=1556> European Environmental Policy: The Administrative Challenge for the Member States, Demmke Ch and Unfried M, 2001, fq. 316.

gjësë së gjallë. Se si do të ishte dëmshpërblimi dhe forma e veprës penale ose civile, ajo përcaktohej rast mbas rasti. Kishe raste kur dëmi kalonte nga një vepër civile në atë penale, madje edhe duke dëmtuar nderin dhe dinjitetin e të dëmtuarit. Veprat në lidhje me mjedisin ishin kryesisht ato që lidheshin me pronën ose nënkuptonin shkatërrimin e këtyre pasurive, siç është rasti i shkatërrimit apo djegia e pyjeve, vrasja e shpendëve, dëmtimi i kanaleve vaditëse apo burimeve ujore, ose pasurive të përbashkëta që kishte katundi, këto vepra dënoheshin edhe penalisht por edhe si forma të dëmeve civile për shkak të dëmtimeve që i kishte ardhur mjedisit. P.sh. vjedhja e bagëtive në perimetrin e banesës quhej vjedhje e banesës; përveç sanksioneve civile dhe rikthimin në gjendjen e mëparshme, kishte edhe dëmshpërblim edhe sanksione penale për personin, si lëcim (largim) nga fshati për muaj, madje edhe vite. Vjedhja e mbajtësve të bletëve (kosheret) dënohej si vepër penale edhe civile njëkohësisht, për shkak të rëndësisë që i jepej nga (Elezi I, 1983 : 220) KLD këtij aktiviteti. Dëmi jo i pasur (moral) apo dëmi i shkaktuar në shëndet, e ka zanfillën si institut në këto kode zakonore, pasi bëhej fjalë për dëme ndaj shëndetit dhe moralit.

3.5.2 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis sipas Statutit të Shkodrës

Statuti i Shkodrës⁸⁹ (SSH) njihet si një nga statutet e para dhe burim i së drejtës shqiptare rreth shekullit të XIV. Ai kishte edhe norma të cilat e trajtonin mjaft mirë kontekstin e përgjegjësisë juridiko-civile të dëmit në mjedis. Veçojmë disa prej tyre: “Mbi hedhurinat” parashikohej gjobitje për këdo që hidhte mbetjet nga ballkoni, dritarja, në rrugët publike

⁸⁹ Në shek. XIV Venediku ka përparësi dhe ndikimi nivelues i Venedikut nuk manifestohet vetëm në faktin se statutet konfirmoheshin në Venedik, por edhe se apelet gjyqësore përcaktoheshin nga guvernatorët që, në instancë të fundit, si p.sh. ai i Shkodrës apo i Durrësit, caktoheshin me urdhër dhe se vetë statutet e Venedikut qenë burimi i së drejtës në statutet e qyteteve shqiptare, BIB'LIOTHECAE 4 Organ i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, fq 25.

apo private, apo të çdo ambienti tjetër publik apo privat. Gjopa ishte e parashikuar 12 gosh dhe ndahej përgjysmë mes Kontit dhe Komunës. Infrasktruktura komunitare ose prona publike si servitutet mbroheshin nga hapja e themeleve të banesave, ndotja nga apo hedhja e dherave dënohej me gjobë 4 hyperpeshë të skalvonishë dhe ndahej përgjysmë mes Kontit dhe denoncuesit. Konti, si përfaqësues i zonës dhe sovrani i saj, merrte gjysmën e të hollave nga vjelja e gjobave për dëmtimet ndaj mjedisit; pjesa tjetër i shkonte autoritetit lokal, komunës dhe palës së dëmtuar. Shihet qart se dëmi/jashtëkontraktor (mjedisor) është parakusht i lindjes së përgjegjësisë juridiko civile në SSH.

3.5.3 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis sipas Kanunit të Labërisë

Kanuni i Labëris në nenin 394 (Elezi I: 146-147), kishte përdorimin e përbashkët të pronave, ku thuhet: 1. Pronat e përdorimit të përbashkët zotërohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë banorët e bashkësisë vendore. Kudo vepron rregull, “sot kam unë, nesër ke ti” 2. Asnjë pjesëtar nuk ka të drejtë të shesë a të blejë pjesë të kories së mushasë, apo pyllit. 3. Drurët e mëdhenj, lisat, ku mërzejnë bagëtitë, nuk mundet të priten nga njeri. 4 Mali, koria, janë të përbashkëta për kullotën e gjësë së gjallë, ashtu edhe për lëndë drusore. 5. Çdo shtëpi ka pjesë të pronës së përbashkët, e kështu me radhë. Neni 395 flet për përdorimin e malit dhe livadhit, neni 396 flet për prerjen e drurëve dhe të pyjeve, neni 397 për shfrytëzimin e pyjeve për lëndë ndërtimi, neni 398 pronësia mbi gjënë e gjallë, e kështu me radhë. Rregullimi juridik që ka bërë Kanuni i Labërisë është i ngjashëm me kanunet dhe statutet e tjera në Shqipëri të kohës, norma të cilat edhe pse nuk kanë termin literal mjedis, mbrojnë mjedisin nëpërmjet faktorëve dhe elementeve që përbëjnë mjedisin. Duke patur

parasysh që Shqipëria ka qenë një vend i prapambetur, dëmet ndaj mjedisit, si ndotja e ujit, djegia e pyllit, dëmtimi i tokës nga bagëtitë e të tjera, trajtohej në bazë të së drejtës zakonore sepse nuk ekzistonte ndarja klasike penale apo civile në këtë fushë si parakusht i të së drejtës mjedisore. P.sh., neni 396 i Kanunit të Labërisë shprehet se: 1. Prerja e drurëve. Në pyje të përbashkëta ka vende të caktuara për prerjen e druve të zjarrit apo të lëndës drusore. 2. Koria shfrytëzohet në mënyrë të barabartë nga banorët e bashkësisë vendore për lëmishte, për dru zjarri, vegla pune për kullotë etj. Neni 397: 1. Shfrytëzimi i pyjeve për lëndë ndërtimi. Shfrytëzimi i pyjeve për lëndë ndërtimi bëhet në vende të caktuara për çdo bark, mëhallë dhe bashkësi vendore, në pyje, në male apo aty ku ka drurë të përshtatshëm. 2. Shkelja e këtyre rregullave dënohet me gjobë dhe deri në dëbim nga bashkësia vendore të personit. Neni 765. Dëmtimi i pyllit. Askush nuk ka të drejtë të dëmtojë pyllin. Pylli është pasuri e përbashkët e tërë bashkësisë së njësisë vendore. Për dëmtimin e pyllit me prerjen e drurëve të njoma (fidanë) ose me djegie, fajtori paguan dëmin dhe gjobën sa të vendosë gjyqi i pleqve. Shohim se këtu kemi dy momente, gjobën si një dënim i komunitetit (aspekti administrativ dhe penal) si dhe dëmin (dëmin civil – mjedisor) që lindte si detyrim ndaj kreditorit. Këto zakone u trashëguan brez pas brezi në traditë gojore, ritesh etj. (Elezi I: 147-245)⁹⁰. E drejta zakonore, mbrojtjen e mjedisit e trajtonte edhe si pjesë të pronës së bashkësisë (pronë publike) por edhe në sferën e pronës private. Më pas këto norma zakonore të cilat shfrytëzonin në mënyrë racionale pyjet, tokën, përdorimin e ujit dhe gjithçka, kishte lidhje me mjedisin dhe do të bëheshin një bazë e mirë për ndërtimin e normave juridike, norma të cilat më pas do të reflektoheshin edhe në fushën e mjedisit dhe dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.

⁹⁰ Elezi I, Kanuni i Labërisë, nr 34 Uet: 147-245

3.5.4 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis mbas Shpalljes së Pavarësisë, si dhe periudha e monarkisë

Me shpalljen e Pavarësisë në 28 Nëntor 1912, u hodhën themelet për ndërtimin e shtetit të së drejtës nga Burri i Urtë Ismail Qemali dhe patrioti Isa Boletini e të tjerë. Më 4 dhjetor të 1912 u krijua qeveria e parë, megjithëse muajt dhe vitet e para që do të pasonin ishin ende të dobëta për të ndërtuar institucione dhe norma juridike të qëndrueshme për kërkesat e kohës. Ende nuk kishim ndërtuar një substrat për legjislacionin dhe në veçanti për të drejtën e mjedisit. Në fillim të vitit 1925, Kuvendi Kushtetues vendosi që Shqipëria të shpallej Republikë dhe më 2 Mars 1925 miratoi Statutin Themeltar të Republikës Shqiptare. Me kalimin nga Monarki në Republikë, filloi edhe evolucioni në legjislacionin vendas. Këshilli i Ministrave me vendim nr. 1327, datë 7.8.1926, miratoi Komisionin Qendror Legjislativ të përbërë prej avokatëve, Thoma Orollogaj, Agjah Libohova, Baltazar Benusi, Mehdi Frashëri e Faik Dibra. Ky Komision kishte për detyrë të hartonte një raport “Mbi përmirësimin dhe modernizimin e ligjeve të drejtësisë”, ku vëmendja kryesore ishte te Kodi Civil, Kodi Penal, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurës Penale, Kodit të Tregtisë dhe ligjit mbi organizimin e gjyqeve. Kodi Civil I 1929 (Sinani P. A, 2013: /12/13/14)⁹¹. Kalimi nga Republikë në Monarki në vitin 1928 nuk e çënoi evolucionin për përmirësimin e legjislacionit shqiptar, përkundrazi, e përshpejtoi si proces duke kaluar nga e drejta osmane (Mexheleja) në të drejtë në Civil Law .

Kalimi nga e drejta otomane në atë romano-gjermanike (civil law) në periudhën e mbretit A. Zog, e vuri legjislacionin, institucionet dhe shoqërinë shqiptare të kohës përpara sfidave

⁹¹ Petrit. A. Sinani, historian, Avokatia VI, 2013: /12/13/14

dhe risive me të cilat ajo nuk nuk ishte përballuar më parë, përfundimet ishin një modernizim i legjislacionit të kohës dhe një hap përpara i Shqipërisë drejt shoqërive perëndimore. Ende sot, Kodi Civil ose Kodi i Zogut (1929) njihet për saktësinë, qartësinë, vizionin perëndimor dhe thjeshtësinë e tij në fushën e së drejtës. “Çdo pjesëtar mund t’i përdorë gjanat e përbashkëta, me konditë që përdorimi të bahet simbas destinacionit të caktuem prej zakonit dhe të mos përdoren kontra interesës”, pra përdorimi i pasurisë së përbashkët lejohet në përputhje me interesin publik. (Kodi Civil, 1929: Neni 1025)

Trajtimi i dëmeve të shkaktuara në mjedis dhe çështjeve të lidhura me të mbështetej më shumë në interpretimin e dispozitave për tokën, ujin etj. si dispozita të përgjithshme. P.sh., në librin e tretë të Kodit Penal trajtoheshin disa çështje që lidheshin me mjedisin, një dispozitë e tillë ishte neni 542 që fliste për rreziqet e përbashkëta ose komune, siç ishte ndotja apo hedhja e sendeve të ndotura në puse, sterna, burime, lumenj, vija dhe kanale vaditëse apo burime ujore të pijshme ose për gatim. Në bazë të kësaj dispozite të KP, ndëshkohej kushdo që *“nëpër puseta, puse, sterna burime, lumenj ose vija, ujnat e të cilavet përdoren për me pi ose me ba gjellë ose pije, hedh sende të qelbuna ose të tjera gjana që sjellin një krupë (degout), kur përdoren si dhe ay që fëlliq ato”*. Mosrespektimi i urdhërave të autoritetit për zbatimin e vendimeve që ai përcaktonte apo detyrime ligjore për pastrimin, përsëritja e tyre përbënte rrethana rënduese⁹². Vepra të tjera kundër mjedisit që trajtoheshin nga e drejta penale më shumë¹³⁷ ishin të parapara si delikte, p.sh. rasti i dëmtimit të drurëve frutorë, (në kuadrin e dëmtimit të pronës), gjuetia e paligjshme në pronën e tjetrit dhe kur pronari ia ka ndaluar këtë të drejtë. Raste të veçanta të ndotjes së

⁹² Kodi Penal, 1928 neni 543.

ujit të pijshëm ishin përfshirë në titullin e VII të librit të dytë mbi deliktet kundër “tanësisë publike”, të mirës publike. Në kod gjejmë edhe disa rregullime të posaçme si: “Përgjegjësia për dëmet e shkatuara nga shembja e ndërtesave”, “Përgjegjësia nga dëmet e shkaktuara nga kafshët” etj.

Dëmet ndaj ushqimeve publike, shëndetit, shkatërrimi apo ndotja e ujërave komunë që vinte jetën dhe shëndetin e njerëzve në rrezik, përbënte krim mjedisor dhe dënohej, përveç shpërblimit të dëmit në mjedis të shkaktuar ndaj personit. Zjarrvënja e pyjeve ishte një krim tjetër mjedisor që trajtohej në kuadrin e së mirës publike, ndaj edhe marzhi i dënimit ishte i rëndë. Pavarësisht se në periudhën e mbretit A. Zog nuk shikojmë ndonjë rregullim të posaçëm në germë të dëmit për dëmin në mjedis, por në frymë dhe në interpretim të dispozitave të Kodit Penal dhe Civil të kohës ajo ekzistonte dhe deri diku krijonte një bazë të shëndoshë për mbrojtjen e jetës, shëndetit dhe mjedisit të kohës, pasi si bazë të përgjegjësisë juridiko-civile jashtëkontraktore ishin elementet që janë edhe sot për dëmin mjedisor, faji, lidhja shkakore, paligjshmëria e veprimit dhe dëmi. Legjislacioni i periudhës së Mbretërisë ishte mjaft i avancuar për kohën dhe baza kryesore e legjislacionit të shtetit modern shqiptar, e cila vazhdon edhe sot.

3.5.5 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis midis viteve 1945-1990

Me mbarimin e luftës dhe çlirimit të vendit nga pushtuesi, në vitin 1945-1946 legjislacioni shqiptar pësoi një regres duke cënuar parime të rëndësishme të shtetit të së drejtës, si e

drejta mbi pronën ,liritë politike, ekonomike etj. Reforma agrare e vitit 1946 shpronësoi pa shpërblim tokën, ndërtesat dhe gjithë inventarin bujqësor. U ndalua shitblerja, qiradhënia, tjetërsimi, lënia peng dhe trashëgimi i tokës. Pyjet, kullotat, ujërat u shtetëzuan dhe një pjesë e tyre u kthye në pronë të përbashkët të komunitetit. Pronarëve kryefamiljarë që punonin tokën vetë iu la në posedim deri në 5 hektarë tokë. Në vitin 1975, me Kushtetutën e re të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, toka përfundimisht u shpall pronë ekskluzive e shtetit ku individi si pronar i tokës privohet nga çdo e drejtë në lidhje me të. Ndryshimi i regjimit të tokës, si dhe e drejta e pronës dhe e lirive të lidhura me të, do të riktheheshin me përmbyshjen e sistemit në fillim të viteve 1990 dhe futjen e sistemit kapitalist si model demokratik, duke u mbështetur në parimet dhe liritë themelore të shtetit të së drejtës, si ato politike, ato për pavarësinë e institucioneve, besimet e ndryshme fetare filozofike, liritë vetjake (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, kreu II) etj., si dhe një shoqëri ku iniciativa dhe sipërmarrja e lirë ekonomike i nënshtrohej rregullave të një tregu dhe konkurrence të lirë dhe të ndershme.

Kur flasim për legjislacion mjedisor, Shqipëria, një vend jo vetëm që kishte mbetur mbrapa nga izolimi, por edhe si pjesë e një sistemi juridik global, ku e drejta e mjedisit pothuajse ka qenë e panjohur në këtë fushë rrjedhimisht legjitimimi për dëmit në mjedis ka qenë i panjohur deri në vitet '90. Gjatë kësaj periudhe u morën disa masa të cilat kanë ndikuar në komponentë të veçantë të natyrës, si relievi, bimësia, tokat, hidrografia etj., por edhe si peizazhe karakteristike që formohen nga uniteti i tyre, ku peizazhet natyrore janë zëvendësuar prej atyre antropogjen. (Akademia e Shkencave, Vëll.1,199: 359).

Gjatë kësaj periudhe, Shqipëria bëhet anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara⁹³, anëtarësim në të cilin ajo do të bëhet pjesë edhe e disa detyrimeve ndërkombëtare që buronin nga statuti i OKB dhe KDNJ. Ndryshimet ligjore të viteve 1948 dhe më pas ato të viteve 1952 do të prekjin më shumë në formë edhe disa dispozita të mëparshme në lidhje me dëmet në mjedis, ato ishin të shpërndara në kapituj dhe nënkapituj të pjesës së posaçme: Kapitulli i Tretë i Kodit Penal trajtonte krimet në mjedis, me titullin “krime kundër sistemit socialist të ekonomisë”, duke iu kushtuar dy nënkapituj krimeve në bujqësi, në gjueti dhe peshkim. Shkelja e karantinës së bimëve apo shkelja e karantinës së kafshëve, të veterinarisë ishin pjesë të nënkapitullit që trajtonte bujqësinë. Legjislacioni i vitit 1945 - 1971 parashikonte disa akte normative në lidhje me mbrojtjen e bujqësisë dhe pyjeve të tilla si: Dekreti mbi Mbrojtjen e Tokës⁹⁴, objekt i cili ishte miradministrimi i tokës, dekreti mbi ndërtimin dhe administrimin e veprave të kullimit dhe ujitjes së tokës⁹⁵, dekreti mbi mbrojtjen e bimëve⁹⁶, mbi organizimin rrënjësor të punës kërkimore-shkencore në lëmin e prodhimit bujqësor⁹⁷ dhe shumë akte të tjera për pyjet, kullotat, bujqësinë, që në tërësinë e tyre përbënin korpusin ligjor mjedisor (përmbledhëse e përgjithshme e legjislacionit në fuqi të Republikës Popullore të Shqipërisë 1945-1971, fq. 237-315), Vendim i kryesisë së Këshillit të Ministrave për disa masa ta ngutshme për kursimin e karburanteve dhe lëndëve djegëse e të tjera, udhëzim i Këshillit të Ministrave për saktësimin e matjes së karburanteve

⁹³ http://www.punetejashme.gov.al/files/userfiles/Aktet_e_OKB.pdf

⁹⁴ Dekret për Mbrojtjen e Tokës, nr 4823, datë 2.3.1971, g.z, nr 2/1971.

⁹⁵ Dekreti nr, 4311, datë 8.9.1967, g.z. nr 11/1967.

⁹⁶ Udhëzim nr 6, datë 14.6.1983i Këshillit të Ministrave për saktësimin e matjes së karburanteve gjatë furnizimit dhe shpërndarjes së tyre.

⁹⁷ Dekreti mbi mbrojtjen e bimëve nr 4757, datë 3.11.1970, g.z, nr 9/1970, VKM nr 26, datë 11.4.1966, g.z, nr 2/1966.

gjatë furnizimit⁹⁸ dhe shpërndarjes së tyre e shumë akte të tjera që kanë lidhje indirekte me mjedisin⁹⁹. Dekreti i vitit 1973 “Mbi mbrojtjen e ambientit nga ndotja” parashikonte disa masa për shkarkimet e gazrave, lëngjeve të ngurta, radioaktive, në tokë, ujë, ajër të institucioneve në masën e përcaktuar nga dekreti. Ky dekret përcaktonte edhe vendet e posaçme për hedhjen apo grumbullimin e mbeturinave, larg qendrave të banuara, larg fshatrave qyteteve, porteve, lumenjve, apo vendeve të përcaktuara nga ligji ku ndalohej kjo veprimtari. Dispozita e parë për mbrojtjen e ambientit është trajtuar si vepër penale nga Kodi Penal i vitit 1977 (Kodi Penal i Shqipërisë 1977, Neni 173/174) i mbështetur në dekretin e vitit 1973 “Mbi mbrojtjen e ambientit nga ndotja” (ujë, ajër, tokë), dispozitë e cila parashikonte se institucioneve, ndërmarrjeve, organizatave, u ndalohej të ndotin, ujin, ajrin, tokën, natyrën, në atë masë që rrezikohej shëndeti i personit si dhe dëmtimi i rëndë i natyrës, florës dhe faunës¹⁰⁰. Objekt i kësaj vepre penale neni 235¹⁰¹ është mbrojtja e shëndetit të popullatës nga ndotja, i cili e kushtëzonte përgjegjësinë penale me ardhjen e pasojave në mjedis dhe ndotjen e tij. Gjatë kësaj periudhe kemi një privim të lirive dhe të drejtëve private për shkak se prona ishte shtetërore dhe jo private, kështu përgjegjësia juridike civile në lidhje me dëmit në mjedis nuk u zhvillua si doktrinë, madje bëri hapa pas, pasi shumë institute të së drejtës private u privuan dhe u kufizuan në masë.

⁹⁸ Vendim i kryesisë së Këshillit të Ministrave nr 201, datë 30.7.1979, ndryshuar me vendim nr, 223, datë 12.6.1980 për disa masa të ngutshme për kursimin e karburanteve dhe lëndëve djegëse e të tjera

⁹⁹ Përmbledhës i Përgjithshëm i Legjislacionit në fuqi të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë 1945-1985, fq 1029/1030 e në vazhdim.

¹⁰⁰ Dekreti nr, 5105, neni 2, “mbi mbrojtjen e ambientit nga ndotja” datë 30/10/ 1973.

¹⁰¹ Elezi I, E drejtë Penale pjesa e posacme cit, Kodi Penal, neni 235, 2008, i ndryshuar.

3.5.6 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis mbas viteve 1990, si dhe anëtarësimi i Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe mjedisore.

Në Shqipëri, e Drejta e Mjedisit fillon e merr format e veta natyrale mbas rënies së sistemit totalitar në vitet '90 dhe me anëtarësimin e Shqipërisë në strukturat e Euro-Atlantike. Anëtarësimi në Këshillin e Europës në vitin 1995¹⁰², aderimi dhe anëtarësimin në Konventën e Aarhusit¹⁰³. Konventa për Ndotjen e Ajrit Ndërkufitar me shtrirje të gjerë në Gjenevë¹⁰⁴, si dhe ratifikimin e shumë Konventave dhe marrëveshjeve për mjedisin do ta shoqëronin Shqipërinë në një proces rruge integrimi të pakthyeshëm, si pjesë e detyrimeve dhe standarteve ndërkombëtarë për t'u bërë pjesë e plotë e tyre. Këtu fillon periudha moderne e legjislacionit mjedisor dhe problematikave që i mbart të bëhet pjesë e sistemit të brendshëm normativ, si dhe të harmonizohet me legjislacionet e karakterit rajonal dhe global. Mbrojtja e mjedisit nga dëmtimet është baraz me zhvillimin e qëndrueshëm. Pas viteve '90, koncepti i rritjes ekonomike nuk nënkuptonte më rritjen ekonomike të (PBB) GDP si zhvillim ekonomik, por ruajtjen e parametrave të cilësisë së mjedisit, shëndetit të jetës që identifikohen me Zhvillimin e Qëndrueshëm¹⁰⁵.

Në Dispozitat Kushtetuese të vitit 1992, të cilat ishin aktet më të larta në vend mbas rënies së sistemit totalitar, nuk ishin parashikuar ende nene të veçanta, të cilat mbronin shëndetin,

¹⁰² <http://www.punetejashme.gov.al/al/misioni/organizatat-nderkombetare/keshilli-i-evropes> aderim në vitin 1998 dhe ratifikimin e saj nga Parlamenti Shqiptar në 1 tetor të vitit 2001, me ligjin nr 8672.

¹⁰³ http://www.punetejashme.gov.al/files/userfiles/Aktet_e_OKB.pdf.

¹⁰⁴ http://www.punetejashme.gov.al/files/userfiles/Aktet_e_OKB.pdf Data e hyrjes në fuqi të Konventës:16.03.1983, kapitulli XXVII fq 29-30.

¹⁰⁵ OKB Komisioni Botëror i Mjedisit dhe Zhvillimit, KBMZH, Brundtland Afrika e Jugut 1987, Raporti i Komisionit "E ardhmja jonë e përbashkët, na paraqitet për herë të parë termi Zhvillim i Qëndrueshëm.

jetën e individit, të cilat indirekt nënkuptonin dëmim në mjedis ndaj mjedisit dhe shëndetit të individit. Me ratifikimin e shumë konventave, traktateve dhe akteve të tjera që vinin si detyrim i Integritetit të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare globale dhe rajonale si ajo e Këshillit të Europës dhe më pas si kandidate në Bashkimin Europian, do të ndihej nevoja për disa përcaktime specifike në legjislacionin shqiptar në lidhje me mbrojtjen e dëmeve që mund t'i vinin mjedisit. Mbas miratimit të Kodit Civil Shqiptar në vitin 1995 dhe miratimit të kodeve të tjera, atij të Procedurës Civile, Kodit Penal, Procedurës Penale etj., diskutimet u shtrinë mbi nevojën e hartimit të dispozitave që duhet të kishte Kushtetuta e Re e Shqipërisë diskutim i cili si rezultat i kushteve të reja social-ekonomike dhe politiko-juridike të Shqipërisë do të sillte frytet e para edhe pse jo të mjaftueshme në lidhje me çështjet dhe dëmet në mjedis edhe si pjesë e përgjgjësisë juridiko-civile mbi të cilën do të krijoheshin kushtet për legjitimitetin aktiv të palëve në proces. Me miratimin me Referendum të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë¹⁰⁶, do të kishim edhe dy dispozita themelore kushtetuese ku përmendet fjala mjedis por jo dëmi në mjedis si kategori juridike:

Asnjëherë më parë në ligjin themelor të Shqipërisë nuk ishin përmendur çështje të tilla që lidheshin me mjedisin. Kjo ishte një arritje për shoqërinë dhe të drejtën e mjedisit në Shqipëri. Mjedisi fillon dhe shikohet jo më si një aspekt abstrakt dhe i nënvlerësuar i së drejtës, por si një standard i domosdoshëm për shëndetin, cilësinë e jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm, edhe pse nuk mund të ankimohesh drejtpërsëdrejti në gjykat si aspekt objektiv social.

¹⁰⁶ Miratuar në datë 28.11.1998, ligj nr. 8417 21.10.1998.

Kodi Civil Shqiptar, i miratuar në vitin 1994, parashikoi për herë të parë në një nen më vete përgjegjësinë e Dëmit në mjedis si pjesë e titullit IV të detyrimeve që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit.

Neni 624 i Kodit Civil shprehet: Personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Ky nen i KC flet në mënyrë të posaçme për shkaktimin e dëmit në mjedis real, por që nuk përcakton saktë “dëmin e heshtur” ose dëmin në të ardhme, shkak për moslegjitimitimin e palëve si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin në mjedis, por edhe për një fakt tjetër pasi kërkon elementin e fajit për t’u plotësuar figura e PJC, ndërkohë që veprimtaritë e rrezikshme shkaktojnë dëm në mjedis jashtëkontraktor edhe pa faj, (përgjegjësi objektive).

3.5.7 E drejta e mjedisit dhe përgjegjësia mjedisore. Marrëveshja e Asocim Stabilizimit (MSA) dhe legjislacioni Aquis Communautaire (AC)

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Asocim Stabilizimit, MSA-ja legjitimon dhe artikulon në mënyrë konkrete qëllimet dhe angazhimet e ndërsjellta të palëve nënshkruese (BE-Shqipëri) në lidhje me: bazat e dialogut për angazhimin e Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Unionit; bazat e bashkëpunimit mes palëve në fusha si drejtësia, liria dhe siguria, mjedisi etj. Në këtë mënyrë, MSA-ja, ndryshon statusin e vendit tonë si në kuadrin e ngushtë rajonal, ashtu edhe në atë më të gjerë: europian e

ndërkombëtar. MSA-ja është fillesa e konkretizimit të perspektivës europiane, ku çështjet e mjedisit janë të një rëndësie të dorës së parë për komunitetin si proces integruar për vendet jo vetëm anëtare por edhe ato aspirante për t'u bërë pjesë e Bashkimit European, siç është rasti i Shqipërisë. Procesi i MSA-se fillon në vitin 2001 me propozimin e Komisionit European dhe u siglua në Tiranë më 12 qershor 2006; kjo marrëveshje bashkë me Marrëveshjen e Integritimit u nënshkruan në Bruksel nga Qeveria Shqiptare dhe Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të BE-së. Hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje më 1 prill 2009 shënon një fazë të re më të avancuar të marrëdhënieve të Shqipërisë me BE-në¹⁰⁷. Si rezultat kemi edhe procesin e përafrimit të legjislacionit me BE që njihet si Acquis Communautaire, e cila është në ndryshim të vazhdueshëm. Pranimi i «acquis communautaire» nga vendet anëtare është parakusht për aderimin e tyre në BE. Kjo gjë nënkupton përshtatjen e legjislacioneve kombëtare me normat e KE-së dhe zbatimin e tyre që në momentin e aderimit, legjislacion në të cilin ka edhe kapituj të veçantë që flasin për çështjet mjedisore, si respektimi i Konventës së Aarhusit për çështjet mjedisore, apo zbatimin me më efikasitet të vendimeve të GJEDNJ-së, si dhe përfaqësimin me vendimet e Gjykatës Europiane të Drejtësisë (GJED) si anëtare e ardhshme e Bashkimit European etj. Legjislacionit European dhe ndërkombëtar për dëmet që mund t'i shkaktohen mjedisit aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore, mbështetet në disa marrëveshje dhe konventa specifike për këtë fushë, si Konventa e Esposit e cila trajton mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare¹⁰⁸, Konventa e sipërpërmendur ka për qëllim vlerësimin e ndikimit në mjedis të projekteve që zhvillohen kryesisht në zona ndërkufitare dhe që mendohet se mund

¹⁰⁷ <http://www.punetejashtme.gov.al/al/misioni/integrimi-ne-be/marredheniet-shqiperi-be>

¹⁰⁸ Ligj nr. 9700, datë 26.3.2007 për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet ndërkufitare.

të kenë ndikim në mjedisin e vendeve fqinje. Kjo Konventë synon bashkëpunimin midis shteteve për mbrojtjen e mjedisit ndërkufitar nga projektet me ndikim në mjedis¹⁰⁹, *një rast i tillë ka qënë rasti Vjosës dhe Radikës, repsektivisht me Greqinë dhe Maqedoninë në vitin 2014-2015*). Konventa e Aarhusit ku një nga tre shtyllat e saj, ajo e nenit 9 lidhet me të drejtën e gjithkujt për të patur mundësi të ngrëjë padi për çështjet mjedisore edhe kur legjislacioni vendas nuk ja garanton këtë të drejtë, gjithashtu edhe një sërë direktivash të BE-së dhe KE-së, të cilat i vijnë në ndihmë legjislacionit shqiptar në kuadër të “acquis communautaire” dhe atij ndërkombëtar. Kjo Konventë u ngrit mbi parimet kryesore të Deklaratës së Rios (1992)¹¹⁰ për Mjedis dhe Zhvillim, e cila në nenin 10 përcakton pjesëmarrjen e publikut në çështjet mjedisore. Protokollin e Kievit është i rëndësishëm për t’u përmendur në kontekst të vlerësimit strategjik të mjedisit, meqenëse do të mund të konsiderohej si një prej instrumenteve më të rëndësishme ndërkombëtare që parashtron kushte për vlerësimin e propozimeve strategjike. Protokollin është aprovuar në një takim të jashtëzakonshëm të palëve pjesëmarrëse në Konventën Espoo dhe kërkon nga palët e saj që t’i vlerësojnë pasojat mjedisore të projekteve të planeve dhe të programeve të tyre zyrtare¹¹¹. Ka më shumë se 100 shtete në botë të cilat çështjet që lidhen me mjedisin i trajtojnë si të drejta të ngritura në nivelin e lirive themelore të individit.

Akt tjetër i rëndësishëm është direktiva “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin”¹¹², e ndryshuar, e cila përpiqet të përcaktojë të drejtat

¹⁰⁹ http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Topic_Legjislacioni/Ligji_VSM_91-2013.pdf

¹¹⁰ Doracak për zyrtarë komunalë të mjedisit, 2006, fq. 17.

¹¹¹ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/Debate-Publike/Draft-VSM-i-PZHU-se--Lipjan.pdf.aspx fq6>

¹¹² Direktiva 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin”, e ndryshuar.

dhe detyrimet e palëve në fushën e përgjegjësisë juridiko-civile por edhe administrative në lidhje me dëmin në mjedis, pasi nuk jep një përkufizim fiks për mjedisin, p.sh. pika C e saj shprehet se: (përbën dëm në mjedis) çdo kontaminim i terreneve që krijojnë një rrezik të rëndësishëm dhe efekte negative në shëndetin e njeriut, si pasojë e drejtpërdrejtë ose indirekte në terren, në tokë ose në nënpushimin e substancave të përgatitura nga organizmat e mikroorganizmave, fakt i cili nuk është reflektuar në mënyrë efikase në legjislacionin shqiptar. Direktiva i quan si dëm në mjedis edhe përcaktimet që vijnë nga direktivat e tjera, p.sh. ajo 2000/60 mbi përcaktimi e efekteve negative dhe negative të gjendjes ekologjike, kimike dhe/ose sasisë dhe/ose mbi ecurinë potenciale të ujërave.

Pa trajtuar Konventat apo aktet e tjera rajonale ndërkombëtare mjedisore, aktet juridike kombëtare, vendimet e gjykatave (GJEDNJ), edhe në kuptimin e termave të tyre ne nuk mund të kuptojmë dhe të orientohemi drejt kuptimit objektiv të dëmit në mjedis, apo dëmin në mjedis në të ardhmen si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile, e cila krijon kushtet e nevojshme për t'u legjitimuar në procesin civil për kërkimet e parashtruara nga palët. Dëmi në mjedis është një kategori shumë e gjerë, e cila përfshin shumë fusha dhe ka pak vite e cila po zhvillohet si doktrinë në të drejtën ndërkombëtare. Në Shqipëri kjo temë është pothuajse e patrajtuar më parë, ndaj ky punim është risi në këtë fushë.

KAPITULLI IV-MBROJTJA E MJEDISIT SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

4.1 Hyrje

Në këtë punim bëhet një analizë e ligjit themeltar të Shqipërisë, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Çfarë parashikon ajo në Kushtetutën e saj miratimin, a përfshin ajo çështje mjedisore si norma juridike, çfarë normash janë ato, duke filluar që nga e drejta e informimit të mjedisit, neni 56 dhe neni 5, për të drejtën e një mjedisit të pastër në kuadrin e objektivave sociale dhe si të pa-ankimueshme. Sistemi politiko-juridik trajtohet në këtë punim duke bërë edhe një përshkrim dhe pozitës dhe prevalencës midis tyre si pjesë e çështjeve që lidhet me politikat mjedisore, duke kaluar në pjesën tjetër të legjislacionit kuadër në fushën e mjedisit tek ai sektorial në këtë fushë, duke filluar me ligjin për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimin të ndikimit në mjedis, vlerësimin të ndikimit në mjedis, ligje të posaçme më pas, si ai për menaxhimin e integruar të ujit, ligji për menaxhimin e mbetjeve, duke kaluar tek legjislacioni penal, i cili parashikon edhe disa sanksione penale në fushën e veprave mjedisore. Përgjegjësia juridiko-civile e dëmit në mjedis është e lidhur ngushtë edhe me kriteret e posaçme të ligjeve kuadër dhe sektorial të mjedisit për ta parë procesin si një të tërë.

4.2. Normativa Kushtetuese

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e votuar me Referendum më datë 22 Nëntor 1998 nga Kuvendi, hyrë në fuqi më datë 28 Nëntor 1998, si një Kushtetutë e re moderne në kohë edhe ajo shfaq problematika në nenet e saj, në të cilat nuk e ka të sanksionuar në mënyrë të

drejtpërdrejtë të Drejtën e Mjedisit si një të drejtë themelore për të patur një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër, por e trajton në kuadrin e të drejtës së informimit dhe si një të drejtë brenda objektivave sociale.

Neni 56 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë shprehet:

“Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij. Publiku i interesuar është kushdo, çdo person fizik apo juridik vendas apo i huaj, privat apo publik, si dhe personat pa shtetësi. Ligji për të Drejtën e Informimit përcakton se edhe pa paraqitur asnjë arsye apo pa patur asnjë qëllim, mund të informohet nga autoritetet që e kanë për detyrë informimin në lidhje me çështjet mjedisore, personin e interesuar që i kërkon këto informacione¹¹³.”

Ky nen garanton lirinë themelore të individit për t’u informuar për mjedisin, por jo të drejtën për t’u legjitimuar në proces për çështjet mjedisore si një liri e drejtpërdrejtë themelore e posaçme procedurale apo materiale.

Neni 59/1 pikën “d” dhe “dh”, i ka trajtuar si të drejta themelore sociale jo individuale¹¹⁴, brenda objektivave sociale, pra si një tërësi rrethanash dhe jo si një rrethanë e mëvetshme e

¹¹³ http://www.akafp.gov.al/ep-content/uploads/2015/04/ligj_nr_119_dt_18_9_2014_19327_1_E-drejta-e-informimit1.pdf

¹¹⁴ Neni 59 i Kushtetutës shprehet për objektivat sociale:

1.Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:

- a) punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë;
- b) plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim;
- c) standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm;
- ç) arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve, si dhe të personave të pazënë me punë;
- d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
- dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore

posaçme e karakterit procedural apo material në nivel kushtetues për të drejtën e një mjedisi të shëndetshëm dhe të pastër, apo të drejtën për të ngritur padi për mbrojtjen e mjedisit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë futet në grupin e “Kushtetutave të Ngurta”, të cilën, për ta ndryshuar duhet një shumicë e cilësuar me mbi 2/3 e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, nisma për rishikimin e saj kërkon pjesëmarrjen e jo më pak se 1/5 e të gjithë anëtarëve të Kuvendit¹¹⁵, pra praktikisht pa një vullnet të përbashkët politik në Kuvendin e Republikës dhe të një konsensusi të gjerë, ndryshimet janë të thuajse pamundura.

Vetë mënyra e ndërtimit të së drejtës si model sistemesh të së drejtës, atij të Supremacisë së Gjyqësorit dhe Supremacisë së Legjislativit dhe Ekzekutivit¹¹⁶, është ngritur mbi supremacinë e Ekzekutivit, çka bën që e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër të mos jetë e garantuar në nivel kushtetues, për rrjedhojë edhe si një liri e ankimeshme e drejtpërdrejtë dhe themelore e individit në Gjykatë Kushtetuese, por garantohet nëpërmjet ligjeve të përcaktuara në hierarkinë e Akteve Normative në Shqipëri, të cilat kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë¹¹⁷, por edhe nëpërmjet normave të tjera të përgjithëshme kushtetuese të cilat në thelb e vështirësojnë procesin për efikasitetin e aksesit në drejtësi për padin mjedisore si një e drejtë themelore dhe Kushtetuese. Kur flasim për

mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm;

e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;

ë) zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse;

f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paafteve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës;

g) mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe.

2. Përmbushja e objektivave socialë nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë.

Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave.

¹¹⁵ Neni 177 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹¹⁶ http://www.researchgate.net/publication/228186675_Between_Judicial_and_Legislative_Supremacy_A_Cautious_Defense_of_Constrained_Judicial_Review

¹¹⁷ Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

doktrinën e Supermacisë së Gjyqësorit përballë Legjislativit dhe Ekzekutivit, kjo supermaci ngrihet dhe mbështetet mbi parimet bazë të konstitucionalizmit, atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve midis tyre, të përcaktuara edhe në nenin 7 të Kushtetutës Shqiptare, në pjesën e parë të saj, ku parashikohen parimet themelore.

Garancitë e Konventës ndikojnë në interpretimin dhe mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të individit të shprehura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Veç kësaj, Gjykata Kushtetuese çmon se teksti i Konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese¹¹⁸. Ky pozicion i Konventës vjen si pasojë e angazhimeve të Shtetit Shqiptar për t'i dhënë një mbrojtje të garantuar të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Aspekt tjetër me rëndësi ka të bëjë me detyrimet që rrjedhin nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut për palët që marrin pjesë në gjykim, sepse sipas nenit 41 të Konventës, palët kontraktuese, me ratifikimin e Konventës, janë të detyruara të garantojnë përputhshmërinë e legjislacionit të brendshëm me Konventën. Pra, ky problem ka mbetur për t'u vlerësuar rast pas rasti nga gjykatat që gjykojnë në shkallë të parë dhe nga ato që gjykojnë në shkallë të dytë, pa harruar se objekt i këtij vlerësimi, sipas Gjykatës së Strasburgut, duhet të jetë tërësia e procesit, së bashku me fazën e hetimeve dhe me shkallën e apelit, me procesin eventual para Gjykatës Kushtetuese, si dhe me ekzekutimin e vendimit. Përsa u parashtrua, duke u bazuar në këto standarde kushtetuese, kërkesa e kërkuarit me objekt konstatimin e cënimit të së drejtës kushtetuese, për një proces të rregullt ligjor si rezultat i moszbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, brenda një

¹¹⁸ VGJK/ 2006, nr 6.

afati të arsyeshëm, duhet pranuar edhe për një shkak tjetër, sepse moszbatimi i një vendimi të tillë cënon të drejtën e individit për t'iu drejtuar gjykatës”. Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve Ligjvënës, Ekzekutiv dhe Gjyqësor. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me këtë nen për ndarjen dhe balancimin e pushteteve, bëjnë edhe interpretimet përkatëse për konfliktet apo interpretimet e ndryshme:¹¹⁹ *“Rëndësi të drejtpërdrejtë në gjykimin e çështjes ka dhe parimi kushtetues i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, sanksionuar nga neni 7 i Kushtetutës”*. Ky parim ndihmon që pushteti të shpërndahe në disa mbajtës, me funksione e detyra të ndryshme, të mirëpërcaktuara nga Kushtetuta, si dhe mundëson bashkëveprimin midis tyre, me qëllim unitetin në veprimin shtetëror. Kjo dispozitë i është nënshtuar edhe interpretimeve të GJK¹²⁰: Gjykata Kushtetuese¹²¹. Qeveria është organi që i propozon Kuvendit më shumë se 99% të ligjeve për miratim, konceptimi dhe paraqitja e politikave dhe programi qeverisës, zakonisht paraqitet si program elektorale në zgjedhjet periodike që organizohen çdo katër vjet në Shqipëri, në kuadrin e këtyre politikave Kryeministri mban përgjegjësi për realizimin ose jo të tyre edhe sipas përcaktimit në Kushtetutë. Sistemi i formës qeverisëse Asambleare është e kundërta e formës së sistemit të Qeverisjes së Kabinetit Ministror¹²². E kundërta ndodh me formën e Qeverisjes së Kabinetit Ministror: ajo është propozuesja më e madhe e ligjeve në Parlament; mosmiratimi i ligjeve nga Parlamenti rrezikon rënien e qeverisë nëpërmjet mocionit të besimit ndaj Kryeministrit neni

¹¹⁹ VGJK /2006, nr. 24.

¹²⁰ VGJK /2007, nr. 41.

¹²¹ VGJK /2004, nr. 11.

¹²² Gurakuqi, R, leksione UET: 2013-2014.

104¹²³. Në doktrinën juridiko-kushtetuese, ligje të drejtimit politik konsiderohen: Ligji për buxhetin, i cili përcakton ndarjen e mjeteve financiare në administratë dhe sektorin publik kryesisht, ligje afatshkurtra dhe afatmesme për zhvillimin e ekonomisë apo degëve të rëndësishme të saj, ligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, ligje për amnistitë fiskale apo veprave penale etj. (Anastasi A, Tiranë 2008: 252/253).

Pra, duke parë se këto ligje propozohen nga Ekzekutivi, i japin atij një pozitë dominuese në raport jo vetëm me Legjislativin por edhe Gjyqësorin. Ekzekutivit nuk i intereson që “e drejta për një mjedis të shëndetshëm dhe të pastër” të jetë e garantuar në nivelin e një dispozitë kushtetuese si liri e drejtpërdrejtë e individit, qoftë materiale apo procedurale, liri e cila mund ta ankimonte çdo çështje në lidhje me dëmet e shkaktuar apo që mund të shkaktoheshin në mjedis në mënyrë të drejtpërdrejtë në gjykatë, pasi do të përbënte një shqetësim të klimës së biznesit sipas doktrinës së ekzekutivit. Ndërkohë që vendi është në një proces ekonomiko-social, ku si prioritet ka thithjen e investimeve të huaja dhe përkrahjen e biznesit, ende ka të papërcaktuar modelin e zhvillimit ekonomik, si dhe e

¹²³ 1. Kryeministri ka të drejtë t'i paraqesë Kuvendit mocion besimi ndaj Këshillit të Ministrave. Në rast se mocioni i besimit votohet nga më pak se gjysma e të gjithë anëtarëve të Kuvendit, Kryeministri, brenda 48 orëve nga votimi i mocionit, i kërkon Presidentit të Republikës shpërndarjen e Kuvendit. 2. Presidenti shpërndan Kuvendin brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Kërkesa për mocion besimi nuk mund të paraqitet gjatë periudhës së shqyrtimit të mocionit të mosbesimit, sipas nenit 105. 3. Votimi i mocionit nuk mund të bëhet pa kaluar tri ditë nga paraqitja e tij.

Neni 105.

1. Një e pesta e deputetëve ka të drejtë të paraqesë për votim në Kuvend një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit në detyrë, duke propozuar një Kryeministër të ri.

2. Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit vetëm duke zgjedhur me votat e më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij një Kryeministër të ri.

3. Presidenti i Republikës dekreton shkarkimin e Kryeministrit në detyrë dhe emërimin e Kryeministrit të zgjedhur jo më vonë se 10 ditë nga votimi i mocionit në Kuvend. Në nenin 104 vihet re se nëse mocioni besimit nuk votohet nga 71 vota, qeveria bie, gjithashtu shpërndahet edhe Kuvendi dhe shkohet në zgjedhje të reja. Vërehet se ka një marrëdhënie varësie midis Kuvendit dhe Ekzekutivit.

Në nenin 105 të Kushtetutës, i cili shprehet për mocionin e mosbesimit ndaj Kryeministrit nga 28 deputetë ose 1/5 e 140 deputetëve të Kuvendit, vihet re se për shkarkimin e tij nevojten të paktën 71 vota, dhe 71 vota për zgjedhjen e një Kryeministri të ri, në total 142 vota në të njëjtin votim.

shoqëruar me bazë ligjore të dobët në këtë fushë mund të ndeshet me sfida të tipit një shfrytëzim maksimal i dëmshëm¹²⁴. Kujtojmë këtu se në një vit, si pasojë e ndotjes së ajrit, sipas raportit të vitit 2016 për vitin 2013 të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, humbasin jetën mbi 2100 persona¹²⁵, ku më shumë se gjysma janë në Tiranë. Tirana është një nga qytetet më të ndotura në rajon dhe Europë, ku ndotja e ajrit është 10 herë më e lartë se mesatarja e një qytetit European kur flasim për zonën e “21 Dhjetorit”, “Zogut të Zi” etj.¹²⁶

Shqipëria gjendet përpara katastrofave mjedisore (përmbytjet në Shkodër në 2010 dhe Vlorë në 2014 dhe nëntor 2016, çështja e ndotjes në fushës Patos-Marinëz, Zharrëzi 2017), ndërkohë që aspiron të bëhet vend anëtar i BE-së deri në vitin 2027, plani i Evropës për ujërat kërkon që të gjitha vendet të kenë ujëra me status të mirë ekologjik, si dhe bashkëpunim rajonal për mbrojtjen e mjedisit, pasi mjedisi nuk është thjesht e vetëm një koncept i përbashkët, por mbi të gjitha një hapësirë e të gjithëve që nuk njuh kufij. Sigurisht që vdekja dhe sëmundjet në nivele alarmante në Shqipëri nga ndotja e mjedisit janë pasoja të disa shkaqeve, njëra nga këto është efikasiteti i aksesit në drejtësi për çështjet mjedisore fut këtu edhe padin mjedisore. Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese është shprehur se elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme është karakteri normativ i aktit të kundërshtuar. Aktet individuale, të ndryshme nga ato të përcaktuara shprehimisht në nenin 115/2 të Kushtetutës, i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike,

¹²⁴ Shkrim analitik i gazetës britanike The Guardian, i pasqyruar në: <http://www.kohajone.com/index.php/aktualitet/mediat-britanike-shqiperia-te-pergatitet-per-katastrofa-natyrore>

¹²⁵ <https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2016>

¹²⁶ Buletini i Institutit të Shëndetit Publik, nr 2, 2014: 20/21.

të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektësh¹²⁷ (Vendim GJK nr. 81 datë 28.05.2015)¹²⁸¹²⁹. Shumë çështje trajtohen edhe rast mbas rasti pasi nuk kemi një praktik të jurisprudencës në këtë fushë për të përcaktuar saktë dhe qartë përgjegjësinë juridiko-civile të dëmit në mjedis.

4.3 Legjislacioni kuadër mjedisor që përcakton kriteret e përgjithshme të dëmit në mjedis, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit – LMM është një ligj kuadër¹³⁰. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, mbrojtjen e përbërësve të mjedisit dhe proceseve mjedisore, sigurimin e kushteve materiale për zhvillimin e qëndrueshem,

¹²⁷ shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2014 ; nr.59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

¹²⁸ shih vendimet nr. 29, datë 21.10.2009; nr. 14, datë 21.03.2014; nr. 59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

¹²⁹ Jurisprudenca kushtetuese është shprehur se elementi përcaktues që ndan juridiksionin kushtetues nga ai i gjykatave të zakonshme është karakteri normativ i aktit të kundërshtuar. Aktet individuale, të ndryshme nga ato të përcaktuara shprehimisht në nenin 115/2 të Kushtetutës, i nënshtrohen kontrollit të sistemit të zakonshëm gjyqësor. Një akt me karakter normativ duhet të vendosë norma të përgjithshme sjelljeje, me karakter abstrakt, që rregullojnë marrëdhënie të caktuara juridike, të cilat i shtrijnë efektet e tyre mbi një kategori të pacaktuar subjektësh. Akti normativ është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje, dhe që nuk është shterues në zbatimin e tij, kuptim i dhënë edhe nga ligji nr. 49, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Për sa i përket aktit individual ai është vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijojnë, ndryshojnë ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete. Ai i referohet një fakti konkret, jo një numri faktesh të mundshme ose hipotetike, dhe i jep zgjidhje një çështjeje konkrete me natyrë teknike dhe jo normative (shih vendimet nr. 14, datë 21.03.2014 ; nr.59, datë 23.12.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Përcaktimi nëse një akt është individual ose normativ bazohet në tri kriteret që përcaktojnë: (i) subjektet të cilave akti u drejtohet subjekte individualisht të përcaktuara të së drejtës/një grup personash të përcaktueshëm në bazë të karakteristikave të përgjithshme ose subjekte të papërcaktuara të së drejtës; (ii) objektin - krijimi, ndryshimi ose shuarja e një marrëdhënieje juridike konkrete e së drejtës administrative ose përcaktimi i normave të përgjithshme të sjelljes me karakter abstrakt; (iii) karakterin shterues/jo shterues - efektet shtrihen te subjekte të përcaktuara dhe në mënyrë të njëhershme ose te subjekte të papërcaktuara të së drejtës në mënyrë të vazhdueshme dhe jo të njëhershme.

¹³⁰ <https://eëë.yumpu.com/sq/document/vieë/50002081/ligji-nr-8934-date-05092002>. Manuali “Menaxhimi i Problemeve Mjedisore në Nivel Vendor” u përgatit nga Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike QShKE, 2006 /

duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesave kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër. LMM është një ligj kuadër, ku ndër objektivat e tij do të veçonim:

- Përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

- Përdorimin racional të resurseve natyrore dhe pakësimin e shkarkimeve ndotëse në mjedis, parandalimin e dëmtimeve ndaj tij dhe rehabilitimin e dëmeve në mjedis.

- Koordinimin e aktiviteteve ekonomike dhe sociale të vendit me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

- Krijimin dhe forcimin e sistemit institucional për mbrojtjen e mjedisit në nivel qendror.

Vështirësitë që has ligji MM.

Megjithëse neni 48 sipas Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit duhet të sigurojë garancitë e Nenit 9.3 të Konventës, "në rast kërcënimesh, dëmtimi apo ndotje të mjedisit, qytetari, publiku dhe organizatat jofitimprurëse kanë të drejtë të" kenë të drejtë ligjore para një gjykate kundër organit publik ose fizik ose personit juridik që ka dëmtuar mjedisin ose mund ta dëmtojë atë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile", kjo e drejtë nga pikëpamaja e efikasiteti ndeshet me pengesa ose bëhet praktikisht e pamundur për t'u zbatuar edhe për shkak të paqartësisë, pasi trajtohet në mënyrë të përgjithshme legjitimimi i palëve në procesin civil.

Në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit mund të bëhen ndryshime dhe shtohet edhe se: Publiku, në rast kërcënimi ndaj mjedisit, ndotjeje dhe dëmtimi të tij, shkaktim dëmi “apo mundësis së ardhjes së dëmit në mjedis” (për dëmin potencial GJK është shprehur në lidhje me shoqatat)¹³¹, që prek drejtpërdrejt apo vuan pasojat e dëmit të shkaktuar në mjedis, apo kanë një interes të ligjshëm, kanë të drejtë të kërkojnë kompensim duke: a) iu kërkuar autoriteteve publike përkatëse marrjen e masave të duhura brenda afateve dhe në përputhje me autoritetin që u jep ligji; b) ngritur padi në gjykatë, kundër autoritetit publik ose personit fizik e juridik, që ka sjellë “apo mund të sjellë” dëme në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë.

Kësisoj shtohen garancitë për aksesin në drejtësi si pjesë e interes të ligjshëm për çështjet mjedisore ku teorikisht dëmi në mjedis përmendet por në praktik bëhet tepër i vështirë për t’u vërtetuar, qoftë dëmi në mjedis në mënyrë të drejtpërdrejtë apo dëmi në shëndetin e individit në forma të ndryshme që vjen nga mjedisi në mënyrë të drejtpërdrejtë/jo të drejtpërdrejtë apo të heshtur.

Në nenin 50 pika 1/a për Përgjegjësinë për dëmin në mjedis duhet:

1. Qëllimi i përgjegjësisë për dëmin në mjedis, mbështetur në parimin “Ndotësi Pagueu” është: parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet “është: parandalimi dhe zhdëmtimi i të gjithë dëmit që i shkaktohet mjedisit”, pra, më sipër përfshijmë edhe si kategori të posaçme dëmin në të ardhme në mjedis dhe të mirëpërcaktuar.

¹³¹ Vendim nr. 14 datë 21.03.2014, “Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cënim të interesit”.

Parimi “Ndotësi Pagan” është i mbështetur mbi parimin e përgjegjësisë juridiko civile, ai që shkakton një dëm mjedisor në mjedis apo shëndetin e njeriut është përgjegjës dhe detyrohet të dëmshpërblejë/kompensojë këto kosto të cilat janë të fshehura edhe të produkti fizik natyror, por edhe në shëndetin e njeriut; pra, kemi të bëjmë me dëm jashtëkontraktor në mjedis (A. C. Pigou, me sipër). Sa më i madh dëmi në mjedis, aq më e madhe përgjegjësia mjedisore.

2. Përgjegjësia për dëmin në mjedis përcaktohet në bazë të:

a) dëmit të shkaktuar në mjedis nga veprimtarit e operatorit (të shfuqizohet kjo pjesë: *nga çdonjëra prej veprimtarive të rrezikshme, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni,*) si dhe nga kërcënimi i mundshëm për një dëm të tillë.

Dëmi në mjedis, nga pikëpamja e përgjegjësisë civile dhe jo vetëm, nuk përcaktohet vetëm nga rrezikshmëria e veprimtarive të përcaktuara në listën e VKM; ai është vetëm një element që nuk mund të jetë shterues për përcaktimin e dëmit maksimal mjedisor, ai parashikon *a priori* shkakun, por nuk mund të parashikojë *posteriori* pasojën, pasi ky dëm mund të vijë edhe nga një aktivitet që nuk është i listuar në listën e veprimtarive të rrezikshme (dëm jashtëkontraktor), për më tepër kur VKM-ja është një akt nënligjorë dhe i ndryshueshëm, i cili duhet kthyer në ligj; idealja do të ishte të ishte pjesë e Kodi Mjedisor shqiptar, pasi kriteret e vendosura këtu edhe nga pikëpamja formale e sigurisë juridike nuk do të binin në kundërshtim me elementet e Kodin Civil apo Kodin e Procedurës Civile që kanë lidhje më legjitimitimin e palëve, dëmin mjedisor/mjedisor në të ardhme, si pjesë e

interesit të ligjshëm për legjimimin e palëve në procesin gjyqësor civil apo administrativ etj.

b) dëmi i shkaktuar (të shtohet “apo që mund të shkaktohet”) ndaj llojeve të mbrojtura dhe habitateve natyrore nga çdo veprimtari profesionale e ndryshme nga ato të parashikuara në shkronjën “a” të pikës 3 të këtij neni, si edhe nga çdo kërcënim i mundshëm i këtij dëmi, si pasojë e kryerjes së këtyre veprimtarive (të shfuqizohet kjo pjesë: për shkak të pakujdesisë së operatorit).¹³²

3. Këshilli i Ministrave miraton: listën e veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin (të shfuqizohet pjesa: në kuptim të pikës 2 të këtij neni), pasi është kufizuese në përcaktimin e veprimtarive që shkaktojnë dëme apo kërcënojnë mjedisin, sigurisht veprimtaritë e rrezikshme kanë një kriter më shumë për dëmin në mjedis në të ardhme por ajo nuk duhet të jetë në kuptimin shterues. Kriteret në bazë të të cilave bëhet vlerësimi i kërcënimit të mundshëm dhe përcaktimi i dëmit në mjedis (të shtohet dhe dëmit në të ardhme në mjedis).

Në pikën 7 duhet të shtohet edhe: “Në rast se dëmi në mjedis nuk ka ndodhur, por ekziston një kërcënim i drejtpërdrejtë për një dëm të tillë, operatori¹³³ merr menjëherë dhe pa vonesë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar shkaktimin e dëmit në mjedis. Nëse operatori nuk e përmbush këtë detyrim, Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr masat e nevojshme parandaluese dhe operatori është përgjegjës për të mbuluar koston përkatëse (të

¹³² Pakujdesia është kategori penale dhe atë e zgjidh kodi penal në kuptimin objektiv, për sa i përket aspektit civil pakujdesia si dëm i ardhur përcaktohet nga sasia e dëmit të shkaktuar apo edhe e dëmeve kolaterale që e pasojnë. Në këtë rast i lihet autoritetit të AKM të përcaktojë pakujdesinë e cila ka lidhje me dëmin mjedisor dhe dëmin mjedisor të të ardhme kësaj publiku e ka të vështirë të legjitimohet për ngritjen e padis në Gjykat Administrative por edhe për dëmin personal që mund ti jetë shaktuar apo që mund ti shkaktohet personit.

¹³³ Kosova përdor termin “ndotës” në ligjin për mbrotjen e mjedisit, Ligji nr.03/L-025 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

shtohet “dhe dëmin në të ardhme”). Kjo pikë e këtij neni ndërtohet mbi idenë e parashikueshmërisë sipas teorisë së shkakut të drejtpërdrejtë, ku ngjarja në rrjedhën e natyrshme të ngjarjeve duhet të shkaktojë dëm, dhe këtë fakt juridik (ngjarje) e përcakton organi i specializuar i fushës, ekspertizë nga e cili rrjedh edhe përgjegjësia juridiko-civile. (Pra, siç e shohim, koncepti i dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile lidhet drejtpërsëdrejti edhe me të drejtën administrative, pasi dëmi në mjedis përcaktohet nga një Ent shtetëror i autorizuar nga ligji) dhe shpeshherë keto dy fusha të së drejtës nuk mund t’i ndash dot për të dalë në një zgjidhje të tipit idal për përcaktimin e dëmit në mjedis dhe përcaktimin e përgjegjësisë juridiko-civile të palëve dhe legjimimit e tyre në proces.

Në 50/16 ka nevojë për një ripërcaktim si më poshtë se: *Ekspertët e Fushës gjithashtu janë autoritet kompetent për identifikimin, vlerësimin përcaktimin e dëmit në mjedise dhe dëmit në mjedisë në të ardhmen.*

Në nenin 51/1 mund të aplikohen masa lehtësuese për ndotësin ose të përjashtohet nga përgjegjësia nëse operatori dëshmon se ka aplikuar masat adekuate për mbrojtjen e mjedisit, të cilat i kanë diktuar rrethanat për të parandaluar ose zvogëluar dëmin, atëherë ndotësi mund të përjashtohet nga përgjegjësia për ndotje në këto raste:

- a. kur dëmin e ka shkaktuar personi i tretë;
- b. kur dëmi është shkaktuar nga fuqia madhore;
- c. kur dëmi është shkaktuar si pasojë e konfliktit të armatosur.

Në neni 51/2 në ligjin për MM, detyrimet e ndotësit të mjedisit duhet të jenë në përputhje me parimin e kostove të fshehura negative të prodhimit (më sipër, A. Pigou), si dhe kjo dispozitë i përcakton më saktë përgjegjësitë ndaj ndotjes dhe dëmit në mjedis.¹³⁴

Në nenin 51/2, në lidhje me detyrimet e operatorit sipas parimit “ndotësi paguan”, duhet të parcaktojë masat e parashikuara në rast aksidenti:¹³⁵

Në nenin 51/3 Garancia financiare e operatorëve duhet të jetë një kusht për fillimin e veprimtarisë si masë paraprake në rastet se ndodh një aksident apo dëmtohet mjedisi për faj të ndotësit apo edhe në kushtet kur përgjegjësia do kohë të dalë në kuptimin e efikasitetit të legjitimitetit të palëve në procesin civil mjedisor¹³⁶ (rasti i Zharrëzit).

¹³⁴ 1. Ndotësi i cili me veprimin ose mosveprimin e vet shkakton ndotjen e mjedisit, është i detyruar që të ndërmer masat e parapara me planin e mbrojtjes nga aksidenti mjedisor, planin për parandalimin dhe planin për rehabilitim.

2. Nëse dëmi i shkaktuar në mjedis nuk mund të parandalohet përmes masave adekuate, personi juridik ose fizik i cili ka shkaktuar dëmin, duhet ta kompensoj dëmin në vlerën e të mirave të shkatërruara.

¹³⁵ 1. Operatori (ndotësi) i cili me veprimin ose mosveprimin e vet shkakton ndotjen e mjedisit, është i detyruar që të ndërmarrë masat e parapara me planin e mbrojtjes nga aksidenti mjedisor, planin për parandalimin dhe planin për rehabilitim (edhe sipas përcaktimve ligjore).

2. Nëse dëmi i shkaktuar apo që mund të shkaktohet në mjedis nuk mund të parandalohet përmes masave adekuate, personi juridik ose fizik i cili ka shkaktuar dëmin, duhet ta kompensoj dëmin në vlerën e të mirave të shkaktuara apo që mund të shkaktohen

¹³⁶ 1. Operatori është përgjegjës për dëmin mjedisor të shkaktuar në mjedis dhe ai duhet t’i mbartë shpenzimet për vlerësimin e dëmit dhe mënjanimin e tij posaçërisht:

a) shpenzimet e ndërhyrjes urgjent të ndërmarra në momentin e shkakimit të dëmit, të cilat janë të domosdoshme për kufizimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

b) shpenzimet e parandalimit, krijimit të gjendjes së re ose rikthimin në gjendjen e mëparshme të mjedisit, si dhe monitorimit të efekteve të parandalohet dhe efekteve të dëmit të shkaktuar në mjedis;

c) shpenzimet e kompensimit të personave juridik ose fizik të cilët janë të kërcënuar dhe të dëmtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes dëmtimit të mjedisit.

ç) Operatori është i detyruar që të ofrojë garanci financiare ose ndonjë lloj tjetër të garancie për të siguruar kompensimin e shpenzimeve nga paragrafi 1/a,b,c, të këtij neni, gjatë dhe pas kryerjes së aktiviteteve.

d) Qeveria me akt nënligjor përcakton llojin e garancisë nga paragrafi 2. i këtij neni, shumën e mjeteve dhe kohëzgjatjen e garancisë të cilin duhet ta sigurojë operatorin.

Në nenin 51/4 duhet të shtohet se çdo ndotës ka detyrimin ligjor të sigurohet në bazë të nivelit të rriskut që paraqet veprimtaria e tij, madje të ketë edhe sanksione të ashpra administrative dhe penale nëse nuk zbatohet:

Detyrimet e sigurimit për operatorët (ndotësit). Çdo person juridik ose fizik i cili me veprimtari ose me aktivitetin e vetë paraqet nivel të lartë të rrezikut për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, duhet të sigurohet nga përgjegjësia në rast të dëmeve të shkaktuara ndaj palës së tretë.”

Neni 52 i Ligjit për MM ka nevojë të riformulohet dhe rikonceptohet edhe duke ndjekur modelin e ligjit për MM simotër në Kosovë, p.sh.

Kompensimi i dëmit në mjedis:

1. Publiku Subjektet fizike apo juridike dhe shoqatat mjedisore në territorin që preket drejtpërdrejtë apo vuan pasojat e dëmit të shkaktuar apo që mund të shkaktohet në mjedis, apo kanë një interes të ligjshëm, kanë të drejtë t'i kërkojnë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit autoritetit publik ose shtetëror përgjegjës të kërkojë nga operatori:

a) rikthimin e mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme;

b) kompensimin e dëmit të shkaktuar në mjedis, në përputhje me sa parashikohet në këtë ligj, nëse rikthimi i mjedisit në gjendjen e tij të mëparshme është i pamundur.

Kërkesa për kompensimin e dëmit mund ti parashtrahet drejtpërdrejt ndotësit ose siguruesit të tij, respektivisht garantuesit financiar të ndotësit tek i cili ka ndodhur aksidenti, nëse një sigurues, respektivisht garantues financiar i tillë ekziston.

Nëse më shumë ndotës janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar në mjedis dhe nuk mund të përcaktohet saktësisht përgjegjësia e secilit prej tyre, ata i bartin shpenzimet në mënyrë solidare, dhe veç e veç. Procedura për iniciimin e kompensimit të dëmit parashkruhet pas tre vjetësh që prej momentit kur i dëmtuari ka kuptuar për dëmin e bërë dhe për dëmtuesin. Për çdo rast, kërkesa për kompensim parashkruhet pas tridhjetë vjetësh që nga dita kur është shkaktuar dëmi)¹³⁷.

Gjithashtu, sistemi ndien nevojën e ngritjes së “Fondit të Mjedisit”, i cili do të administronte të ardhurat që do të vinin nga lejet, taksat, gjobat apo garancive financiare të propozuara më sipër në funksion të efikasitetit të mbrojtjes së mjedisit por edhe kur përgjegjësia është konkrete për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në mjedis.

Të gjitha këto ndryshime do të ndikonin në rritjen e efikasitetit dhe përcaktimit të kriterëve të dëmit por edhe elementëve që lidhen me legjitimimin e palëve si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin mjedisor.

Pa përcaktim të saktë e të qartë në këtë ligj, të kriterëve së çfarë një përbën dëm në mjedis, procesi i legjiimit të palëve si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile bëhet i vështirë dhe i pamundur, panoramë e cila ndikon drejtpësdrejt në parimin për një një proces të rregullt dhe ligjor.

¹³⁷ Pra padia parashkruhet dhe bie në dekadencë mbas 30 vitesh nëse pala nuk ka pasur dijeni, aktualiasht padit për dëmet pasurore/ jopasurore (në mjedis) sipas Kodit Civil parashkruhen brenda 3 vjetëve.

4.4 Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis-LVNM

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis-LVNM (Legjislacion Kuadër) është një nga aktet ligjore më të rëndësishme për parandalimin e ndotjes apo dëmtimit të mjedisit nga aktivitetet humane. Ai synon të sigurojë:

- Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë, të ndikimeve mjedisore, të projekteve ose veprimtarive që kërkojnë të zbatohen, duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis.

- Një proces vlerësimi të hapur dhe të administruar me paanshmëri, nëpërmjet pjesëmarrjes së organeve qendrore e vendore, publikut, organizatave jofitimprurëse për mjedisin, propozuesit e projektit dhe personave fizikë dhe juridikë, të specializuar në këtë fushë.

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat, afatet, të drejtat dhe detyrat:

Në zbatim të ligjeve për të përcaktuar termat në mënyrë më konkrete, apo masën e shkaktimit të dëmit apo rregullimin e marrëdhënieve që kanë nevojë të konkretizohen më mirë, Këshilli i Ministrave nxjerr akte nënligjore (VKM)¹³⁸, gjithashtu edhe Ministrinë e linjës nxjerrin vendime në zbatim të ligjit, po ashtu ky është edhe një tagër i autoriteteve publike të cilat kanë kompetenca për të nxjerrë akte nënligjore të cilat i vijnë në ndihmë zbatimit të ligjit.

Vështirësitë që shfaq në praktikë ligji i VNM-ve:

¹³⁸ <http://www.kryeministria.al/al/newsroom/vkm/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-dates-9-shtator-2015&page=1>

Kuadri ligjor aktual mbi VNM-të dhe futja në procedurë e Qendrës Kombëtare të Licencimit ka sjellë paqartësi dhe vështirësi.

Konsultimet me publikun kërkohen në një faz 137 më të hershme para se të përfundojë VNM-ja. Dokumenti për pjesëmarrjen publike konsiderohet vetëm si një nga dokumentet e nevojshme për t'u plotësuar, por nuk ka standarde të cilësisë të kërkuara ose kontrolluara. Kryesisht organizohet vetëm një debat publik në fazën e aplikimit para se drafti i dokumentacionit të VNM-së të jetë gati, e cila nuk mjafton¹³⁹. Në këtë ligj lista e veprimtarive të aneksit një dhe dy duhet zgjeruar për t'u përcaktuar më saktësisht edhe veprimtaritë që nuk janë pjesë e kësaj liste, por edhe të theksohet shprehimisht se: përcaktimi i veprimtarive që nuk janë pjesë e aneksit I dhe II të ligjit për VNM të bëhet nga një autoritet i pavarur, sipas përcaktimit të ligjit për MM (Mbrojtjen e Mjedisit, autoriteti i pavarur ose Akademia e Shkencave..). Edhe shmangia e procedurave të konlutimit dhe dëgjësive me publikun e prekur apo të interesuar në thelbin e vetë përbën shkak për të pasur dëm në mjedis real dhe në të ardhmen e cila lidhet drejtpërsëdrejti më përgjegjësinë juridiko-civile të palëve dhe legjimitimin e tyre në procesin civil. (P.sh. janë shumë vendime të GJEDNJ të cilat vendimin e tyre për kompensim apo dëmshpërbilm të shkaktuar nga dëmi mjedisor e kanë të bazuara mbi mos respektimin e kësaj procedure, dhe i kanë gjetur autoritetet publike me faj, si dhe bashkëpërgjegjëse me subjektet private për dëmin mjedisor/shëndetësor të shkaktuar ndaj publikut, duke përcaktuar edhe përgjegjësinë juridiko-civile).

¹³⁹http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Sherbime/Raportimi_per_implementationin_e_Konventes_te_Aarhu_sit_2009-2013.pdf

4.5. Legjislacioni Sektorial Mjedor

Legjislacioni sektorial nënkupton ligje specifike për fusha të veçanta për mbrojtjen e mjedisit dhe veprimtarisë njerëzore. Ligj i tillë është: Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore¹⁴⁰. Ky ligj ka për qëllim:

a) mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave ndërkufitare, të ujërave nëntokësore, si dhe të statusit të tyre; sigurimin, shpërndarjen, mbrojtjen, ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të burimeve ujore, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social e ekonomik të vendit. Ky ligj është përafuar plotësisht me Direktivën e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”¹⁴¹.

Ligji për Lejet e Mjedisit, Ligji për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve¹⁴² dhe ligje të kësaj natyre trajtojnë parime dhe termat kryesorë¹⁴³ në lidhje me mbrojtjen e çështjeve të mjedisit, dëmit në mjedis, të cilat janë edhe instrumente legjitimimi për palët në proces për çështjet mjedisore dhe efikasitetin në drejtësi. Legjislacion mbi Zhurmat, (sektorial) Legjislacioni mbi Mbrojtjen e Mjedisit Detar (sektorial)¹⁴⁴, Legjislacion për administrimin e mbetjeve të ngurta (sektorial)¹⁴⁵, ligji për kimikatet etj.

¹⁴⁰ Ligji për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore nr.111/2012, datë15.12.2012.

¹⁴¹ Direktivën 2000/60/KE.

¹⁴² Ligj Nr.10 463, datë 22.9.2011 për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

¹⁴³ http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2014/PDF-2014/109-2014.pdf

¹⁴⁴ <http://www.mjedisi.gov.al/upload/legjislacioni>

¹⁴⁵ <http://www.riciklimi.al/uploads/documents/1935194869-1350435582.pdf>

Përcaktimi në mënyrë të posaçme edhe në këto ligje se: publiku ka të drejtë të legjitimohet kur konstaton se: po shkaktohet ose mund të shkaktohet ndotje në mjedis, do të rriste efektivitetin për përcaktimin e PJC, rrjedhimisht dëmit në mjedis dhe legjimimin e palëve në procesin civil.

4.6 Legjislacioni Penal Mjedisor dhe dëmi në mjedis

Në Shqipëri veprat penale mjedisore parashikohen në Kreun IV të Kodit Penal, me titull “Veprat penale kundër mjedisit”¹⁴⁶, por dëmi në mjedis nuk kufizohet vetëm nga këto norma specifike në lidhje me mjedisin në KP. Kodi Penal parashikon përgjegjësinë penale të personave juridik, çka nënkupton se kur veprat penale mund të kryhen nga një person juridik, edhe ky i fundit do të mbajë përgjegjësi për dëmin e shkaktuar në mjedis. Në nivel Europian Direktiva¹⁴⁷ për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet së drejtës penale (Direktiva e KE/PE 2008-99), vendos detyrime për shtetet anëtare që të parashikojnë si vepra penale një sërë shkeljesh mjedisore si dhe rekomandon shtetet në pritje të anëtarësimit ta transpozojnë në legjislacionin vendas.

Nga një krahasim i legjislacionit tonë me parashikimet e Direktivës del se një sërë çështjesh që parashikohen nga Direktiva janë jashtë mbulimit të legjislacionit tonë penal. Direktiva për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtës penale iu kërkon vendeve anëtare që të parashikojnë si vepra penale në legjislacionet e tyre një sërë shkeljesh të legjislacionit mjedisor të Bashkimit Europian.

¹⁴⁶ Kodi Penal nenet 201-207.

¹⁴⁷ <http://ec.europa.eu/environment/legal/crime/>

Direktiva vendos standardet minimale. Shtetet anëtare mund të shkojnë përtej këtyre limiteve. Në preambul të direktivës jepen këto arsye:

-Shqetësimi për numrin në rritje të shkeljeve mjedisore, efektet e të cilave sa vjen e më tepër po i shtrijnë efektet e tyre përtej kufijve të shteteve në të cilat janë shkaktuar.

-Moszbatimi i normave mjedisore dhe nevoja për të forcuar zbatimin e tyre nëpërmjet parashikimit të veprave penale të cilat shprehin një mospajtim shoqëror të një natyre cilësisht të ndryshme nga normat administrative apo civile.

-Rregulla të përbashkëta sa i përket veprave penale i bëjnë më efektive metodat e hetimit dhe bashkëpunimit mes vendeve anëtare.¹⁴⁸

Në procesin penal mund të kemi edhe padi civile për dëmin e shkaktuar në mjedis, ky përcaktim vjen nga K.Pr.P¹⁴⁹. Shihet qartë që e drejta penale jo vetëm ka një rol të veçantë të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e mjedisit dhe komponentëve që lidhen me të, por edhe në përcaktimin ka apo nuk ka dëm mjedisor (e cila përbën provë të plotë nëse vërtetohet

¹⁴⁸ Disa elemente kryesore dallues të Direktivës 2008/99 dhe Kodit Penal shqiptar - Kodi ynë dënon vetëm ndotjen e ajrit dhe ujit, por jo të tokës, në një kohë që Direktiva mbulon edhe tokën.

-Në rastin e ndotjes së ajrit, kodi ynë kërkon që substancat të jenë toksike apo radioaktive, ndërsa direktiva nuk e kërkon një gjë të tillë. (standardi i direktivës është shumë më i relaksuar)

-Në rastin e ndotjes së ajrit Kodi ynë dënon shkarkimin përtej kriterëve të lejuara, ndërsa direktiva e lidh veprën me pasojën. Nëse ka ardhur pasoja, pavarësisht nivelit, shkarkimi është i dënueshëm për direktivën.

-Kodi ynë parashikon si paragraf të veçantë ardhjen e pasojave për jetën apo shëndetin e njerëzve, si në rastin e ndotjes së ujit ashtu edhe në rastin e ndotjes së ajrit. Direktiva, nga ana tjetër dënon edhe ardhjen e pasojave për kafshë dhe bimët. Me sa shikojmë më sipër të gjitha këto Vepra Penale dhe rekomandime të Direktivës i vijnë në ndihmë mbrojtjes së mjedisit, por edhe përafritimit të legjislacionit dhe standardeve europiane si kërkesë e Unionit dhe Këshillit të Europës.

Spektri ligjor për mbrojtjen e mjedisit dhe rregullimit të marrëdhënieve në këtë fushë është më i gjerë, më sipër kemi përmendur vetëm disa norma juridike kryesore të cilat veprojnë më shumë në këtë fushë. Mbrojtja e mjedisit nuk mund të kufizohet si mbrojtje e vetëm disa ligjeve të caktuara, ajo është një fushë e re dhe abstrakte e cila ka nevojë për tu përditësuar harmonizuar dhe sistemuar, për ti shërbyer shëndetit dhe cilësisë së jetës, florës dhe faunës dhe ambientit në të cilin individit ushtron aktivitetin e tij.

¹⁴⁹ Kodi i Procedurës Penale, neni 61.

fajësia) nga e cila buron edhe përgjegjësia juridiko civile, ku procesi civil në parim lejohet që të ngrihet brenda një procesi penal deri sa të mos ketë filluar shqyrtimi¹⁵⁰.

Në parim, një proces civil për dëmin e shkaktuar ndaj mjedisit nuk mund të përfundojë pa përfunduar plotësisht procesi penal, nëse ka një të tillë.

Problemet që has legjislacioni mjedisor shqiptar në kuadër sektorial, penal, kryesisht lidhen edhe me moszbatimin me efikasitet të këtyre normave, përveç aspekteve të paplota dhe të paraqarta të disa përgjegjësive administrative nga të cilat lidhen me dëmit në mjedis dhe përgjegjësinë juridiko-civile të palëve.

¹⁵⁰ Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, 2000, nr 284 “...pacia civile nuk mund të paraqitet në një fazë procedimi që nuk e parashikon K.Pr.C. Ky procedim nuk mund të fillojë në gjykatën e shkallës së dytë, sic ka vepruar gjykata e apelit, pasi do të ndodheshim para cënimit të parimit të respektimit të shkallëve të gjykimit civil, të parashikuar në nenin 135 të Kushtetutës dhe të parashikuar hollësisht në ligjin procedural”.

KAPITULLI V-DËMI NË MJEDIS SI PJESË E PËRGJEGJËSISË

JURIDIKO CIVILE

5.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të trajtohet një analizë specifike procesuale teorike dhe praktike lidhur me efikasitetin e legjislacionit shqiptar të dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile, Legjitimi i palëve, interesit i ligjshëm, përcaktimi i dëmit dhe dëmit në të ardhmen, do të analizohen në këtë kapitull duke sjellë edhe raste nga praktika e jurisprudencës shqiptare dhe ndërkombëtare.

Dëmi në mjedis në të ardhmen trajtohet nga disa teori, si ajo e kauzalitetit adekuat (e disa shkaqeve) dhe të shkakut të drejtpërdrejtë. Sigurimi i padisë dhe padia për çështjet mjedisore vjen në këtë kapitull e zhvilluar jo vetëm teorikisht por edhe nëpërmjet rasteve konkrete, siç është rasti i ndërtimeve te Parku i Liqenit Artificial Tiranë 2016 etj.

Organet të cilat legjitimohen për çështjet mjedisore, roli i Konventës së Aarhusit dhe i tre shtyllave të saj në lidhje me aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore, si dhe roli i padisë së Begatimit pa Shkak.

Ky kapitull përpiqet të japë një pamje të qartë të efikasitetit të legjislacionit shqiptar për përgjegjësinë juridiko-civile dhe dëmit në mjedis si në aspektin teorik dhe praktik.

5.2. Interesi i ligjshëm, legjitimimi racione materiae dhe dëmit në mjedis, si pjesë e efikasiteti në drejtësi

Fusha e përgjegjësisë juridiko-civile mjedisore, duke qenë një fushë e re, e gjerë, shfaq dhe përcakton disa probleme të ndryshme të cilat përballen më zgjidhje të ndryshme.

Elementi i parë është përcaktimi dhe qasja ndaj objektit se çfarë është dhe çfarë kuptojmë me dëm në mjedis sipas përcaktimit që ka bërë legjislatori!

Elementi i dytë ka të bëjë më kuptimin që ai mer sipas të drejtës vendase komunitare apo ndërkombëtare!

Elementi i tretë ka të bëjë më anën procedurale të dëmshpërblimit të këtij dëmi dhe mbi çfarë kriteresh mbështet!

Elementi i katër është mbi çfarë kriteresh bazohet përgjegjësia juridiko-civile!

Elementi i pestë është kriteret e identifikimit të lidhjes shkakësore (të drejtë përdrejt-indirekte-objektive-subjektive)!

Elementi i gjashtë është parandalimi dhe sigurimi ndaj dëmit në mjedis!

Në titullin e IV të Kodit Civil (KC), kreu i saj parashikon dispozita të përgjithshme për Përgjegjësinë e Shkaktimit të Dëmit, neni 624: " Personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke e keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar", është i detyruar të kompensojë dëmin e shkaktuar, duke përbërë një

hap të rëndësishëm në evolucionin e kësaj problematike, madje ky nen në thelb përbën parimin mbi të cilën mbështetet analiza dhe elementet e tjerë që paraqiten në gjykatë për t'u trajtuar rast pas rasti. Ky nen është i mbështetur në parimin “Ndotësi Pagan” nga e cila rrjedh edhe përgjegjësia juridiko-civile (PJC) për shkaktuesin e dëmit në mjedis. Gjuha e Kodit Civil në lidhje me përgjegjësinë civile dhe dëmit në mjedis për legjitimimin e palëve ka një harmonizim minimal pasi shumë kriteret, përcaktimet, në lidhje me dëmin në mjedis nuk janë të detajuara apo të përcaktuara plotësisht, si dhe duke qenë e ndërvarur edhe nga fusha të tjera të së drejtës. P.sh. në analiz të nenit nën 608 sipas KC dëmi duhet të jetë i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë ndaj personit¹⁵¹ dhe të jetë cënuar një interes i ligjshëm apo e drejtë dhe zakoni i mirë ndaj personit të cilat mbrohen nga rendi juridik. Marrëdhënien juridiko-civile do ta gjejmë, atëherë, kur plotësohen në mënyrë kumulative këto elemente, objekti, subjekti dhe përmbajtja. Përgjegjësia civile lind atëherë kur kemi mospërbushje të detyrimit nga debitori që lind nga kontrata, ose në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit, e cila ka vend të zbatohet kur ekziston lidhja shkakësore midis sjelljes së paligjshme të një personi dhe pasojës që ka ardhur, si dhe fajit. Përgjegjësia civile si rregull është përgjegjësi me faj, megjithëse ekzistojnë edhe përgjegjësi pa faj, kjo lloj përgjegjësie mund të ekzistojë vetëm në rastet e shprehura shprehimisht me ligj (Semini M. Tutulani, 2006: 181), ku janë të përcaktuar në mënyrë konkrete aktivitetet me impakt në mjedis, si rasti i ligjit për VNM i cili ka një aneks ku liston aktivitetet që duhet të pajisen me leje mjedisore (VNM). Faji, lidhja shkakësore, paligjshmëria e veprës dhe dëmi i

¹⁵¹ Kodi Civil mbi përgjegjësinë e shkakimit të dëmit nën 609: Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit. Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjanuar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

shkaktuar janë elementet që përbëjnë dëmin në thelb dhe lindjen e përgjegjesisë juridiko-civile të dëmit në mjedisor. (Elementet e dëmit, faji, dëmi shkaktuar, paligjshmëria e veprimit, lidhja shkakësore: “*Nullum crimen nulla poena sine causa*”¹⁵²).

Në nenin 624 për të pasur përgjegjësi ndaj cënimeve që mund t’i vijnë mjedisit, kërkohet edhe faji si element i dispozitës. Pyetja që ngrihet, a mos duhej të kishte edhe përgjegjësi pa faj (objektive) për ta bërë dispozitën edhe më kuptim plotë për figurën e përgjegjesisë juridiko-civile.

I analizojmë më poshtë elementet e përgjegjesisë civile në kontekstin e dëmit në mjedis.

5.2.1 Faji në Kodin Civil

Personi që me faj ka cenuar mjedisin, duke keqësuar, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar (ne lidhje me)¹⁵³.

Subjekt i marrëdhënies së përgjegjesisë juridiko-civile është çdo person fizik që ka mbushur moshën 14 vjeç dhe është i aftë, si dhe çdo subjekt tjetër fizik apo juridik në kuptimin e ligjit. Përkufizimin e fajit e gjejmë në nenin 14 të Kodit Penal: “*Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si vepër penale, në*

¹⁵² Semini M. Tutulani, 2002, fq.226.

¹⁵³ Në nenin 608 të Kodit Civil parashikohet që:

“Personi që në mënyrë të paligjshme dhe me faj, i shkakton tjetrit një dëm në personin dhe pasurinë e tij, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj. Dëmi quhet i paligjshëm kur është rrjedhim i shkeljes ose i cënimit të interesave dhe i të drejtave të tjetrit, që mbrohen nga rendi juridik ose nga zakonet e mira.” Kjo dispozitë parashikon faktin juridik njerëzor të sjelljes së paligjshme dhe me faj të një personi që i shkakton dëm një personi tjetër. Nëse vërtetohet fakti i paligjshëm dhe lidhja shkakësore e tij me dëmin, lind marrëdhënia e detyrimit, e drejta subjektive e personit të dëmtuar për të kërkuar dëmshpërblim dhe detyrimi i personit përgjegjës për ta shlyer atë.

qoftë se vepra nuk është e kryer me faj. Quhet me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi”¹⁵⁴. Faji përmendet edhe në KC¹⁵⁵ i cili shprehet se:

“Kur personi që ka kryer veprimin apo mosveprimin e paligjshëm krahas dëmit të shkaktuar, ka patur edhe një përfitim të dukshëm, gjykata me kërkesën e palës së dëmtuar duke patur parasysh natyrën e dëmit, shkallën e fajësisë dhe rrethana të tjera të çështjes mund të llogarisë në shpërblimin e dëmit, tërësisht apo pjesërisht përfitimin”

Në kuptim objektiv të shkaktimit të dëmit në të drejtën civile (Nuni A, 2008: 98 – 99), përgjegjësia trajtohet në bazë të sasisë dhe vlerës së dëmit të shkaktuar nga personi. Zakonisht ndarja e kategorive të përgjegjësisë për fajin (për përgjegjësinë e shkaktimi të dëmit) synon të ndajë edhe përgjegjësinë për masën e shkaktimit dhe të shpërblimit të dëmit. Kodi Penal i trajton¹⁵⁶.

¹⁵⁴ Faji si kategori e brendshme psiqike, ekziston vetëm kur personi dëmin e shkakton me vetëdije dhe me vullnet për të krijuar pasojën e dëmshme, pra paraqet raportin mes asaj çka dëshiron personi dhe veprimeve të jashtme që manifeston.

¹⁵⁵ Neni 644, Kodi Civil.

¹⁵⁶ Kodi Penal shprehet:

A. Dashja Vepra penale kryhet me dashje, kur personi i parashikon pasojat e veprës penale dhe dëshiron ardhjen e tyre ose, megjithëse i parashikon dhe nuk i dëshiron ato, me ndërgjegje lejon ardhjen e tyre. Dashja ndahet në 2 kategori: Dashje Direkte dhe Dashje Indirekte.

B. Dashja direkte (dolus directu). Te dashja direkte shkaktuesi i dëmit, dëmin e kryen me paramendim, është i vetëdijshëm për pasojat e tij, të cilat edhe i dëshiron.

C. Dashja eventuale (dolus eventualis). Te dashja eventuale e cila ndonjëherë quhet dhe dashje e rastit, shkaktuesi i dëmit është i vetëdijshëm për pasojat e dëmit që mund të shkaktojë veprimi apo mosveprimi i tij, edhe pse nuk i dëshiron këto pasoja nuk heq dorë nga shkaktimi i dëmit.

D. Pakujdesia. Vepra penale kryhet me pakujdesi kur personi, megjithëse nuk i dëshiron pasojat, e parashikon mundësinë e ardhjes së tyre dhe me mendjelehtësi shpreson t'i shmangë ato, ose nuk i parashikon, megjithëse sipas rrethanave duhej dhe kishte mundësi t'i parashikonte.

E. Kemi Vetëbesimin e Tepruar dhe Neglizhencën, si nënkategori të Pakujdesisë, I Elezi, S Kacupi, M Haxhia, Komentari i Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë fq. 113-121.

Në të drejtën civile parimi i prezumimit të fajit është kusht për lindjen e përgjegjësisë civile, barrë e cila i bie debitorit për të vërtetuar të kundërtën.

Kemi dy lloje përgjegjësish: ajo objektive dhe subjektive.

Te përgjegjësia objektive personi nuk ka faj por ka përgjegjësi (përgjegjësia mbi sendet e rrezikshme, aktivitetet e rrezikshme mjedisore), e kundërta ndodh te ajo e përgjegjësisë subjektive ku personi ka faj dhe jo përgjegjësi, pra ka faj më të rëndë dhe të drejtpërdrejtë si shprehje e vullnetit të tij të drejtpërdrejtë për ardhjen e pasojave. Në këtë kuptim, përgjegjësia për dëmit në mjedis pa faj në nënin 624 të KC nuk ekziston.

Faji nënkupton bashkimin e tre elementeve: 1. ai material, 2. shkeljen e një detyre (paligjshmërinë e veprimit) 3. në parim të vepruarit qartë me mendje të mprehtë, nga një njeri mesatar (Legier G, 2008 : 137-138).

Faji në kuptimin e përgjegjësisë së marrëdhënies juridiko-civile për shkaktimin e dëmit në mjedis ka kuptim objektiv sasior: sa më i madh është faji aq më i madh është dëmi, sa më i madh është dëmi aq më e madhe është përgjegjësia e subjektive e personit, qoftë me veprim apo mosveprim të tij për shpërblimin e dëmit, si përfundim doktrina juridike e përkufizon fajin duke përfshirë të gjitha veprimet me të cilat bëhen gabime dhe iu shkaktohet dëm personave të caktuar, gjatë të cilit shkelen standartet e sjelljes personale dhe shoqërore nga një njeri i zakonshëm, me profesion të mirë dhe standarte ekonomike të zakoshme (njeriu mesatar), të cilët duhet të plotësojnë detyrimet ligjore, gjithmonë duhet të sillen në respekt të traditave dhe zakoneve të mjedisit ku ata veprojnë (Calnan A, 2007: 105).

Në kushtet kur KC nuk e ka të përcaktuar si kategori të posaçme dëmin në mjedis në të ardhmen (p.sh. kostot e fshehura të prodhimit, A. Cecile, më sipër, nga e cila lind përgjegjësia juridiko-civile për dëmin në mjedis), apo doktrina ndeshet me probleme në këto përcaktime, në aspektin procedural dhe material në lidhje me dëmin në mjedis dhe përcaktimin e përgjegjësisë juridiko-civile (PJC) dhe efikasitetit e saj, normativa KC mund të përmirësohet duke u përpjekur të bëj disa rregullime apo harmonizime në ligjet e posaçme si ligji për Mbrotjen e Mjedisit, ligji për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis ligji për Gjykatën Administrative etj, që kanë lidhje me çështjet mjedisore dhe fushave të tjera të së drejtës që integrohen me këtë të drejtë.

P.sh. në nenin 624 “Përgjegjësia ndaj cënimeve të mjedisit mund të jetë edhe përgjegjësi objektive, pa faj, që nënkupton përfshirjen e një kategorie me të gjerë të dëmit në mjedis dhe konsolidimin më mirë të figurës së PJC të dëmit në mjedis.

Në nenin 609 të KC psh: Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit, (fakt i paligjshme, ekzistenca e dëmit, faji, lidhja shkakësore).

Mospengimi i një ngjarjeje nga personi që ka detyrimin ligjor për ta mënjeluar, e ngarkon atë me përgjegjësi për dëmin e shkaktuar.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave që të lindë detyrimi i dëmtuesit për shpërblimin e dëmit pasuror/jopasuror (jasht-kotraktor) duhet të ekzistojnë në mënyrë kumulative këto kushte:

1. Fakti i paligjshëm; 2. Ekzistenca e dëmit; 3. Faji; 4. Lidhja shkakësore (pra, parimisht dëmi në lidhje me dëmin e shkaktuar në mjedis duhet të ketë ndodhur, të jetë real).

- Kemi disa lloje dëmsh në mjedis, por ajo që do të trajtojmë kryesisht është dëmi i ardhshëm pasi aty shfaqet problematika më e madhe e legjislacionit në legjitimimin e palëve si pjesë e PJC. Kemi dëmin real (*damnus emergens*), dëmi konkret, dëmi abstrakt, dëmi direkt, dëmi i tërthort, dëmi efektiv, fitimi munguar, dëmi i vërtetë; të gjitha këto lloje dëmsh kanë një lloj rregullimi ligjor, praktika gjyqësore apo doktrinale të ndryshme. Në kuptimin e dëmeve në mjedis ajo që nuk është qartësisht e përcaktuar është dëmi i ardhshëm, në lidhje me cënimet që mund t'i vijnë mjedisit (*dhe që mund të përbëjë dëm material ose jo material*). Pavarësisht Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë¹⁵⁷ për dëmin ekzistencial¹⁵⁸ në vitin 2007 apo VGJK për dëmin real dhe potencial¹⁵⁹, edhe në kuptimin e dëmit në mjedis nga ana praktike ai ndeshet me shumë vështirësi. Në planin teorik ai përpiqet të mbulojë dëmet që mund t'i vijnë personit në shëndetin dhe cilësinë e jetës, personalitetin e tij indirekt edhe nga mjedisi, por kategoria e dëmit në mjedis në natyrë si dëmi kryesor, nuk përcaktohet dhe nuk del saktë nga normativa shqiptare: kjo përbën arsye të mjaftueshme që në planin praktik për dëmet e tjera që kanë lidhje me dëmin kryesor atë

¹⁵⁷ Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dt. 13.09.2007 dhe 14.09.2007, nr. 12

¹⁵⁸ Dëmi Ekzistencial sipas vendimit unifikues të sipërpërmendur: dëmi ekzistencial është dëmi i shkaktuar nga fakti i paligjshëm i të tretit cenon të drejtat e personalitetit të njeriut duke dëmtuar thujse në mënyre të përhershme shprehjen dhe realizimin e te dëmtuarit si njeri, shfaqjen e personalitetit të tij në botën e jashtme, duke tronditur objektivisht jetën e përditshme dhe veprimtarinë e zakonshme të tij, duke i shkaktuar përkeqësim të cilësisë së jetës nga ndryshimi dhe prishja e ekuilibrit, sjelljes e zakoneve të jetës, të marrëdhënieve personale e familjare. Për shkak të një gjendjeje të tillë psiko-fizike, i dëmtuari nuk mund të kryejë më veprimtari të caktuara që karakterizojnë pozitivisht qenien e tij apo mund ta karakterizojnë pozitivisht në të ardhmen, duke e detyruar të shtyhet drejt zgjidhjeve të ndryshme në jetë nga ato të dëshiruara e të pritshme apo në heqjen dorë nga këto të fundit për shkak të vërtetimit të faktit të paligjshëm.

¹⁵⁹ “Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushitetshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit” shih vendimet nr.33, datë 24.06.2010; nr.4, datë 23.02.2011; nr.43, datë 06.10.2011; nr.37, datë 13.06.2012, të Gjykatës Kushtetuese.

në mjedis të mos jenë të realizueshme, dhe aksesimi në drejtësi të mos jetë efikas duke mos dal qartë PJC.

Dëmi është pjesë e rëndësishme e marrëdhënies së detyrimeve, ai mund të lindë nga një marrëdhënie kontraktuale, por mund të jetë burim edhe i një marrëdhënieje të përgjegjësisë juridiko-civile jo kontraktuale që bie në fushën e ligjit, si ai i dëmit jashtëkontraktor.

“Qëllimi i përcaktimit të përgjegjësisë juridiko-civile është mbrojtja e subjektit dhe e pasurisë së tij nga veprimtaritë e paligjshme dhe të dëmshme të personave që mbajnë sjellje të tilla”¹⁶⁰ (Nuni. A, 2008: 95). Në themel të shkaktimit të dëmit qëndron fakti juridik të cilit ligji i ka përcaktuar se çfarë pasojash ka sjellë. Fakt është çdo sjellje e njeriut, ngjarje shoqërore ose fenomen të natyrës për të cilat ligji përcakton pasojat juridike në lidhje me dëmin mjedisor, si baza kryesore për një Interes të Ligjshëm të kërkuarit.

5.2.2 Lidhja shkakësore

Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit apo mos veprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre mungon lidhja shkakësore;¹⁶¹ kështu e përcakton Lidhjen Shkakësore Kodi Penal, por ndryshimi midis të drejtës penale dhe asaj civile është se përgjegjësia civile lind edhe pa patur faj, përgjegjësi objektive (shkak objektiv), për të qenë përgjegjës për një VP duhet të provohet faji dhe lidhja shkakësore që të plotësohet figura e anës subjektive të VP.

¹⁶⁰ Nuni A, Mustafaj I, Vokshi A, I, shih Detyrimet dhe Kontratat, Prof dok. Mehdi J. Hetemi, fq 76, E Drejta e Detyrimeve, BQPZ Tiranë 2008, fq. 95.

¹⁶¹ Elezi I, Kacupi S, Haxhia M, Tiranë 2006, fq. 101-103.

Pa lidhjen shkakësore nuk mund të ketë përgjegjës për shkaktimin e dëmit shtesë. Duhet të ekzistojë një lidhje midis veprimit/mosveprimit të dëmtuesit dhe efektit që rrjedh prej tij (dëmi i shkaktuar). Lidhja e kërkuar duhet të jetë e drejtpërdrejtë, pikërisht veprimi ose mosveprimi i personit duhet të ketë shkaktuar dëmin dhe jo veprimin/mosveprimin e dikujt tjetër. Gjithashtu, kërkohet që dëmi të jetë pasojë e menjëhershme e veprimit ose mosveprimit të personit. Kjo duhet të kuptohet në lidhje me kohën dhe hapësirën midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit që rrjedh dhe pasojës që prodhon. Nuk mund të kalojë një kohë shumë e gjatë ndërmjet sjelljes (veprimit ose mosveprimit) dhe ardhjes së pasojës pasi lidhja shkakësore midis veprimit apo mosveprimit me pasojat bëhet më e vështirë për t'u përcaktuar si pjesë e provave, kështu që bie një nga elementet që përcakton dëmin në mjedis, për pasojë edhe përgjegjësia juridiko-civile nuk del.

Në kuptimin e së drejtës civile, lindja e një ngjarjeje është kusht për lindjen e dëmit, pa shkaktim ngjarjeje nuk kemi dëm të shkaktuar: dëmi është pasoja, shkak është ngjarja.

Fakti juridik që ligji i ngarkon pasoja juridike është ngjarja që ka ndodhur ose që mund të ndodhë. Ndodhja e kësaj ngjarjeje detyron shkaktuesin e dëmit të shpërblejë dëmin e shkaktuar si pasojë e ngjarjes (Legeir G, 2008: 158). Doktrina dhe jurisprudenca të ndryshme e trajtojnë në mënyrë të ndryshme Lidhjen Shkakësore. Vende si Austria, Gjermania, Zvicra, Franca etj., në shkaktimin e dëmit nëpërmjet veprimit apo mosveprimit të subjektit, marrin parasysh raportin e proporcionit të veprimeve të dëmshme në proporcion me dëmin e shkaktuar.

Pra, nuk kemi një kusht të drejtpërdrejtë të vetëm siç e përcakton doktrina e kushtit të drejtpërdrejtë të lindjes së ngjarjes, po kemi një tërësi rrethanash të cilat vlerësohen në bindjen dhe gjykimin e gjyqtarit, kushti i drejtpërdrejtë lidhet më shumë me shkakun objektiv, kërkon që pasoja të ketë ardhur për t'u legjitimuar dhe pasur një interes të ligjshëm.

Përcaktimi i dëmit në mjedis nuk mund të kufizohet vetëm në lindjen e një fakti juridik të drejtpërdrejtë, por e një tërësie faktesh sipas kësaj doktrine e cila merr në raport proporcionin e veprimeve apo mosveprimeve në proporcion me dëmin e shkaktuar në mjedis, elemente të cilat do të rrisnin garancit për legjitimitimin e palëve mbi padinë mjedisore. Kjo doktrine parashikon edhe dëmin abstrakt dhe joreal, pra dëmin që mund të ndodhë duke u bazuar në analizën e teorisë së riskut, se sa këto veprime jo ligjore mund të shkaktojnë dëme në të ardhmen në mjedis; ne na mungon një bazë e tillë ligjore për përcaktimin e veprimtarive të rrezikshme në mjedis dhe riskut të tyre, bazë e posaçme ligjore mjedisore e cila përcakton më qart përgjegjësin juridiko civile të palëve në proces

Shembull: Ndërtimi në një zonë të mbrojtur si rasti “Langarica” i një HEC-i, jo vetëm shkel ligjin për zonat e mbrojtura¹⁶², por shfrytëzon burimet ujore në kundërshtim me Kushtetutën e Shqipërisë, gjithashtu bie në kundërshtim me ligjin për tokat bujqësore, për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe një sërë ligjesh të tjera të cilat çenojnë edhe pronën private

Pra, siç shikojmë për të përcaktuar dëmin në mjedis të shkaktuar në faunën dhe florën e Lumit dhe Luginës Langarica, dëmi ndaj vaditjes së tokave bujqësore që ndodhen anës

¹⁶² “Ligji Për Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar Nr. 8906, datë 6.6.2002.

brigjeve në perimetrin e caktuar nga ligji, dëmtimin e pyjeve dhe nga ky dëmtim janë larguar shpendët e zonës që ishin burim për turizmin e kësaj zone, (turizmi ishte burim i të ardhurave kryesore private dhe publike) në këtë zonë¹⁶³ ka pasur dëmtimi të peizazheve natyrore, ndotje ujërash, (Instituti i Naftës, studim, Fier: 2002) ndotje të ajrit, ndotje nga zhurmat dhe të ardhurat në këtë zonë kanë rënë që në momentin që ka filluar të ndërtohet ky HEC. Siç shihet, nuk kemi vetëm një ngjarje në kuptimin e ligjit, por kemi shumë fakte juridike që në tërësinë e tyre na çojnë te lindja e dëmit të shkaktuar apo që mund të shkaktohen nga këto ngjarje, diku kanë lidhje të drejtpërdrejta shkak-pasojë, diku kanë lidhje indirekte ose zinxhirë shkak-pasojë dhe parimi i “conditio sine qua non”, në këtë rast, nuk vlen, pasi janë një tërësi rrethanash që dëmtojnë mjedisin edhe nëse supozojmë se uji u përdor si një arsye legjitime për të pasur energji elektrike dhe ulur çmimin etj.! Pra, ngjarja ndërtohet si një e tërë dhe jo e fragmentizuar për të nxjerë përgjegjësinë juridiko-civile dhe dëmin në mjedis në këtë rast.

(Jurisprudenca Shqiptare)

Ligji dhe jurisprudenca jonë për dëmin në mjedis kryesisht kërkon lindjen e drejtpërdrejtë të ngjarjes, e jo vetëm, por edhe lindjen e drejtpërdrejtë të dëmit, pra dëmi i shkaktuar të jetë real të plotësohet figura e PJC që më pas gjykata të mund të legjitimojë si palë aktive në proces për dëmin në mjedis dhe në funksion të efikasitetit në drejtësi për çështjet mjedisore.¹⁶⁴ Rastet e përgjegjësisë objektive kanë qenë mjaft të kufizuara më parë, për shkak se parimet morale dominonin mbi ato ligjore dhe nuk kishte përgjegjësi për dëmin e

¹⁶³ Ligji Për Mbrojtjen e Pyjeve Ligji Nr. 9385, datë 4.5.2005.

¹⁶⁴ Rasti i tre padive të cilat nuk u rrezuan me arsyetimin se nuk legjitimohen palët kur nuk kanë një interes të ligjshëm të drejtpërdrejt personal (Çështja e ndërtimit të këndit të lojrave të Liqeni Artificial Tiranë (Mars-Korrik 2016).

shkaktuar nëse nuk shkaktohej së paku nga neglizhenca (faj). Kufijtë e fushës së përgjegjësisë objektive lidhen me karakterin e zhvillimit industrial, duke u bazuar në përdorimin e mjeteve të prodhimit të cilat janë burime të rrezikut për personat dhe sendet (fabrikat e ricklimit, karrierat, automjetet motorike, industria e përpunimit të naftës etj.) si pjesë e pandashme social-ekonomike e zhvillimit tonë. Lidhja shkaksore mbetet një element konceptual në zhvillime sipër për sa i përket lidhjes më dëmin e shkaktuar në mjedis me theks përgjegjësinë objektive pa faj si pjesë e së drejtës civile.

Qëndrimi i doktrinës sonë në lidhje më lidhjen shkaksore

Doktrina shqiptare, në praktikë, i mëshon më shumë faktit të shkakut të drejtpërdrejtë të shkakimit të dëmit (në mjedis). Ana pozitive është se ti mund të vërtetosh dëmin në mjedis në natyrë, por është e vështirë të vërtetohet lidhja e këtij dëmi më dëmin e shkaktuar në shëndetin e njeriut.

Në nenin 609 të Kodit Civil, përcaktohet së dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit të personit me faj (neni 624 mbi përgjegjësin ndaj mjedisit). Që dëmi në mjedis duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë i veprimit të personit, kjo duhet kuptuar se midis veprimit dhe pasojës duhet të ekzistojë një lidhje shkaksore e drejtpërdrejtë (kusht objektiv). Por që dëmi të jetë dhe rrjedhojë e menjëhershme e veprimit kjo kërkesë mund të paraqesë vështirësi në disa raste, si p.sh. në dëmet e shkaktuara në ndotjet e mjedisit, dëme në shëndet apo dëme të cilat nuk shfaqen menjëherë pas ndotjes mjedisore, por mund të shfaqen në mënyrë të heshtur apo pa dijenin dhe ndërgjegjjen e plotë të personit. Për të arritur në konkluzione nëse kemi një dëm në mjedis në të ardhmen,

në kuptimin klasik dëmtim të mjedisit (tokës, ajrit, ujit, florës/faunës) dhe në kuptimin biologjik (shëndetësor-psikologjik) gjykata dhe organet kompetente thërrasin ekspertët e fushës për të bërë këto përcaktime të vështira të cilat nuk përkthehen thjeshtë dhe në vlera monetare por edhe shpirtërore dhe sociale (rasti i trashëgimis kulturore).

5.2.3 Teoria e kushteve jo te drejtpërdrejta (adekuat/të përshtatshëm) për dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjesisë juridiko-civile

Kjo teori e shikon shkaktimin e dëmit jo vetëm si një ngjarje të lindur nga një fakt, por nga shumë fakte që kanë lidhje në masën e gjykimit që e vlerëson gjyqtari midis veprimit dhe dëmit të shkaktuar, pra nuk janë kritere fikse të përcaktuara, por shikohet rast mbas rasti. Dëmi që shkaktohet në mjedis sipas kësaj doktrine e cila aplikohet në Francë, Itali dhe kryesisht në vendet e zhvilluara kërkon një analizë të thellë të gjithanëshme dhe nuk kushtëzohet vetëm nga lindja e një kushti për shkaktimin e dëmit, por kushti shikohet edhe vetë brenda tij për lindjen dhe rolin e kushtit të kushtit në lindjen e ngjarjes për shkaktimin e dëmit për të nxjerrë dhe përcaktuar përgjegjësinë juridiko-civile e cila del nga dëmi mjedisor.¹⁶⁵

¹⁶⁵ Shembull: Pronari i një automjeti ka harruar ta mbyllë atë me çelës; ose e ka harruar çelësin brenda në automjet duke e lënë hapur atë, nga kjo situatë ka përfituar një person tjetër për ta vjedhur; hajduti ndërkohë largohet me automjet shkaktonte një aksident i cili shkaktonte edhe dëm në mjedis; mund të themi se pakujdesia e pronarit ka qenë një nga shkaqet e aksidentit? (Kjo është teoria e shkaktimit adekuat). Nuk mund të themi se fajin për aksidentin e ka pronari i mjetit pse ai harroi çelësin në automjet, ose duke e lënë hapur atë. Shkaku adekuat i dëmit (Legeir G, 2008, fq. 157-9) që u shkaktua nga aksidenti erdhi si pasojë e përplasjes së automjetit të cilin e drejtonte subjekti x (hajduti automjetit) ky mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për lindjen e kushtit dhe shkaktimit të dëmit si dhe dëm në mjedis kur nga shpejtësia e automjetit janë dëmtuar pemë, tubat e ujit të pijshëm, është derdhur vaj në rrugë nga përplasja si dhe ka substanca të tjera ndotëse për ambientin. Pronari i automjetit që kishte harruar çelësin në automjet nuk mban përgjegjësi për dëmin e shkaktuar. Kodi Civil i Napoleonit i vitit 1804 parashikonte përgjegjësinë e mësuesit dhe se ai i nënshtrohej parimit të njëjtë të hamendësimit të fajit si prindi. Në vitin 1937 me ligjin e datës 5 Prill, ky hamendësim u hoq dhe duhet provuar fajësia e mësuesit që shteti të marrë përsipër përgjegjësinë e shkaktimit të dëmit. Pra nëse një nxënës në vitin 1804 më KN do të shkaktonte një zjarr në pyll apo do të dëmtonte mjedisin kur ishte nën përgjegjësinë e mësuesit edhe nëse ky vërtetonte që

Edhe Kodi Civil Shqiptar ka ecur në rrugën e përgjegjësisë objektive si kusht për vërtetimin e lidhjes shkak-pasojë për lindjen dhe shkaktimin e dëmit (Nuni A, 2008: 112-113) për personat nën mbikëqyrje. Përgjegjësia lind edhe nga shkelja e zakoneve të mira¹⁶⁶. Padijenija në mosnjohjen e ligjeve nuk përbën fakt për përjashtimin nga përgjegjësia juridiko-civile¹⁶⁷.

Kodi Civil i Francës¹⁶⁸ parasheh rastin kur shkelja e detyrimeve kontraktore rezultojnë në mashtrimin e debitorit, zhdëmtimi nuk do të përfshijë çdo humbje që ka pësuar kreditori dhe fitimin e munguar, por vetëm atë dëm që shkaktohet nga shkelja e menjëhershme dhe e drejtpërdrejtë e marrëveshjes. Edhe kësaj teorie i bëhen vërejtje sepse përfshin vetëm dëmin integral por jo edhe fitimin e munguar dhe nuk merr parasysh edhe rrethanat e tërthorta që mund të ndikojnë në shkaktimin e pasojës së dëmshme.

5.2.4 Teoria e lidhjes shkakësore të drejtpërdrejtë

Kjo teori dikton kushtin e drejtpërdrejtë që ka shkaktuar dëmin mjedisor. Nëse një person i shet dikujt një shpend dhe ky shpend është i infektuar, ndërkohë ky infeksion iu kalon edhe shpendëve të tjera që ai ka e ndërkohë ato ngrodhin, personit të dëmtuar i lind e drejta të dëmpshpërblehet për dëmin real që i është shkaktuar nga ngrodhja e këtyre shpendëve, por

nuk kishte mundësi të kuptonte apo të merrte masa për ta parandaluar këtë gjë hamendësohej se faji ishte i mësuesit, dhe ai ishte përgjegjës për lindjen e ngjarjes dhe shkaktimin e “dëmit në mjedis”. Ligji i vitit 1937, nëse do të ishim përsëri përballë të njëjtës situatë atëherë pala që ngrinte pretendimin duhet të vërtetonte hamendësimin e fajit ndaj mësuesit, pra barra e provës i takon paditësit për pretendimet që ka në lidhje me dëmin e shkaktuar në mjedis, për të përcaktuar përgjegjësinë, e cila quhet përgjegjësi pa faj ose objektive (Legeir G, 2008:156).

¹⁶⁶ Omari L. Rendi juridik është, tërësia e marrëdhënieve të njerëzve në shoqëri që shprehen dhe sanksionohen në të drejtën, në normat juridike.’ “Parime dhe institucione të së drejtës publike”, Shtëpia botuese, Tiranë, 1999, fq 193.

¹⁶⁷ Semini M. Tutulani. “E drejta e detyrimeve dhe e kontratave, pjesa e përgjithshme, botimi i tretë, Tiranë 2002, fq 226.

¹⁶⁸ Kodi Civil i Francës, në nenin 1151.

nuk i jepet fitimi munguar nga aktiviteti që ai do të fitonte nga ato, pra fitimi munguar, i cili mund të jetë dëm kolateral indirekt (mjedisor) që duhet vërtetuar nga paditësi.

Lidhja shkakësore jo gjithmonë mund të vërtetohet në mënyrë të lehtë dhe të qartë. Kështu, për gjyqtarin, në raste të caktuara paraqiten situata të komplikuara ku është shumë e vështirë të mund të konstatohet kjo lidhje midis veprimit të dëmshëm dhe pasojës së krijuar. Për të vërtetuar lidhjen shkakësore është e domosdoshme të konstatohet në të gjitha rastet, qoftë tek përgjegjësia personale, përgjegjësia për të tjerët apo përgjegjësia për sendet e rrezikshme dhe veprimtaritë e rrezikshme që kanë lidhje më dëmin që shkaktohet në mjedis.

Në praktikën gjyqësore preferohet që për këto raste gjykatësi me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së çështjes për shpërblimin e dëm në mjedis, për ta përcaktuar saktë lidhjen kauzale duhet të bashkëpunoj me ekspertë të fushave të caktuara që të arrijnë në një vendimi të drejtë dhe të balancuar.

Përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar në mjedis lind vetëm nëse vërtetohet lidhja shkakësore midis veprimit dhe mosveprimit, apo pasjes së sendeve të rrezikshme apo ushtrimit të veprimtarive të rrezikshme mjedisore që shkaktojnë dëm në mjedis, pa patur nevojë që personi përgjegjës të ketë faj, për dallim nga përgjegjësia penale e cila lind kur vërtetohet lidhja shkakësore dhe faji i personit përgjegjës.

5.2.5 Paligjshmëria e Veprimit

Cënim i Mjedisit nënkupton dëmtimin e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër, ndodhet e ndryshon një send, shfaqet një dukuri etj.: hapësira dhe gjithçka rreth e rrotull; ambient, përbërësit natyrorë, si ajri, toka, ujërat, klima, flora dhe fauna në tërësinë e ndërveprimeve me njëra-tjetrën, si dhe trashëgimia kulturore, si pjesë e mjedisit të krijuar nga njeriu, që e cënojnë ose dëmtojnë atë sipas përcaktimeve ligjore. (norma juridike e shkelur që cënon mjedisin). Paligjshmëria e veprimit në dëm të mjedisit nënkupton shkeljen e normës juridike, zakoneve apo rregullave të moralit të një shoqërie, lindja e kësaj marrëdhënieje duhet të ketë të paktën dy subjekte (Latifi J, 2007: 127). Shkelja e këtyre normave nënkupton shkaktimin e dëmit material dhe jo material nga veprimtari të kundraligjshme që mund t'i shkaktohen mjedisit dhe shëndetit të njeriut, si nga personat fizikë, ashtu dhe nga ata juridikë.

Burimi i kushtëzimit për të qenë detyrim civil nuk kushtëzohet nga fakti se më parë duhet të jetë vepër penale apo administrative¹⁶⁹. Disa autorë e përfshijnë veprimin e kundraligjshëm aktiv apo pasiv si pjesë të fajit në shkeljen e normës, sipas kësaj teorie sa herë shkelet norma ka paligjshmëri dhe faj¹⁷⁰. Një pjesë tjetër e juristëve i qëndrojnë pikëpamjes se faji duhet të ndahet nga paligjshmëria e veprimit të shkaktuar për të lindur përgjegjësia e posaçme juridiko-civile në lidhje me dëmin në mjedis, kundërligjshmëria e

¹⁶⁹ Mjafton që të provohet se nga ajri i ndotur X person është kthyer në azmatik dhe do ti dëmtohen të mbjellat apo aktivitete të cila ndikohen nga ndotja etj, dëmtim shëndeti ose dëmitm prone, edhe pse nuk është e përcaktuar në norma penale dhe administrative norma e lejuar e oksidit të karbonit në ajër ose është nën nivelin e përcaktuar nga ligji, personit X i lind e drejta për të ngritur padi dhe kërkuar dëmshpërblim si për mbrojtjen e shëndetit dëmtimit të pronës dhe mjedisit, kur ai është dëmtuar.

¹⁷⁰ Që të ketë dëm në mjedis ajo më parë duhet të fillojë nga një normë juridike, penale, administrative apo civile, pra nëse sasia e derdhjes së ujërave të ndotura në zona ku nuk lejohet, është mbi normat e lejuara nga ligji dhe ka shkaktuar dëm në mjedis atëherë ai përbën burimin kryesor për ngritjen e padisë për shkaktim të dëmit në mjedis.

veprimit nuk kushtëzohet me fajin e personit (Gams A, 1972:321), përgjegjësia pa faj p.sh. është një aspekt i tillë i përgjegjësisë juridiko-civile, faji dhe kundërligjshmëria sipas këtyre juristëve është pjesë e figurës së veprës penale, kushte pa të cilat ajo nuk do të mund të ekzistonte VP¹⁷¹.

Teoria objektive e veprimit të paligjshëm, e cila mjaftohet me shkeljen e normës juridike, nuk gjykon pjesën e fajit, në shkaktimin e dëmit në mjedis.

Teoria subjektive e trajton veprimin e paligjshëm në kuptimin e sasisë, sa faj dhe përgjegjësi mund të kesh në shkaktimin e dëmit, si pjesë e përgjegjësisë subjektive.

Teoria e tretë është ajo e kombinimit të dy të parave, të cilat në përcaktimin e veprimit të kundërligjshëm marrin parasysh edhe anën objektive, edhe atë subjektive për shkaktimin e dëmit në mjedis.

Edhe kur mungon një normë specifike ligjore ose një rregull që përcakton detyrimin për të mbajtur një qëndrim të caktuar, qëndrimi i pakujdesshëm mund të përjashtojë ekzistencën e përgjegjësisë shtesë. E vetmja gjë që mund të heqë elementin e paligjshmërisë në një veprim që ka shkaktuar dëme në mjedis është një arsyetim ligjor i pranuar si interes i ligjshëm në rrethana dhe kushte të vecanta.

¹⁷¹ Nëse një anije ndot ujërat detare mbi nivelin e caktuar, që do të thotë kalon nivelit e ndotjes të përcaktuar si kundravajtje administrative, si dhe bie nën juridiksionin e veprës penale, kjo masë ndotjeje mund të shkaktojë dëm në mjedis dhe përbën VP, si rrjedhojë edhe burim për lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar në mjedis apo shëndetin e njeriut.

5.2.6 Dëmi (në mjedis)

Një nga kërkesat e ligjit në KC është se duhet të jetë shkaktuar një dëm (në mjedis) ekonomik ose jo ekonomik në mënyrë që ai të ekzistojë si figurë juridike. P.sh. neni 624: personi që me faj ka cënuar mjedisin”.... pra ka cënuar ka shkaktuar..., ka përgjegjësi në kuptimin e këtij neni. Neni 640 i KC shpjegon se nga çfarë përbëhet ky dëmi. Dëmi i pronës përbëhet nga humbja (efekti i dëmit, ajo që është shkatërruar, ndotur ose dëmtuar) dhe mungesa e fitimit. Janë gjithashtu shpenzimet e arsyeshme të paguara për të parandaluar, shmangur ose zvogëluar dëmet, shpenzimet e nevojshme për të përcaktuar përgjegjësinë dhe shtrirjen e dëmit, si dhe të gjitha shpenzimet e arsyeshme të shkaktuara për të marrë kompensim në mënyrë ekstraligjore. Dëmi jomaterial parashikohet në legjislacionin tonë në nenin 625 të Kodit Civil¹⁷². Ky lloj dëmi ka të bëjë me stresin, frikën, dhe dëmin psikologjik që i shkaktohet të dëmtuarit (p.sh. nga një veprimtari ndotëse mjedisore) dhe kjo është kategoria më e vështirë e përcaktimit të dëmit jo material dhe përgjegjësisë juridiko-civile në lidhje me dëmit në mjedis dhe se sa ndikon ky dëm si lidhje shkakësore për të vërtetuar dëmin jomaterial apo material që ka ndodhur apo që mund të ndodhë.

Dëmi në Mjedis (kontraktor)

Dëmi në mjedis mund të paraqitet në dy rrethana: ajo kontraktore dhe jashtëkontraktore, nëse e para është e qartë, e përcaktuar, se kush e ka përgjegjësinë juridiko-civile edhe në bazë të një kontrate apo akti administrative (p.sh. kur kalohen kufijtë e ndotjes së ajrit nga

¹⁷² Për më shumë, në këtë çështje kemi vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 12, datë 14.09.2007.

një fabrikë, e përcaktuar nga ligji), problemi shfaqet edhe më i komplikuar në rastin e dytë, rrjedhimisht edhe përgjegjësinë juridiko-civile dhe legjiminin e palëve në proces është e vështirë për ta përcaktuar nëse figura e dëmit në mjedis nuk del. (Pavarësisht kësaj, GEDNj bën përgjegjës autoritetet publike dhe private për mosmarrjen e masave të duhura për parandalimin e këtyre dëmeve edhe pse ato përcaktohen në aktie normative por nuk mbrojnë mjaftueshëm publikun).

Dëmi kontraktor vjen si pasojë e mospërmbushjes së objektit kryesor të kontratës nga debitori. Me fjalë të tjera, dëmi kontraktor është dëm që jep shkas për kërkimin e dëmshpërblimit për mospërmbushjen e plotë ose të pjesshme të kontratës (detyrimeve).

“Detyrimi për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mospërmbushja e një detyrimi kontraktor është detyrim dytësor”¹⁷³. Me këtë kuptojmë se detyrimi kryesor i debitorit është objekti i kontratës, pra ai veprim apo mosmarrëveshje që ai duhet të realizonte, por që nuk e realizoi¹⁷⁴. Siç e shikojmë të ilustruar në shembullin e mësipërm, përgjegjësia ndaj dëmit të shkaktuar në mjedis mund të vijë edhe si përgjegjësi indirekte dytësore kontraktore nga mospërmbushja e kontratës.

¹⁷³ Nuni A, Mustafaraj I, Vokshi A, “Contractual and non-contractual obligations in English law”. Geoffrey Samuel and Jac Rinkes, fq 178, 2008, fq. 106.

¹⁷⁴ Shembull: personi X ka lidhur një kontratë me personin Y për mbjelljen e 1000 pemëve në një zonë të caktuar për të mos patur rrëshkitje të tokës, kontrata nuk përmbushet, ose përmbushet pjesërisht. Nga ky veprim kemi jo vetëm mospërmbushje të kontratës nga mosmbjellja e pemëve në kohë, por edhe dëme në mjedis që kanë shkaktuar erozion të tokës dhe përmytje të mëdha në zonë, të cilat kanë dëmtuar florën, faunën, jetën dhe shëndetin e banorëve të zonës, dhe cilësinë e jetës së tyre.

5.2.7 Dëmi jashtëkontraktor (mjedisor)

Përgjithësisht, përgjegjësia lind kur shkaktohet dëmi, dhe përbën kërkesën kryesore të të dëmtuarit. Mjafton të ndodhë ngjarja, fakti juridik që ligji i ka ngarkuar pasojat e caktuara juridike (*ndotja e ujërave, ndotja e tokës, ndotja e ajrit, raste tipike të dëmit jashtëkontraktor mjedisor*) dhe kur nuk është e rregulluar me kontratë, atëherë do të kemi dëm jashtëkontraktor, edhe pse në shumë raste përgjegjësia jashtëkontraktore nga ajo kontraktore është e vështirë për t'u dalluar veprimi juridik si mospërmbushje e kontratës shpreh një vullnet të drejtpëdrejtë (Nuni A, 2009: 583-584) ku pasojat apo detyrimet që lindin nga mospërmbushja e saj janë të përcaktuara në kontratë për veprimet juridike ku pasojat e fakteve për përgjegjësinë e dëmit në mjedis burojnë nga ligji jo nga vullneti i personit si në rastin e kontratave (Trabuchi A, 1981: 139).

Lindja e përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar në mjedis mund të vijë edhe nga veprimtari të rrezikshme apo sende të rrezikshme, sipas përcaktimeve të Kodit Civil neni 622. Këto dëme mund të jetë edhe dëme të shtrira në kohë për mjedisin, pra vijnë në një kohë të ardhshme teorikisht, praktikisht në Shqipëri bëhet tepër e vështirë për një sërë faktorësh.

5.2.8 Teoria e Riskut me rastin e shkaktimit të dëmit nga sendet e rrezikshme

Veprimtaritë e rrezikshme trajtonë ekzistencën e prezumimit të fajësisë së palës që ushtron veprimtari apo posedon sende të rrezikshme dhe nuk ka nevojë që të provohet fajësia e tij si subjekt përgjegjës për shkaktimin e dëmit (dëm në mjedis).

Në këto raste, që të ngarkohet me detyrimin për të kompensuar dëmin, personi përgjegjës duhet të vërtetohet lidhjen shkakësore midis dëmit dhe pasojave të krijuara. Sipas teorisë së rrezikut (*theorie du risque cree*), baza e përgjegjësisë nuk mbështetet në idenë e fajësisë, por në idenë e krijimit të rrezikut. Shtrirja e sferës së përgjegjësisë objektive për dëmin mjedisor lidhet me karakterin e zhvillimit industrial, të bazuar mbi përdorimin e mjeteve të prodhimit, që në vetvete janë burime rreziku për personat dhe për sendet (*landfillet, fabrikat e çimentos, guroret, HEC-et, fabrikat e përpunimit të naftës dhe nënprodukteve të tyre etj.*) të një rreziku shoqërisht të pranuar si një komponent i paevitueshëm i ambientit ku ne jetojmë dhe ushtrojmë aktivitetin tonë. Lindja e përgjegjësisë për mjedisin në legjislacionin tonë është përgjegjësi me faj, dhe përgjegjësi pa faj (*ku përfshihet dashja dhe pakujdesia*) (Nuni A, 2008 : 123), kur personi me sjelljen e tij ka cënuar mjedisin duke e keqësuar ndryshuar ose dëmtuar atë tërësisht ose pjesërisht. Shembull¹⁷⁵.

5.2.9 Dëmi i Sigurtë (në mjedis)

Ndodh shpesh dhe është mjaft e vështirë të bëhet dallimi midis një dëmi të sigurtë dhe një tjetri që nuk është i tillë. Gjykatat e konsiderojnë sigurinë në kuptimin e saj relativ: “një

¹⁷⁵ “Në çështjen ‘Gërdeci’ pretendimi i shoqërive që kishin punësuar viktimat e dëmtuara nga shpërthimi ishte se ato nuk kishin përgjegjësi me faj kundrejt palës që i kishte paditur. Gjykata e Apelit shprehet se në veprimtarinë e ushtruar nga i padituri, në bazë të nenit 622 të Kodit Civil konsiderohet veprimtari e rrezikshme, dhe në bazë të kësaj nuk kërkohet që të vërtetohet fajësia klasike që kërkohet zakonisht në ushtrimin e veprimtarisë së rrezikshme që ushtron personi për shkak se përgjegjësia objektive buron nga vetë natyra e rrezikshme e veprimtarisë ose mjeteve të rrezikshme të përdorura, nuk mund të vlejë asnjë justifikim rrethor apo normë juridike me të cilën do të shmangë përgjegjësinë civile jashtëkontraktore për personin që ushtron veprimtari të rrezikshme, kjo edhe për arsyen e thjeshtë sepse në çdo rrethanë asnjë dispozitë ligjore në kohë paqeje nuk mund të justifikojë shmangien e subjektit që ushtron veprimtari të rrezikshme nga shpërblimi i dëmit të shkaktuar të tretëve në jetën, shëndetin dhe pasurinë e tyre”.

Përcaktimi i dëm në mjedis ka rëndësi të madhe në legjitimitetin e palëve në proces. Përgjithësisht në legjitimitimin e palëve jurisprudenca shqiptare pranon parimin e dëmit efektiv, dëmin që ka ndodhur, por këtu ndeshemi me një problem nga pikëpamja e së drejtës duke filluar që me legjitimitimin e palës në proces për dëmin mjedisor pasi ai duhet të jetë real aktual, personal.

mundësi e mjaftueshme” për të ndodhur ky dëm, edhe një dëm i ardhshëm mund të jetë i sigurtë (Legeir G, 2008: 135-136) (ose i paverifikuar ende)¹⁷⁶, kryesisht kur parashikohet vazhdim i dëmit aktual: pra ai mund të përcaktohet, vlerësohet njihet dhe dëmshpërblehet.

Por kjo nuk ndodh me një dëm të mundshëm. Pra, dëmi që i shkaktohet mjedisit në të ardhmen në kuptimin e legjitimitit përpara një gjykate, në rastin konkret kushtëzohet nga një lidhje logjike e vazhdimësisë së dëmit në mjedis të shkaktuar më parë¹⁷⁷.

Përcaktimi i dëmit dhe dëmit në mjedis në të ardhmen, pa patur një lidhje origjine me një dëm të ndodhur më parë, është tepër e vështirë për t’u vërtetuar një “arsye e mjaftueshme” për legjitimin si pjesë e interesit të ligjshëm në procesin civil.

Padia Konsumatore ka filluar të praktikohet vitet e fundit edhe në jursiprudencën ndërkombëtare¹⁷⁸. Me zhvillimet globale tendenca e padisë konsumatore (Class Actione) do të jetë në rritje dhe do të marrë një rol thelbësor edhe në Shqipëri. Dëmin e ardhshëm mjedisor legjislativi shqiptar nuk e përcakton në mënyrë të saktë në kuptimin e prezumimit të një dëmi që mund të vijë në të ardhmen, kjo edhe për shkak se fusha e së drejtës së mjedisit është e re jo vetëm në Shqipëri, por edhe në rrafshin global; përpos kësaj, legjislativi, praktika gjyqësore dhe doktrinat janë ende të paplota, të paqarta në këtë

¹⁷⁶ Danno Ambientale e rischio inquinamento: responsabilita’ civile e aspetti gestionali. Relazione a cura dell’Avvocato Gianluca Limardi e della Dottoressa Sonia Sacco del Foro di Roma Convegno, Lucca 19.05.2011

¹⁷⁷ Pra Përgjegjësia juridiko civile sipas profesor Gerard Legerit për dëmin e ardhshëm ka një korrelacion me një dëm që është shkaktuar më parë, lidhja shkak-pasojë nuk do të kërkohet mbi pretendimin se do të ndodhë një dëm në të ardhmen, por dëmi i së ardhmes duhet të vërtetohet si rrjedhojë e një dëmi të ndodhur më parë

¹⁷⁸ “Rasti Volksäagen” dhe “Mitsubishi” kompani të cilat operojnë në fushën e prodhimit të automjeteve të cilat nuk kishin plotësuar standardet ndërkombëtare për sa i përket shkarkimit të elementëve ndotës të karburantit që ato përdorin. Për këtë arsye padia u vu në lëvizje nga një pjesë e klientëve që kishin blerë këto automjete të cilët u legjitimuan, dhe vendimi që u dha nga gjykatat amerikane në bazë edhe të marrëveshjeve ndërkombëtare i shtrinë efektet jo vetëm për të gjithë blerësit e tyre në SHBA por edhe jashtë saj. Palëve përveç dëmit të shkaktuar nga katalizatorët e këtyre automjeteve për ndotje në mjedis u linte e drejta që të merrnin mbarsht shumë e paguar apo dëme të tjera kolaterale, që mund të kishin ardhur.

përcaktim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me përgjegjësinë juridiko-civile (PJC) dhe efikasitetin në drejtësi.

5.3 Padia (Ius Civile)

Në shoqëritë moderne marrëdhëniet midis personave paraqiten në formën e të drejtave dhe detyrimeve që një njeri ka kundrejt tjetrit dhe procesi është tërësia e mjeteve që janë të destinuara për mbrojtjen e këtyre të drejtave nga pushteti gjyqësor si pjesë e së drejtës private (Brati A, 2008:150).

E drejta është krijuar nga dy sisteme normash të veçanta dhe të koordinuara që integrohen dhe plotësojnë njëra-tjetrën: atë të marrëdhënieve juridike materiale që përfaqësohen nga të drejtat dhe detyrimet koresponduese, sipas situatave të ndryshme në të cilën ndodhen personat, dhe ato procedurale ose të procesit dhe që formojnë mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave materiale. Midis dy sistemeve nuk ka një rend primar, të dyja janë të rëndësishme dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Pa një bazë ligjore materiale nuk mund të ngresh një padi si pjesë e normës procedurale, por njëkohësisht nëse ka një normë materiale ti nuk mund të vërtetosh pretendimin në lidhje me dëmin e shkaktuar në mjedis pa ekzistencën e një normë procedurale për vërtetimin e dëmit të shkaktuar ose të pretenduar.

Gjykatat kanë për detyrë që nëpërmjet një gjykimi që përmbush kushtet e nenit 42 të Kushtetutës, t'i japë drejtësi atij që e kërkon, dhe për këtë arsye, si kushte thelbësore, rendi ynë kushtetues duhet t'i krijojë të gjithëve mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës në lidhje me pretendimet për dëmin në mjedis si pjesë e interesit kushtetues (interes i ligjshëm).

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës për mbrojtjen e të drejtave dhe një Interesi të Ligjshëm të atij që pretendon se i janë shkelur këto të drejta apo interesa, jepet për të mbrojtur këto të drejta në fakt që vijnë në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme: *kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore*, gjë që tregon se kjo e drejtë nuk i takon atij që kërkon mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Pikërisht ky indikacion shërben për të përcaktuar personin që rast pas rasti mundet të veprojë në mënyrë efektive në gjykim dhe që teknikisht quhet *legjitimiteti për të vepruar* ose aktiv, po aq i rëndësishëm është edhe *legjitimimi pasiv* (subjekti i paditur) si parakusht procedural për t'u plotësuar figura e përgjegjësisë juridike dhe për të nisur procesi gjyqësor.

5.3.1 Iniciativa e palës në proces, një detyrim por edhe një e drejtë (parimi disponibilitetit)

Iniciativa për të filluar procesin i takon palës së interesuar dhe prokurorit. Vetëm palët mund të vënë në lëvizje procesin.¹⁷⁹

Legjitimiteti aktiv kushtëzohet edhe nga Interesi i Ligjshëm i personit si një nga dy kushtet themelore për të ngritur padinë për dëmin mjedisor.

Ky interes ka një sërë faktesh dhe rrethanash që vërtetohen nga gjykata, rast mbas rasti dhe më pas ajo vendos ose jo për legjitimimin e palës, legjitimim i cili dikton ngritjen e padisë për dëmin në mjedis, konstatimi i ekzistencës së dy kushteve të mësipërme për ngritjen e padisë mund të evidentohet nga gjykatat në çdo shkallë të gjykimit, legjitimimi dhe interesi janë dy kushte të lidhura pazgjithshmërisht midis njëra-tjetrës për ngritjen e kërkesë-padisë nga kërkuesi.

¹⁷⁹ Kodi i Procedurës Civile, neni 2.

Kodi i Procedurës Civile neni 32:

Interesi për të ngritur padi:

a) Për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm.

b) Për vërtetimin e qenies ose mosqenies në një marrëdhënie juridike ose një të drejte.

c) Për njohjen e vërtetësisë ose të pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin.

Nga nenet e mësipërme shikojmë se për t'u legjitimuar personi duhet të ketë një interes të ligjshëm. Interesi për të ngritur padinë vjen si element dytësor procedural, në lidhje me interesin e parë material dhe ka për objekt masën ose llojin e vendimit që i kërkohet gjykatës për përmbushjen e interesit material të cënuar nga pala tjetër ose në mënyrë të përgjithshme nga gjendja faktike objektive ekzistuese¹⁸⁰ (dëmi i shkaktuar në mjedis dhe vërtetimi i këtij dëmi).

Përsa i përket vërtetimit të Interesit të Ligjshëm për dëmin në të ardhmen, legjislacioni shqiptar është demotivues në këtë pikë; siç e kemi përmendur më sipër, dëmi në mjedis

¹⁸⁰ Shembull: Nëse nga ndotja e ajrit dhe ujërave në qytetin e Elbasanit nga aktiviteti i uzinës së metalurgjikut janë shkaktuar dëme të drejtpërdrejta në shëndetin e komunitetit që preket direkt apo indirekt nëpërmjet ndotjes së ujërave të Lumit Shkumbin në të cilin në rrjedhën e poshtme të tij ka toka bujqësore që vaditen nga ky lumë, apo uji që pijnë bagëtitë dhe kafshët e tjera që u shkaktohet dëm, gjithashtu edhe zonat industriale kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në ndotjen e ajrit dhe shkaktimit të dëmit.

Matjet e cilësisë së ajrit kanë treguar probleme serioze për grimcat në Elbasan të shkaktuara nga industria metalurgjike edhe pse disa matje ditore duken sikur janë brenda parametrave normalë . Matje ditore, PM2,5 dhe PM10, SO2, NO2, CO, Pb, O3, sasia e lartë e benzenit dhe e ndotësve të tjerë në fabrikat e çimentos dhe nga depozita të hapura të krijuara nga aktivitetet e mëparshme industriale në këtë pellg janë një element tjetër për shkaktimin e (kjo vërtetohet me një matje të ujit dhe ajrit, qoftë nga Inspektorati i Mjedisit apo Instituti Shëndetit Publik apo ente të tjera të licensuara për këto veprimtari për parametrat e ndotjes së tyre) dëmit i cili është kushti për të ngritur padinë si elementi procesual që vërteton pretendimet e bazuara mbi të drejtën materiale.

duhet të jetë një dëm në koherencë dhe i lidhur me një dëm të shkaktuar më parë më të cilin ai duhet të ketë lidhje shkak-pasojë i lidhur me të ose ndryshe mund të quhet dëm i vazhdueshëm në kohë.

Interesi është jo vetëm një nga parakushtet e padisë¹⁸¹, por i të gjithë të drejtave procedurale: I të drejtës për të ngritur kundër padi ose prapësime¹⁸², i të drejtës për të kundërshtuar një vendim gjyqësor të disfavorshëm.

Praktikisht, përcaktimi i interesit të palës për ngritjen e padisë për çështjet mjedisore, sipas nenit 32 K.Pr.C., për dëmin në mjedis që mund të vijë në një të ardhme dhe i palidhur me një dëm të mëparshëm është e vështirë për të mos thënë e pamundur të quhet interes i ligjshëm nga gjykata për të plotësuar njërin nga dy kushtet themelore për ngritjen e padisë për çështjet mjedisore sipas legjislacionit shqiptar. Vetë Konventa e Aarhusit çështjen e “interesit të ligjshëm” ia lë në juridiksion legjislacionit kombëtar, siç është përmendur në kapitullin teorik, edhe ky instrument lidhet drejtpërsëdrejti me aksesin në drejtësi dhe efektivitetin e padis mjedisore, si dhe me parimin Kushtetues për një proces të rregullt dhe ligjor. Ndryshimet e fundit në K.Pr.C. nuk e kanë ndryshuar gjendjen e çështjes së legjitimitetit për padin mjedisore. Vlen për t’u theksuar se Kodi i Procedurës Administrative të vitit 1999 i kishte më të mirë përcaktuara kriteret e legjitimitetit të palëve në procesin administrativ nëpërmjet nenit 45 (Legjitimiteti), ku nëse personit i shkaktohesh dëm në të drejtat e përbashkëta si: shendetit publik, arsimimi, trashëgimia kulturore, mjedisi, si dhe cilësia e jetës mund të nisnin një proces administrativ apo të marin pjesë në të. Tashmë ky

¹⁸¹ parakushte procedurale, Juridiksioni dhe Kompetenca e Gjykatës, Zotësia dhe legjitimiteti formal i palëve, mungesa e pengimeve që rrjedhin nga litispendenca dhe klauzola e arbitrazhit K.Pr.C.

¹⁸² K.Pr.C. neni 160/442/a.

nen me këtë përmbajtje nuk ekziston më: në këtë këndvështrim ka pasur hapa pas. Kjo dispozitë duhet të traspozohet në K.Pr.C, pasi rrit efikasitetin e përcaktimit të përgjegjësisë juridiko-civile në procesin civil për dëmin e shkaktuar në mjedis, pasi është më e plotë, e saktë dhe e qartë si pjesë e kritereve legjitimuese për palët në procesin civil dhe jo vetëm.

5.3.2 Sigurimi i Padisë (për dëmin mjedisor)

Sigurimi i Padisë ka natyrë të përkohshme, instrumentale dhe proporcionale në arritjen e qëllimit që synon të mbrojë. Masa e Sigurimit të Padisë synon të bëjë efektiv dhe të dobishëm procesin gjyqësor të themelit dhe aksesin në drejtësi

Dy kushte bazë që duhet të plotësojë kërkitimi i masës së SP janë:

- 1) ekzistenca e premisave mbi bazueshmërinë e themelit të kërkitimit (*fumus boni iuris*);
- 2) dyshimi i arsyeshëm që vështirëson apo bën të pamundur ekzekutimin e vendimit për të drejtat e paditësit (*periculum in mora*).

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë¹⁸³ shprehet për qëllimin e Sigurimit të padisë¹⁸⁴ që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor dhe të sigurojë shmangien e dëmeve të menjëhershme dhe të pariparueshëm për palët në proces dhe Interesin Publik.

¹⁸³ VUKBGJL nr, 22, viti 2011.

¹⁸⁴ Kështu, në Vendimin Nr. 22, datë 19.01.2011 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera është shprehur se: "Qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është: (i) jo vetëm sigurimi i së drejtës, e cila përbën dhe tërësinë e kërtimeve që do të parashtrorë paditësi në padinë e tij, (ii) por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja, është që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, i cili do të realizohet mes palëve në të ardhmen, në mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet një procesi gjyqësor, të mos jetë e kërcënuar nga një dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, dhe që vendimi përfundimtar të mos mbetet i paekzekutueshëm. Kolegji Civil i Gjykatës me së Lartë çmon se pikërisht ky lloj kërkitimi, pavarësisht se është në funksion të padisë së themelit është një kërkitim i një lloji të veçantë, i cili ndryshon nga kërkitimet që paraqiten në padinë e themelit pasi:

Gjykata duhet të mbështetet në parimin e barazisë, proporcionalitetit, ligjshmërisë dhe paanësisë në vendimin e saj jo vetëm për të legjitimuar palet, por edhe për të kuptuar se në vendimin e saj për legjitimimin e palëve ato nuk çënohen në të drejtat e tyre ose këto masa të jenë sa më pak të dëmshme për palët. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë shprehet se çështja e nenit 202 e Kodit të Procedurës Civile për Sigurimin e Padisë nga gjykata duhet të shqyrtohet rast mbas rasti.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë¹⁸⁵, nënvizojnë përfundimin se “gjkimi për kundërshtimin e aktit administrativ nuk ka tiparet e një padie civile të mirëfilltë, prandaj edhe pezullimi i zbatimit të aktit administrativ nga ana e gjykatës, kur e lejon ligji, nuk konsiderohet si masë e përkohshme për sigurimin e padisë”, dalin në përfundimin unifikues se “referenca në këtë rast në nenin 202 të K.Pr.Civile, nuk është e saktë”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë analizojnë se “gjkata duhet rast pas rasti, që të vendosë një masë sigurimi për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por pa rrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e interesave të ligjshme të të paditurit”.

Më pas, duke analizuar pikërisht rastin e pezullimit të aktit administrativ, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, analizojnë se “në këtë rast zgjidhja përfundimtare e

(i) Siç u tha dhe më sipër, qëllimi i vetëm i kërkuarit kur kërkon marrjen e masës për sigurimin e padisë është të sigurojë faktin që vendimi përfundimtar të jetë i ekzekutueshëm, dhe që procesi gjyqësor ka qenë i efektshëm dhe i dobishëm, kurse me padinë e themelit paditësi kërkon rivendosjen e të drejtave të tij të pretenduara të cënuara apo të shkelura...

(iv) Gjykimi për marrjen e masës për sigurimin e padisë është një proces i shpejtë, ku gjykata nuk shqyrton dhe vlerëson të gjitha provat në mënyrë të hollësishme për të parë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuarit, nëse qëndron apo jo e drejta. Në gjykime të këtij lloji, gjykata vetëm heton nëse plotësohen këto kushte: (a) ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje në procesin e gjykimit të padisë, dhe (b) ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë. E kundërta ndodh në gjykimin e themelit të padisë gjatë të cilës gjykata duke respektuar të gjitha normat procedurale shqyrton në themel nëse ekziston apo jo e drejta e pretenduar nga paditësi, nëse kërkimet e tij janë të mbështetura apo jo në prova dhe në ligj”.

¹⁸⁵ VUKBGJL nr.10, dt. 23.04.2004.

çështjes duhet bërë me një procedurë të shpejtë dhe të thjeshtë. Si rregull duhet të shoqërohet me një garanci pasurore për të mbuluar dëmet e të paditurit, duhet të hetohet, pasi zvarritja e gjykimit mund të çojë në shkaktimin e dëmeve të mëdha e të pariparueshme për të paditurin”.

Ligji për OFGJAGJMA i ndryshuar; rruga e Sigurimit të Padisë ndaj një dëmi në mjedis që buron nga një akt administrativ¹⁸⁶, shprehet se:

Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Gjykata vendos për sigurimin e padisë vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshem dhe të atëçastshëm për paditësin:¹⁸⁷ pra, duhet kushti objektiv të jetë shkaktuar dëmi në mjedis.

Siç e shohim më sipër, Sigurimi i Padisë ka dy rrugë, ajo e një procesi administrativ dhe civil, por që në thelb kanë lidhje më dëmin që mund t’i shkaktohet mjedisit dhe sigurimi i

¹⁸⁶ Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

¹⁸⁷ b) nuk cënohet rëndë interesi publik;

c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë

Konventa e Aarhusit për të drejtën e publikut për të patur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, Neni 1.

“Me qëllim që të kontribuojmë në mbrojtjen e të drejtës së çdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij, çdo palë do të garantojë të drejtën e publikut, për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t’iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente”

Neni 9.3 Konventa e Aarhusit

Kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, nëse ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t’iu drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat privatë dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vetë kombëtar, në lidhje me mjedisin.

padisë pikërisht këtë ka si mision, ndalimin dhe parandalimin e këtyre dëmeve në mjedis nëpërmjet një instrumenti procesual si Sigurimi i Padisë, i cili mund të ngrihet edhe para kërkes -padisë së themelit me kushtin që brenda një afati prej dhjetë ditësh të ngrihet padia e themelit. Sigurimi i Padisë mund të ngrihet në çdo fazë të gjykimit kur pala mendon dhe arsyeton se ka një interes të ligjshëm dhe nuk cënohet interesi publik¹⁸⁸, mjafton të vërtetojë tre kushtet e dëmit, dëm i rëndë, i atëçastshëm, i parikuperueshëm. Siç e shohim, dëmi në mjedis në të ardhmen në rastin e Sigurimit të Padisë nuk meret parasysh nga jurisprudenca, cka ndikon në efikasitetin e aksesit në drejtësi duke mospërcaktuar qartë PJC dhe dëmin në mjedis si pjesë të saj.

Çfarë duhet ndryshuar? 1. Sigurimi i Padisë për dëmin në mjedis duhet të jetë kategori më vete në ligjin për OFGJAGJMA, mjafton të vërtetohet kushti më anë të një ekspertize shtetërore ose private për dëmin në mjedis apo mundësisë së ardhjes së dëmit në mjedis, dhe nga ky fakt lind kushti pezullues si interes i ligjshëm i publikut të prekur për t'u legjitimuar në ngritjen e Sigurimit të Padisë për dëmet në mjedis apo që hamendësot të vijjnë. (Këtu aplikohet teoria e rrezikut të ardhjes së dëmit, që kryesisht nuk njihet si kusht objektiv për përcaktimin e dëmit në doktrinën tonë)¹⁸⁹.

¹⁸⁸ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr 10, datë 24.03.2004.

¹⁸⁹ ...Në çështjen e ndërtimeve të Liqeni Artificialë Tiranë në 2016, 3 Sigurim Padish nuk u pranuan nga gjykata me arsyetimin se nuk plotësohen tre kushtet e dëmit si më sipër, edhe pse u paraqitën, fakte, dëshimi, fotografi, akt ekspertimi mjedisor, pamjet e televizioneve ishin prova publike.

5.3.3 Legjitimiteti (ratione materiae)

Legjitimiteti përcakton personin të cilit i përket interesi (paditësit) për të ngritur padinë, dhe personit kundrejt të cilit do të ngrihet padia (të paditurit). Sipas jurisprudencës sonë (Brati A, 2008: 158), nga përmbajtja e nenit 32 të K.Pr.C. del se për të ngritur padi duhet të ketë një interes, gjë që tregon se interesi për të ngritur padi jo vetëm që duhet të ekzistojë por duhet të jetë në mënyrë e qart tek ai që ngre padinë, *askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç se kur ligji parashikon ndryshe*¹⁹⁰. Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar edhe në dispozitat e tjera procedurale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, rasti i nenit 15 të ligjit nr 49/2012¹⁹¹, i cili kërkon vendosjen e dy kushteve për legjitimitimin aktiv, paligjshmërinë e aktit administrativ dhe paditësi të jetë cënuar në interesat i tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë (dëmi mjedisor). Prapësimi është pohimi dhe provimi nga i padituri të një fakti shues, ose ndryshues i drejtpërdrejtë për të arritur rrëzimin e pjesshëm ose të plotë të padisë për dëmin mjedisor.

Pra, prapësimi është një mjet procedural që i padituri të mbrojë të drejtat dhe pretendimet e tij gjatë gjyimit. Kemi dy lloje prapësimi:

- Prapësim procedural, p.sh. pala e paditur ngre pretendime mbi juridiksionin, moskompetencën e gjykatave apo pavlefshëmërinë e akteve procedurale;
- prapësim i themelit kur pala e paditur nuk pranon që ajo është shkaktuesja e dëmit në mjedis dhe paraqet fakte të cilat mund të jenë shuese ose ndryshuese në lidhje me

¹⁹⁰ Kodi i Procedurës Civile, neni 90.

¹⁹¹ Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

dëmin në mjedis. Edhe këtu duhet të dallohen pengesat e ngritura kryesisht nga gjykata dhe ato që mund të kërkohen vetëm nëpërmjet prapësimit nga ana e palës; përsa më sipër, Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë sqaron pozitën e prapësimit në procesin legal¹⁹². Kundërpadia¹⁹³ është padia e të paditurit që i drejtohet paditësit e paraqitur në një gjykim të filluar derisa nuk ka përfunduar hetimi gjyqësor. Përveç plotësimit të kushteve themelore të kërkesë-padisë (legjitimitit dhe interesit të ligjshëm), për dëmin në mjedis kemi edhe kushtet formale të saj si pjesë e PJC. Pavarsisht se baza ligjore materiale për të përcaktuar interesin e ligjshëm që ka personi në ngritjen e padisë për çështjet mjedisore si Interes i mjaftueshëm i cili përcaktohet nga faktet, provat¹⁹⁴, rrethanat, aktet juridike vlerësohen nga bindja e brendshme e gjykatës. Shqipëria, si pjesë e Këshillit të Europës dhe anëtare OKB-së dhe e shumë Konventave Ndërkombëtare, si dhe anëtare e ardhshme e BE, ka bërë pjesë të legjislacionit të brendshëm edhe detyrimet që burojnë nga e drejta ndërkombëtare, një nga këto është Konventa e Aarhusit (Danimarkë)¹⁹⁵, e cila trajton në mënyrë specifike aksesin në drejtësi për çështjet mjedisore, ku parimisht ajo shprehet në shtyllën e saj të tretë për ankimimin në gjykatë, së çdo shtet duhet të garantojë pjesëmarrjen në gjykatë të personave edhe nëse legjislacioni i saj i brendshëm nuk e bën të mundur këtë gjë. Shteti është i detyruar që t'i garantojë publikut të drejtën e pjesëmarrjes në gjykatë për çështjet (dëmin mjedisor)

¹⁹² Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 901 datë, 14. 07. 2000 .

¹⁹³ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 13, datë, 09.03. 2006.

¹⁹⁴ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 00-2016-761 (83), datë 16. 03. 2016.

¹⁹⁵ Konventa e Aarhus-it u miratua më 25 qershor 1998 në Aarhus të Danimarkës dhe jep mundësi për të aderuar për vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Evropën, ato me status këshilltari pranë këtij Komisioni dhe organizatat rajonale të integritimit ekonomik, të përbëra nga shtetet anëtare sovraane të KEE, tek të cilat shtetet anëtare kanë transferuar kompetencën për çështjet që trajtohen nga Konventa.

mjedisore, për një ankimim efektiv të palëve edhe sipas parimit kushtetues¹⁹⁶ ¹⁹⁷ për një proces të rregullt dhe ligjor. Konventa, në mënyrë indirekte, dikton dhe garanton edhe përgjegjësinë juridiko-civile të palëve në procesin jo vetëm administrativ, por edhe civil.

Shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën e Aarhus-it¹⁹⁸.

Për më tepër, neni 9 (3) i Konventës së Aarhus-it, përmban një dispozitë thelbësore e cila i mundëson publikut të aktivizohet personalisht për mbrojtjen e mjedisit në të cilin jeton. Përkatësisht, neni 9 (3) i Konventës parashikon se “kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, nëse ka të tilla në ligjin kombëtar (Interesi i Ligjshëm, K.Prc.C. neni 32), ata do të kenë të drejtë për t’iu drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat privatë dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vet kombëtar, në lidhje me mjedisin”¹⁹⁹

¹⁹⁶ “Arsyetim ligjor mbi legjitimitimin e paditësve, për çështjet mjedisore” (kërkesë-padia, Çështja e Liqenit Artificial Tiranë 14 prill 2016, Apeli Administrativ më pas e kalon në shkallën e parë të Gjykatës Administrative për moskompetencë funksionale, pasi akti normativ i Këshillit të Ministrave KKT ishte një akt për një çështje të vecantë individuale dhe jo me karakter të përgjithshëm.

¹⁹⁷ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 42.

¹⁹⁸ Ligji nr.8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhus-it për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’ju drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit

¹⁹⁹ Në përputhje me nenin 116 (1) (b) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, siç është Konventa e Aarhus-it, janë akte normative që kanë fuqi në të gjithë territorin shqiptar. Për më tepër neni 122 i Kushtetutës i vlerëson këto akte me epërsi mbi ligjet e vendit dhe iu jep forcën për të qenë direkt të aplikueshme.

Interpretimi i përbashkët i dispozitave të mësipërme të Konventës së Aarhus-it të ratifikuar u jep paditësve të drejtat e mëposhtme:

Të drejtën për tu informuar për çështjet mjedisore, nga autoriteti publik ose privat;

Të drejtën për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tyre;

Të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës kundër veprimeve të autoriteteve publike të cilat janë në kundërshtim me dispozitatat e legjislacionit kombëtar në lidhje me mjedisin sipas nenit 9 (3).

Përkatësisht, në nenin 1 të ligjit “Për mbrojtjen e mjedisit” (MM), përcaktohet se qëllim i ligjit është mbrojtja e një niveli të lartë të mjedisit, ruajtja dhe përmirësimi i tij, parandalimi dhe pakësimi i rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimi i kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në të njëjtën mënyrë, të gjitha parimet e ligjit për mbrojtjen e mjedisit, të tilla si parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, parimi i parandalimit, parimi i përgjegjësisë, parimi “ndotësi pague”, parimi i informimit të publikut dhe pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore etj., synojnë zbatimin e të drejtës për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm. Të gjitha këto parime janë të përkthyer në një sërë procedurash të domosdoshme që duhen zbatuar nga autoritetet publike dhe private, gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre.

Në rastin konkret, këto parime gjejnë pasqyrim më tej në parashikimet e Ligjit “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”²⁰⁰, Ligjit “Për Lejet e Mjedisit”²⁰¹, Ligji “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor”²⁰² dhe Ligji “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”²⁰³ (VNM) ‘si dhe ligje të tjera të cilat kanë lidhje me mjedisin.

E drejta për t’iu drejtuar gjykatës kundër veprimeve të autoriteteve publike të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar në lidhje me mjedisin, garantohet nga

E drejta për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien, sanksionuar nga neni 1 i Konventës së Aarhus-it, njihet në Shqipëri edhe nga një numër i madh parimesh dhe procedurash të tjera ligjore.

²⁰⁰ Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

²⁰¹ Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit.

²⁰² Ligji nr. 91/2013 “Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

²⁰³ Ligji nr.10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

neni 48 (b) i Ligjit për MM, i cili parashikon “*se publiku ka të drejtën të ngrejë padi në gjykatë kundër autoritetit publik që ka sjellë dëme në mjedis ose rrezikon ta dëmtojë atë*”.

Kriteret ligjore të legjitimitit përpara gjykatave të anëtarëve të publikut, ashtu siç kërkohet nga neni 9 (3) i Konventës së Aarhus-it, janë shprehimisht të përcaktuara në legjislacionin shqiptar mjedisor dhe përkatësisht në ligjin për MM dhe ligjin për VNM. Sipas nenit 5 (12) të Ligjit për MM, “publiku është një ose më shumë persona fizikë apo juridikë në përputhje me legjislacionin dhe praktikën kombëtare”. Ky përkufizim i përgjithshëm, plotësohet nga përkufizimi më specifik i dhënë nga neni 6 (5) i Ligjit për VNM-të i cili flet për publikun e ndikuar dhe e përkufizon këtë të fundit si “publiku i prekur ose që mund të preket, apo publiku që është i interesuar për vendimmarrjen mjedisore”. Por legjitimiti aktiv i shoqatave dhe i gupeve qytetare të organizuara si grupe interesi për çështje të tilla, në praktik bëhet nul nga legjislacioni shqiptar²⁰⁴, pasi e shmang ose e bën të pamundur legjitimitin e tyre. Një argumentim i mësipërm për moslegjitimitin aktiv është dhënë për

²⁰⁴ Neni 15 i ligjit nr. 49/2012.

E drejta e padisë.

Të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

- a) çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;
- b) organi i administratës publike, që pretendon se është cënuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast, organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit;
- c) punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike;
- ç) çdo subjekt që pretendon se është cënuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ;
- d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cënuar një interes i ligjshëm publik:
 - i) nga një akt normativ;
 - ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj;
 - dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.

kërkes-padit në lidhje me çështjen “Këndi i lojrave te Liqeni Artificial, Tiranë 2016” nga Gjykata Administrative, Shkalla e Parë, Tiranë²⁰⁵.

Sipas gjykatës, në interpretimin që ajo i bën ligjit në Vendimin nr. 80-2016-36-35, AH, AM, ky legjitimitet është i kufizuar, pasi një shoqatë apo grupim interesi mund të ankoher në gjykatë vetëm për të shfuqizuar një ligj apo akt që cënon interesin publik, por nuk mund të kërkojë shfuqizimin e një akti administrativë individual (vendimin e KKT 12.02.2016) pasi nuk provuan cënimin e një interesi të ligjshëm. Pra sic shihet aksesi në drejtësi për nuk garantohet në kuptimin e efikasitetit të saj për të parandaluar, apo të ndaluar dëmet në mjedis. Aarhusi jo pa qëllim e bën publikun pjesmarrës dhe vendimmarrës të politikave, planeve, strategjive, projekteve, të cilat janë të gjitha faza paraprake të veprimtarive për çështjet mjedisore për të pasur efikasitet, gjë e cila ende nuk ndodh në nivele të kënaqshme në Shqipëri dhe brenda standardit të mbrojtje së mjedisit. Ajo që duhet ndryshuar në ligj por edhe si pjesë e doktrinës është mënyra e qasjes drejtë problemit, por edhe në kuptimin substancial e ligjor, kjo qasje ndaj shoqatave dhe organizimeve qytetare si grupe interesi dhe që përfaqësojnë një interes publik edhe në kuptimin e pjesmarrjes së tyre në këto kauza ato duhet të legjitimohen duke e përcaktuar në mënyrë të posaçme të drejtën e padisë edhe nëse akti administrativ është individual apo për veprimtari që ka lidhje me mjedisin, apo edhe në rastin nëse ekspertiza e një eksperti mjedisor apo që ka lidhje me këtë fushë vërteton se ka ardhur dëm nga aktiviteti apo mundësis së ardhjes së dëm në mjedisë nga kjo veprimtari.

²⁰⁵ Vendim i Gjykatës Administrative Shkalla e Parë Tiranë, nr rregjistri, 3439(03166-2016).

5.3.4 Roli i Konventës së Aarhusit dhe i legjislacionit shqiptar

Roli i Konventës së Aarhusit dhe i legjislacionit shqiptar^{206 207}.

Kjo konventë i vjen në ndihmë legjitimitimit të palëve për çështje mjedisore. Ndihma vjen në formën juridike materiale dhe procedurale, të praktikave gjyqësore apo asistencës juridike të Këshillit të Pajtueshmërisë²⁰⁸ (Mete E : 2012/13).

“Edhe pse për synim ka aspektin rajonal, rëndësia e Konventës së Aarhus-it është globale. Ky është, sigurisht, përpunimi më mbresëlënës i parimit të 10-të Deklaratës së Rios, e cila thekson nevojën për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet mjedisore dhe qasjen në informata mjedisore të mbajtura nga autoritetet publike. Si e tillë, kjo konventë paraqet hapin më ambicioz në fushën e demokracisë mjedisore, që është ndërmarrë ndonjëherë nën përkrahjen e Kombeve të Bashkuara” – Kofi A. Annan, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Kërkesat e Konventës, të drejtat dhe detyrimet që ajo përmban, janë orientuar në momente kyç të marrëdhënieve mjedisore dhe grupohen tri shrylla:

Tre shtyllat e Konventës së Aarhusit²⁰⁹

²⁰⁶ Konventa e Aarhus-it është miratuar në Konferencën e IV Ministrove të mbajtur, më 23-25 Qershor 1998, në qytetën Aarhus të Danimarkës, nën autoritetin e Komisionit Ekonomik Evropian të Kombeve të Bashkuara (UNECE), ajo është ratifikuar nga Parlamenti me ligjin nr.8672, datë 26.10.2000 dhe ka hyrë në fuqi në 30 tetor të vitit 2001. Konventa është ratifikuar nga 44 vende, duke përfshirë dhe Komunitetin Evropian.

²⁰⁷ <http://kos.rec.org/albanian/pdf/Doracaku%20-%20Shqip.pdf>

²⁰⁸ http://www.archive.rec.org/albania/Projects/Ligjet/A2JBook_alb.pdf fq. 18-19). Komiteti Pajtueshmërisë, është një organ këshillimor i Konventës së Aarhusit, i cili i'u ofron asistencë juridike palëve për çështjet e mjedisitqë ka një rol të rëndësishëm këshillues në asistencën e ofruar ndaj palëve, nëpërmjet gjetjeve edhe rekomandimeve.

- 1) E drejta e publikut për të patur akses në informacionin mjedisor;
- 2) E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- 3) E drejta e publikut për të patur akses në drejtësi, e cila nënkupton edhe ankimimin efektiv në gjykatë për çështjet e mjedisit, ose ndryshe e drejta e përgjithshme për të ngritur padi në lidhje me çështjet mjedisore,

Mënyrat e ankimimit ndaj moszbatimit të kërkesave të Konventës: çdo person ka të drejtë të ankohet kur vëren se të drejtat e tij për informim për çështjet e mjedisit dhe për pjesëmarrjen e tij gjatë vendimmarrjes për çështje të mjedisit nuk përmbushen nga organet përgjegjëse.

Ankimimi mund të bëhet si për mosrealizim të plotë apo të pjesshëm të detyrimeve që kanë palët për zbatimin e Konventës, ashtu edhe për mënyrën apo procedurën se si palët përgjegjëse zbatojnë në lidhje me informimin mjedisor dhe pjesëmarrjen e publikut. Është thelbësore që kërkesat e Konventës që zbatohen në përputhje me procedurat përkatëse si p.sh.: pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje të kalojë në të gjitha fazat e saj dhe në afate kohore të përshtatshme për të mundësuar përfshirje sa më të gjerë të publikut.²¹⁰

²⁰⁹ Konventa e Aarhus-it u miratua më 25 qershor 1998 në Aarhus të Danimarkës dhe jep mundësi për të aderuar për vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Evropën, ato me status këshilltari pranë këtij Komisioni dhe organizatat rajonale të integritit ekonomik, të përbëra nga shtetet anëtare sovraane të KEE, tek të cilat shtetet anëtare kanë transferuar kompetencën për çështjet që trajtohen nga Konventa.

²¹⁰ Çdo palë do të ketë detyrimin që të:

(a) zbatojë klauzolat e këtij neni, në lidhje me vendimet për lejimin e aktiviteteve të propozuara, sipas listës në Aneksin I;

(b) zbatojë klauzolat e këtij neni, në përputhje me ligjin e vet ndërkombëtar, edhe për vendimet mbi aktivitetet e propozuara jo të listuara në aneksin 1, të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm mbi mjedisin. Për këtë qëllim, palët do të vendosin nëse një aktivitet i propozuar do t'u nënshtrohet klauzolave të këtij neni;

Ankesat mund të paraqiten në këto mënyra:

- Individualisht, nga çdo person që mendon se i cënohen të drejtat që i jep Konventa;
- Me anë të grupimeve specifike ose nëpërmjet OJF-ve;
- Me përfaqësi të specializuar (Avokati i Popullit ose avokat privat).

5.3.5 Neni 9 i Konventës së Aarhusit

Neni 9 i KA nga pikëpamja e ligjit procedural të brendshëm, nëse ka pengesa, ofron zgjidhje procedurale sipas përcaktimeve dhe në përputhje me konventën apo praktikave orientuese të Këshillit të saj (Komiteti i Përputhshmërisë), në rastin tonë në lidhje me ngritjen e padisë për çështjet mjedisore.

Pika 2 e tij shprehet se: Çdo palë brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar do të sigurojë që anëtarët e publikut të interesuar që: a) *kanë interes të mjaftueshëm*, ose b) *u është cënuar një e drejtë*, në rast se ligji procedural i një pale e kërkon këtë si parakusht, do të kenë të drejtën për një procedure shqyrtimi përpara gjykatës dhe/ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj, për të mos pranuar legalitetin substancial dhe procedural të çdo vendimi, veprimi ose mosveprimi, sipas klauzolave të nenit 6 dhe kur kjo parashikohet në ligjin kombëtar dhe pa paragjykuar paragrafin 3, më poshtë, të klauzolave të tjera përkatëse të kësaj konvente.

Për një ankimim efektiv kërkuesi mund edhe t'i drejtohet Aarhusit kur dëmi që mund të shkaktohet është i rëndë, parikuperueshëm, dhe i atëçastshëm, si dhe i vazhdueshëm në

(c) mund të vendosë, rast pas rasti, në qoftë se parashikohet nga ligji kombëtar, për të mos zbatuar klauzolat e këtij neni për aktivitetet e propozuara, të cilat u shërbejnë qëllimeve të mbrojtjes kombëtare, në qoftë se kjo palë mendon se një aplikim i këtij neni do të ketë ndikim negativ mbi këto qëllime.

kohë edhe nëse organet administrative apo gjyqësore nuk janë efikase në marrjen në shqyrtim të kërkes-padisë²¹¹.

Shqipëria nuk e njeh një praktikë të tillë, për më tepër edhe në vendet e tjera nuk njihet, në kushtet kur gjykata nuk ka pezulluar ndërtimet për raste të tilla me impakt madhor në mjedis dhe deri në përfundim të procesit pasojat mund të jenë të rënda, mbas kalimit të fazës së apelimit për të tre apelimet e Sigurimit të Padisë subjekti mund t'i drejtohen drejtpërsëdrejti Aarhusit dhe ende pa ju drejtuar Gjykatës së Lartë, duke u mbështetur tek efikasiteti i aksesit në drejtësi sipas përcaktimit të Aarhusit. Ky lloj kërkimi do ta bënte më efikase nxjerrjen e përgjegjësisë juridike-civile dhe administrative mjedisore për palët, pasi çështja do të shqyrtohej në një kohë të shpejtë, nga një organ i specializuar, si dhe vendim do të ishte i shpejtë për të ndaluar dhe parandaluar dëmet që i kanë ardhur dhe mund t'i vijnë mjedisit.

5.4 Aksesit në drejtësi sipas Konventës së Aarhusit

Shtylla e tretë e Konventës së Aarhusit (artikulli 9/3), e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës, është një mekanizëm që siguron përmbushjen e detyrimeve dhe të drejtave të përcaktuara në Konventë. Palët në Konventë janë të detyruara të përdorin mjete të efektshme juridike dhe ligjore për ata që me Konventë iu shkelen të drejtat dhe u cënohet interesi. Kjo nënkupton qasje në një procedurë rishikimi para një gjykate apo organi tjetër, të pavarur

²¹¹ “Rast për tu përmendur është rrëzimi i tre Sigurimeve të Padisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nga subjekte të ndryshme grupimeve të interesit edhe shoqatat Maj-Qershor 2016, ku si fakte u paraqitën fotografi, dëshmi të ekspertëve dhe qytetarëve, ekspertiza nga ekspertët mjedisor për dëmet që janë shkaktuar dhe që do të vijnë në të ardhmen në këtë zonë si dhe shkresa e Ministrisë së Mjedisit ku u kthehet përgjigje qytetarëve protestues në lidhje me projektin e “këndit të lojrave” te Parku i Liqenit të Tiranës”

dhe të paanshëm, të krijuar me ligj. Mund të ankohet gjithkush, që nuk ka marë informacionin e duhur dhe nuk ka qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse mjedisore nëprmet nenit 9²¹². Në rrethanat kur një palë parashikon një shqyrtim të tillë nga një gjykatë, ajo do të sigurojë që ky person të ketë gjithashtu të drejtë për një procedurë të shpejtë e efektive të vendosur me ligj, e cila është pa pagesë ose jo e shtrenjtë për rishqyrtim prej një autoriteti publik ose nga një organ i pavarur dhe i paanshëm.

Çdo palë, brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar, do të sigurojë që anëtarët e publikut të interesuar që: kanë interes të mjaftueshëm ose u është cënuar një e drejtë, në rast se ligji procedural i një pale e kërkon këtë si parakusht, do të kenë të drejtën për një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës dhe/ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj. Çfarë përbën interes të mjaftueshëm dhe cënim të një të drejte do të përcaktohet, në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar dhe me objektivin për t'i dhënë publikut të interesuar të drejta më të zgjeruara për t'ju drejtuar gjykatës, brenda sferës së kësaj Konvente. Për këtë qëllim, interesi i një organizate jo qeveritare që ka për objekt në statutin e saj mjedisin do të konsiderohet si organizat që u cënohet intersi dhe legjitimohet të ngrej padi mjedisore në gjykatë.

Përveç kësaj, dhe pa paragjykuar procedurat e shqyrtimit, çdo palë do të sigurojë që, në rastet kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, nëse ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t'iu drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar

²¹² Çdo palë, brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar, do të sigurojë që çdo person, i cili mendon se kërkesa e tij për informacion sipas nenit 4 është nënvleftësuar, refuzuar gabimisht, pjesërisht ose tërësisht, i është përgjigjur në mënyrë të pamjaftueshme ose nuk është trajtuar në përputhje me klauzolat e këtij neni, ka të drejtë për të pasur një procedurë shqyrtimi përpara gjykatës ose çdo organi tjetër të pavarur dhe të paanshëm, të krijuar me ligj.

veprimet apo neglizhimet nga personat private dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vet kombëtar, në lidhje me mjedisin.

Me qëllim që të rritet efektiviteti i klauzolave të këtij nenin, çdo palë do të sigurojë që publikut t'i jepet informacion për të drejtën e tij për t'iu drejtuar procedurave të shqyrtimit administrativ e gjyqësor dhe do të marrë në konsideratë krijimin e mekanizmave ndihmës të përshtatshëm, për të hequr ose pakësuar pengesat financiare ose pengesa të tjera në ushtrimin e së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës²¹³.

Çdo palë do të sigurojë që, në rastet kur anëtarët e publikut plotësojnë kriteret, nëse ka të tilla në ligjin kombëtar, ata do të kenë të drejtë për t'iu drejtuar procedurave administrative ose gjyqësore për të mos pranuar veprimet apo neglizhimet nga personat private dhe autoritetet publike, të cilat janë në kundërshtim me klauzolat e legjislacionit të vetë kombëtar, në lidhje me mjedisin. Këtu fillon edhe problemi në lidhje me legjislacionin tonë që pjesërisht është i qartë, diku i paqartë, në thelb është e njëjta situatë burokratike e ndjekjes se rrugës për ngritjen e padisë.

Konventa i njeh dhe u këshillon shteteve anëtare të drejtën për të krijuar hapësira ligjore në rrugë administrative dhe gjyqësore ndaj kërkesave që vijnë nga publiku, por këto hapësira nuk duhet të jenë në kundërshtim me parimet edhe normat ndërkombëtare.

²¹³ Manual për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, Regional Environmental Centre (REC), fq. 54.

E analizojmë më konkretisht situatën e legjislacionit tonë në lidhje më Konventën e Aarhusit edhe praktikën ndërkombëtare në lidhje me to.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (LMM) ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Ky ligj është përafuar me Direktivën e Parlamentit Europian dhe Këshillit “mbi Përgjegjësinë Mjedisore, Parandalimin dhe Riparimin e Dëmeve mbi Ambientin” e ndryshuar²¹⁴, dhe si objektiva kryesore në nenin 2 të tij ky ligj, përcakton parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë.

Konventa e Aarhus-it bën dallimin mes konceptit “publik”, të kuptuar si çdo person fizik e juridik sipas përcaktimit të legjislacionit kombëtar dhe konceptit të “publikut të interesuar”²¹⁵, të kuptuar si publiku që ndikohet apo mund të ndikohet nga vendimmarrja mjedisore. Shoqatat duhet të kenë në objektin e veprimtarisë së tyre mjedisin, që të quhen “publik i interesuar” si kriter paraprak për të kërkuar legjitimin në gjykatë. Praktikisht, bëhet e pamundur kjo gjë nga pikëpamja e efikasiteti në drejtësi edhe pse Aarhusi është pjesë e legjislacionit të brendshëm sepse kërkohet kushti objektiv i shkaktimit të dëmit (nuk ka ndodhur dëmi, por eventualisht mund të ndodhë), por mungon edhe kriterin tjetër i

²¹⁴ Direktiva nr 2004/35/KE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 21 Prill 2004 “Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin” e ndryshuar, Numri CELEX: 32004L0035, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 143, datë 30.4.2004, fq. 56-75.

²¹⁵ Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis nr 10440, datë 7.7.2011.

akteteve individuale, për të cilat nuk mund të kërkohet pavlefshmëri sepse nuk përcaktohen në ligjin për Gjykatat Administrative²¹⁶, si dhe një kriter i tillë nuk është i përcaktuar në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit si ligji kuadër, por edhe në ligje të tjera që kanë lidhje me mjedisin²¹⁷. Kësisoj, PJC humbet rrugës duke ndikuar në efikasitetin e procesit gjyqësor, civil dhe administrativ.

5.5 Kodi i Porcedurës Civile e drejta për t'u legjitmuar (dëmi në mjedis)

Neni 48, paditë që rrjedhin nga shkaktimi dëmit mund të ngrihen si në gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri, ashtu edhe në gjykatën e vendit ku është shkaktuar dëmi. Kur kërkohet shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga vdekja ose dëmtimi i shëndetit, padia mund të ngrihet edhe në vendin ku banon paditësi. Kur flasim për publik të prekur direkt ose indirekt mjafton të jetë shkaktuar dëmi në mjedis dhe pala të vërtetë interesin e ligjshëm, dëmtimin që ajo ka pësuar apo dhe mund të vijë nga ky dëm mjedisor. Kjo nuk

²¹⁶ Ligj nr. 49/2012 Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative neni 15 Neni, E drejta e padisë, Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik; b) organi i administratës publike, që pretendon se është cenuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast, organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit; c) punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike; ç) çdo subjekt që pretendon se është cenuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ; d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik: i) nga një akt normativ; ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj; dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj.

²¹⁷ Rasti i 3 kërkes-padive, Prill 2016 për çështjen e “këndit të lojrave” Tiranë, ky Gjykata Administrative shkalla e parë Tiranë, nuk legjitimoi palët ku dy nga kriteret kryesorë për legjitimitimin aktiv, janë ato të përmendura më sipër, shkaktimi i dëmit dhe akti individual, ku sipas vendimit të gjykatës, e para nuk ka ndodhur (nuk kemi dëm) dhe e dyta nuk përcaktohet në ligj akt individual.

lidhet thjeshtë dhe vetëm me afërsinë e vendit të shkaktimit të dëmit gjeografikisht, por edhe me pasojat e ardhura nga x subjekt për dëmin në mjedis²¹⁸ të shkaktuar ndaj personit.

Nëse një person fizik apo juridik, ndryshe publik, apo publik i interesuar i ndikuar që ka një interes të ligjshëm sipas nenit 32 të K.Pr.C., i lind e drejta për të paraqitur kërkesë-padi sipas nenit 31 të po këtij kodi, situata bëhet më e vështirë për përcaktimin e interesit të ligjshëm, kur dëmi në mjedis nuk ka lindur ende por ka premisë të vijë në një të ardhme. Interes i ligjshëm sipas Kodin Civil në nenet 624 dhe 609 nënkupton se dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit, pra dëmi është përcaktuar si direkt, personal, aktual, real, që të plotësojë interesin e ligjshëm dhe kërkon pasojën (në kuptimin e dëmeve në të ardhme në mjedis, koncepti i rrezikut të ardhjes së dëmit nuk trajtohet qartë), si dhe në kuptimin e Sigurimit të Padis dëmi duhet të plotësojë në mënyrë kumulative këto element dëmi të jetë: i rëndë, i parikuperueshëm dhe të atëçastshëm që të plotësojë interesin e ligjshëm VUKBGJL²¹⁹ për Sigurim Padie, e cila ka lidhje të drejtpërdrejtë me përcaktimin e PJC si pjesë e efikasitetin në proces.

Kodi krijon një barrierë e cila kërkon shkaktimin e dëmit, pra dëmi të jetë shkaktuar jo të jetë “Eventual” i pritshëm, ndryshe mundësia për të drejtën e aksesit në gjykatë bëhet më e vështirë për të mos thënë e pamundur, kur kriteret e dëmit në mjedis përcaktohen me VKM sipas ligjit për Mbrotjen e Mjedisit (neni 50/a.b.), ku autoriteti kompetent për verifikimin e

²¹⁸ Nëse një fabrikë riciklimi në Mal të Zi ndot ajrin apo ujërat që kanë një lidhje organike me ajrin dhe ujërat e territorit shqiptar si dhe ka pasoja në dëmtimin e tokave ujërave ajrit, bujqësisë, aquakulturës dhe shëndetin e qytetarëve të Shkodrës, ata mund të ngrejnjë padi si në gjykatën e rrethit Shkodër po ashtu edhe në Malin e zi, duke u mbështetur edhe në Konventën e Essposit (Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në Kontekstin Ndërkufitar Espoo, Finlandë 25 Shkurt 1991) nëse ka pretendime se projekti nuk është konsultuar më parë me publikun e prekur në kontekstin ndërkufitar si dhe bie ndesh me Konventën e Aarhusit.

²¹⁹ Vendim Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.22 dt.19.01.2011.

këtyre dëmeve të mundshme në mjedis bëhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Nëse publiku jo i prekur direkt (ai indirekt) do të përpiqet të ngrejë padi për dëmit në mjedis, mundësitë janë minimale, shancet rriten për publikun e ndikuar që i duhet të argumentojë interesin e ligjshëm (lidhjen shkak-pasojë) si persona fizik dhe ata juridik, për pasojë dëmi në mjedis në të ardhmen do të jetë një dëm i madh jo vetëm i paparashikueshëm, por edhe i pamundur për t'u rikuperuar dhe rikthyer në gjendjen e mëparshme sipas parimit “ndotësi paguan” dhe pasojat e tjera kolaterale duke mos garantuar edhe të drejtat civile në lidhje me dëmshpërblimin nga dëmi mjedisor. Zharrëzit është rasti konkrete së si dëmet në mjedis ndotin dhe shkatërrojnë atë zonë, pronën private dhe shëndetin e njeriut, mungesa e aparaturave nga shteti për vërtetimin se tërmetet në këtë zonë vijnë nga aktiviteti industrial apo janë natyrore ka çuar në degradimin e kësaj zone, dhe se dëmi në mjedis si kategori juridike nuk mund të përcaktohet ende, pasi mungon një kriter ligjor teknik.

5.6 Legjitimi i Organizatat jo fitimprurëse

Kryesisht, OJF-të, Organizatat jo fitimprurës kanë mundësi më të madhe për t'u legjitimuar nëse ato si objekt dhe qëllim të veprimtarisë në statut apo aktin e themelimit të tyre (Kodi Civil, neni 39 e në vazhdim) kanë të përcaktuar mbrojtjen e mjedisit²²⁰, apo interesin publik²²¹ që lidhet me mjedisin. Praktika në Shqipëri në lidhje me çështjet mjedisore ka treguar se është ende e re dhe e paformësuar mirë, duke parë edhe traditën europiane 30 vjeçare përse i përket korpusit të akteve ligjore në lidhje me çështjet e mjedisit, e drejta mjedisore shfaqet edhe si pjesë e kolezionit të ligjit procedural i cili për legjimimin aktiv,

²²⁰ http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.i/Jurisprudence_prj/ARMENIA/Armenia_2009_2011_Teghout.pdf

²²¹ Ligj nr.8788, datë 7.5.2001 për Organizatat jo Fitimprurëse, neni 2 pika 6.

kërkon që ky interes i mjaftueshëm në radhë të parë të lidhet me faktin se dëmi është shkaktuar realisht, dëm real, aktual i drejtpërdrejt ndaj personit.

Ligji për Gjykatën Administrative përcakton edhe kushtet për ngritjen e padisë, nëse padia ka lidhje me një akt administrativ ose njëra nga palët është autoritet publik, ose kjo e drejtë i është deleguar si dhe për Sigurimin e Padisë²²². Si rregull, ajo ngrihet brenda 45 ditëve

²²² Ligj nr. 49/2012 për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative. Kreu IV subjektet dhe kushtet formale të padisë, Neni 14 Të drejtat dhe detyrat e palëve Palët, përfaqësimi, të drejtat dhe detyrat e palëve dhe të përfaqësuesve, përgjegjësia e palëve për shpenzimet dhe për dëmet gjatë procesit, pjesëmarrësit e tjerë në gjykim rregullohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile, për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji. Neni 15 E drejta e padisë Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik; b) organi i administratës publike, që pretendon se është cenuar në ushtrimin e kompetencave nga një akt administrativ apo nga një akt nënligjor normativ i paligjshëm, i një organi publik, me të cilin nuk ka lidhje varësie hierarkike. Në këtë rast, organi shtetëror mund të kërkojë zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës dhe/ose shfuqizimin e aktit; c) punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike; ç) çdo subjekt që pretendon se është cenuar në të drejtat dhe interesat e tij të ligjshëm për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ; d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik: i) nga një akt normativ; ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj; dh) çdo subjekt tjetër, të cilit kjo e drejtë i njihet shprehimisht me ligj. Neni 28 Sigurimi i padisë 1. Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të riparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ. 2. Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia. 3. Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. 4. Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi jepet nga gjykata, pranë së cilës ndodhet padia. Neni 29 Kushtet për sigurimin e padisë Gjykata vendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin; b) nuk cenohet rëndë interesi publik; c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Neni 30 Llojet e masave për sigurimin e padisë Sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet: a) pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ; b) marrjes edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme. Neni 31 Revokimi ose ndryshimi i masave për sigurimin e padisë 1. Gjykata, kryesisht ose me kërkesë të palëve, kur ndryshojnë rrethanat, mund të revokojë ose të ndryshojë vendimin për sigurimin e padisë. 2. Kërkesa për revokim apo ndryshim të masave për sigurimin e padisë nuk pranohet për rrethana dhe fakte që nuk kanë ndryshuar ende. I njëjti kusht vlen edhe për kërkesën e riparimit për një masë sigurimi të refuzuar më parë nga gjykata.

nga ezaurimi i rrugës administrative. Personit që me faj dëmton mjedisin²²³ hamendësohet se është ai shkaktari, dhe atij i bie barra për të provuar të kundërtën (Gjata. Ç: 2011-2012). Përsa i përket shpërblimit të dëmit të shkaktuar, merret parasysh dëmi efektiv, si dhe gjithë shpenzimet që duhen bërë për rivendosjen në gjendjen e mëparshme, kritere të cilat përcaktohen me VKM.

OJF-të në këto lloj ankimesh ndeshen me vështërsi të karakterit burokratik pasi ato mund të legjitimohen si palë vetëm për akte normative të përgjithëshme, jo akte normative individuale²²⁴, pengesa të cilat bien në kundërshtim me konventën e Aarhusit neni 3, por edhe me precedentët e Komiteti të Përputhshmërisë²²⁵, të cilat ndikojnë në përcaktimin e PJC dhe efikasitetin e procesit civil në lidhje me dëmin e shkatuar në mjedis. Parimi i Zhvillimit të Qëndrueshëm arrihet: duke mbajtur në ekuilibër zhvillimin mjedisor me atë ekonomik. Çdo veprim, vendim apo mosveprim në fushën mjedisore, duhet të jetë në përputhje me qëndrueshmërinë mjedisore²²⁶, ndaj edhe PJC për dëmet në mjedis duhet të jenë më të qarta si figura juridike.

Çfarë instrumentesh juridike të tjera mund të përdorim në rastin kur një dëm në mjedis në të ardhmen apo i shkaktuar nuk mund të vërtetohet, apo mund të vi gradualisht për 10 vje?

²²³ Në këtë dispozitë parashikohet. “Personi që me faj ka cënuar mjedisin, duke keqësuar, ndryshuar, ose dëmtuar atë tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar” KC neni 624.

²²⁴ ...si rasti i vendimit të KKT 12. 02. 2016 “çështjen e këndit të lojrave Tiranë”, ku tre padit për këtë çështje nuk u legjitimuan me arsyetimin se nuk plotësonin kriteret ligjore në interes publik, edhe si OJG, dhe grupim i organizuar.

²²⁵ Komiteti Përputhshmërisë, organ i Konventës së Aarhusit, jep këshilla dhe rekomandime në lidhje me çështjet mjedisore Mete E, leksione 2012-2013.

²²⁶ Lëvizja Europiane në Shqipëri EMA, Konventa për Integrimin grupi i punës IV mjedisi, Sheraton, fq. 2, Tiranë 26.05.2016.

Sigurisht që instituti Begatimit pa Shkak (BpSH) mund të përdoret në rastin kur nuk mund të ngrihet padi tjetër të përcaktuar nga ligji për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar, rasti mund të ishte dëmi në mjedis.

“Personi që pa shkak të ligjshëm, ka fituar ose ka kursyer dicka në dëm të një personi tjetër, detyrohet të shpërblejë këtë të fundit për humbjet pasurore që ka pësuar, brenda caqeve të begatimit. (KC, nenet 655-658). Në përgjithësi, doktrina dhe jurisprudenca jonë është e mjaftuar me interpretime strikte të kushteve të padis së begatimit dhe ta përjashtojë ngritjen e kësaj padie kur i dëmtuari mund të ngrije një padi tjetër (Bushati E: 211).

Rasti mund të ishte i një aktiviteti industrial apo veprimtarie të një personi fizik, i cili në ushtrimin e veprimtarisë së tij parimisht ishte brenda përcaktimeve të aktet normative administrative etj., por publiku e ka të pamundur të vërtetojë dëmin në mjedis. Mbas shekullit të XIX është diskutuar gjerësisht edhe padia e begatimit pa shkak edhe për administratën publike²²⁷ (shtetin) nëse aktiviteti i mësipërm do të ishte publik, apo i kombinuar me atë privat, ose privat. Në rastin konkret barra e provës anon më tepër nga personi që ushtron aktivitetin në mjedis për të vërtetuar e si ai e ka ushtruar këtë veprimtari pa shkaktuar dëm në mjedis të pala e tretë (publiku). Begatimi ka kuptimin aktiv të pasurimit dhe kursimit të personit në “kurriz” të një personi tjetër. Kjo lloj padie ka marrë një kuptim specifik në jurisprudencë më kalimin e kohës. Për aq kohë sa dëmi në mjedis nuk del qartë si figurë e PJC, për shkaqe objektive dhe subjektive, Begatimi pa Shkak është një institut i cili na vjen në ndihmë për të shpërblyer të dëmtuarin nga dëmi në mjedis si pjesë të PJC.

²²⁷ E Bushati, Doktoratura Begatimi pa Shkak, fq. 178.

5.7 Raste nga jurisprudenca shqiptare për çështjet e dëmeve në mjedis

5.7.1 Rasti i Gjirit të Vlorës 2005

Në vitin 2005 më datë 1 Maj një organizatë jo qeveritare e krijuar posaçësisht për mbrojtjen e Gjirit të Vlorës me emrin Aleanca Civile për mbrojtjen e Gjirit të Vlorës, paraqiti një kërkesë në Komitetin e Pajtueshmërisë në lidhje me pretendimet që ata shfaqnin përse i përket vendimarrjes nga autoriteti shtetëror (publik) për ndërtimin e një parku industrial në këtë gji në lidhje me çështjet mjedisore, konkretisht në zonën e quajtur Tri-Port Vlorë. Shkeljet e pretenduara nga ACGJV, mbështeteshin mbi mosplotësimin e detyrimeve nga marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria ishte pjesë, specifikisht Konventa e Arhusit, neni 3 paragrafi 2, neni 6 paragrafi 2, dhe neni 7 i Konventës. Financuesi kryesor i këtij projekti ishte BERZH, (Banka Europiane për Rindërtim edhe Zhvillim) por edhe partnerë të tjerë investitore²²⁸.

²²⁸ Fakte dhe rrethana.

Më datë 19 shkurt 2003 Këshilli Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë (KKRTRSH) merr vendimin për krijimin e një parku energjitik në Vlorë nga pjesa veriore e qytetit²²⁸. Ky vendim përcaktonte se Ministria e Industrisë dhe Energjitikës do të bashkëpunonte me ministrinë e tjera edhe autoritetet e tjera që përfshin ky perimetër për zbatimin e projektit edhe përcaktime të tjera në projekt. Pala e cila ngre pretendimin, shprehet se ky vendim mbi këtë projekt ka qënë subjekt i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, por në mënyrë të përgjithshme jo të specifikuar. Mbasi nuk kishte marë përgjigje nga autoriteti publik, pasi ishte refuzuar nga gjykata kërkesa e palës për padi, por edhe kërkesa për referendum nga Gjykata Kushtetuese, ajo i drejtohet Komitetit të Pajtueshmërisë. Pretendimi i OJQ, lidhet jo me procedurën për dhënien e lejes për ndërtimin e parkut sepse ajo i është nënshtruar VNM por për projektet shitesë dhe projektet e tjera të veçanta që duhet të nënshtrohen VNM, p.sh. rasti shtimit të kapacitetit të depozitave të naftës nga 170 mijë në 500 mijë tonë, marrëveshje e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar në 2005 midis Shqipërisë edhe Rumanisë. Aleanca

ngre pretendimin se këto shtesa në projekt duhet ti nënshtrohen VNM dhe nuk mund të jenë pjesë e VNM të planit gjeneral të parkut energjistik. Komiteti i kërkon informacion shtetit shqiptar në lidhje me pretendimin e palës për sa i përket informimit të publikut edhe pjesëmarrjes së publikut. Duke filluar që nga 2005 deri në 2008 ka pasur një mardhënie të ngjeshur komunikimi midis Komitetit OJQ edhe shtetit shqiptar, me mbi 16 seanca për të plotësuar më mirë informacionin e kërkuar nga komiteti edhe për ta patur më të qartë tablonë e paraqitur nga palët pasi palët kanë paraqitur probleme në hartimin dhe paraqitjen e kërkesave të tyre. Qeveria shqiptare i përgjigjet kërkesës për informacion të Komitetit, ku citohet në dokumentat zyrtare shoqëruese se VNM është bërë sipas procedurave të caktuara²²⁸. Elementi i vetëm i pjesëmarrjes së publikut në këtë fazë ka qenë pjesëmarrja e publikut në takimin publik të datës 28 ose 31 tetor të 2003, pala e interesuar ka informuar Komitetin se në këtë takim ka marrë pjesë edhe publiku, ekspertë, madje edhe OJQ, pra Alenaca Civile për Mbrojtjen e Gjirit të Vlorës²²⁸. Ky pohim i palës së interesuar u mohua kategorikisht nga ACMGJV. Deri në maj të vitit 2007 pala e interesuar sipas Komitetit kishte dështuar për dhënien e informacionit në mënyrë specifike për publikun.

Konkluzione të Komitetit nëpërmjet Gjetjeve edhe Rekomandimeve.

Përsa i përket parkut energjistik, Komiteti konstaton se vendimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë në caktimin e territorit për parkun industrial dhe energjistik, Parku i Vlorës, është nën fushë veprimin e nenit 7 dhe për këtë arsye është subjekt i kërkesave të nenit 6, paragrafët 3/4 dhe 8 të Konventës së Arhusit. Pala e interesuar ka dështuar të zbatojë këto kërkesa të rëndësishme në vendim - marrje duke mos qënë në përputhje me nenin 7.

Në lidhje me propozimin e stacionit termik të energjisë elektrike, Komiteti konstaton se vendimi nga Këshilli i Rregullimit të Territorit në përcaktimin e sheshit të ndërtimit të TECIT pranë Vlorës është subjekt i kërkesave të nenit 6, paragrafët 3/4 dhe 8. Edhe pse janë bërë disa përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen e publikut, këto në masë të madhe u zhvilluan pas vendimit të rëndësishëm mbi vendndodhjen dhe ish-in objekt i disa elementëve jo më pak të rëndësishëm se TECI, si dhe kishte mangësi duke e cuar Komitetin në gjetje, se pala e interesuar ka dështuar të pajtohet plotësisht me kërkesat në fjalë si dhe për të krijuar një kornizë të qartë, transparente dhe të qëndrueshme për zbatimin e dispozitave të konventës në legjislacionin shqiptar.

Komiteti gjithashtu rekomandon që masat e propozuara të merren ose përpunohen, sipas nevojës, në konsultim me OJQ-të. Komiteti fton palën e interesuar që të hartojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe t'i paraqesë këto në Komitet deri më 15 shtator 2007. Komiteti fton palën e interesuar për t'i siguruar informacion Komitetit nga 15 Janar 2008 mbi masat e marra dhe rezultatet e arritura në zbatimin e rekomandimeve të mësipërme. Komiteti i kërkon sekretariatit dhe fton palët, përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe rajonalë, organizatat dhe institucionet financiare, për të siguruar këshilla dhe asistencë palës së interesuar sa është e nevojshme në zbatimin e masave të përmendura. Komiteti vendos të shqyrtojë

5.7.2 Rasti i Liqeni Artificial Tiranë “ndërtimet nën digë” 2014-2015

(Sigurim Padie dhe Padi Themeli)

Projekti i pesë kullave, i miratuar me vendimin e Bashkisë Tiranë²²⁹ për miratimin e lejes zhvillimore në 1 gusht dhe miratimin e fillimit të punimeve më datë 1 tetor të vitit 2014²³⁰ e cila lejoi subjektin të fillojë ndërtimet në zonën e nëndiges të Liqeni Artificial Tiranë. Në vendimin për bllokimin e punimeve tek Diga e Liqenit, INUK rendit 14 shkelje ligjore të Bashkisë së Tiranës, që sipas tij e bëjnë nul lejen e ndërtimit; njëra nga këto është mosdhënia e miratimit të studimit hidrologjik nga Komiteti Kombëtar i Digave²³¹ por kompania e çoi çështjen në Gjykatën Administrative, ku kërkoi zhblokimin e punimeve.

Përmes vendimit të shpallur më 23 janar 2015, gjykata rrëzon INUK-un dhe i jep të drejtë kompanisë të vazhdojë punimet.

(Përmes një vendimi të 14 janarit 2015²³², INUK, Inspektoriati i Ndërtimeve Urbanisitike Kombëtare e shpalli të paligjshme lejen e ndërtimit dhe urdhëroi bllokimin e punimeve).

çështjen jo më vonë se tre muaj nga rekomandimet edhe gjetjet edhe rënia dakort e tyre nëse mbas kësaj mbledhje ka paqartësi osë problema të tjera në lidhje me informacionin e marë nga palët nga Komiteti. Qeveria shkeli parimin për të informuar publikun për çështjet mjedisore, të drejtën për pjesëmarrjen e publikut për çështjet mjedisore, e shumë parime të tjera të cilat përbëjnë interes të ligjshëm për t’iu drejtuar gjykatës nëpërmjet padis për dëme mjedisore apo për dëmin në të ardhme, ku si publik i legjitimuar drejtpërsëdrejti janë komuniteti i Vlorë dhe OJF me objekt çështjet mjedisore. Përfaqësuesit e OJF-ve në Vlorë nuk e vazhduan më komunikimin me Komitetin e Përputhshmërisë si hapa paraproceduralë për t’iu drejtuar më pas Konvetës së Aarhusit (OKB) apo GJEDNJ për shkeljet e konstatuara.

²²⁹ Vendimet nr.9967/7 dt. 1 Gusht 2014, Bashkia Tiranë.

²³⁰ Vendim 9967/13 dt 1 Tetor 2014, Bashkia Tiranë.

²³¹ Vendimin nr. 4 të datës 6 janar 2015 të Komitetit Kombëtar të Digave.

²³² Në vendimin e gjykatës, dy janë argumentet mbi të cilat është vendosur sigurimi i padisë;

Kompania “xx” kërkon Sigurim Padie mbështetur në nenin 202-203...206 për pezullimin e punimeve nga INUK në Gjykatën Administrative shkalla e parë dhe dhjet ditë më pas, Gjykata Administrative e Tiranës e rrëzoi bllokimin. Ky vendim u ankimua nga INUK-u në Gjykatën Administrative të Apelit, ku gjykata vendosi “ndryshimin e vendimit me numër 230 akti, datë 23 janar 2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë²³³, duke rrëzuar kërkesës për sigurimin e padisë”, ndërkohë që ndërhyrja mjedisore në këtë park ka nisur qysh prej muajit gusht të vitit 2014 dhe dëmet janë mjaft të mëdha.

Në datë 29 maj 2015, Gjykata Administrative e Apelit ka hedhur poshtë kërkesën e subjektit që po ndërtonte pallatet tek Diga e Liqenit Artificial në Tiranë për të shpallur të paligjshëm vendimin e INUK-ut i cili vendosi ndërprerjen e punimeve në këtë kantier. Çështja vazhdon në Gjykatën e Lartë.

-dysimi i arsyeshëm për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë për kompaninë;
-dhe moscënimi i interesit publik.

(Aryestim i vendimit të sigurimit të padisë së kërkuar nga subjekti x) “Sipas gjykatës, kompania xx kishte shpenzuar rreth 183 milionë lekë dhe kishte parapaguar 71 milionë të tjera për materiale, deri në momentin e vendimit të Gjykatës Administrative. Një tjetër argument, që anoi peshoren e gjykatës nga vazhdimi i punimeve ishin dy kredi bankare të marra nga kompania, në vlerën e 4 milionë eurove.

Gjyqtari çmon në të njëjtin vendim se nuk çënohet interesi publik. Argumenti i përdorur për të justifikuar këtë qëndrim është vendimi i KRRTRSH-së i vitit 2006, që e kthen këtë tokë në kufi me Parkun e Tiranës në një zonë ndërtimesh.

Ky vendim i Gjykatës kundërshtohet nga ekspertët, të cilët pretendojnë se vendimi i 2006-s i KKT-së rrëzohet nga Plani Urbanistik i Tiranës, i hartuar nga Bashkia Tiranë 2012. “Plani Rregullues i Tiranës e parashikon si zonë rekreative dhe jo ndërtimesh,” . Në shtator të vitit 2014, Bashkia e Tiranës i dërgoi këtij komiteti studimin hidro - teknik të sigurisë së digës së liqenit dhe kërkoi miratimin e tij. Ky studim u miratua më 23 shtator 2014 nga Komiteti i Digave, por një kontroll i mëpasëm i Zyrës së Antikorrupsionit të Këshillit të Ministrave zbuloi shkelje ligjore në këtë vendim. “Dokumenti i miratuar nga KKDM nuk ishte hartuar nga një studio ligjore e licensuar dhe u votua pa kuorumin e nevojshëm,” thuhet në aktin e kontrollit të Zyrës së Antikorrupsionit.

²³³ Vendimit nr 230, datë 23 janar 2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5.7.3 Rasti i ndërtimit të “këndit të lojrave për fëmijë” të Parku i Liqenit Artificial Tiranë 2016

Në datën 10 shkurt 2016 midis pjesës hyrëse të Parkut nga krahu i digës dhe përgjatë gjithë kolinës deri të kisha e Shën Prokopit dhe në afërsi të Amifiteatrit kjo zonë u rrethua me një gardh, ku sipas Bashkisë Tiranë më vonë u deklarua që do të ketë një kënd lojrash për fëmijë, ku në vendin e rrethuar nuk ishte vendosur asnjë tabelë informative për çfarë ishte vënë rrethimi, mbas reagimit të shoqërisë civile për mosbërjen transparente të projektit dhe kjo çështje mori një dimension publik²³⁴.

²³⁴ Në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurorit Publik në datën 14.12.2015 njoftohet hapja e tenderit me nr 49 me objekt Këndi Lojrave dhe ku autoriteti prokurues është Bashkia Tiranë, në datë 08.02.2016 lidhet kontrata me fituesin e shpallur . Vendimi KKT përcakton se kjo zonë është me rëndësi kombëtare në planifikimin e territorit, identifikuar si kurora e gjelbër Tiranë.

Shoqëria civile gjatë kësaj periudhe proteston për mostransparencë nga institucionet shtetërore për ditë dhe muaj me radhë. Në një letër që i dërgohet Ministrisë së Mjedisit nga qytetarë të angazhuar në lidhje me ndërtimin në park për lejen mjedisore dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis..., në kthim përgjigjen e saj Ministra (në datë 23.03.2016 nr prot 570/1 drejtuar Qytetarëve për Parkun) sqaron se: Sipas akteve ligjore në fuqi, aplikimet në Agjencin Kombëtare të Mjedisit vijnë si më poshtë:

- Njëpërmjet Ministrisë së Mjedisit për Procedura të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
- Njëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit për procedurë të Lejeve Mjedisore

Për sa më sipër. Ju njoftojmë që pranë AKM, nuk është bërë asnjë aplikim për “Ndërtimin e projektit pilot të këndit të lojrave për fëmijë, në parkun e Liqenit Artificial Tiranë”.

Siç e shohim më sipër nuk është aplikur për këtë projekt. Përpos kësaj, bashkia pretendon së janë bërë konsultimet me publikun, ndërkohë që para se të bëhet kjo “dëgjese” Zhvilluesi i Lejes duhet të aplikojë në AKM (Agjencin Kombëtare të Mjedisit) ku pjesë e këtij procesi është edhe eksperti i Ministrisë për një periudhë që zgjat minimalisht rreth 2 muaj. Vetëm publikimi dhe informimi në vendin ku do të ndërtohet, në media elektronike gazeta, televizione, shpallje dhe mënyra të tjera sipas përcaktimit ligjor, si afat kohor zgjat minimalisht 25 ditë, kjo gjë nuk u vërtetua nga bashkia dhe palët e tjera.

Në përpjekjet e saj shoqëria civile depozitoi në datë 04.04.2016 një kërkesë-padi në Gjykatën për këtë çështje mjedisore duke u bazuar mbi shkeljet e mësipërme që janë vetëm një pjesë e shkeljeve si dhe dëmin e shkaktuar në këtë hapësirë publike të gjelbër që quhet Parku i Madh i Tiranës. Më pas në gjykatë u depozituan edhe 2 kërkes-padi të tjera nga grupe interesi dhe shoqata mjedisore. Objekti i kërkesë- padisë nr 1 si pikë të parë kishte Sigurimin e Padisë me arsyetimin edhe siç u trajtua para gjykatës se ishte shkaktuar dëm në mjedis dhe po shkactohej ende dëm. Pikat e tjera të objektit kishin të bënin me pavlefshmëritë e akteve administrative si pjese e themelit dhe se e gjithë kjo veprimtari na con në arsyetimin e besueshëm së po shkactohej një dëm i rëndë, i atëcastshëm dhe i pakthyeshëm për qytetarët e Tiranës në shëndet, në cilësinë e jetës, në veprimtarinë ekonomiko - sociale, në pamjen vizuale të zonës ku po ndërtohet, në ndotje mjedisore, akustike, ndotje e tokës etj.

Në terma konkrete, po shkactohej një dëm në mjedis dhe mospezullimi i zbatimit të veprimit administrativ, krijon pasoja të rënda për paditësin, pasi ndërkohë që gjykata do të vlerësojë ligjshmërinë e veprimit dhe aktit administrativ, paditësi e ka të pamundur më mënyra të tjera të mbrojtë mjedisin nga dëmet e shkaktuara me

anë të projektit të ndërtimit të parkut të lojërave, përderisa autoriteti publik Bashkia Tiranë ka bllokuar pjesmarrjen e publikut në konsultime dhe vendimarrjet mjedisore për këtë çështje.

Masa e sigurimit të padisë synon të bëjë efektiv e të dobishëm procesin gjyqësor të themelit dhe se sigurimi padisë ka natyrë të përkohshme dhe instrumentale e proporcionale në arritjen e qëllimit që synon të mbrojë..., sipas parashtrimeve të prapësuesve.

Në datë 12.05.2016 Gjykata Administrative e Shkallës së parë rrethi Tiranë, rrëzon kërkesën për Sigurim Padie (SP) nga kërkuessit, me arsyetimin se nuk plotësohen tre kushtet kumulative të dëmit, të rëndë, të parikuperueshëm dhe të atëcastshëm, Pra situatë që na paraqitet tregon se edhe në rastin e SP sipas VUKBGJL duhet që dëmi të ketë ndodhur praktikisht dhe pasojat të kenë ardhur.

Arsyetimi i kërkuessit edhe duke u mbështetur në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. “Mjafton që dëmi (dëmi mjedisor) të jetë i argumentuar se do të vi dhe mund të kërkohet sigurim padie...”, në rastin konkret në sance u paraqit dhe u pranua një akt ekspertimi mjedisor nga një ekspert i licencuar mjedisor i cili shpjegonte dhe trajtonte nga ana shkencore dëmet në mjedis të shaktuara apo që mund të shkaktoheshin në këtë zonë, ndërkohë kthim përgjigja e Ministrisë së Mjedisit nr.570/1, datë 23.03.2016 ndaj qytetarëve shprehet se për këndin e lojrave nuk është bërë asnjë aplikim, kështu nuk u trajtua si çështje e sigurimit të padisë por si pjesë e themelit nga gjyqtarja në seancë, ndërkohë për mendimin tonë duhet të ishte marrë parasysh ky fakt për Sigurimin e Padisë.

Argumenti tjetër për Sigurimin e Padisë i mbështetur në nenin 13 të KEDNJ nuk u mor parasysh, gjë e cila vështirëson ose bën të pamundur efektivitetin e ankimit, kërkesë thelbësore që buron nga neni 13 i Konventës dhe nga neni 8 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.

Pala e paditur ngriti pretendimin se nuk kemi të bëjme me një dëm të rëndë dhe kërkon rrëzimin e kërkesës për Sigurim Padie.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë rrëzon Sigurimin e Padisë në seancë, ndërkohë që SP u ankimua në Apelin Administrativ. Në datën 14. 06. 2016 Gjykata Administrative e shkallës së parë Tiranë hedh poshtë kërkesë-padinë nr. 2 të një grupimi qytetar të cilët kishin kërkuar pavlefshmëri absolute të vendimit të KKT dhe lejes së Bashkisë Tiranë në lidhje me ndërtimin, gjykata arsyeton se: “pala paditëse nuk ka legjitimitetin aktiv për të kërkuar nëpërmjet një padie kundërshtuese pavlefshmërinë e vendimit të 12. 02. 2016 të KKT-së për miratimin e dhënies së lejes së ndërtimit për parkun e lojrave, dhe për pasojë padia e ngritur prej tyre duhet rrëzuar si e pabazuar në ligj pasi paditësit gjatë gjykimit nuk provuan çënimin e një interesi të ligjshëm që vinte nga akti administrativ, vendimi nr 1, datë 12.02.2016 i KKT-së. Gjykata konstaton se nuk është çënuar ndonjë veprimtari sipas përcaktimit të aneksit 1 të Konventës së Arhusit, apo veprimtari me ndikim të rëndësishëm në mjedis për të cilat publiku mund ti drejtohet gjykatës në përputhje me pikën 9/2 dhe 6 të Konventës”.

Ndërkohë në pikën 20 të listës së aneksit 1 të KA se do të shqyrtohen edhe rastet të cilat nuk janë në këtë listë por që janë të përcaktuara në ligjin kombëtar, pikërisht palët këtë nuk arritën të argumentonin në gjykatë edhe pse nuk ekziston në listën e konventës ai ekziston në ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në aneksin e dytë të saj ku përcaktohet termi “Park Tematik”.

Bashkia Tirane (BT) dhe Avokatura e Shtetit kërkuan rrëzimin e padisë me arsyetimin se ishte ndryshuar objekti dhe baza ligjore e padisë (pasi gjatë procesit u kërkuar pavlefshëmri relative e aktit duke ia dorëzuar gjykatës kërkesën, më tepër pasi më parë dy kërkes-padi më të njëjtin objekt ishin rrëzuar nga po kjo gjykatë). Arsyetimi jonë ishte se thelbi dhe përmbajtja e padisë ishte po ajo, shfuqizimi i vendimit të KKT-së dhe lejes së BT në lidhje me parkun e lojrave për fëmijë (park tematik) pavarësisht se ndryshonte shkaku ligjor nga pavlefshmëria absolute në relative, ky arsyetim ishte i mbështetur edhe në dy vendime të VUKBGJL, dhe vendime të cilat flasin për objektin e kërkimit të kërkesë-padisë, e cila pavarësisht se ndryshon bazën ligjore në përmbajtje është e njëjtë.

Gjykata dha vendimin se ky parashtrim paraprak për ndryshim të bazës ligjore ju duhet njoftuar palëve të cilat mungonin në proces, të cilat ishin kompanitë e nënkontraktuara nga BT për ndërtimin e parkut, për këtë arsye seanca gjyqësore u shty për në datë 1.07.2016.

Strategjia e padisë së parë u ndërtua mbi një sërë ndryshimesh të palëve të mëparshme, dhe do të përqëndrohesh në dy aspekte. 1 Ndryshimi i çdo fjale nga pavlefshmëri absolute në pavlefshmëri të akteve (pasi edhe padia numërr dy e rrezuar kishte pavlefshmëri absolute në objektin e padisë mjedisore), dhe 2, ligji për LVNM në aneksin nr.2 të saj ka të përcaktuar termin Park Tematik ndërkohë që leja e ndërtimit dhe

Në përputhje edhe me garancitë që ofron konventa për aksesin në drejtësi mbi çështjet mjedisore dhe efikasitetin e këtij aksesi, mendojmë se kjo veprimtari është nën juridiksionin e pikës 7 të konventës dhe janë shkelur kriteret e pikës 6, 3/4 dhe 8 të saj, ku publiku nuk është bërë pjesë e vendimarrjes në këtë proces pasi, vendi ku është dhënë leja e ndërtimit është subjekt i Konventës dhe është shkelur pika 9/3 e shtyllës së tret të KA për akses në drejtësi, si dhe e drejta Kushtetuese për një proces të rregullt dhe ligjor.²³⁵ Çështja

vendimet e tjera kryesisht i referohen më termin kënd lojrash për fëmijë, dhe se parku ka infrastrukturë lojrash argëtimi për grup moshash të ndryshme dhe me tema të ndryshme, dhe zbërthimin gjuhësor dhe letrar të fjalës park dhe park tematik sipas fjalori zyrtar të Akademisë së Shkencave:

Par/k-ku-qe-qet. Kopësht i madh me drurë zbukurues e me lule ose me mjete të ndryshme për argëtim a për sport. Parku I lojërave për fëmijë. 2 tek. Vendi ku mbahen dhe ndreqen automjete:autopark. Parku automobilistik. Parku i autobusëve.

Tematik/Ë,-A: mb. Tërësia e temave dhe e çështjeve, të cilat shtrihen, studiohen dhe zgjidhen në një vepër, në një mbledhje etj. Tematikë e larmishme: përcaktuan tematikën

Tematik,-E, mb. Që lidhet me tema të caktuara; që bëhen a ndërtohet sipas temave a sipas çështjeve të ndryshme. Treguesi tematik i lëndës, pasdite tematike, plan tematik.

I gjithë ky konstatim i mësipërm synonte ta çonte procesin drejtë moslënies së hapësirës të palës kundërshtare por edhe për t'i dhënë gjykatës shpjegimin e duhur sintaksor se çfarë kuptojmë më termin Park Tematik dhe "Kënd Lojrash për Fëmijë", me terma dhe përmbajtje të ndryshme, që nënkupton së ky term kënd lojrash për fëmijë është përdorur si term për të tentuar shmangien ligjore nga përgjegjësia ligjore të autoritetit publik në informimin pjesëmarrjen dhe vendimarrjen e publikut në këtë veprimtari. Vendimi i Gjykatës Administrative Shkalla e parë rrëzoi kërkesë-padinë nr.1 me arsyetimin se palët nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u legjitimuar, si dhe projekti "kënd lojrash për fëmijë" nuk është i listuar në ligj dhe se nuk ka një dem të drejtpërdrejt personal si interes i ligjshëm personal (në mjedis), të tre padit në lidhje me këtë çështje patën të njëjtin fat. Sipas arsyetimit të gjykatës legjitimi aktiv ka dy kushte, 1) kur ekziston një akt administrativ i paligjshëm, 2) kur personit i është cënuar interesi i tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, "për të cilat paditësit kanë depozituar si prova, ekspertiza mjedisore, pamje filmike publike, dëshmi, fotografi, prova dhe fakte të tjera etj të cilat nuk u morën parasysh nga gjykata për të vlerësuar dëmin e shaktuar apo edhe që mund të shkaktohet. Gjykata shprehet se dëmi duhet të jetë konkret dhe në vazhdim në kohë për të përfaqësuar interesin e ligjshëm në mënyrë që pala të legjitimohet gjatë procesit paraprak gjyqësor hetimor.

²³⁵ Disa arsye sipas Gjykatës ASHKT që rrëzoi kërkesë padit dhe Sigurimin e Padisë:

1 nuk u vërtetua që ka një dëm në mjedis apo që mund të vijë një dëm në mjedis.

2 projekti "kënd lojrash" nuk është subjekt i ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (ska nevojë për leje mjedisore).

3. Shoqatat grupet e interesit nuk mund të legjitimohen të kërkojnë shfuqizimin e një akti administrativ individual sic ishte vendimi i KKT 12. 02. 2016 pasi kjo gjë nuk garantohet nga ligji dhe nuk ka një interes të cënuar (interes të ligjshëm) lidhur me, kush bën përcaktimin nëse kemi dëm në mjedis, dhe si përcaktohet apo vlerësohet dëmi mjedisor, dëmet në mjedis ose që rrezikon ta dëmtojë atë has barriera, ligjore.

Për shembull, (Agjencia Kombëtare e Mjedisit) AKM është autoriteti që përcakton aktivitetet e rrezikshme mjedisore, dëmin mjedisor duke e përcaktuar vlerësuar sipas kriterëve të VKM, pra e cunuar dhe në konflikt interesi më paditësin, pasi kryesisht goditen në gjykatë aktet administrative të cilat dalin kryesisht nga ekzekutivi. Ekzistenca e një organi tjetër të pavarur ekspertësh, qoft kjo Akademia e Shkencave apo një këshillë me ekspert të fushës i votuar nga Kuvendi dhe i disa ndryshimeve të tjera në normativën procedurale dhe materiale do të rrisnin efikasitetin e aksesit në drejtësi për padit mjedisore, në funksion të mbrojtjes së të

vazhdon në Gjykatën e Apelit ndërkohë është bërë edhe një apelim në Konventën e Aarhusit për të nxjerrë përgjegjësitë mjedisore.

5.7.4 Çështja e importit të mbetjeve dhe Ligj për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2016

Në datën 22/09/2016 Kuvendi i Shqipërisë miraton disa ndryshime me ligj nr. 92/2016, në Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve²³⁶, ndryshime të cilat lejonin importin e mbetjeve nga jashtë me arsyetimin se industria vendase ka nevojë për lëndë të parë dytësorë, dhe se kapacitetet vendase nuk e bënin dot të mundur furnizimin e këtyre fabrikave ricikluese me mbetje dhe se ishin në prag falimentimi, ndërkohë nga një studim i BIRN rezultoi e kundërta²³⁷.

Çështja e impotit të mbetjeve gjatë 12 viteve të fundit në Shqipëri ka pasur një ndjeshmëri të lartë qytetare, prandaj është kontestuar në mënyrë të qëndrueshme nga qytetarët shqiptarë dhe AKIP (Aleanca Kundër Importit të Plehrave), pasi çdo qeveri ka tentuar të lidhë marrëveshje me palët për të importuar mbetje nga jashtë²³⁸.

drejtave dhe lirive themelore të individit, mbrojtjes së mjedisi, jetës dhe shëndetit, si dhe konformë parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

²³⁶ Ligji nr 10 463, datë 22/09/2011” Ligj për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”

²³⁷ <http://www.reporter.al/genjeshtra-e-qeverise-ndalimi-i-importit-te-mbetjeve-nuk-i-demtoi-ricikluesit/>

²³⁸ Ligji i parë për menaxhimin e mbetjeve në shqipëri në vitin 2011 lejonte në mënyrë të kufizuar importin e mbetjeve nga jashtë nga industria e riciklimit por ai percaktonte qart në listën e gjelbër se importi lejohet kur vërtetohet se nuk ka mbetje në vend, ndërkohë që kjo dispozitë me ndryshimet në vitin 2013 dhe vitin 2016 u hoq. Sipas studimeve dhe raporteve zyrtare të cilat nuk janë të qarta delë se në Shqipëri nuk riciklohen më shumë se në maksimum rreth 17% të mbetjeve në vend, pra rreth 83% e tyre gjenden kudo në hapësirën Shqiptare, tokë, ujë etj, për këtë arsye sipas OBSH, Shqipëria është një nga vendet më të ndotuara në rajon dhe botë. Qeveria shqiptare në Strategjinë Ndërsektoriale të Mjedisit 2015 – 2020 ka vendosur si prioritet ndarjen e mbetjeve në burim dhe mbledhjen e tyre. Ndryshimet në ligj bien ndesh jo vetëm me qëllimin e

Ky ligj shfuqizon pikën 3 të nenit 22 ku thuhet “Në pikën 3 të nenit 22, pas fjalës “ndalon”, shtohet togfjaleshi “...ose kufizon...” pra lejonë importimin e mbetjeve, nen të cilin po e njëjta qeveri në vitin 2013 e ndryshoi duke shfuqizuar fjalën “kufizon” dhe lënë vetëm fjalën “ndalon”, duke e arsyetuar në atë kohë së më këtë ndryshim i jepet fund çështjes së referendumit për plehërat, për të cilën ishin mbledhur rreth 65 mijë firma nga qytetarët. Ligji nuk kaloi, Kuvendi e votoi dekretin e Presidentit, i cili kundërshtonte thelbin e ligjit, atë të importit të mbetjeve. Në lidhje me dëmin në mjedis, importi i mbetjeve në parim bie ndesh me këtë fushë të parregulluar mirë nga pikëpamaja materiale dhe proceduraile, si dhe shmanget përgjegjësia mjedisore pasi ka shumë laguna ligjore.

strategjisë por edhe vet ligjit, ku qëllimi i tij për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut si dhe menaxhimin efikas të mbetjeve. Dispozitat, që lejojnë importin e mbetjeve me qëllim riciklimin e tyre në Shqipëri, bien në kundërshtim me direktivën e BE-së për zbatimin e “Parimit të vetëmjaftueshmërisë dhe afërsisë.” Sipas direktivës 2008/98/EC (neni 16), çdo vend duhet të synojë të menaxhojë mbetjet e veta dhe mbetjet duhet të trajtohen sa më afër burimit të prodhimit.

Gjithashtu, importi i mbetjeve bie ndesh me përparësi që duhet te ketë trajtimi i mbetjeve që prodhohen nga tregu shqiptar. Kjo do të thotë që me politika stimuluese fiskale, siç janë heqja e TVSH-së apo subvencionet, duhet stimuluar industria e riciklimit që të trajtojë mbetjet lokale. Lejimi i importit i bën të pamundura politika të tilla shtetërore, pasi nuk mund të subvencionohet trajtimi i mbetjeve që vijnë nga jashtë. Për më tepër, importimi i mbetjeve nga jashtë ulë interesin për trajtimin e mbetjeve që prodhohen brenda territorit tone dhe rrit ndotjen e mjedisit.

Me qëllim që ligji të realizojë plotësisht qëllimet, për të cilat është miratuar dhe zgjidhjet e ofruara për menaxhimin e mbetjeve në Republikën e Shqipërisë, si dhe të garantojnë sa më tepër rezultate pozitive. Ligji bie ndesh edhe me një sër dispozitash të tjera kushtetuese dhe konventave ndërkombëtare të cilat u reflektuan edhe në dekretin e Presidentit i cili e ktheu ligjin në Kuvend , për pasojë ai nuk mund të hyj në fuqi pa kaluar procedurat parlamentare ku duhen 71 vota për ta rrëzuar dekretin e tij, dekret i cili u parapri nga protesta të mëdha qytetare dhe nga një reagim qytetar – civil si dhe nga ekspertiza profesionale e ekspertëve të ligjit dhe mjedisit. AKIP ka pasur një rol të rëndësishëm në oponencën, transparencën, ekspertizën, organizimin e veprimtarive kundër importit të mbetjeve, duket se deri më tani ja ka arritur.

Nga legjislatori u tentua që ligji të kalojë pa transparencën dhe debatin e nevojshëm, madje vetë ndryshimet me nr 92/2016 , edhe për sa i përkasin teknikës legislative janë të paqarta, të pakuptueshme, dhe kontradiktorë, . Disa nga argumentet ligjorë pse AKIP është kundër importit të mbetjeve dhe ndryshimeve në “Ligjin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” . Ligji 92-2016 u rrëzua në 28 shtator të 2017 në Kuvendin e Shqipërisë duke u votuar dekreti i Presidentit i cili kundërshtonte argumentat e paraqitura për importin e mbetjeve nga BE.

KAPITULLI VI-VËSHTRIM KRAHASIMOR

6.1 Hyrje

Në këtë kapitull do të trajtohet një këndvështrim krahasimor se si normativat ndërkombëtare e kanë rregulluar përgjegjësinë juridiko-civile të dëmit në mjedis. Do të trajtohen raste nga Vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Kasacionit italiane për shkak të ngjashmërive të mëdha të dy sistemeve juridike. Vështrim mbi disa Kushteta për mënyrën se si trajtohet dëmi në mjedis dhe e drejta e mjedisit. Vështrim dhe një tablo e përgjithshme se si e drejta për të jetuar në një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm është e ngritur në nivel kushtetutes nga Kushtetuta Franceze, e cila është model unik në botë²³⁹ (Carta Dell’Ambiente) për mënyrën se si ajo e trajton këtë të drejtë në Kushtetutë, ku përgjegjësia juridiko-civile e zbërthyer dhe interpretuar me norma të tjera nën hierarrik e saj ka një bazë mjaft solide dhe të qëndrueshme.

Vend të veçant ka Kushtetuta e Kosovës për mënyrën origjinale se si ajo e trajton në Kushtetutë këtë të drejtë.

Vështrim mbi Kodin e Mjedisit Italian si pjesë e legjislacionit të posaçëm mjedisor, si një model që duhet ndjekur, dhe modelet e këtyre vendeve.

Raste nga vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me çështjet e dëmeve mjedisore si dhe ku e gjejmë të drejtën e mjedisit në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut.

²³⁹ Kushtetuta e Republikës Franceze, në fund ka një kapitull prej 10 pikash e cila trajton mjedisin dhe quhet Carta Dell’Ambiente.

6.2 Çfarë parashikojnë normativat e vendeve Europiane për mbrojtjen e mjedisit

6.2.1 Përgjegjësia Juridiko-Civile e dëmit në mjedis në BE, Itali

Përcaktimi në normativë për "dëmet në mjedisit" në sistemet e brendshme të Bashkimit Evropian është i ndryshem nga vendi në vend, si në formën ashtu edhe në efektet e konsideruara.

A) Disa juridiksione të fushës civile ende nuk i kanë të rregullar të plotësuara në mënyrë specifike çështjet që trajtojnë problemin e "dëmtimit të mjedisit në kuadrin e të drejtave civile private (Austria, Belgjika, Greqia), por ato i trajtojnë "brenda dispozitave të përgjithshme të Kodit Civil";

B) Juridiksionet e zakonshme të ligjit, edhe pse të janë të karakterizuara në fushën e dëmit në mjedis në vitet e fundit përsëri mbeten ende një disiplinë e gjerë.

Vende si Australi, Kanada, Angli, Uells dhe Zelanda e Re, kanë dispozita të cilat kanë të bëjnë me konfigurimin e dëmit dhe kompensimin e tij, ato mbeten të lidhura në lidhje me dhe me efektivitetin e mbrojtjes procesin (Modeli Common Law).

C) Në juridiksione të tjera (Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Suedi) u përfshinë rregulla të veçanta, qoftë si rezultat i reformimit të kodeve, apo si rezultat i rregullave të sektorit në çështjet e mjedisit. Në këtë rast rregullimi i përgjegjësisë juridike dhe dëmit në mjedis vjen nga ligji dhe nga rastet në praktikë, por pa harruar edhe

legjislacionit ndërkombëtar. Kontekstet e përcaktimit të dëmit në mjedis dhe përgjegjësisë juridiko-civile ndryshojnë edhe nga koha në kohë, ndaj nevojitet një qasje balancuese.

Përgjegjësia Juridiko-Civile në lidhje me dëmin në mjedis del edhe nga një tërësi rrethanash si interpretimet e gjykatave italiane se çfarë përbën dëm në mjedis dhe çfarë sistemi ligjor ka vendi, si dhe nga kontekstet civile, administrative dhe penale, kushtetuese, p.sh.: Gjykata e Kasacionit, në aktgjykimin e saj 10118/2008, sqaroi se "kompensimi për dëmit në mjedisduhet të përfshijë si dëmin personal që i shkaktohet pronës publike ose private, edhe ato që kanë tipare jo-monetare (jo-materiale). Rrjedhimisht, dënimi i personit përgjegjës për rivendosjen e gjendjes në vend ose pagesa e shumës së parave për kompensim, nuk përbën një dublim të mjetit juridik kur sjellja e parë ka për qëllim dhënien në shfrytëzim të pronës dhe pasurisë".

Kushtetuta Italiane (KI) nuk e ka të parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e mjedisit si normë më vete dhe nuk e përcakton si parim themelor, por ajo del nga interpretimi i artikujve (9, 32, 42, 44) të saj²⁴⁰. Mjedisi si koncept gjithëpërfshirës që mbron shëndetin jetën cilësinë e jetës, florën, faunën, apo integritetin e njeriut, del nga norma të tjera të përcaktuara në Kushtetutën Italiane. Ndryshimet e KI të vitit 2001 në pjesën e V neni 9 të saj përmendet për herë të parë termi mjedis, në kuadrin e ekspertizës së shtetit në lidhje me standartet e ekosistemit florës dhe faunës.

Mbrojta e mjedisit, si mbrojtje e shëndetit të individit dhe parimit për cilësinë e jetës, trashëgimisë kulturore, gjallesave etj., del se është një e drejtë themelore e njohur nga

²⁴⁰ Kushtetuta e Republikës Italiane, neni 9.32.42,44

Gjykata Kushtetuese Italiane (GJKI) dhe ajo e Kasacionit (Gjykatë e Lartë) nëpërmjet interpretimit të artikullit 9²⁴¹, 32, 42²⁴², 44²⁴³ etj. të Kushtetutës Italiane.

“Republika nxit zhvillimin e kulturës dhe kërkimit shkencor dhe teknik të cilat respektojnë integritetin dhe dinjitetin e njeriut dhe të gjitha qenieve të gjalla. Mbrojtja për trashëgiminë kulturore të vendit, mjedisin dhe të gjitha gjallesat” (shih. L’ambiente nella costituzione: quando in Italia come in Europa)²⁴⁴. Gjykata e Kasacionit shprehet se mbi këtë baz ëligjore interpretuese ajo mjafton, bashkarishtë me nenin 2043 të Kodit Civil, për të përcaktuar Përgjegjësin Juridiko Civile për dëmin mjedisor.

Gjykata Kushtetuese Italiane, vendim për mbrojtjen e mjedisit: ²⁴⁵

Mjedisi është një e mirë jo materiale e përbashkët, e përbërë nga komponentë të ndryshëm, ku secila prej tyre në mënyrë të izoluar ose veç e veç mund të përbëjë objekt mbrojtje²⁴⁶
“siç dihet tashmë, doktrina dhe jurisprudence kanë zhvilluar konceptin ligjor të mjedisit, duke filluar që nga artikulli 9 e deri te ai 32 i Kushtetutë, për ta parë atë si një koncept më

²⁴¹ Kushtetuta e Republikës Italiane art. 9, “La Repubblica promuove lo sviluppo della cultura e la ricerca scientifica e tecnica che rispettino l'integrità e la dignità dell'uomo e di tutti gli esseri viventi. tutela il patrimonio storico e artistico del paese, l'ambiente e le specie viventi”

²⁴² Prona është publike osë private. Të mirat ekonomike i përkasin shtetit, enteve, apo individëve. Prona private njihet dhe garantohet nga ligji, I cili përcakton mënyrat e flimit dhe gëzimit të saj në mënyrë të tillë që qëllimin i saj social që të jetë i aksesueshëm për të gjithë. Prona private, përkundrejt kompensimit të përcaktuar në ligj, mund të shpronësohet për Interes Publik (Interes të përgjithshëm, përkthimi fjal për fjal nga italishtja).Ligji përcakton kufijtë e ligjshmërisë mbi trashëgiminë dhe të drejtat e shtetit në çështjet e trashëgimisë.

²⁴³ Në mënyrë që të arrihet një përdorim racional i tokës dhe marrëdhënie e drejtë shoqërore ligji imponon detyrime mbi përdorimin e pronës private, fikson shtrirje dhe përcaktimet sipas krahinave dhe tokës bujqësore, promovon transformimin e pronave të mëdha dhe riorganizimin e njësisë së prodhimit të fermave, ndihmon pronën e vogël dhe të mesmë. Ligji parashikon lehtësira për zonat malore.Në interpretim të këtyre dispozitave Kushtetuese, jo vetem nga GJKI por edhe GJKsI, në mënyrë specifike në fushën e të drejtës së mjedisit krijohet baza kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të mejdisit duke i renditur ato si liri themelore edhe pse nuk janë parime apo norma specifike të drejtpërdrejta në Kushtetutë.

²⁴⁴ www.lexambiente.com

²⁴⁵ http://awsassets.wwf.it/panda.org/downloads/wwfdoc_richiostaambienteincostituzione_maggio2013.pdf

(Shih. La richiesta: inserire l’ambiente nella costituzione italiana).

²⁴⁶ Shih Corte Costituzionale che nella sentenza del 30 dicembre 1987 n. 641 ha definito l’ambiente

të gjerë dhe të unifikuar. Kjo përfshin të gjitha elementet e mjedisit natyror, përfshi ajrin, tokën, ujin, flora, fauna, në lidhje me pasojat e tyre në dëm të shëndetit, të zhvlerësimit të rigjenerimit të burimeve natyrore. Për të kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, thotë GJKI, mjafton të marrësh parasysh çfarë ka ndodhur njëzet vitet e fundit me zhvillimet ekonomike-politike-mjedisore në fushën e mjedist dhe për t'i dhënë asaj vlerën e një norme themelore, mjedisi është duhet mbrojtur si pjese përcaktuese e cilësisë së jetës²⁴⁷. Mbrojtja e tij nuk mund të ndjekë objektiva abstrakt natyroro-estetike, por shpreh nevojën për një habitat natyror ku njeriu jeton si qytetar dhe krijon akte komunitare për ta bërë atë vlerë primare absolute të qytetarisë së tij si Integritet Mjedisor”.

Kjo gjetje e Gjykatës Kushtetuese Italiane është përkrahur edhe nga Gjykata e Kasacionit²⁴⁸, e cila shprehet se: Mbrojtja ligjore e mjedisit e gjen burimin e vet gjenetik drejpërdrejtë në Kushtetutë dhe se prandaj mjedisi kuptohet në kuptimin e unitetit të së mirës publike²⁴⁹ jo materiale të saj edhe pse nuk e përjashton natyrën e dyfishtë të saj, materiale dhe jo materiale, të përcaktuara dhe provuar si asete të paprekshme në kufijtë e tyre.

Në një vendim tjetër të seksionit civil të GJKSI, ajo shprehet se mjedisi nuk mund të konceptohet si një material i vetëm, por ajo duhet të konsiderohet si një vlerë e tërthortë e mbrojtur me Kushtetutë, në funksion të të cilit shteti të mund të miratojë standarde uniforme në të gjithë vendin²⁵⁰. Mjedisi është një materie transversale, shprehet Gjykata

²⁴⁷ Gjykata Kushtetuese Italiane. 407/2002 dhe 536/2002.

²⁴⁸ Shih Vendimin e Gjykatës së Kasacionit, Cassazione III Sez. Civile n. 5650/1996, GJKSI ekuivalent i Gjykatës së Lartë Shqiptare.

²⁴⁹ www.giurcost.org Shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Italiane. nr. 67/1992.

²⁵⁰ Shih Vendimin e Gjykatës së Kasacionit, Seksioni III. N civile. 1087/1998.

Kushtetuese Italiane, prandaj edhe rajonet nuk mund të ushtrjnë veprimtari të tipit urban, industrial apo bujqësor në autonomi të plotë rajonale, ku territori si mjedis nuk kupton vetëm njësinë gjeografike të përcaktuar në Kushtetutë²⁵¹; pra, siç e shohim, dëmi në mjedis dhe përgjegjësia juridiko-civile ka lidhje të drejtpërdrejtë me këto përcaktime se çfarë e përbën një mjedis²⁵².

Si përfundim kjo nuk është e lehtë për t'u përcaktuar, kur mjedisi vendoset në kushte jo racionale, por ajo që shkon për t'u nënvizuar është fakti se politika mjedisore duhet të investojë një material që përputhet me vlerat dhe zhvillimin e shoqërisë²⁵³. Zhvillimet e legjislacionit konstitucionalist Italiane nuk erdhën në mënyrë të rastësishme: ato u diktuan nga kontekste të shumta ekonomiko-sociale në vend dhe si vazhdimësi e politikave për mbrojtjen e mjedisit duke filluar nga Konventa e Stokholimit e deri te politikat e Këshillit dhe Unionit Europian, si dhe direktiva 2004/35. Legjislacioni Italian, jo vetëm kushtetues por në tërësinë e tij, ka shumë ngjashmëri me legjislacionin tonë shqiptar, si për nga struktura ashtu edhe nga normativa. Përcaktimi i të drejtës së mjedisit si një e drejtë që ngrihet në nivelin kushtetues të lirive dhe të drejtave themelore të individit, do të pasohej nga shumë ligje dhe akte normative të legjislacionit Italian, ku më i rëndësishmi për t'u përmendur është Kodi i Mjedisit i miratuar në vitin 2006, i cili trajton në mënyrë të posaçme çështjet që lidhen me mjedisin apo dëmet që i shaktohen mjedisit²⁵⁴, duke e bërë Italinë ndër vendet që e kanë miratuar këtë Kod.

²⁵¹ Shih Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Italiane, Corte cost., sent. nr. 536 del 2002.

²⁵² <http://www.ambientediritto.it/home/dottrina/il-risarcimento-del-danno-ambientale>

²⁵³ Shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese Italiane 1986. nr 121 dhe me gjykimin e 30 dhjetor 1987 nr. 641.

²⁵⁴ Dekret legjislativ nr 152, dt, 03/04/2006.

Si konstatim mund të themi se edhe pse Kushtetuta Italiane (KI) nuk e ka të përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e mjedisit si një të drejtë themlore, në nenin 117 të KI²⁵⁵ ajo vjen indirekt duke interpretuar përmbajtjen e termit zhvillimin e qëndrueshëm (*ka tre elemente: ekonominë, zhvillimin, mjedisin*) ajo e ka përsosur këtë të drejtë me vendimet para dhe pas vendosjes së disa dispozitave në lidhje me mjedisin në KI, duke e bërë pjesë të sistemit konstitucional të saj bashkë edhe me interpretimet e GJKI, si dhe Vendimeve të Gjykatës së Kasionit Italiane (*Gjykata e Larte Shqiptare*).

“P.sh. në KC shqiptar mund të shtoheshin edhe disa dispozita të tjera që kanë lidhje indirekte me mjedisin, si rasti i Kodit Civil Italian në kapitullin për pasurin e paluajtshme, (pasi ai ka dhe Kodin e Mjedisit), për çështjet e bonifikimit apo krijimit të konsorciumeve të tokës²⁵⁶, për kushtet hidrologjike dhe për qëllime të tjera, rregullimi i mbrojtjes së rrjedhës ujore etj., do të ndikonin në mirëpërcaktimin e PJC të dëmit në mjedis. Shumë nga këto dispozita janë interpretuar nga gjykatat italiane (e Kasacionit, si dhe Gjykata Kushtetuese në kontekstin e mjedisit); në Shqipëri kjo lloj jurisprudencë është ende e panjohur, pasi ka nevojë edhe për praktikën e saj, edhe për faktin e kompleksitetit të dëmit në mjedis”.

Jurisprudenca italiane dhe vendimet e gjykatave të saj në lidhje me përcaktimin si një të drejtë themelore për të drejtën e mjedisit si një e drejtë kushtetuese, që del e kombinuar në mënyrë surrogative dhe Ad Hock nga brendia e artikujve 9,32,42,44..117 të Kushtetutës Italiane, do të përbënin një burim mjaft të mirë për legjislacioni tonë kushtetues, për PJC

²⁵⁵ www.Dirittoambiente.com Shih, Gargallo F, Lentini C, L'ambiente come diritto fondamentale dell'uomo

²⁵⁶ Kodi Civil Italian, Dudaj&Marlin Barleti Press. Fq 311/12/13.

dhe dëmin mjedisor, por edhe për praktikat e gjykatave tona, si ajo e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, pasi ngjashmëritë, siç e kemi theksuar, midis dy sistemeve të së drejtës janë mjaft të ngjashme për të pasur një efikasitet dhe efikasitet më të madhe në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të të drejtave të njeriut në fushën e mjedisit, gjithashtu edhe për të vazhduar traditën pozitive të vendimeve të tjera të gjykatave italiane që janë bërë pjesë e jurisprudencës shqiptare, por edhe për një përafrim, sa më të shpejtë të legjislacionit shqiptar me atë të Acquis Communautaire.

Kryesisht, Italia dhe Franca në Kodet Civile dhe K.Pr.C nuk ka një model fiks për përcaktimin e dëmit në mjedis, dhe dëmit në mjedis në të në të ardhme. Në këto vende përdoret teoria e ekuivalencës së kushteve (pa ngjarjen 'kushtin', dëmi nuk mund të vinte) dhe teoria e shkakut të drejtpërdrejtë të domosdoshëm për ngjarjen që ka prodhuar pasojën "dëmin", apo kombinim e të dyjave; pasi rastet janë të ndryshme në hapësirë dhe kohë.

Italia Përgjegjësisinë Juridiko-Civile për dëmit në mjedis, e nxjerr edhe nga interpretimet e gjykatave për raste të caktuara, çfarë përbën dëmi në mjedior dhe çfarë kuptojmë më dëm në mjedis.

6.2.2 Kushtetua Franceze (Carta Dell' Ambiente)

Kushtetuta Franceze²⁵⁷ (Carta Dell' Ambiente) ka bërë pjesë të saj "Kartën e Ambientit"²⁵⁸, një paketë në Kushtetutën Franceze e cila flet për të drejtat dhe liritë humane të njeriut dhe të drejtat që lidhen me të, si e drejta për një mjedis të shëndetshëm

²⁵⁷ Kushtetuta e Republikës Franceze

²⁵⁸ http://www.assemblee-nationale.fr/italiano/8db.asp#charte_env

dhe ekologjikisht të pastër. Kjo kartë proklamon vazhdimësinë dhe besnikërinë ndaj Kartës së të Drejtave të Njeriut të vitit 1789 në Francë.

Neni 1. Kushdo ka të drejtë të jetojë në një mjedis të balancuar për shëndetin e tij.

Neni 2. Secili ka për detyrë të marrin pjesë në ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit.

Neni 3. Gjithkush ka për detyrë, në kushtet e përcaktuara me ligj, për të parandaluar ose, në mungesë, për të kufizuar çdo dëm që ai mund të shkaktojë për mjedisin.

Neni 4. Çdo individ duhet të kontribuojë për të riparuar dëmin që ai ka shkaktuar në mjedis, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Neni 5. Në rast rreziku të dëmit ndaj mjedisit, për shkak të një studimi shkencore që mund të jetë i pasigurt, që dëmton mjedisin seriozisht dhe në mënyrë të pakthyeshme, autoritetet publike duhet, në bazë të parimit parandalues dhe në kontekstin e tyre, marrin masa për zbatimin e procedurave për vlerësimin e rrezikut dhe miratimin e masave të përkohshme dhe të veçanta, në mënyrë për të riparuar dëmin.

Neni 6. Politikat publike duhet të promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë qëllim, duhet pasur në konsideratë mbrojtja dhe përmirësimi mjedisit, zhvillimit ekonomik dhe përparimit shoqëror.

Neni 7. Secili ka të drejtë, sipas kushteve dhe brenda kufijve të përcaktuar me ligj, të drejtën e informimit për mjedisin nga autoritetet publike dhe për të marrë pjesë në zhvillimin e vendimeve publike që kanë ndikim në mjedis.

Siç vërejmë, Kushtetua Franceze e ka të pasqyruar në mënyrë më të zgjeruar të drejtën e mbrojtjes së mjedisit si bazë e fortë materiale për padinë mjedisore në raport me vendet e tjera të Unionit Europian. Kjo Kushtetutë është modeli më i qartë dhe më i saktë e i plotë në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në Europë madje edhe në nivel botëror.

Shumë vende që kanë dispozita direkte për mbrojtjen e mjedisit nuk i referohen parimit të zhvillimit të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave mjedisore, këto janë disa vende si Franca, Zvicera, Portugalia, Sllovakia, Çekia, Polonia, pasi për mbrojtjen e mjedisit është dispozitë Kushtetuese pa patur nevojë për interpretime të tërthorta.

Vendet që nuk kanë dispozita të drejtpërdrejta në Kushtetutë për mbrojtjen e mjedisit, i janë drejtuar për interpretim parimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, apo amendamenteve të tjera në mënyrë indirekte nëpërmjet vendimeve të gjykatave respektive, si mbrojtja e shëndetit, mbrojtja e peizazhit, apo vlerave të tokës bujqësore etj., për të nxjerrë përgjegjësitë ligjore mjedisore. Disa nga këto vende janë, Greqia, Holanda, Gjermania Finlanda, Spanja, Hungaria, Sllovenia, Malta, Letonia, Lituania, Estonia, Italia²⁵⁹.

6.3 “Kodi Mjedisor” si nevojë për rritjen e efikasitetit të përcaktimit të dëmit në mjedis

Zhvillimi i Qëndrueshëm kërkon me patjetër që ky koncept të materializohet në nivelin e ligjeve.

Kodi i munguar i mjedisit në Shqipëri do të ishte një zgjidhje mjaft efikase përse i përket problematikave që ka legjislacioni ynë, duke harmonizuar jo vetëm të drejtën e brendshme,

²⁵⁹ <http://www-3.unipv.it/ebdsps/docenti/cordini/cv/publicazioni.pdf> Shih Cordini G, Universiteti i Parias, principi costituzionali di tutela ambientale e sviluppo sostenibile, Il principio dello “Sviluppo sostenibile”

por edhe të këtë të drejtë me atë rajonale dhe ndërkombëtare në kushtet kur Shqipëria është edhe pritë të jetë pjesë e BE pas disa viteve. Principet si ndotësi paguan apo dëmi i shkaktuar në mjedis, si dhe parandalimi i dëmeve mjedisore, më shumë se disiplina të përgjithshme, do të përcaktoheshin si rregulla sektoriale në Kodin e Mjedisit si një nivel teknik më i lartë i mbrojtjes së tij, si problemet për menyrën e përdorimi të ujit²⁶⁰ (përdorim si pjesë e zhvillimit të qendrueshëm nga HEC-et), tokës, ndotjes në mjedis, nivelet e shkarkimit në mjedis, terminologjia, sanksionet etj.

Shqipëria ka një sërë detyrimesh edhe si anëtare e Konventës së të Drejtave të Njeriut. Këto detyrime vijnë edhe si pasojë e disa vendimeve të fundit të marra nga Gjykata e Strasburgut që prekin edhe fushën e mbrojtjes së mjedisit në kontekstin e mbrojtjes së jetës, shëndetit dhe cilësisë së jetës.

Ato janë gjithashtu të referuara shprehimisht si disiplina të cilat kërkojnë masa parandaluese për të parandaluar e për të zvogëluar rreziqet mjedisore dhe të kufizojnë dëmin në përputhje edhe me Direktivën e KE²⁶¹. Kodi i Mjedisit do të disiplinohet edhe nga pikëpamja e kompetencës lëndorë se cila gjykatë do të ishte përgjegjëse në shqyrtimin e çështjeve mjedisore.

Parimi parandalues është i sanksionuar në Konventën e Rios (1992); ai rrit rëndësinë për marrjen e masave ndaj rreziqeve hipotetike, apo si dëmi i shkaktuar në të ardhme në mjedis: Sipas këtij parimi, në prani të një rreziku të rëndë në mjedis, pasiguria shkencore nuk duhet të jetë një arsye e mjaftueshme për të mos ndërhyrje. Nevoja se rreziku është propozuar nga

²⁶⁰ Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Besnik Baraj, diskutim, Shkelzen Kerluku (përfaqësues i koncesionarit HEC- Lengarica) Datë 04.03.2014.

²⁶¹ Direktaiva 35 /2004 / EC për masat parandaluese në mjedis ndaj rreziqeve mjedisore.

hulumtime të kryera me metoda shkencore, shprehja e mendimeve të publikut, rëndësia e përfshirjes së palëve të interesuara në zgjedhjen masat e reduktimit të rrezikut; proporcionaliteti midis masave dhe rrezikut hipotetik, duhet të jenë argumentet kryesore për të ndërhyrë në rast të një dëmi hipotetik.²⁶²

Siç e shikojmë, Kodi i Mjedisit²⁶³ do ta lehtësonte mjaft përcaktimin e bazës ligjore materiale dhe procedurale për përcaktimin e PJC nga shkaktimi i dëm në mjedis.

P.sh. neni 3-bis i Kodit të Mbrojtjes së Mjedisit Italian shprehet se: parimet në këtë kod dhe parime të tjera konstitucionale janë në përputhje të plotë me parimet e Traktatit Europian²⁶⁴, neni 3-4 shprehet për parimin e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Çdo aktivitet njerëzor i ligjshëm dhe i rëndësishëm në përputhje me këtë kod, duhet t'i përmbahet Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe se nuk do të ketë kompromis për përmbushjen e nevojave të tashme duke dëmtuar cilësinë e jetës dhe brezat e ardhshëm. Atikulli 3-gjashtë parashikon të drejtën e infomimit, të pjesëmarrjes së publikut në çështjet e mjedisit sipas Konventës së Arhusit pa paraqitur arse (Kodi i Mjedisit Italian art 3 sexies).

Këshilli dhe Unioni Europian kanë mbajtur qëndrime edhe më të përcaktuara në lidhje me të drejtën e mjedisit si të drejtë themelore. Psh. artikulli 8 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut që flet për të drejtën e gëzimit dhe respektimit të jetës private dhe familjare në interpretim të GJEDNJ, shikohet si e drejtë themelore edhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm, brenda kuptimit të nenit 8 të saj, duke përfshirë edhe mbrojtjen e

²⁶² http://www.lex.unict.it/didattica/materiale09/dirprivatoambiente/lezioni/principi_generali.pdf Shih Salanitro U, I principi generali nel Codice dell'ambiente.

²⁶³ Modeli Italian i Kodit të Mjedisit, Decreto legislativo, 03/04/2006 n° 152, G.U. 14/04/2006, i riformular në 28 dhjetor të 2015.

²⁶⁴ <http://www.altalex.com/documents/codici-altalex/2011/02/14/codice-dell-ambiente#parte1>

familjes kundër faktorëve të ndotjes dhe degradimit kimik, nuhatjes, marrjes frymë, tingujve etj., të cilët ndikojnë në gëzimin e një jete familjare të qetë dhe të shëndetshme. Edhe pse KEDNJ nuk e ka të përcaktuar si amendament më vete të drejtën për një mjedis të pastër e të shëndetshëm, ajo e ka ngritur në këtë nivel nëpërmjet vendimeve interpretuese të Gjykatës së Strasburgut, ku si referencë kryesore dhe ndihmëse e saj është Konventa e Aarhusit si aspekt procedural për çështjet në shqyrtim në fushën e dëm në mjedis.

Dëmi në mjedis është një përlllogaritje komplekse dhe tepër e vështirë, duke filluar që nga dëmi pasuror që përbëhet nga humbja e pësuar dhe fitimi i munguar, dhe duke kaluar të dëmi jopasuror (nenit 625 të Kodit Civil). Miratimi i Kodit Mjedisor do të ishte një hap i madh në disiplinim më të mirë të figurës së përgjegjësisë juridiko-civile për dëmin e shkaktuar në mjedis.

6.4. Raste nga jurisprudenca ndërkombëtare të dëmit në mjedis

6.4.1 Rasti Powell dhe Rayner kundër Mbretërisë së Bashkuar. (Dëmi në mjedis nga zhurmat)

Ankuesit²⁶⁵ pretenduan se ishin viktimat, për shkak të zhurmës së tepruar të shkaktuar nga avioni në aeroportin Heathrow²⁶⁶, një shkelje e pajustificuar e të drejtave të tyre të garantuara nga neni 8 i Konventës KEDNJ. Ata e konsideronin të papranueshëm nivelin e zhurmës së autorizuar nga rregulloret e trafikut ajror, dhe masave qeveritare jo efektive që synojnë reduktimin e ekspozimit ndaj zhurmës së shkaktuar nga avionët. Në vendimin e saj

²⁶⁵ European court of human rights case of Hatton and others v. the United Kingdom, Application no. 36022/97 judgment Strasbourg 8 July 2003

gjkata konstatoi se ekzistenca e aeroporteve të mëdha ndërkombëtare, madje edhe në zonat e mëdha urbane me dendësi të lartë të popullsisë, dhe në rritje përdorimi i avionëve reaktiv, tani ishin të nevojshme për mirëqenien ekonomike të një vendi. Ai vuri në dukje se aeroporti Heathrow, ndër më të ngarkuar në botë, duke zënë një pozicion kyç në tregti dhe marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në ekonominë e Britanisë, dhe shfrytëzimi i tij ndoqi një qëllim legjitim që nuk do të ndikojë negativisht në mjedis.

Gjkata ka shqyrtuar masat e marra nga autoritetet britanike për të kontrolluar zhurmën e avionëve në aeroportin Heathrow dhe vuri në dukje se këto masa i kishin dhënë standarde ndërkombëtare, evolucionin teknik në fushën e aviacionit dhe nivelet e ndryshme të zhurmës të vuajtura më parë nga banorët vendas janë brenda parametrave. Prandaj u arrit në përfundimin se qeveria britanike nuk e kishte tejkaluar marzhin e tyre të vlerësimit apo të shqetësimit, e drejtë kjo e siguruar në pajtim me nenin 8 të Konventës, e cila garanton të drejtën për jetën private dhe të qetë. Më vonë në vitin 1993 në rastin Hatton kundër Britanisë GJEDNJ vlerësoi shkaktim dëmi mjedisor lidhur me veprimtarinë dhe zbatimin e protokolleve qeveritare lidhur me zhurmat dhe ndotjen në aeroportin Heathrow të Londrës. Në këtë rast ankuesit pretenduan se politika e zbatuar nga qeveria në vitin 1993 në temën e fluturimeve natën në Heathrow do të rezultojë në shkeljen e të drejtave të tyre sipas nenit 8 të Konventës.

Gjkata vendos në favor të Hatton, duke u shprehur se është shkaktuar dëm mjedisor, përveç dëmit të shkaktuar gjykata urdhëron shtetin të mara masa për parandalimin dhe eliminimin e këtyre zhurmave natën që bien ndësh me parimin numër tetë të KEDNJ për

gëzimin e një jetë të qetë dhe familjare. Shteti u gjet përgjegjës për shkaktim dëmi mjedisor nga personit.

6.4.2 Rasti Lopez Ostra kundër Spanjës. (Mungesa e infomimit, dhe pjesmarrja në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka shkaktuar dëm në mjedis)

Rasti ka të bëjë kur zonjën Lopez Ostra²⁶⁷, e cila ka banesën afër një fabrike përpunimi lëkurësh dhe mbetjesh të tjera. Ndërkohë, nga aktiviteti i këtyrë fabrikave vinte ere e padurueshme, tym, zhurma dhe ajër i ndotur; të gjithë këta faktorë marrë së bashku ndikuan në jetën dhe shëndetin e znj. Lopez Ostra dhe familjes së saj. Ajo u kërkon autoriteteve të zonës të marrin masat e duhura. Autoritet lokale përcaktojnë disa masa për eliminimin e këtyre faktorëve dëmtues të shëndetit që ishin pjesë e mjedisit, por përsëri këta ishin shqetësues. Ajo i drejtohet përsëri autoriteteve lokale; autoriteti komunal i përgjigjet se veprimtaria ishte brenda parametrave ligjorë të përcaktuar. Edhe pse këta faktorë ishin brenda parametrave ligjore, ajo e vazhdon betejën e saj ligjore deri në GJEDNJ pasi pretendonte se kishin ndikuar në jetën dhe shëndetin e saj.

Viti 1994, me rastin Lopez Ostra kundër Spanjës në lidhje me emetimet në ajër të faktorëve ndotës nga një stacion i pastrimit të ujit dhe trajtimit të mbetjeve të një fabrikë lëkurësh, është rasti për të shënuar pasi pati një ndryshim të rrënjësor në praktikën gjyqësore dhe të jurisprudences ndërkombëtarë, me vendimin e saj se "kërcënimet ndaj ndotjes së rëndë mjedisore mund të ndikojnë në mirëqenien e një personi dhe të parandalojë ata nga gëzimi një jetë të shëndetshme dhe private të qetë në shtëpinë e tij", ajo të drejtën e mjedisit e bën pjesë integrale të të drejtave themelore të individit.

²⁶⁷ <http://pshpartners.al/pdf/materiale> shih Francois J, Kombe A, fq. 50-51.

Gjykata pranoi se e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, përfshi të drejtën për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm, përbën shkelje të nenit tetë të KEDNJ. Duhet thënë se, në kundërshtim me këtë rast, në të cilën Powell dhe Rayner kishin mirëqenie, në rastin Lopez Ostra u kërcënua e drejta e shëndetit. Kështu, gjykata zgjeroi shkallën e dëmit si një përkufizim më i gjerë shëndetësor që përfshin mirëqenien e popullsisë; kjo është disi një shkallë ideale për mbrojtjen e shëndetit, këtu shfaqen format e padisë kolektive (Class Actione-Actio Popularis).

Shteti u gjet me faj sipas gjykatës, si dhe u shpreh se kur shtetet dështojnë të sigurojnë një ekuilibër të drejtë midis interesave të mirëqenies ekonomike dhe gëzimin efektiv të së drejtës për të respektuar shtëpinë e tij dhe jetën e tij private dhe familjare, ata mbajnë përgjegjësi edhe pse parametrat e mësipërme janë brenda ligjit, kjo nuk nënkupton se nuk çënohet neni tetë i KEDNJ për gëzimin e një jete familjare dhe private dhe të shëndetshme.

Shteti merr masa pro-aktive për të mbrojtur dhe garantuar gëzimin efektiv të së drejtës për të respektuar jetën e tij private dhe familjare.

6.4.3 Në rastin Roche kundër Britanisë. (Mungesa e infomimit, dhe pjesëmarrja në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka shkaktuar dëm në mjedis)

Një ish-ushtar në Britani²⁶⁸ kuptoi se ai vuante nga hipertensioni, dhe nga një sëmundje kronike e ngushtimit të kanaleve të frymëmarrjes (bronchit) dhe astma bronkiale si rezultat

²⁶⁸ <https://www.timeshighereducation.com/news/echr-judgment-in-roche-v-uk-only-violation-of-article-8-in-former-servicemans-inability-to-sue-for-for-ill-health-he-believed-to-have-been-caused-by-porton-down-research-facility/199284.article> Shih. European Court of Human Rights application no. 32555/96.

i pjesëmarrjes së tij në testimet e gazrave nervore kimike, të kryera nën patronazhin e forcave të armatosura britanike. Ai kishte aplikuar për pension invalidor tek këshilli i apeleve për pension, i cili kishte vërtetuar se nuk kishte pasur prova të besueshme për të sugjeruar lidhjen shkakësore mes testeve dhe kushteve mjekësore të pretenduara nga paditësi, meqënëse të gjitha mjetet “mjekësore” dhe “politike” të aktivizuara nga paditësi kishin rezultuar me zbulim të pjesshëm faktesh.

Mungesa e informacioneve, gjithashtu ishte për shkak të faktit se studimet e plota epidemiologjike rreth incidentit, kishin filluar pothuajse 10 vite pasi paditësi kishte filluar kërkimin e tij për të dhënat dhe pasi ai e kishte paraqitur padinë e tij në gjykatë. Gjykata vërejti se pasiguria e paditësit rreth asaj nëse ai ishte ekspozuar në rrezik përmes pjesëmarrjes së tij në teste kimike në mënyrë të arsyeshme mund të pranohet si diçka që i ka shkaktuar ankth dhe stres të konsiderueshëm. Mungesa e ndonjë detyrimi për të dhënë informata dhe për t'i informuar individët relevantë, rrethana se dhënia e informatave kishte qenë e pjesshme dhe pothuajse katër vite më vonë, mbeti e papërfunduar, së bashku me rrethanat e tjera të ilustruara më lartë, të gjitha e kishin shtyrë gjykatën që të vërtetojë se ishte shkelur neni 8 i KEDNJ për shkak se Mbretëria e Bashkuar nuk e kishte përmbushur detyrimin pozitiv për caktimin e një procedure efektive dhe të aksesueshme që do t'ia kishte mundësuar paditësit qasjen në të gjitha informatat e rëndësishme dhe të duhura, të cilat do t'ia kishin mundësuar atij dhe këshillit të pensionit vlerësimin e rreziqeve ndaj të cilave ai ishte ekspozuar gjatë pjesëmarrjes së tij në test. Gjykata e gjenë në shkelje shtetin për mosinformim dhe pjesëmarrje në çështjet e mjedisit, fakt i cili bie në fushëveprimin e nenit

8 të KEDNJ, si dhe detyrimin për të dëmshpërblyer dëmin shëndetësor që ka ardhur nga ndtoja mjedisore.

6.4.4 Rasti Oneryldyz kundër Turqisë. (Mungesa e Infomimit për Mjedisin ka shkaktuar dëm në mjedis, duke cënuar jetën dhe shëndetin e personave si dhe të drejtën për të gëzuar një jetë familjare dhe të qetë)

E drejta ndërdimensionale për të kërkuar dhe marrë informacion mjedisore mbi rreziqet që kanë të bëjnë me vendbanimin, gjithashtu ishte objekt i rastit nën fushën e së drejtës për jetën, ku në një vend të grumbullimit të plehrave në Turqi, nga shpërthimi i gazit metan, humbën jetën 9 persona, si dhe u plagosën shumë të tjerë²⁶⁹. GJEDNJ e gjeti shtetin Turk në shkelje të nenit 2 dhe 8²⁷⁰ të KEDNJ për të drejtën e jetës pasi, nuk kishte infomuar (komunitetin rom) për çështjet e mjedisit dhe dëmet e tjera, si dhe nuk kishte marrë masa për eliminimin e këtyre dëmeve në mjedis. Gjykata u shpreh se e drejta e jetës përfshinë edhe të drejtën për një mjedis të shëndetshëm, e cila garanton dhe siguron jo vetëm për jetën, por edhe për cilësinë e saj.

Ajo shprehet se shteti Turk duhet të marrë masa parandaluese (detyrim pozitivë i shtetit) duke përcaktuar instrumentat efikas për informimin e publikut të prekur direkt dhe indirekt, siç ishte rasti romëve të dëmtuar nga shpërthimi i gazit metan në vendgrumbullimin e mbeturinave, si dhe dëmshpërblimin përkatës për sigurimin e jetës dhe shëndetit të banorëve.

²⁶⁹ Oeryildiz v Turkey (application no. 48939/99) 30 November 2004.

²⁷⁰ E drejta e gëzimit efektive e jetës private dhe familjare neni 8 i KEDNJ.

6.4.5. Rasti Fadeyeva kundër Ruisë. (Mungesa e informimit dhe pjesmarrja në Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis ka dëmtuar shëndetin e personave)

Sipas nenit tetë KEDNJ, shtetet e kanë për detyrë që jo vetëm të ofrojnë mbrojtje pro-aktive të të drejtave të personave, por edhe të sigurojnë që gëzimi i së drejtës të mos pengohet nga veprimet apo aktivitetet e palëve të treta. Shumica e rasteve nga neni 8, të shqyrtuara nga gjykata në lidhje me këtë, kanë të bëjnë me aktivitetet që pretendohen të jenë të dëmshme të zonave industriale dhe të emetimeve pasuese, qofshin ato vullnetare apo aksidentale, të substancave të rrezikshme në mjedisin përreth dhe çenojnë të drejtën për një jetë private dhe familjare sipas nenit tetë të KEDNJ. (Qeveria nuk ka bërë informimin e duhur të pasojave dhe projektit dhe nuk ka marë masat Rasti Eco-Trans kundër Moldsvila²⁷¹, e ngjashme me Fadeyeva)²⁷².

Në rastin Fadeyeva²⁷³, paditësja e cila jetonte në një banesë, të vendosur brenda një zone sigurie sanitare rreth një impianti të çelikut, ishte ankuar se operimi i industrisë në afërsi të shtëpisë së saj ia kishte rrezikuar jetën dhe shëndetin dhe se mos zhvendosja e saj ishte shkelje e obligimeve pozitive që parashihen me nenin tetë. Gjykata, duke u bazuar në paraqitjet e autoriteteve, vërejtë se përqendrimi i disa substancave të caktuara të rrezikshme në atmosferë brenda zonës e tejkalonte në masë të madhe “kufirin maksimal të lejuar” të përcaktuar nga legjislacioni i Ruisë. I vetmi rezultat i padisë gjyqësore të ngritur nga

²⁷¹ <http://business-humanrights.org/en/fadeyeva-v-russia-re-severstal-smelter>

²⁷² http://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/a.to.i/Jurisprudence_prj/REPUBLIC_OF_MOLDOVA/Summary_RepublicMoldova_2008_Moldsilva.pdf

²⁷³ <http://ëëë.ehrac.org.uk/resources/fadeyeva-v-russia/> shih Fadeyeva v Russia Case Summary Case No. 55723/00

paditësja për të kërkuar zhvendosje jashtë zonës ishte vendosja e paditëses në “një listë pritëse të përgjithshme”, në vend të vendosjes në një “listë pritëse prioritare” që ishte identifikuar nga gjykata si e drejtë e paditëses.

Gjyqëtarët në Strasburg arritën në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit tetë të Konventës përse i përket dështimit të shtetit për të gjetur një barazpeshë të drejtë mes interesave të komunitetit dhe gëzimit efektiv të drejtës së paditëses për jetën private dhe familjare të saj. Ndonëse shteti nuk e kontrollonte e as operonte impiantin e çelikut, gjykata vërejti se përgjegjësia e shteteve në rastet mjedisore mund të ngrihet si rezultat i mosrregullimit të industrisë private. Nëse aktiviteti ndotës i shkel ligjet aktuale të vendit, interesi i shtetit apo interesi i përgjithshëm ekonomik gjatë operimit bëhet i vështirë për t'u vërtetuar. Vonesat në kryerjen e vlerësimit të ndikimit mjedisor mund të përfshijë përgjegjësi shtetërore. Gjykata, megjithatë, nuk është e gatshme që të pranojë se mungesa e sigurisë së komunitetit shkencor dhe teknik lidhur me disa operacione të caktuara të përdoret si arsye për të shtyrë miratimin e masave efektive dhe proporcionale me qëllim të parandalimit të rrezikut të dëmeve të rënda dhe të pariparueshme të mjedisit.

Në këtë aspekt, gjyqëtarët në Strasburg e bënë të qartë se duhet të mbizotërojë parimi i parandalimit, qëllimi i së cilit është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe mjedisit të klientëve (Roagna I, 2012: 66-67). Shteti Rus u gjet përgjegjës dhe në shkelje të nenit tetë të KEDNJ për mos sigurimin e një jete familjare private si pasojë e një mjedisi të ndotur nga aktiviteti i operatorit privat afër banesës së paditësit që i ka shkaktuar dëm.

KAPITULLI VII-KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në këtë kapitull do të trajtohen konkluzionet dhe rekomandimet e dalta nga ky punim doktoral. Ky kapitull përfshin konkluzione dhe rekomandime në lidhje me të dëmin në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile, apo të fushave të ndryshme të së drejtës të cilat kanë lidhje me të, si ajo civile, kushtetuese, administrative, teorike, empirike që kanë lidhje me fushën e dëmit në mjedis dhe mjedisin. Këto konkluzione dhe rekomandime janë të analizuara në harmoi me të drejtën komunitare dhe ndërkombëtare lidhur me dëmin e shkaktuar në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.

Konkluzione:

1. Kushtetuta

Kushtetuta jonë e ka paraparë të drejtën e mjedisit si synim i objektivave sociale: “për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm” **si synim të objektivave sociale dhe përgjegjësi të shtetit, brenda kompetencave të tij.** Neni 59, pika 2 e Kushtetutës shprehet: (Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kreu V neni 59, pika 2):

“Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejtë në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave”.

Paragrafi i mësipërm krijon një barrierë burokratike në efikasitetin e ngritjes së padisë për çështjet e mjedisit, duke e klasifikuar si objektiv social, madje subjektet private dhe publike

nuk mund të legjitimohen për ngritjen e padisë për dëmin mjedisore si pjesë e objektivave sociale.

Shfuqizimi i pikës dy në nenin 59 të Kushtetutës (*“Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë. Ligji përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i këtyre objektivave”*) do të mundësonte ngritjen në nivel kushtetues të së drejtës për të patur një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të pastër për brezat e tashëm dhe të ardhshëm, për rrjedhojë edhe figura e PJC e dëmit në mjedis do të kishte një bazë të mirë në nivel Kushtetues, nga ku do të harmonizoheshin edhe normat e tjera sipas hierarkisë.

2 – Përcaktimi i një dispozite tjetër në pamundësi për të shfuqizuar pikën dy të nenit 59, do të ishte një zgjidhje tjetër për efikasitetin e aksesit në drejtësi për çështjet mjedisore në nivel Kushtetues.

Pasurimi sa më shumë i praktikave dhe interpretimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë etj., për çështje që kanë të bëjnë me dëmin në mjedis.

2. Kodi Civil

Ndryshimet në Kodin Civil do të përbënin një hap të rëndësishëm në përcaktimin e qartë të dëmit në mjedis dhe përgjegjësisë ndaj mjedisit, dispozita të cilat do të nënkuptonin, përcaktonin, përafrojnë edhe më mirë konceptet dhe terminologjitë në lidhje me dëmin në mjedis në të ardhmen.

3. Kodi i Procedurës Civile

Në Kodi i Procedurës Civile, në nenin 32, nevojitet një përmbajtje më efikase edhe nga pikëpamja terminologjike për padin mjedisore në kuadrin e legjitimitit të palëve dhe *ratio materia*: Padia mund të ngrihet në mbrotje të interesave të prekura ose që mund të preken nga shkaktimi ose mundësia për t'u shkaktuar dëm në të drejtat e përbashkëta, si p.sh. shëndeti publik; mjedisi, arsimimi, cilësia e jetës, trashëgimia kulturore. Shoqatat me objekt mjedisin kanë të drejtë të legjitimohen për çështjet mjedisore. Kjo dispozitë do të ndikonte jo vetëm si pjesë e aspektit procesual të padisë për dëmin në mjedis, por në tërësinë e saj për aksesin të drejtësi të padisë mjedisore.

4. Kodi i Mjedisit

Kodi i Mjedisit propozohet si një zgjidhje e domosdoshme për të drejtën shqiptare për disa arsye:

- a) për të përcaktuar më mirë dëmin në mjedis;
- b) për të qartësuar kriteret mbi legjitimitimin aktiv dhe pasiv lidhur me ngritjen e Padisë Mjedisore;
- c) me qëllim unifikimin e kuadrit normativ shqiptar në përputhje me aktet ndërkombëtare.

5. Ligji nr. 49/2012, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative"

Ky ligj në legjitimitimin e palëve për çështjet mjedisore nuk garanton efikasitetin e duhur, ndaj duhet ndryshuar; rasti i tre padive të rrëzuara nga gjykata e shakllës së parë Tiranë me disa arsyetime tregon se ai ka nevojë t'i nënshtrohet ndryshimeve duke u përshtatur dhe

harmonizuar më mirë me aktet e brendshme por edhe ndërkombëtare në veçanti në konventën e Aarhusit për të përcaktuar më mirë përgjegjësinë ndaj mjedisit dhe palëve në proces.

5. BE/Integrimi

Shqipëria duhet të transpozojë dhe implementojë me efikasitet legjislacionin e BE-së për të drejtën e mjedisit, përgjegjësinë civile ndaj mjedisit, me qëllim harmonizimin e të drejtës shqiptare me atë të BE-së në kuadër të rekomandimeve që lidhen me procesin e integrimit të saj në BE. Kjo do të ndikonte drejtpërsëdrejti si në zgjidhjen e problemeve që lidhen me dëmin në mjedis dhe PJC, po ashtu edhe me mbrotjen e mjedisit si pjesë e Komunitetit fizik European dhe global.

6. Ankimimi efektiv në Komitetin e përputhshmërisë së Aarhusit dhe GJEDNJ

Edhe pse vendimet e komisionit të Konventës së Aarhusit janë këshilluese dhe sugjeruese, ato kanë treguar se janë efektive në marrjen e masave parandaluese apo ndaluese për dëmin mjedisor, në funksion të mbrojtjes së mjedisit lirive dhe të drejtave që lidhen me to. Vendimmarrjet e GJEDNJ në Strasburg kanë treguar se ka një rritje të nivelit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave që lidhen me mjedisin, si e drejta e jetës, e shëndetit dhe për të pasur një jetë të qetë dhe familjare si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile nga shkaktimi i dëmit në mjedis.

7. Legjislacioni Shqiptar, kuadër dhe sektorial mjedisor për kritere dhe standarde të cilat përcaktojnë dëmin në mjedis

Zgjerimi dhe mirëpërcaktimi i listës së aktiviteteve të cilat duhet të jenë subjekt i ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis që gjendet në aneksin e ligjit, si dhe mirëpërcaktimi i procedurave të informimit, pjesëmarrjes dhe vendimmarrjes së publikut për çështjet mjedisore, pasi ka shumë hapësira dhe nuk shprehet qartë. Në ligjin për Mbrotjen e Mjedisit ka nevojë për ndërhyrje, specifike dhe konceptuale, si dhe duhet përshatur më mirë më të drejtën komunitare dhe ndërkombëtare, e njëjtja frymë duhet të mbizotërojë edhe në ndryshimet e tjera të ligjeve kuadër dhe sektoral apo që kanë lidhje me dëmin në mjedis, i cili do të mirëpërcaktonte përgjegjësinë juridiko-civile të palëve dhe do ta bënte procesin më efikas.

8. Arsimi fillor

Edukimi i mjedisor i brezave ka nevojë për një vendimmarje politike dhe shtetërore në nivel strategjie dhe plani kombëtar për këtë fushë. Sa më i madh të jetë edukimi në fushën e mjedisit, aq më e mirë dhe e shëndetëshme është prespektiva e kësaj fushe me të gjithë elementet e saj.

9. Komiteti i Përputhshmërisë Aarhus

Rekomandimet e Komitetit të Përputhshmërisë Aarhus duhet jo vetëm të bëhen pjesë e normativës së brendshme, por edhe të zbatohen në planin praktik për të rritur efiaksitetin e aksesit në drejtësi për 135ështjet mjedisore dhe në mbrotje të mjedisit, por edhe harmonizimit të së drejtës së brendshme me atë komunitare dhe ndërkombëtare.

Rekomandime:

1. Kushtetuta

Rasti mund të ishte: *(Kushtetuta Franceze Carte dell Ambient)*

“Kushdo ka të drejtën e mbrojtjes së shëndetit dhe cilësisë së jetës”

“Kushdo ka të drejtë për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm”

“Kushdo ka të drejtë të jetojë në një mjedis të balancuar për shëndetin e tij” (Kushtetuta Franceze Carte dell Ambient).

Rasti mund të ishte: *(Kushtetuta e Republikës së Kosovës)*

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila e ka parashikur si pjesë në Kapitullin II të të drejtave dhe lirive themelore të saj të drejtën për një mjedis jetësor.

Neni 52. Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor

Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.

Në Kushtetutën Shqiptare duhet një dispozitë Kushtetuese e cila të legjitimojë në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin e Konventës së Aarhusit dhe të konventave mjedisore, apo që kanë lidhje me të në kuadrin e mbrojtjes së mjedisit dhe të drejtave dhe lirive të njeriut që burojnë nga ajo.

Këto norma Kushtetuese do të ndikojnë në jurisprudencën shqiptare, duke qenë një bazë e mirë ligjore edhe për interpretimet e ndryshme nga Gjykata Kushtetuese, si dhe vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe doktrinës në tërësi, për të patur efikasitet të aksesit për padinë mjedisore, si dhe ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit, përmirëson legjislacionin duke e harmonizuar dhe integruar më shpejtë me legjislacionin komunitar dhe ndërkombëtar.

Ky model jo vetëm do të afirmonte mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet të drejtave dhe lirive të njeriut në nivele Kushtetuese si pjesë e demokracisë mjedisore e cila dikton dhe promovon vendimmarrjen e publikut në mënyrë të drejtpërdrejtë për veprimtarit mjedisore, por ajo do të ishte një instrument i zbatimit të drejtpërdrejtë të konventave dhe akteve ndërkombëtare, si dhe rrit efikasitetin e mbrojtjes së mjedisit dhe aksesit në drejtësi (për ngritjen e padisë për çështjet mjedisore) edhe në kuadrin e parimit Kushtetutes të nenit 42 ‘për një proces të rregullt dhe ligjor’.

2. Kodi Civil

Në Kodin Civil, neni 624, duhet të hiqet pjesa ku thuhet “ka cënuar”, pasi nënkupton një dëm të shkaktuar, pasojat e të cilit kanë ardhur dhe kanë cënuar palën. Neni 624 duhet të

jetë: “Personi që me faj ose përgjegjësi ‘cënon’ mjedisin, duke e keqësuar atë, ndryshuar ose dëmtuar atë, tërësisht ose pjesërisht, detyrohet të shpërblejë dëmin e shkaktuar”.

Ky nen, përveç përcaktimeve të tjera të dëmit, nuk e pengon legjitimitimin për çështjet mjedisore të palëve pasi hiqet fjala “ka” (ka cënuar), dhe zëvendësohet me fjalën “cënon”, që nënkupton edhe dëmet mjedisore në të ardhmen përveç dëmit të shkaktuar, si dhe ndihmon në efikasitetin e figurës së PJC të dëmit në mjedis.

1.Në nenin 624 të KC të shtohet edhe një paragraf, i cili të përcaktojë se çdo person që vërtetohet se do të shkaktojë një dëm në mjedis në të ardhmen, ka përgjegjësi juridike.

2.Personi që shkakton një dëm në mjedis, edhe dëm mjedisor në të ardhmen, ka përgjegjësi. (këtu kemi përgjegjësi pa faj).

Në kapitullin për pasuritë e paluajtshme të rirregullohen dispozitat në përputhje me Kodit Civil Italian kapitullin II (Pasuria), të cilat kanë lidhje me mjedisin dhe janë interpretuar nga gjykatat dhe jurisprudenca italiane. Çështje si Kushtet hidrologjike dhe për qëllime të tjera, apo rregullimi i mbrojtjes së rrjedhave ujore, apo sendet me rëndësi kulturore dhe historike, duhet të harmonizohen edhe me KC shqiptare.

Doktrina shqiptare duhet të zhvillojë më mirë teorinë e shkakut objektiv të dëmit në mjedis, fazë e cila do t’i hapte rrugën edhe teorisë së shkaqeve jo të drejtpërdrejta apo teorisë së përzierjes së të dy modeleve të mësipërme për ta bërë me efikase përcaktimin e dëmit në mjedis si pjesë e përgjegjësisë juridiko-civile.

3. Kodi i Procedurës Civile

Në Kodi i Procedurës Civile, në nenin 32, të shtohet edhe pika “c” me këtë përmbajtje: Padia mund të ngrihet në mbrojtje të interesave të prekura ose që mund të preken nga shkaktimi ose mundësia për t’u shkaktuar dëm në të drejtat e përbashkëta, si p.sh. shëndeti publik; mjedisi, arsimimi, cilësia e jetës, trashëgimia kulturore. Shoqatat me objekt mjedisin kanë të drejtë të legjitimohen për çështjet mjedisore .

4. Kodi i Mjedisit

Modeli Italian i Kodit të Mjedisit do të ishte rruga e duhur për t’u adoptuar dhe integruar në legjislacionin tonë, pasi dy sistemet juridike kanë ngjashmëri të mëdha për të përcaktuar më mirë dëmin në mjedis.

- Kodit të Mjedisit francez gjithashtu do të ishte një model për t’u marë dhe përshtatur me legjislacionin dhe të drejtën shqiptare.

5. Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”

Neni 15 d)

Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: Çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cënuar një interes i ligjshëm publik:

Nga një akt administrativ (të shtohet: **edhe individual**), në rast se një e drejtë e tillë u njohet me ligj; (ose të vendoset si përcaktim i posaçëm në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit), si dhe të

vendosen kritere më të qarta për legjitimimin e shoqatave dhe grupeve të interesit në këtë ligj.

6. BE/Integrimi

Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Burimeve Natyrore, studim të saktë mbi nivelin e mbetjeve në vend dhe sasinë e riciklimit të tyre, si dhe aspektet e kapaciteteve menaxhuese të tyre sipas BE, si dhe zbatimi i VKM nr. 418, 2014.

Ndalimin e importit të mbetjeve pasi nuk plotëson standardet e KE/BE.

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me Direktivën Europiane 2008/99/EC për mbetjet dhe “Për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet legjislacionit penal”, që parashikon një listë shkeljesh mjedisore që duhen trajtuar nga shtetet anëtare si krime mjedisore dhe të dënohen si vepra penale, të cilat do të përcaktojnë edhe fajësinë ndaj subjektit mbi të cilin do të përcaktohet përgjegjësia juridikocivile apo administrative për çështjet mjedisore për dëmin e shkaktuar në mjedis. Duhet të shtohet edhe ndotja e tokës si pjesë e veprave penale²⁷⁴.

Zbatimin e politikës së manaxhimit të mbetjeve në përputhje me standardet e BE-së.

Arritjen e Standardeve të BE-së përsa i përket kontrollit të ndotjes industriale.

Miratimi i Ligjit për kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha industriale, i cili duhet të përafrohet me Direktivën Europiane 96/82/EC.

²⁷⁴ Council of Europe, convention of protection of environment through criminal-law, explanatory report 1998

Implementimin me efikasitet të direktivës 2004/35 mbi përgjegjësinë civile për dëmet në mjedis në legjislacionin kombëtar.

7. Ankimimi efektiv në Komitetin e përputhshmëris së Aarhusit dhe GJEDNJ

